

ROLI I BASHKIMIT EVROPIAN PËR ZGJIDHJEN E KONFLIKTEVE NDËRKOMBËTARE NË KUADËR TË POLITIKËS SË JASHTME DHE TË SIGURISË SË PËRBASHKËT

Doktoranti:

JONIDA MEHMETAJ

Dorëzuar:

Universitetit Evropian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Fakultetin Juridik me profil, **E DREJTË NDËRKOMBËTARE**, për marrjen e gradës shkencore “**DOKTOR**”

Udhëheqës shkencor:

Prof. Asoc. Dr. ERJONA BANA (CANAJ)

Numri i fjalëve: 56 521

Tiranë, Mars 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

© E drejta e autorit: Jonida Mehmetaj 2016

Nën përgjegjësinë time personale deklaroj për originalitetin e plotë të këtij punimi, pasqyrimin me korrektësi të referencave, citimeve dhe burimeve sipas standarteve të kërkuara nga Shkolla Doktorale e Universitetit Europian të Tiranës. Shtoj se, punimi nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij.

Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cënues me çfarëdo lloj mjeti apo forme pa lejen përkatëse me shkrim të autorit.

ABSTRAKTI

Bashkimi Evropian synon rritjen e rolit dhe identitetit të tij në arenën ndërkombëtare, për ruajtjen e paqes, zgjidhjes së konflikteve dhe fuqizimit të sigurisë ndërkombëtare, nëpërmjet Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët. Bashkimi Evropian fillimisht nuk ka arritur të luajë një rol të rëndësishëm në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në arenën ndërkombëtare. Traktati i Lisbonës përcaktoi një kornizë të re institucionale dhe ligjore duke rritur koherencën e PJSP-së dhe aftësinë e BE-së për të folur në një “zë të vetëm” në arenën ndërkombëtare. Ky hulumtim ka për qëllim analizën e kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe koherencën e PJSP-së në funksion të zgjidhjes së konflikteve ndërkombëtare dhe rritjes së rolit të Bashkimit Evropian.

Megjithatë kjo politikë mbetet e veçuar nga fushat e tjera të veprimtarisë së BE-së dhe i nënshtrohet një tërësie rregullash të ndryshme institucionale dhe procedurale. PJSP-ja vepron në bazë të bashkëpunimit ndërqeveritar, në këtë kuadër për PJSP-në nuk miratohen akte ligjore por një sërë instrumentash. Nga ana tjetër organet komunitare kanë rol të kufizuar dhe Gjykata e Drejtësisë nuk ka juridiksion mbi dispozitat e kësaj politike. PJSP-ja bën pjesë integrale të saj Politikën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes së Përbashkët, e cila përfaqëson aspektin mbrojtës të BE-së nëpërmjet ndërmarrjes së misionëve civile dhe operacioneve ushtarake. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare si NATO dhe OKB-ja kanë forcuar kapacitetet e BE-së për të qenë një aktor në arenën ndërkombëtare. Bashkimi Evropian është një aktor i rëndësishëm në ndërmjetësimin e konflikteve ndërkombëtare.

Fjalët kyçe: *Politika e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët, Traktatet, koherenca, institucione, Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët, Politika Evropiane e Fqinjësisë, zgjidhje konfliktesh.*

ABSTRACT

The European Union aims to increase its role and identity in the international arena, for peacekeeping, conflict resolution and strengthening international security, through the Foreign Policy and Common Security. The European Union initially failed to play an important role in the field of security and defense in the international arena. The Lisbon Treaty established a new institutional framework and legal increasing the coherence of the CFSP and the EU's ability to speak in a "single voice" in the international arena. This research aim is an analysis of the legal and institutional framework and coherence of the CFSP in the function of settling international disputes and increasing the role of the European Union.

However, this policy remains separate from other areas of EU activity and is subject to a different set of institutional rules and procedures. CFSP shall act on the basis of intergovernmental cooperation in this context for the CFSP-legislative acts adopted but not a set of instruments, the Community bodies have a limited role and the Court of Justice has no jurisdiction over the provisions of this policy. CFSP shall be its integral part Security Policy and the Common Defence, which represents the defense aspect of the EU through the Enterprise civil missions and military operations. Cooperation with international organizations like NATO and the UN have strengthened the capacity of the EU to be an actor in the international arena. The European Union is a player in mediating international disputes.

Key words: *Common Foreign and Security Policy, Treaty, coherence, institutions, and Common Defense and Security Policy, the European Neighbourhood Policy, conflict resolution.*

Dedikuar

***Bashkëshortit tim Ervin dhe
dy vajzave të mia Mei dhe Aria***

FALENDERIME

Përfundimi i këtij projekti iu nënshtrua këshillave, ndihmës, dashamirësisë dhe përkrahjes së një sërë personash, të cilët meritojnë një falenderim mëse të veçantë dhe të singertë. Falenderoj udhëheqësen e këtij studimi, Prof. Asoc. Dr. Erjona Bana (Canaj) e cila nëpërmjet këshillave, sugjerimeve, ndihmës së vazhdueshme, kohës së pakursyer në asnjë rast, më dha forcën për të punuar edhe më me pasion dhe kureshtje se më parë. Kontributi profesional, idetë e vyera, disponueshmëria e pakushtëzuar dhe diskutimi kritik erdhi padyshim nga profesori i nderuar Prof. Dr. Ksenofon Krisafi dhe nga kolegu im Dr. Erjon Hitaj, që këtu gjej mundësinë për t'i falenderuar për zemërsisht. Një falenderim i veçantë shkon edhe për Përgjegjësin e Departamentit të Drejtësisë Dr. Sokol Bana që asnjëherë nuk ka kursyer përkrahjen e tij për këtë projekt.

Por, krahas përkrahjes profesionale qëndron edhe ajo morale dhe për këtë arsye falenderoj familjen time. Gjithçka i detyrohem bashkëshortit tim, Ervinit, i cili besonte tek unë edhe kur dorëzohesha, e falenderoj për mbështetjen emocionale, dashurinë, durimin dhe inkurajimin që më dhuroi përgjatë gjithë kohës në të cilat isha plotësisht e absorbuar në projektin tim. Falenderoj prindërit e mi të shtrenjtë dhe prindërit e bashkëshortit tim për mbështetjen e vazhdueshme dhe dashurinë që më kanë dhuruar. Veçanërisht falenderoj znj. Gjinovefa, nënën e bashkëshortit tim, që është kujdesur gjatë gjithë kohës për gjithçka në mënyrë të pakushtëzuar. Pa dyshim, që falenderoj dy vajzat e mia të mitura dhe ju kërkoj ndjesë që në këtë periudhë nuk isha më shumë pjesë e lojërave të tyre. Duke ju falenderuar, shtoj se ju ishit burimi i frymëzimit tim.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Dedikimi

Mirënjohje

Abstrakti

KREU I. HYRJE DHE BAZA TEORIKE

1.1. Hyrje	15
1.2. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza e punimit	19
1.2.1. Pyetjet hulumtuese të studimit	19
1.2.2. Hipoteza e punimit	21
1.3. Metodologjia dhe metodat e punimit shkencor	22
1.3. Struktura e punimit	25

KREU II. POLITIKA E JASHTME DHE SIGURISË SË PËRBASHKËT NË RRJEDHËN E TRAKTATEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN

2.1. Aspekti konceptual i sigurisë kolektive, zgjidhjes së konflikteve dhe koncepte të tjera të objektit të studimit	30
2.2. Perspektiva historike e Bashkimit Evropian në fushën e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët	37
a) Plani “Pleven”, Komuniteti Evropian i Mbrojtjes dhe Komuniteti Politik Evropian	40
b) Planet “Fouchet”	42

2.2.1. Bashkëpunimi Politik Evropian	44
2.2.2. Pozicioni i Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët në Aktin Unik Evropian	48
2.3. Traktatet që kanë institucionalizuar Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët si një fushë me vete e Bashkimit Evropian	51
2.3.1. Traktati i Maastrichtit, nevoja për të qenë aktor ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes	51
2.3.2. Politika e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët në Traktatin e Amsterdimit, përpjekjet e para për rritjen e efektivitetit të Bashkimit Evropian.....	59
2.3.3. Politika e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët në Traktatin e Nics	67
2.4. Riset e Traktatit të Lisbonës për forcimin e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët	71

KREU III. PARIMET, NORMAT DHE NDARJA E KOMPETENCAVE MIDIS BASHKIMIT EVROPIAN DHE SHTETEVE ANËTARE NË FUSHËN E POLITIKËS SË JASHTME, SIGURISË DHE MBROJTJES

3.1. Kuadri ligjor, normat dhe parimet e veprimit të jashtëm	77
a) <i>E drejta parësore e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët</i>	79
b) <i>E drejta dytësore e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët</i>	82
3.1.1. Normat e detyrueshme të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së	

Përbashkët.....	86
3.1.2. Koherenca, parimi themelor i Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët në rendin ligjor të Bashkimit Evropian	92
a) <i>Kuadri ligjor, koncepti i parimit të koherencës dhe dykuptimësia e zbatimit të këtij parimi në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian</i>	96
3.1.3. Dimensionet e koherencës në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë	102
3.2. Kapaciteti i jashtëm dhe natyra e kompetencave të veçanta të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët	115
3.2.1. Personaliteti juridik si element i rëndësishëm për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare	116
3.2.2. Ndarja e kufijve të kompetencave të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët	121
3.2.3. Natyra e kompetencave. Kompetencat ekskluzive, kompetencat e përbashkëta dhe kompetencat mbështetëse lidhur me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët	124
3.3. Raporti i të drejtës së Bashkimit Evropian me të drejtën ndërkombëtare publike në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Çështja <i>Kadi I</i> , <i>Kadi II</i> dhe <i>Kadi III</i>	131

KREU IV. KUADRI INSTITUCIONAL DHE PROCESI I VENDIMMARRJES NË FUNKSION TË PËRFORCIMIT TË ROLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN NË ARENËN

NDËRKOMBËTARE

4.1.	Institucionet përgjegjëse që përcaktojnë Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët dhe që përforcojnë rolin e Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare	139
4.1.1.	Këshilli Evropian	139
4.1.2.	Këshilli i Ministrave	141
4.2.	Institucionet komunitare që kanë rol të kufizuar në Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët	145
4.2.1.	Komisioni Evropian	145
4.2.2.	Parlamenti Evropian	147
4.3	Gjykata Evropiane e Drejtësisë dhe roli i saj i kufizuar lidhur me Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët	150
4.4.	Aktorët institucionalë që kanë ridimensionuar kapacitetin e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët për të vepruar në arenën ndërkombëtare	154
4.4.1.	Përfaqësuesi i Lartë për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët	154
4.4.2.	Presidenti i Këshillit Evropian	160
4.4.3.	Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian	163
4.5.	Procesi i vendimmarrjes në Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët	165

KREU V. POLITIKAT E BASHKIMIT EVROPIAN PËR ZGJIDHJEN E KONFLIKTEVE NDËRKOMBËTARE

5.1.	Politikat e Bashkimit Evropian për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare	172
------	--	-----

5.2	Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët, krah i “armatosur” i Bashkimit Evropian	173
5.2.1.	Kuptimi dhe formalizimi i Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët	173
5.2.2.	Kuadri ligjor dhe institucional i Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët	179
a)	<i>Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët në dispozitat e Traktatit të Lisbonës. Çështja Lisboa</i>	179
b)	<i>Organet kryesore politike dhe ushtarake të themeluara në bazë të Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët</i>	190
5.2.3.	Misionet civile të Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët	193
5.3.	Politika Evropiane e Fqinjësisë në funksion të zgjidhjes së konflikteve ndërkombëtare	198
5.3.1.	Krijimi i Politikës Evropiane të Fqinjësisë dhe kuptimi i saj	198
5.3.2.	Politika Evropiane e Fqinjësisë, një politikë e qeverisur nëpërmjet instrumenteve ligjore të buta (<i>soft law</i>)	200
5.3.3.	Politika Evropiane e Fqinjësisë dhe zgjidhja e konflikteve: mekanizëm efikas?	204

KREU VI. EFEKTIVITETI I BASHKIMIT EVROPIAN NË ZGJIDHJEN E KONFLIKTEVE NDËRKOMBËTARE

6.1	Bashkëpunimi ndërmjet Bashkimit Evropian dhe NATO-s në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare	207
-----	--	-----

6.2.	Marrëdhënia e ngushtë ndërmjet Bashkimit Evropian dhe OKB-së për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare	212
6.2.1.	Përparësia e Kartës së Kombeve të Bashkuara në rendin juridik të Bashkimit Evropian	214
6.2.2.	Misionet civile dhe ushtarake të Bashkimit Evropian në sistemin e sigurisë kolektive të OKB-së	219
6.3.	Bashkimi Evropian një aktor në ndërmjetësim	223
	a) <i>Aktorët kryesore për ndërmjetësim në Bashkimin Evropian</i>	226
	b) <i>Raste praktike të ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve nga Bashkimin Evropian</i>	230
6.4.	Bashkimi Evropian si aktor efektiv në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare ...	239

KREU VII. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

7.1.	Konkluzione	243
7.2.	Rekomandime	253
	BIBLIOGRAFIA	261

LISTA E SHKURTIMEVE

AEM	-	Agiensia Evropiane e Mbrojtjes	(European Defence Agency)
BE	-	Bashkimi Evropian	(European Union)
BEP	-	Bashkimi Evropian Perëndimor	(Western European Union)
BPE	-	Bashkëpunimi Politik Evropian	(European Political Co-operation)
COREPER	-	Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm	(Committee of Permanent Representatives)
COREU		Korrespondenca Evropiane	European correspondence
GJED		Gjykata Evropiane e Drejtësisë	(European Court of Justice)
GJND	-	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë	(International Court of Justice)
KEM	-	Komuniteti Evropian i Mbrojtjes	(European Defence Community)
KS	-	Këshilli i Sigurimit	(Security Council)
KPS	-	Komiteti Politik dhe i Sigurisë	(Political and Security Committee)
NATO	-	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut	(North Atlantic Treaty Organisation)
OKB	-	Organizata e Kombeve të Bashkuara	(United Nations Organisation)
PEF	-	Politika Evropiane e Fqinjësisë	(European Neighbourhood Policy)
PESM	-	Politika Evropiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes	(European Security and Defence Policy)

PJSP	- Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët	(Common Foreign and Security Policy)
PSMP	- Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët	(Common Security and Defence Policy)
SHVJE	- Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian	(European External Action Service)
TBE	- Traktati i Bashkimit Evropian	(Treaty on European Union)
TFBE	- Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian	(Treaty on the Functioning of the European Union)

KREU I. HYRJE DHE BAZA TEORIKE

1.1. Hyrje

Ky studim analizon rolin e Bashkimit Evropian në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare nëpërmjet politikës së tij kryesore, Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (PJSP). Që nga vitet 90' nën dritën e ndryshimeve të njëpasnjëshme të reformave institucionale, Bashkimi Evropian (BE) ka mundur të krijojë një kornizë ligjore dhe infrastrukturë institucionale në shërbim të nismës së operacioneve të sigurisë dhe operacioneve të mbrojtjes.

Kontributi i Bashkimit Evropian realizohet nëpërmjet krijimit të sistemit të menaxhimit të krizave, të misioneve civile, misioneve ushtarake, sundimit të ligjit, përpjekjeve për ndërtimin e një sistemi demokratik. Bashkimi Evropian bashkëpunon ngushtë me organizatat ndërkombëtare si OKB-ja dhe NATO. Respektimi i parimeve të Kartës së OKB-së, perceptimi i BE-së nga Kombet e Bashkuara si një organizatë e rëndësishme rajonale dhe përdorimi i kapaciteteve të NATO-s nga Bashkimi Evropian në çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë, kanë afirmuar rolin e Bashkimit Evropian si aktor në skenën ndërkombëtare.

Kërcënimi i sigurisë dhe paqes botërore, si konfliktet në Ballkanin Perëndimor, luftërat Arabo-Izraelite, lufta në Vietnam, kriza e naftës, lufta në Afganistan, kriza në Iran etj., kushtëzuan nevojën për marrjen e masave konkrete nga Bashkimi Evropian. Krahas prioriteteve në fushën ekonomike do të merrte jehonë krijimi i projekteve për institucionalizimin e një Politike të Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët dhe inkuadrimin progresiv të një Politike të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët (PSMP).

Ky studim ka për qëllim të zhvillojë një studim shkencor të analizës së dispozitave të veçanta të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, për të theksuar përpjekjet për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare dhe jurisprudencën e paktë lidhur me këtë fushë. Formalizimi i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët nëpërmjet amendimeve të njëpasnjëshme në Traktatet e Bashkimit Evropian është përballur me një sërë sfidash. Korniza juridike e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët për herë të parë është sanksionuar në vitin 1993, në Traktatin e Maastrichtit në një shtyllë më vete. Ky Traktat përcaktoi instrumentat dhe objektivat e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

Ndryshimet e mëvonshme që solli Traktati i Amsterdimit konsistojnë në përvijëzimin e mëtejshëm të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, Politikës Evropiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (më vonë PSMP) dhe në përcaktimin e detyrave të Petersburgut. Traktati i Nicës krijoi një sistem të menaxhimit të krizave dhe procedurën e vendimmarrjes me shumicë të cilësuar. Ndryshimet më të rëndësishme për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian në kuadër të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, erdhën me miratimin e Traktatit të Lisbonës në vitin 2009. Ky Traktat shkriu tre shtyllat e Bashkimit Evropian duke e lënë gjithsesi Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët një shtyllë më vete.

Në fakt, Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët përbënte një politikë të dallueshme dhe të veçantë nga politikat e tjera të Bashkimit Evropian, përse i përket procedurave të vendimmarrjes. Traktati i Lisbonës ruajti ende karakterin e bashkëpunimit ndërqeveritar ndërmjet Shteteve Anëtare duke përfshirë Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët në Traktatin e Bashkimit Evropian (TBE) dhe jo në Traktatin mbi

Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Ndryshimet e Traktatit të Lisbonës në aspektin institucional sollën krijimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian të Punëve të Jashtme dhe Politikave të Sigurimit, Shërbimin e Veprimit të Jashtëm Evropian dhe Presidentin e Këshillit Evropian. Ndër të tjera Traktati i Lisbonës i dha Bashkimit Evropian personalitet juridik ndërkombëtar, rriti bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare, zgjeroi fushat në të cilat votimi bëhej me shumicë të cilësuar dhe shtoi kompetencat e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

Studimi pretendon të paraqesë një analizë konstruktive të elementëve efikasë që kanë rritur rolin e Bashkimit Evropian dhe të identifikojë problemet kryesore institucionale dhe juridike, që lidhen me mungesën e strukturave adekuate për forcimin e kohezionit dhe unitetit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Identifikimi i këtyre problemeve i nënshtrohet analizës së Traktateve të Bashkimit Evropian, në lidhje me mënyrën se si këto traktate kanë rregulluar Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

Sfida kryesore dhe qëllimi i këtij punimi është që nëpërmjet interpretimit të dispozitave dhe koherencës së Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, të shpjegojë rolin që ka Bashkimi Evropian për zgjidhjen jo vetëm të konflikteve rajonale, por edhe të konflikteve më larg tij. Roli i Bashkimit Evropian është rritur ndër vite por nuk ka mundur të konsolidohet krejtësisht pasi Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët mbeti përsëri një “shtyllë” më vete në strukturën evropiane. Karakteri ndërqeveritar ka penguar në një masë të madhe efektivitetin e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian si pasojë e nënshtrimit të vullnetit politik të Shteteve Anëtare.

Studimi përqendrohet në analizën e faktorëve që ndikojnë në përcaktimin e Bashkimit Evropian si aktor ndërkombëtar. Ky studim përpaket të identifikojë disa nga

problemet kryesore që pengojnë rritjen e rolit të BE-së në arenën ndërkombëtare. Identifikimi i këtyre faktorëve na informon mbi natyrën komplekse dhe të fragmentarizuar të Bashkimit Evropian, si dhe na ndihmon të përcaktojmë rrugën dhe mekanizmat për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian, si aktor global në zgjidhjen e konflikteve.

Nevoja për studimin e një teme të tillë ka ardhur edhe për shkak të mungesës së studimeve të thelluara akademike të trajtuara në këtë fushë në vendin tonë. Në literaturën juridike shqiptare nuk ekziston një analizë e mirëfilltë, e drejtpërdrejtë dhe konkrete e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Studiuesit evropian të fushës, që kanë formuar dhe konsoliduar doktrinën për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit Evropian kanë trajtuar aspekte të ndryshme dhe të veçanta të rolit të Bashkimit Evropian në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Si rrjedhojë teoritë për rolin e Bashkimit Evropian janë kategorizuar në dy qëndrime kryesore. Teoritë skeptike i referohen me kritikizëm dhe dyshim rolit të Bashkimit Evropian, në zgjidhjen e konflikteve, ndërsa teoritë e kundërta i bëjnë jehonë përpjekjeve të Bashkimit Evropian për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare.

Një pjesë e studimeve evropiane është përqëndruar vetëm në analizimin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, si dukuri e veçantë. Disa prej studimeve të tjera i referohen analizës së dispozitave të Traktateve të Bashkimit Evropian dhe studime të tjera i referohen fushës së mbrojtjes dhe të sigurisë, disa kompetencave të rralla, etj. Për këtë arsye, sfida më e madhe e këtij punimi është bashkimi i pikëpamjeve dhe krijimi i një qëndrimi të ri, një teorie të re, në kuadrin e këtyre studimeve të ndryshme. Kjo na shërben për të arritur në konkluzionin se, përforcimi i rolit të Bashkimit Evropian, si aktor i vetëm global i dedikohet jo vetëm dispozitave të Traktatit të Lisbonës por edhe parimit të

koherencës në politikën e jashtme dhe të sigurisë. Megjithatë konfirmimi i rolit të Bashkimit Evropian, do të mbetet përsëri i fragmentarizuar, nëse politika e jashtme dhe të sigurisë nuk bëhet pjesë e metodës komunitare.

Konkluzionet e dhëna në fund të analizës do të japin rekomandime nga pikëpamja konceptuale dhe teorike, nëpërmjet identifikimit të mekanizmave, teknikave, procedurave, që mund të përdoren për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian si aktor ndërkombëtar në mënyrë që studimi të kontribuojë në fushën e së drejtës evropiane në vendin tonë.

1.2. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza e punimit

1.2.1. Pyetjet hulumtuese të studimit

Arkitektura e një hulumtimi shkencor kurrë nuk do të ishte e plotë, nëse nuk do të përmbante dy elementë domethënës të tij, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura. Pyetjet hulumtuese kanë rëndësi të veçantë për projektin kërkimor, sepse janë ato të cilat na japin “kahjen e shqyrtimeve” (Mathews dhe Ross, 2010: 57). Projekti do të shqyrtojë një pyetje të përgjithshme, e cila shërben për të strukturuar punimin dhe për të drejtuar nënpyetjet e tjera shoqëruese.

Pyetja e përgjithshme e studimit është: *A mund të konsiderohet Bashkimi Evropian një aktor i rëndësishëm global, i cili ofron zgjidhje efektive, afatshkurtër dhe përfundimtare të konfliktit, nëpërmjet instrumentit të tij PJSP-së?*¹ Në mënyrë që studimi të ndjekë një rrugë të paracaktuar, krahas pyetjes kryesore, në këtë studim janë ngritur dhe nënpyetjet e mëposhtme:

¹ Pyetja e përgjithshme e hulumtimit të këtij disertacioni doctoral është një “pyetje zbuluese”, që synon të kuptojë, zbulojë dhe shqyrtojë rolin e Bashkimit Evropian për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare.

- (i) A është Bashkimi Evropian një aktor i vetëm global në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare?
- (ii) Pse është e vështirë zgjidhja e konflikteve nga Bashkimi Evropian, në një kohë kur kemi një kuadër ligjor dhe infrastrukturë institucionale, që vepron nëpërmjet Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët?
- (iii) A e ka fuqizuar “Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit” koherencën në veprimin e jashtëm?
- (iv) A ka rezultuar Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët një mekanizëm efikas në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare?
- (v) A ka rezultuar i suksesshëm Bashkimi Evropian në misionet civile dhe operacionet ushtarake që ai ka ndërmarrë?
- (vi) Cilat instrumente duhen përdorur nga Bashkimi Evropian për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërkombëtare dhe për të parandaluar konfliktet?
- (vii) Cilat janë arsyet kryesore që pengojnë Bashkimin Evropian të luajë një rol efektiv dhe afatshkurtër në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare?
- (viii) Procesi i vendimmarrjes për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët e ndihmon apo vështirëson rritjen e rolit të Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare?
- (ix) Si mund të tejkalohet fragmentarizimi që vjen nga bashkëpunimi ndërqeveritar për arritjen e konsensusit ndërmjet Shteteve Anëtare në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët dhe Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët?

1.2.2. Hipoteza e studimit

Elementi i dytë i rëndësishëm në arkitekturën e punimit doktoral është hipoteza e studimit, e cila paraqitet në funksion dhe mbështetje të pyetjeve kërkimore.² Ky studim ofron disa hipoteza të rëndësishme që shtrojnë problemin kryesor. Studimi përpiket të tregojë vërtetësinë e këtyre hipotezave në të gjithë paragrafët e tij.

Hipoteza kryesore, e këtij studimi është: *Roli i Bashkimit Evropian si aktor global në zgjidhjen e konflikteve është rritur dukshëm pas Traktatit të Lisbonës, nëpërmjet forcimit të koherencës dhe zgjerimit të kuadrit ligjor dhe institucional të politikave të sigurisë dhe të mbrojtjes (Hipoteza I).*³ Bashkimi Evropian vazhdon të rrisë rolin e tij si aktor efektiv në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare edhe pse Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët ka shfaqur probleme lidhur me efikasitetin dhe konsolidimin e saj në arenën ndërkombëtare. Forcimi i parimit të koherencës në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët në Traktatin e Lisbonës ka mundur të unifikojë politikat e sigurisë, mbrojtjes dhe instrumentet e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian në ndërmarrjen e misionëve civile dhe operacioneve ushtarake për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare.

Karakterizimi i normave të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët si instrumente ligjore të buta “*soft law*” paraqet nevojën e menjëhershme për përfshirjen e

² Në këtë studim hipoteza përfaqëson lidhjen shkakësore midis dy variablave ose vetive, ajo duhet të bëjë një “gjykim fakti” të komunikojë se çfarë është dhe jo “gjykim vlere” se çfarë duhet të jetë.

³ *Variabli i varur* në rastin konkret është “Bashkimi Evropian” dhe roli i tij si një aktor i rëndësishëm global në zgjidhjen e konflikteve. Roli i BE-së është variabël i varur sepse synon të shpjegohet në varësi të variablilit të pavarur. Punimi kërkon të mbrojë hipotezën e ngritur se BE-ja, në sajë të dispozitave të reja të Traktatit të Lisbonës, mund të luajë një rol kryesor në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. *Variabli i pavarur* i hipotezës është “Traktati i Lisbonës”, i cili përbëhet nga dy elementë të rëndësishëm të tij. Elementi i parë i variablilit të pavarur përfshin: *dispozitat* e këtij Traktati, të cilat përforcojnë rolin e BE-së në arenën ndërkombëtare, nëpërmjet PJSP-së. Elementi i dytë i analizës së këtij variabli të pavarur është *koherenca*, rritja e koherencës në PJSP është decizive për të përcaktuar rolin e BE-së, si aktor global. Studimi mbron pikërisht argumentin, se koherenca dhe dispozitat do të jenë ndryshorët që do të shkaktojnë rritjen apo reduktimin e rolit të BE-së, si aktor global në zgjidhjen e konflikteve.

kësaj politike në institucionet komunitare dhe nën juridiksionin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. *Konfirmimi i rolit të Bashkimit Evropian si aktor global në zgjidhjen e konflikteve, do të mbetet i fragmentarizuar për një kohë të gjatë, nëse Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët nuk bëhet pjesë e metodës komunitare (Hipoteza II).* Afirmimi deciziv i rolit të BE-së mund të arrihet vetëm nëpërmjet përfshirjes së PJSP-së dhe PSMP-së në traktatet e ardhshme reformuese në metodën komunitare. *Instrumentat juridike të afirmuara dhe të konsoliduara tashmë në PJSP, nevojiten të bëhen pjesë e metodës komunitare (Hipoteza III).* Ky është një element strukturor shumë i rëndësishëm, që konfirmon mungesën e efikasitetit të plotë dhe unitetit të Bashkimit Evropian, si aktor i fuqishëm në skenën ndërkombëtare. Një aktor, i cili do të ishte gjithmonë i pranishëm, rezultativ dhe i suksesshëm në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare.

1.3. Metodologjia dhe metodat e punimit shkencor

Metodologjia përfaqëson një reflektim korrekt dhe të logjikshëm të analizës shkencore të projektit doktoral. Metodologjia në këtë studim përfaqëson analizën logjike, juridike dhe institucionale të politikës së jashtme dhe të sigurisë.⁴ Metodot paraqesin strategjinë, mjetet dhe teknikat që janë përdorur për ndërtimin e koncepteve të këtij punimi doktoral. Qasja normative aplikohet në qasjen cilësore, për këtë ky studim përdor metodën cilësore që zhvillon analizën normative.⁵ Kjo qasje e përdorur në studim ka si qëllim arritjen e rezultateve objektive, nëpërmjet interpretimit të dispozitave dhe politikave që

⁴ Teza e këtij studimi doktoral mbështetet në analizën normative të metodës epistemologjike. Metodologjia shërben për të studiuar metodat, në thelb ajo ka të bëjë me ontologjinë dhe epistemologjinë e hulumtimit. Një kërkim shkencor në shkencën juridike është i mbështetur në qasjen normative (interpretimin e dispozitave), në atë “se si duhet të jetë” vlera dhe jo “si është” realisht, e kundërta e qasjes pozitiviste.

⁵ Ndërsa, metoda sasiore apo pozitiviste, e cila konsiston në analizën e qasjes epistemologjike pozitiviste, që merret me analizën numerike dhe statistikore përjashtohet në analizën e këtij studimi.

rregullojnë veprimin e jashtëm të Bashkimit Evropian për zgjidhjen e konflikteve. Zgjidhja e konflikteve ndërkombëtare nga BE-ja përbën një analizë objektive të interpretimit, që mbështetet në faktet konkrete, si p.sh, dispozita, vendime, veprime, qëndrime, strategji etj.

Studimi do të përqendrohet në një analizë të thelluar të kalimit nga qasja deduktive në qasjen induktive. Analiza e koncepteve të përgjithshme në lidhje me natyrën juridike të Bashkimit Evropian, zanafillën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët në Traktate, marrëdhënien e Bashkimit Evropian me Kombet e Bashkuara, koherencën e politikës së jashtme, llojet e tjera të politikave për zgjidhjen e konflikteve përbëjnë qasjen deduktive të punimit. Ndërsa, arritja në konkluzionin nëse Bashkimi Evropian ka rol në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare do të përbëjë qasjen induktive.

Projekti përcakton katër metoda kryesore që janë përdorur në studimin e rolit të Bashkimit Evropian si aktor global në zgjidhjen e konflikteve.

Metoda e analizës së literaturës është një nga metodat e para të aplikuara për të zbuluar pozicionin e dukurisë tonë të studimit, që është Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët. Nëpërmjet analizës së literaturës, përmbledhjes së saj dhe studimit të doktrinës, kuptojmë se cilat ishin problemet që zbehin rolin e Bashkimit Evropian, si aktor global. Cilat janë vakumet teorike, rastet e dështimit të Bashkimit Evropian, mangësitë në dispozitat e Traktateve dhe propozimet e akademikëve, juristëve apo profesorëve të së drejtës për miratimin e Traktateve të reja, që forcojnë rolin e Bashkimit Evropian dhe të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët

Metoda e analizës historike: kjo metodë është zhvilluar përgjatë gjithë studimit. Konkretisht është parashikuar në kapitullin e parë, i cili përcakton zanafillën e politikës së jashtme dhe të sigurisë, projektet e para, Traktatet e Bashkimit Evropian, si e kanë

parashikuar dhe sa rëndësi ka marrë në këto traktate politika e jashtme dhe e sigurisë. Metoda historike është përdorur gjithashtu edhe në kapitujt e tjerë, si p.sh, në kapitullin e gjashtë, kur trajtohet Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët dhe Politika Evropiane e Fqinjësisë. Analiza këtu konsiston në ndryshimet që përjetojnë elementë të tillë si kompetencat, institucionet, procedura e vendimmarrjes, politikat etj., në Traktatet e Bashkimit Evropian.

Në kapitullin e tretë dhe të katërt do të trajtohet analiza e politikave të tjera të Bashkimit Evropian, që luajnë rol në zgjidhjen e konflikteve dhe në analizën juridike të koherencës së Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Pra, për të gjitha këto çështje, metoda historike ka shërbyer për të kuptuar, se si kanë qënë të artikuluar dhe çfarë ndryshimesh janë bërë, gjithashtu dhe sa kanë shërbyer këto ndryshime në rritjen e rolit të Bashkimit Evropian, si aktor ndërkombëtar në zgjidhjen e konflikteve.

Metoda e analizës interpretuese, si një nga metodat kryesore të shkencës juridike konsiston në interpretimin e dispozitave të veçanta të Traktateve të Bashkimit Evropian, që lidhen me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Interpretimi i dispozitave të Traktateve, interpretimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe në raste të veçanta të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë zë një vënd të rëndësishëm të studimit.

Secili kapitull analizon dhe interpreton dispozitat e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, të Politikës së Sigurisë dhe të Mbrojtjes së Përbashkët, të Politikës Evropiane të Fqinjësisë, dispozitat e kuadrit institucional, dispozitat e procedurës së vendimmarrjes, dispozitat që parashikojnë lidhjen e ngushtë të Bashkimit Evropian me Kombet e Bashkuara, dispozitat për koherencën etj. Çdo çështje e kapitujve të studimit është e bazuar në metodën interpretuese.

Metoda e analizës krahasuese. Kjo metodë konsiston në krahasimin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët vetëm brenda një subjekti, Bashkimit Evropian. Analiza krahasuese, krahason dispozitat, procedurat, kuadrin ligjor, kuadrin institucional të përcaktuar në Traktatet e Bashkimit Evropian, duke filluar nga Traktati i Mahstrihtit dhe deri në Traktatin e Lisbonës për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët dhe ecurinë e saj.

Krahasimi zhvillohet edhe ndërmjet tre politikave të Bashkimit Evropian, që kontribuojnë në zgjidhjen e konflikteve; krahasimi i Bashkimit Evropian me organizata të tjera për zgjidhjen e konflikteve; krahasimi i rasteve të veçanta të zgjidhjes së konflikteve, etj. Kjo është një metodë e rëndësishme, sepse na ndihmon që të kuptojmë dukuritë e tjera shoqërore dhe evidentimin e dukurisë tonë të studimit përkrah dukurive të tjera.

Metoda e rastit të veçantë, po ashtu është metodë e këtij studimi sepse analizon një element të veçantë, Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit Evropian. Ky është një rast i veçantë studimi, sepse kjo politikë është e veçantë vetëm për Bashkimin Evropian, që ka një natyrë “*sui generis*” dhe e asnjë organizate tjetër ndërkombëtare. Në rastin e studimit tonë, nëse Bashkimi Evropian do të ishte një aktor global për zgjidhjen e konflikteve, do të varej vetëm nga efektiviteti i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

1.4. Struktura e punimit

Punimi doktoral është strukturuar në bazë të një analize konstruktive të ndarë në shtatë krerë kryesore. Secili nga kapitujt ka nëndarjet e veta dhe trajton aspekte të veçanta të punimit të artikuluar në paragrafe dhe nënparagrafe.

Kreu i parë, shqyrton aspektin hyrës dhe bazën metodologjike të studimit. Analiza e këtij kapitulli zhvillohet mbi bazën e një informimi të përgjithshëm, në lidhje me temën e projektit dhe me situatën në të cilën është vendosur objekti i studimit. Pjesa e parë hyrëse analizon qëllimin e përgjithshëm, problematikën që mbart studimi si dhe boshllëkun që ai mbart në mjedisin shqiptar të kërkimit shkencor, ashtu sikurse dhe nevojën për studime të thelluara. Pjesa e dytë e këtij kapitulli zhvillon një analizë të dy elementëve bazë të studimit, pyetjen kërkimore të tij dhe hipotezën mbi bazën e të cilës është ngritur studimi. Themelet e projektit janë mbështetur tek metodologjia dhe llojet e metodave mbi të cilat është bazuar studimi.

Kreu i dytë, përmban një analizë të detajuar të aspektit historik të studimit. Kapitulli ngrihet mbi një analizë konceptuale të çështjeve kryesore që përbëjnë objektin e studimit lidhur me konceptin e sigurisë kolektive, konflikteve ndërkombëtare, mosmarrëveshjeve ndërkombëtare dhe krizave ndërkombëtare. Kapitulli trajton themelet e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, në rrjedhën e traktateve të Bashkimit Evropian. Analiza nis me projektet e para në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Këto projekte janë përballur me sfidat të shumta, shpeshherë me dështime, megjithatë analiza e tyre është e rëndësishme për të përcaktuar “para-historinë” dhe përpjekjet e Bashkimit Evropian për të rritur identitetin e tij në këtë fushë të re për të.

Ideja e zhvillimit të politikës së jashtme dhe të sigurisë, formulohet mbi bazën e projekteve të cilat marrin jetë ligjërish nëpërmjet krijimit të Traktateve dhe dispozitave për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Traktati i parë, i cili i jep jetë kësaj politike është Traktati i Maastrichtit. Ndryshime të rëndësishme janë bërë në Traktatin e

Amsterdami, zhvillimi i PJSP-së ka proceduar më tej në Traktatin e Nicës dhe përfundon tek Traktati i Lisbonës, traktati i fundit i miratuar në Bashkimin Evropian.

Kreu i tretë është një kapitull analitik i cili shqyrton çështje thelbësore të studimit. Në këtë Kre shqyrtohen parimet, normat dhe kompetencat e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Studimi zhvillon analizën e tij nëpërmjet interpretimit të kuadrit ligjor dhe parimeve të PJSP-së duke evidentuar parimin e koherencës si parimi kryesor i kësaj politike. Koherenca zhvillohet në tre dimensionë kryesore që interpretohen në kuadër të jurisprudencës së GJED-së. Çështja tjetër shqyrton normat dhe natyrën detyruese të dispozitave të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Në këtë stad të studimit zhvillohen kapaciteti i jashtëm i Bashkimit Evropian dhe natyra e kompetencave të veçanta të PJSP-së nën jurisprudencën e GJED-së.

Ky seksion specifikon çështjet e rëndësishme që forcojnë rritjen e rolit të BE-së në arenën ndërkombëtare nëpërmjet analizës së personalitetit juridik të BE-së. Kompetencat e Bashkimit Evropian ndahen në tre lloje kryesore, në kompetencat ekskluzive, kompetencat e përbashkëta dhe kompetencat mbështetëse, të gjitha janë analizuar në raport me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Çështja e fundit trajton raportin ndërmjet të drejtës së Bashkimit Evropian me të drejtën ndërkombëtare publike sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë.

Kreu i katërt është vazhdimësi e shtjellimit analitik, ky seksion pasqyron kuadrin institucional të Bashkimit Evropian dhe organet e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Analiza konsiston në detajimin e funksioneve dhe kompetencave që kanë organet kryesore të Bashkimit Evropian, pasi mënyra e organizimit institucional përcakton dhe impaktin e BE-së për të qënë një aktor në arenën ndërkombëtare. Institucionet kryesore

të Bashkimit Evropian trajtohen në përputhje me kompetencat që disponojnë në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Në këtë çështje trajtohen institucionet që kanë rolin kryesor në formësimin e PJSP-së dhe institucionet që kanë rol të kufizuar, vëmendje merr analiza e mungesës së juridiksionit të GJED-së mbi dispozitat e PJSP-së. Krahas institucioneve të Bashkimit Evropian qëndrojnë dhe organet e ngritura për koordinimin e veprimtarisë së Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

Tre institucionet janë ngritur për herë të parë në Traktatin e Lisbonës me qëllim rritjen e efektivitetit dhe koherencës së Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Çështja e fundit që është trajtuar në këtë kapitull ka një rëndësi të veçantë sepse përcakton mënyrën e marrjes së vendimeve. Procesi i vendimmarrjes në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët i nënshtrohet unanimitetit, mekanizmit të abstenimit konstruktiv dhe votimit me shumicë të cilësuar për raste të veçanta.

Kreu i pestë, shqyrton politikat e tjera të Bashkimit Evropian që kontribuojnë në zgjidhjen e konflikteve. Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët, vepron në kuadër të PJSP-së dhe përfaqëson aspektin mbrojtës dhe të sigurisë së Bashkimit Evropian. Nënçështjet e trajtuara në këtë kapitull në kuadër të PSMP-së lidhen me analizën e kuadrit ligjor dhe institucional të PSMP-së në Traktatet e Bashkimit Evropian. Në këtë pjesë trajtohet aspekti praktik i misionëve civile të ndërmarra nga Bashkimi Evropian në kuadër të Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët. Politika e dytë që lidhet me zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare është Politika Evropiane e Fqinjësisë. Kjo politikë nuk ka një ndikim të drejtpërdrejtë në çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes megjithatë elementë të saj lidhen me stabilitetin dhe sigurinë në vëndet fqinje. Analiza e saj është zhvilluar në kuadrin e dispozitave të Traktateve të Bashkimit Evropian.

Kreu i gjashtë, trajton efektivitetin e Bashkimit Evropian në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Analiza ka nisur me trajtimin e marrëdhënies së ngushtë të Bashkimit Evropian me organizata ndërkombëtare si NATO dhe OKB. Në sajë të bashkëpunimit me këto organizata, Bashkimi Evropian ka rritur kapacitetet e tij, për ndërmarrjen e misioneve civile dhe ushtarake, për menaxhimin e krizave dhe ndërmarrjen e misioneve për parandalimin e konflikteve ndërkombëtare.

Në bashkëpunimin me OKB-në shqyrtohet përparësia e Kartës së OKB-së në rendin juridik të BE-së dhe misionet civile dhe operacionet ushtarake të ndërmarra nga BE-ja në kuadër të sistemit të sigurisë kolektive të OKB-së. Një vend të rëndësishëm merr analiza e BE-së si një aktor në ndërmjetësim. Ndërmjetësimi përbën instrumentin kryesor të BE-së për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare, shoqëruar me shembuj dhe raste praktike. Çështja e fundit e këtij kapitulli hedh dritë mbi fakte konkrete që afërmojnë tezën e studimit për efektivitetin e BE-së si aktor në arenën ndërkombëtare.

Kreu i shtatë, zhvillon një analizë të konstatimeve kryesore të studimit doctoral të shprehura në konkluzione dhe në rekomandime modeste individuale. Nëpërmjet raportimit dhe konsultimit të konkluzioneve kryesore, synohet të jepet një kuadër përmbledhës i problematikës, pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të studimit. Në çështjen tjetër të këtij kapitulli propozohen disa rekomandime me qëllim rritjen e rolit të Bashkimit Evropian në zgjidhjen e konflikteve në kuadër të Politikës së Jashme dhe Sigurisë së Përbashkët. Në fund padyshim ka një listë të plotë të referencave mbi të cilat është bazuar ky studim.

KREU II. POLITIKA E JASHTME DHE E SIGURISË SË PËRBASHKËT NË RRJEDHËN E TRAKTATEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN

Evropa nuk do të bëhet e gjitha njëherësh, ose në bazë të një plani të vetëm, por gradualisht. Ajo do ndërtohet nëpërmjet arritjesh konkrete të cilat së pari të krijojnë një solidaritet de facto.

Zhan Mone

2.1. Aspekti konceptual i sigurisë kolektive, zgjidhjes së konflikteve dhe koncepte të tjera të objektit të studimit

Paqja, stabiliteti dhe siguria në arenën ndërkombëtare janë koncepte që synohen të arrihen nga shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, mirëpo disiplinimi i tyre pas cënimit të sferës juridike është i vështirë dhe problematik. Këto koncepte karakterizohen nga një tipar i përbashkët, që është prishja e ekuilibrave normal për ekzistencën e paqes. Zgjidhja e konflikteve ndërkombëtare është një përgjegjësi e të gjitha subjekteve të së drejtës ndërkombëtare, një përgjegjësi e cila kushtëzon krijimin e një infrastrukture të sofistikuar institucionale dhe ligjore, mbi bazën e politikave specifike, efektive dhe afatgjata. Bashkimi Evropian e cilësuar si një organizatë e mbyllur apo *ekskluziviste* (Krisafit, 2015: 265) dhe si subjekt i të drejtës ndërkombëtare mbart përgjegjësinë në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare nëpërmjet garantimit të një mjedisi që ofron siguri, liri dhe prosperitet.

Arena ndërkombëtare është e ngritur mbi bazën e ekuilibrave të forcës në mënyrë, që të kemi një rend ndërkombëtar sa më paqësor dhe të sigurt. Por, *konfliktet gjithmonë do të jenë të pranishme*, sepse sipas Kissinger sistemi i ekuilibrit të forcës nuk pretendon të parandalojë krizat dhe madje as luftërat, ai parashikonte se po të funksiononte, ashtu si

duhet të kufizonte si mundësinë e shteteve për të sunduar të tjerët, ashtu edhe shkallën e konflikteve (1999: 21). Zgjidhja e konflikteve nga Bashkimi Evropian është një proces i vështirë sepse secili nga Shtetet Anëtare është sovran dhe fusha e politikës së jashtme dhe të sigurisë është një çështje delikate. Avokati i Përgjithshëm Jacobs⁶ në opinionin e tij në çështjen *Komisioni kundër Greqisë*⁷ në vitin 1996, ka vënë në dukje se, për shkak të dallimeve gjeografike dhe historike, secili prej Shteteve Anëtare ka problemet e veta specifike dhe shqetësimet në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë.⁸ Sipas tij, siguria është një çështje e perceptimit më shumë sesa një fakt i vështirë.⁹

Për të ndërtuar një analizë konstruktive të studimit, paraqitet e nevojshme një qartësim i koncepteve bazë, të cilat në vetvete përbëjnë edhe thelbin e kërkimit. Koncepte, të cilat duhet të orientohen nga kuptime univoke, të dallueshme qartë nga njëra-tjetra, me qëllim shmangien e konfuzioneve. Nga pikëpamja shkencore, është e nevojshme të bëjmë një analizë për mënyrën, se si këto koncepte trajtohen në të drejtën ndërkombëtare nga organizata të ndryshme dhe veçanërisht nga Bashkimi Evropian, si objekt i studimit tonë.

(i) **Koncepti i sigurisë kolektive** mund të përkufizohet si një marrëveshje ndërmjet shteteve në arenën ndërkombëtare dhe si një marrëveshje ndërmjet Shteteve Anëtare në Bashkimin Evropian, në kuadër të BE si një organizatë rajonale. Koncepti i sigurisë

⁶ Francis Geoffrey Jacobs është një jurist britanik, i cili ka shërbyer si Avokati i Përgjithshëm në Gjykatën e Drejtësisë të Komuniteteve Evropiane nga tetori 1988 deri në janar të vitit 2006.

⁷ Vendimi C-120/94 *Komisioni kundër Greqisë* (Former Yugoslav Republic of Macedonia) [1996] ECR I-1513.

⁸ Vendimi C-120/94 *Komisioni kundër Greqisë* [1996] ECR I-1513, Opinion i Avokatit të Përgjithshëm Jakobs, shih citimin origjinal të paragrafit 54, sipas të cilit: *Because of differences of geography and history each of the Member States has its own specific problems and preoccupations in the field of foreign and security policy.*

⁹ Vendimi C-120/94 *Komisioni kundër Greqisë* (Former Yugoslav Republic of Macedonia) [1996] ECR I-1513, Opinion i Avokatit të Përgjithshëm Jakobs, shih citimin origjinal të paragrafit 54, sipas të cilit: *Security is, moreover, a matter of perception rather than hard fact.*

kolektive nënkupton që Shtetet Anëtare që kanë nënshkruar marrëveshjen ose traktatin, kanë rënë dakord ndërmjet tyre që t'u përmbahen normave dhe rregullave të caktuara për ruajtjen e stabilitetit dhe kur është e nevojshme të mblidhen së bashku për të ndaluar agresionin (Kupchan, Ch. A., dhe Kupchan, C. A., 1995: 53). Siguria kolektive në një kuptim tjetër nuk bën tjetër veçse institucionalizon në mënyrë legjitime përdorimin e forcës. Legjitimiteti ndërkombëtar është një element kyç i misionëve të paqes (Paladini: 2009).

Sistemi i sigurisë kolektive mund të kuptohet si një sistem i institucionalizuar universal apo rajonale, në të cilin shtetet kanë rënë dakord në një traktat, për t'i bërë ballë çdo akt agresioni apo përdorimi tjetër të paligjshëm të forcës nga një shtet anëtar i sistemit (Delbruck, 1992: 646). Ky koncept përbën një sistem të bazuar në një obligim universal të të gjitha kombeve që bashkohen solidarisht kundër një shteti agresor (Johnson dhe Niemeyer, 1954: 20). Teoria e sigurisë kolektive synon të realizojë drejtpërdrejt dhe në mënyrë përfundimtare paqen.

Sistemi i sigurisë kolektive është legjitimuar në një sërë aktesh dhe traktatesh. Shtetet janë pjesë e sistemit të sigurisë kolektive në një sërë organizatash ku më të rëndësishme në rendin ndërkombëtar janë NATO dhe OKB-ja. Sistemi i sigurisë kolektive është sanksionuar në Kartën e Kombeve të Bashkuara, Kartë të cilës i referohet edhe Bashkimi Evropian. Bashkimi Evropian edhe pse një organizatë rajonale ka parashikuar në traktatet e tij sigurinë kolektive ndërmjet Shteteve Anëtare dhe ka legjitimuar këtë koncept dhe në dy politikat e tij PJSP-në dhe PSMP-në.

Një numër shumë i gjerë dispozitash (neni 21, neni 24, neni 42 etj.) në Traktatin e Bashkimit Evropian disiplinojnë sigurinë kolektive të Shteteve Anëtare, kundër një agresori

të mundshëm. Fillimisht siguria kolektive realizohej në kuadrin e Bashkimit Evropian Perëndimor në bashkëpunim me NATO-n dhe më pas nga Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët. PSMP-ja është politika e cila përfaqëson aspektin mbrojtës të Bashkimit Evropian, analiza, interpretimi i PSPM-së dhe i sigurisë kolektive trajtohet në Kreun VI dhe të VII të këtij studimi.

(ii) **Konflikti ndërkombëtar** nuk ka një përkufizim të përcaktuar qartë dhe të vetëm. Autorë të ndryshëm e trajtojnë atë në varësi të teorive të ndryshme që ata trajtojnë. Për t'i dhënë një kuptim nocionit të konflikteve ndërkombëtare në këtë studim, konflikti përkufizohet si, *një situatë, ngjarje a proces i cili kushtëzon prishjen e ekuilibrave ndërmjet subjekteve të së drejtës ndërkombëtare, për një vlerë, e cila konsiderohet shumë e rëndësishme për palët e përfshira në konflikt.*

Në kuptimin klasik të konceptit, konflikti përkufizohet gjerësisht, si një luftë ndërmjet dy ose më shumë palëve mbi vlerat, konkurrenca për statusin, pushtetin apo burimet e pakta (Moore, 1996: 16). Konflikti përbëhet nga tre elementë nga aktorë, veprim, dhe papajtueshmëri. Duke kombinuar të tre elementët me njëri-tjetrin, konflikti përcaktohet, si një situatë sociale, në të cilën minimumi prej dy aktorësh ose palësh, përpiqen të marrin në të njëjtën kohë një kategori burimesh të kufizuara (Wallenstein, 2002: 16). Konflikti shfaqet përmes një procesi interaktiv të bazuar në kërkimin dhe krijimin e kuptimit të përbashkët (Lederach, 1995: 9).

Në Bashkimin Evropian termi konflikt përdoret në disa forma dhe nocione, duke përfshirë në vetvete kategori të tjera të termit. Duke qenë, se zgjidhja e konflikteve përbën një nga qëllimet kryesore të Bashkimit Evropian, vëmendja që i kushtohet zgjidhjes së konflikteve është e madhe. Sipas Blockmans dhe Wessel, ky koncept ka për qëllim të

tregojë çdo situatë kombëtare ose ndërkombëtare, ku ka një kërcënim ose shkelje të vlerave, interesave dhe qëllimeve prioritare (2009). Komisioni Evropian ka dhënë përkufizime të dallueshme qartë, në lidhje me kuptime të ndryshme të situatave konfliktuale, si psh, *zgjidhje konfliktesh*, *menaxhim konfliktesh* dhe *parandalim konfliktesh* (Bayne, 2008: 19).

Me nocionin *parandalimi i konfliktit*, kuptohen veprimet e ndërmarra për një afat të shkurtër me qëllim kryesor parandalimin, uljen dhe përsëritjen e këtyre tensioneve në të ardhmen (Bayne, 2008: 19). Po kështu, është i nevojshëm miratimi dhe zbatimi i masave, që synojnë të pengojnë përshkallëzimin e një mosmarrëveshje jo të dhunshme në një krizë (Blockmans dhe Wessel, 2009). Me *menaxhim konflikti* kuptohen veprimet e ndërmarra me qëllim kryesor menaxhimin në dy dimensione, vertikale dhe horizontale ku *dimensioni vertikal* ka parasysh intensifikimin e dhunës, ndërsa *dimensioni horizontal* shtrirjen territoriale të konfliktit. Me menaxhim konflikti kuptohet ndalimi i përshkallëzimit të konflikteve ekzistuese në konflikte të dhunshme.

Ndërsa me konceptin e tretë të *zgjidhjes së konfliktesh* kuptohet një situatë, ku palët në konflikt hyjnë në një marrëveshje, që zgjidh mospërputhjet e tyre qëndrore, pranimin dhe pushimin e çdo veprimi të dhunshëm ndaj njëri-tjetrit (Wallenstein, 2002: 8). Me këtë koncept kuptohen veprimet e ndërmarra për një afat të shkurtër kohe, me qëllim dhënien fund të një konflikti të dhunshëm (Bayne, 2008: 19). Zgjidhja e konflikteve është përcaktuar nga Komisioni Evropian, si veprimet e ndërmarra gjatë periudhës afatshkurtër për t'i dhënë fund konfliktit të dhunshëm (Duke dhe Ojanen, 2006: 484). Analiza vazhdon edhe më tej duke përcaktuar se i drejtë apo i padrejtë, përfundimi i arritur i procesit të përpjekjeve për marrëveshje është zgjidhja e konfliktit të veçantë (Goldstein, 2003: 195).

(iii) **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare** është pjesë e parimeve kryesore të së drejtës ndërkombëtare publike. Përkufizimin klasik dhe përfundimtar të një mosmarrëveshje e ka dhënë Gjykata e Përhershme Ndërkombëtare e Drejtësisë në rastin *Mavrommatis*¹⁰ të vitit 1924, *Greqia kundër Britanisë së Madhe*. Sipas Gjykatës së Përhershme Ndërkombëtare të Drejtësisë mosmarrëveshja ndërkombëtare është një mosmarrëveshje mbi një çështje të ligjit apo faktit, një konflikt i pikëpamjeve ligjore të interesit midis dy palëve.¹¹

Studiues si Brownlie (2009), Merrills (2005), Hoffmeister (2008), Blockmans dhe Wessel (2011), ndajnë të njëjtën mendim për konceptin e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare të dhënë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë se një mosmarrëveshje lidhet me një çështje specifike ligjore ose politike me pretendimin për një të drejtë, që u është shkelur palëve të përfshira në mosmarrëveshje. Më konkretisht, mosmarrëveshjet kanë të bëjnë me një shkelje të pretenduar të një ose më shumë detyrimeve ligjore (Brownlie, 2009: 267–283). Mosmarrëveshjet ndërkombëtare zgjidhen nga Gjykatat ndërkombëtare, mund të përmendim Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe OKB-ja është organizata që luan një rol të rëndësishëm në këtë aspekt.

(iv) Koncepti **kriza ndërkombëtare** i referohet një tjetër kategorie të dallueshme nga mosmarrëveshjet dhe konfliktet ndërkombëtare. Krizat burojnë nga një shfaqje e papritur, e befasishme e një ngjarje ndërkombëtare, ndërmjet shteteve apo organizatave në rendin ndërkombëtar. Kjo ngjarje e papritur shihet, si kërcënuese dhe duhet të zgjidhet brenda një

¹⁰ Gjykata e Përhershme Ndërkombëtare e Drejtësisë, çështja *Mavrommatis Palestine Concessions (Greece kundër Great Britain)* (Jurisdiction) PCIJ Rep Series A No 2.

¹¹ Çështja *Mavrommatis Palestine Concessions*, shih citimin origjinal të paragrafit 19, sipas të cilit: *A dispute is a disagreement on a point of law or fact, a conflict of legal views or of interests between two persons.*

afati shumë të shkurtër kohe. Elementët kryesorë të një krize janë, papashikueshmëria, kërcënimi që vjen nga kjo situatë dhe koha e shkurtër për marrjen e një vendimi. Dinamika e vendimmarrjes në kohë krize është anormale dhe e jashtëzakonshme.

Krizat përcaktohen, si rrethana të politikës së jashtme, në të cilat përfundimet janë shumë të rëndësishme dhe kufijtë kohorë janë të kufizuar (Goldstein, 2003:177). Përveç elementëve të mësipërm, autorë të ndryshëm theksojnë edhe një element tjetër, që ka të bëjë me mos agravimin e situatës deri në konflikt të armatosur. Ky element jep kuptimin në thelb të një krize, pra kemi një krizë për aq kohë, sa ajo nuk gjeneron në konflikt (dhunë e armatosur).

Por kriza mund të ekzistojë, si një gjendje paralajmëruese për kalimin në konflikt (jo vetë konflikti) ose situatë e papritur, problematike ku shkelen vlera të rëndësishme të një shteti. Kriza mund të përcaktohet gjithashtu, si një gjendje e ndërmjetme ndërmjet dy gjendjeve klasike, paqes dhe luftës. Kriza e brendshme në një shtet në të drejtën ndërkombëtare paralajmëron mosfunksionimin normal të rendit të tij të brendshëm, por që mund të kthehet kërcënuese edhe për rendin ndërkombëtar.

Bashkimi Evropian i ka kushtuar një vëmendje të veçantë menaxhimit të krizave. Studiuesit pranojnë, se fjala krizë është mbi-përdorur, kur është fjala për Bashkimin Evropian (Blockmans dhe Wessel, 2009: 5).¹² Autorë si, Blockmans dhe Wessel, shprehin se fjala krizë në kontekstin ndërkombëtar, është kuptuar gjerësisht si një situatë në të cilën ka të ngjarë, që të përdoret forca e armatosur (2009: 5). Ndërsa, menaxhimi i krizave është koncept tjetër brenda familjes së konceptit kriza ndërkombëtare, por që konkretisht i

¹² Shih gjithashtu: Leonard, (2005: 4).

referohet organizimit, rregullimit, kornizave procedurale, formësimit të rrjedhës së ardhshme të krizës dhe kërkimit të rezolutave për zgjidhjen e saj.

Komisioni Evropian jep një përkufizim disi më të ndryshëm për menaxhimin e krizave. Ai e specifikon, si veprime për parandalimin e shpërthimit apo përshkallëzimin e konflikteve, konsolidimin e paqes dhe stabilitetit të brendshëm në një periudhë tranzicioni¹³ (Bayne, 2008: 19). Koncepti i menaxhimit të krizës përfshin operacionet ushtarake dhe civile të Politikës të Sigurisë dhe të Mbrojtjes së Përbashkët. Pas miratimit të Traktatit të Lisbonës, Politika e Jashtme dhe e Sigurisë të Përbashkët mbetet e vetmja zonë e Traktatit të Bashkimit Evropian, që ka një status të veçantë në legjislacionin dhe në veprimin e jashtëm të Bashkimit Evropian. Krijimi i sistemit të menaxhimit të krizës në Bashkimit Evropian, ka përmirësuar ndjeshëm mundësitë e BE-së për të ndjekur qëllimet e tij në politikën e jashtme (Schroeder, 2010: 15).

Problemet e Bashkimit Evropian në menaxhimin e krizave janë për formulimin e qartë të një strategjie për misionet e menaxhimit të krizave, si pasojë e kombinimit të dy faktorëve: *së pari*, nuk ka vizion afatgjatë për të mbështetur planifikimin operacional dhe *së dyti*, divergjenca ndërmjet interesave të Shteteve të ndryshme Anëtare ka penguar çdo përpjekje për të dalë me një qasje të përbashkët (Hynek, 2010: 6).

2.2. Perspektiva historike e Bashkimit Evropian në fushën e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët

Procesi i zgjidhjes së konflikteve nga BE-ja nuk ka qënë një proces i lehtë dhe i natyrshëm, përkundrazi shumë i vështirë dhe problematik. Shtetet Anëtare nëpërmjet një

¹³ Presidency Conclusions of the European Council of Santa Maria da Feira, 19 and 20 June 2000.

sërë projektsh janë përpjekur të ndërtojnë një qasje të sigurisë dhe mbrojtjes së përbashkët. Shtetet Anëtare në Bashkimin Evropian kanë hartuar një sërë planesh, projektsh, raportesh, analizash dhe traktatesh me qëllim implementimin e një politike të jashtme dhe të sigurisë.

Këto projekte janë përballur me vështirësitë e kohës, dallimet kulturore, politike, juridike, institucionale dhe frikës së delegimit të kompetencave, si rrezik ndaj sovranitetit dhe krizës së identitetit. Gjithsesi, asnjëherë fusha e jashtme dhe e sigurisë nuk do të mbetej jashtë vëmendjes së intelektualëve evropianë. Politika e jashtme dhe e sigurisë dhe zhvillimi i politikës së mbrojtjes, siç është vënë në dukje edhe nga Hill, *është çelësi për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian në botë* (1993: 318). Me qëllim luajtjen e një roli më aktiv në çështjet globale, BE-ja ka zhvilluar një Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (PJSP) dhe një Politikë të Sigurisë dhe të Mbrojtjes së Përbashkët (PSMP).

Ideja për një bashkim të shteteve evropiane lindi në një periudhë kritike, në kohën e prishjes së *sistemit të ekuilibrave*¹⁴ evropianë pas Luftës së Dytë Botërore. Qëllimi ishte vendosja e bashkëpunimit ndërmjet shteteve evropiane dhe krijimit të një Evrope të sigurtë dhe paqësore. Shtetet Anëtare mbajtën një pozicion kritik përsa i përket delegimit të kompetencave në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë. Shtetet Anëtare ishin shumë të ndjeshëm ndaj humbjes së sovranitetit kombëtar dhe përfshirjes së tij në metodën komunitare (Leskoviku, 2010: 150). Kufizimi i sovranitetit të Shteteve Anëtare nëpërmjet delegimit të kompetencave në Komunitetin Evropian, për atë periudhë kohe perceptohej si katalizator i kërcënimit të identitetit të kombeve.

¹⁴ Për informacion të zgjeruar mbi “ekuilibrin e forcave”, shih: Bull, (2010); Oppenheim, (1912); Kissenger, (1999).

Asnjë nga kombet nuk mund të cedonte nga kompetencat e veta sovrane, për këtë arsye më i mundshëm sipas Monnet ishte një bashkim ekonomik, vendosja e bazave ekonomike dhe më pas afirmimi i bashkëpunimit dhe në fushat e tjera,¹⁵ si në ato politike dhe sociale (Monnet, 1976: 350). Bashkëpunimi në fushën ekonomike rezultoi i suksesshëm dhe më pas gradualisht u mendua edhe për një bashkëpunim politik dhe në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes së përbashkët. Shumë studiues kanë përdorur si pikënisje të analizës së tyre për krijimin e një Politike të Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (PJSP), Bashkëpunimit Politik Evropian (BPE) të viteve 1970.¹⁶

Sipas autoreve Federica Bindi (2010:1) dhe Eva Gross (2009: 11)¹⁷ krijimi i Bashkëpunimit Politik Evropian në vitin 1970, ishte një shenjë paralajmëruese e krijimit të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Ndërkohë, që në aspektin e doktrinës së shkencës juridike krijimi i politikës së jashtme dhe të sigurisë i referohet viteve 1990, me miratimin e Traktatit të Maastrichtit.¹⁸ Ky Traktat solli afirmimin dhe konkretizimin ligjor dhe institucional të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

Pjesa më e madhe e strukturës, që kanë përshkruar projektet e para, kanë formuar bazën e Bashkëpunimit Politik Evropian, duke përbërë një pjesë të rëndësishme të parahistorisë në politikën e jashtme evropiane. Bashkëpunimi Politik Evropian është projekti i

¹⁵ Mbi projektet e ndryshme, që pasqyrojnë procedimin në mënyrë graduale të zhvillimit të Bashkimit Evropian, shih: Jacque, (2010).

¹⁶ Shih: Dehousse, (1998); Duquette, (2001); Jorgense, (2004); Bickerton, (2007); Gross, (2009); Bindi, (2010) etj.

¹⁷ Autorja Eva Gross në veprën e saj të vitit 2009 me titull *The Europeanization of National Foreign Policy, Continuity and Change in European Crisis Management* shprehet se dhënia e një zëri Bashkimit Evropian në arenën e jashtme ka qënë shqetësimi kryesor i Shteteve Anëtare që në krijimin e Bashkëpunimit Politik Evropian, pararendësi i PJSP-së.

¹⁸ Një numër autorësh që kanë formuar doktrinën për të drejtën e PJSP-së në Bashkimin Evropian, më shpesh si pikënisje përdorin Traktatin e Maastrichtit, shih: Wessel, (2008-2015); Cremona, (2006-2011); Koutrakos, (2011); Kaczorowska, (2011); Blanke dhe Mangiameli, (2013) etj.

parë më i strukturuar dhe më afër ndërtimit të një politike të jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, por Bashkëpunimi Politik Evropian nuk përmbante asnjë bazë ligjore. Për të konkretizuar përpjekjet e Bashkimit Evropian me qëllim forcimin e rolit të tij në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes analizojmë disa nga projektet e para. Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet se këto projekte nuk ishin të legjitimuara dhe për këtë nuk mund të zhvillojmë një analizë të mirfilltë juridike. Megjithatë analiza e këtyre projekteve na shërben për të kuptuar rolin e Bashkimit Evropian dhe për të përcaktuar parametrat e zhvillimeve të mëvonshme.

a) Plani “Pleven”, Komuniteti Evropian i Mbrojtjes dhe Komuniteti Politik Evropian

Një nga projektet e para në drejtim të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët e ka zanafillën në vitin 1951 në Paris, me propozimin e Planit Pleven.¹⁹ Ky Plan kishte si qëllim krijimin e një ushtrie të përbashkët evropiane, e cila funksiononte nën drejtimin e një Ministrie Evropiane të Mbrojtjes.²⁰ Arsyeja e krijimit të një plani të tillë ishte një përgjigje ndaj përkeqësimit të situatës ndërkombëtare²¹ (Trachtenberg, 1999: 110).

Projektuesi i këtij plani Rene Pleven në Deklaratën e tij,²² propozoi krijimin e një ushtrie evropiane që përfshinte ushtrinë gjermane edhe pse realisht me tone diskriminuese (Duke, 2000:21). Kështu, u propozua krijimi i një ushtrie të fortë evropiane, që nuk

¹⁹ Statement by René Pleven on the establishment of a European army 24 October 1950.

²⁰ Rene Pleven ishte Kryetari i Këshillit Francez të Ministrave dhe ish-Ministri i Mbrojtjes Kombëtare, ai i propozoi Asamblesë Nacionale të Francës krijimin e një ushtrie evropiane, në mënyrë që të shmangej riarmatimi gjerman, siç kërkohej nga Shtetet e Bashkuara.

²¹ Kjo, si pasojë e testimit sovjetik të bombës atomike në shtator të vitit 1949, fitores së forcave komuniste në Luftën Civile kineze në tetor 1949, shpërthimit të Luftës së Koresë në qershor 1950, si dhe rimëkëmbjes së ushtrisë gjermane përkrah forcave të tjera evropiane. Si dhe një përgjigje ndaj sugjerimit të SHBA-së në lidhje me krijimin e një strukture të integruar operationale brenda sferës së Atlantikut, aleancë brenda të cilës ushtria gjermane mund të merrte pjesë nëpërmjet kontrollit të drejtpërdrejtë amerikan.

²² Statement by René Pleven on the establishment of a European army 24 October 1950.

anashkalonte lidhjen e ngushtë me NATO-n, mbështetjen dhe ndihmën për zbatimin e programit të Atlantikut. Plani Pleven u kritikua gjerësisht, si shumë diskriminues²³ dhe i rrezikshëm²⁴ (Lipgens 1984: 651). Gjithashtu, një plan i tillë mund të krijonte ndarje ndërmjet shteteve evropiane, si pasojë e pakënaqësisë së Britanisë së Madhe dhe SHBA-së. Britania e Madhe ishte kundërshtarja më e fortë dhe konsekuente ndaj çdo ndërhyrje të BE-së në fushën e mbrojtjes (Armstrong, Lloyd dhe Redmond, 2009: 275).

Pas dy vjet diskutimesh Plani Pleven u miratua në një formë të re dhe të ndryshuar. Kështu, në vitin 1952, u mbledhën disa nga shtetet evropiane dhe nënshkruan Komunitetin Evropian të Mbrojtjes,²⁵ një komunitet i cili synonte bashkëpunimin e shteteve evropiane në fushën e mbrojtjes. Ky Komunitet ishte një vazhdimësi e Planit Pleven, por në të njëjtën kohë shumë i ndryshëm nga projekti fillestar.²⁶ Disa muaj pas miratimit (por jo ratifikimit) të Komunitetit Evropian të Mbrojtjes në vitin 1953 u miratua Komuniteti Politik Evropian²⁷ (Cardozo, 1987).²⁸ Komuniteti Politik Evropian përbëhej nga parlamenti me dy dhoma, nga një Këshill Ekzekutiv Evropian, nga Presidenti dhe nga Këshilli i Ministrave (Parson, 2003). KPE-ja kishte Gjykatën e vet dhe një Këshill Ekonomik e Social (Lindner dhe Rittberger, 2003: 445-473).

Komunitetit Evropian i Mbrojtjes ishte në proces ratifikimi dhe ky traktat arrin të ratifikohet nga Gjermania dhe vendet e Beneluksit, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu

²³ Shih gjithashtu: Rittberger, (2006: 1213).

²⁴ Albert Wehrer report on the Pleven Plan, 30 October 1950, Luxembourg.

²⁵ European Defence Community Treaty, 27 May 1952, Paris.

²⁶ Schuman e kishte bërë të qartë këtë ambicie madhore të parakohshme kur deklaroi, që Franca do të propozonte në kohën e duhur, krijimin e një organizate politike evropiane, e cila do të formonte një politikë të jashtme të përbashkët.

²⁷ Draft Treaty embodying the Statute of the European Community, Adopted by the *Ad Hoc* Assembly in Strasbourg, European Political Community Treaty, 10 March 1953.

²⁸ Shih gjithashtu: Griffiths, (2000: 56), Milo, (2002: 35).

(Fritsch, 1991: 148). Traktati dështoi në fazën e ratifikimit pikërisht nga Franca, shteti nismëtar i këtij plani. Asambleja Kombëtare Franceze më 30 gusht të vitit 1954, me shumicë votash e hodhi poshtë traktatin mbi KEM (Trachtenberg, 1999: 112). Si pasojë e dështimit të Komunitetit Evropian të Mbrojtjes, dështoi edhe Komuniteti Politik Evropian (Canaj dhe Bana, 2014: 15).

b) Planet “Fouchet”

Kolapsi i Komunitetit Evropian të Mbrojtjes kufizoi mundësinë e krijimit të një politike të jashtme dhe të sigurisë në përpjekjet e mëvonshme të udhëhequra nga dy planet Fouchet në vitin 1961²⁹ dhe në vitin 1962.³⁰ Në atë kohë (në vitet 1960-1962), Komuniteti Ekonomik Evropian përbëhej nga gjashtë Shtete Anëtare si, Italia, Franca, Gjermania, Holanda, Belgjika dhe Luksemburgu, ndërkohë që Britania ende nuk ishte anëtare e saj. Nga ana tjetër në Francë, në pushtet kishte ardhur Gjenerali de Gaulle, i cili ishte kundër përfshirjes dhe anëtarësimit të Britanikëve në Komunitet (Giauque, 2002: 126).

De Gaulle, propozoi krijimin e një politike të përbashkët,³¹ të një Komiteti Politik ose Sekretariati të Përhershëm, që u kundërshtua me tone të ashpra nga Shtetet Anëtare të Komunitetit, në krye të të cilave ishte Holanda (Ludlow, 1999: 231). Kjo erdhi për arsye, se një Komitet i tillë, i dominuar nga Franca apo Gjermania, mund të minonte realisht

²⁹ Draft Treaty, *Fouchet Plan I*, 2 November 1961. Selection of texts concerning institutional matters of the Community from 1950 to 1982. Luxembourg: European Parliament, Committee on Institutional Affairs, 1982.

³⁰ Draft Treaty, *Fouchet Plan II*, 18 January 1962. Selection of texts concerning institutional matters of the Community from 1950 to 1982. Luxembourg: European Parliament, Committee on Institutional Affairs, 1982.

³¹ De Gaulle, këmbëngulte në krijimin e një force, e cila përjashtonte Britaninë. Ai insistonte në një koordinim të plotë dhe të fortë ndërmjet Shteteve Anëtare në fushën e politikës së jashtme, duke synuar krijimin e një Evrope që të ishte një forcë e tretë në marrëdhëniet ndërkombëtare, e pavarur nga superfuqitë ekzistuese.

Komunitetet ekzistuese, mund të dëmtonte procedurat të cilat u kishin kushtuar aq shumë përpjekje për t'i vendosur dhe të cilat ishin ende disi të brishta (Smith, 2004: 67).³² Gjithashtu, ekzistonte bindja se një propozim i tillë mund të cënonte solidaritetin atlantik.

Planet Fouchet, ishin propozime të shtetit francez për krijimin e një politike të përbashkët të jashtme dhe të mbrojtjes, në bazë të bashkëpunimit ndërqeveritar, jashtë kornizës ekzistuese të Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe të Çelikut, dhe Komunitetit Ekonomik Evropian (Keukeleire, 2010: 51). Planet Fouchet, përqendroheshin në idenë e një Këshilli të ri të krerëve të shteteve ose qeverive me kompetenca për të harmonizuar, koordinuar dhe unifikuar politikat e jashtme të mbrojtjes (Allen dhe Wallace, 1982: 78).

Plani i parë Fouchet u hartua nga ambasadori francez Christian Fouchet.³³ Ky plan u paraqit më 2 nëntor të vitit 1961, me qëllim krijimin e një politike të jashtme, që të mbronte vlerat e qytetërimit evropian (Hill dhe Smith, 2000: 47). Plani i dytë Fouchet i sugjeruar përsëri nga Franca, erdhi si pasojë e shqetësimeve të Shteteve Anëtare dhe Francës në lidhje me efektet e dëmshme të supranacionalitetit, marrëdhënieve me NATO-n dhe me Mbretërinë e Bashkuar.³⁴ Plani u kundërshtua në mënyrë të ashpër nga Belgjika dhe Holanda (Hill dhe Smith, 2000: 47).

Qëndrimi i Francës ndaj NATO-s dhe Britanisë, krijoi tension ndërmjet Francës dhe vendeve të tjera anëtare, duke e bërë bashkëpunimin evropian në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes praktikisht të pamundur (Keukeleire, 2010: 53). Përpjekjet e mëparshme për të koordinuar politika dhe për të implementuar politikat e jashtme dhe të sigurisë, në rastet

³² Gjermania, mbështeste propozimin e De Gaulle, pasi përpara propozimit presidenti francez kishte kërkuar mbështetjen e kancelarit gjerman Konrad Adenauer.

³³ Draft Treaty, *Fouchet Plan I*, 2 November 1961

³⁴ Draft Treaty, *Fouchet Plan II*, 18 January 1962.

konkrete si Plani Pleven, Komuniteti Evropian i Mbrojtjes, Komuniteti Politik Evropian, Planet Fouchet, kishin dështuar për shkak të mosmarrëveshjeve themelore rreth mjeteve (Teasdale dhe Bainbridge, 2012: 462).

2.2.1. Bashkëpunimi Politik Evropian

Në vitin 1970, Shtetet Anëtare ndiheshin nën presion nga komuniteti ndërkombëtar për t'u angazhuar më tej në çështjet ndërkombëtare. Shtetet e Bashkuara të Amerikës këmbëngulnin se Evropa tashmë duhet të kontribuonte më shumë në shpenzimet e NATO-s dhe garantimin e sigurisë (Bozo, 1997: 60). Me qëllim nisjen e një projekti për zgjerimin dhe zhvillimin e Komunitetit në çështjen e bashkimit politik, në Hagë arrihet një marrëveshje e re.³⁵

Konferenca Qeveritare në Hagë në dhjetor të vitit 1969, nëpërmjet Deklaratës së Samitit të Hagës, shënoi momentin kulminant të lindjes së Bashkëpunimit Politik Evropian (BPE). Qëllimi i përgjithshëm i Bashkëpunimi Politik Evropian ishte të maksimizonte ndikimin e Shteteve Anëtare në skenën ndërkombëtar (Duquette, 2001: 172). Bashkëpunimi Politik Evropian synonte krijimin e një politike evropiane të jashtme të përbashkët,³⁶ nëpërmjet një sistemi unik të ndërsjellë informacioni, konsultimi dhe koordinimi ndërmjet Shteteve Anëtare.³⁷

Bashkëpunimi Politik Evropian është shumë ndryshe nga projekti i Komunitetit Politik Evropian, që dështoi dhe këto dy projekte nuk duhet të ngatërrohen me njëra-tjetrën.

³⁵ Communiqué of the Conference of the Heads of State and Government of the Member States of the European Community, *The Hague Summit Declaration*, The Hague, 2 December 1969.

³⁶ *The Hague Summit Declaration*, The Hague, 2 December 1969, paragrafi 15.

³⁷ Introduction to European Political Cooperation (1988). Press and Information Office, Federal Republic of German. Fifth Edition.

Bashkëpunimi Politik Evropian mund të perceptohet, si sinonim i politikës së jashtme. Për ndërtimin përfundimtar të tij u hartuan një sërë raportesh, dy raportet e para forcuan mekanizmat ndërqeveritar të konsultimit. Këto mekanizma nuk arritën të aplikoheshin dhe realisht rezultuan joformale.

Bashkëpunimi Politik Evropian ndryshoi dhe u forcua dukshëm në Aneksin e Raportit të Kopenhagenit të quajtur, Rezultatet e fituara nga “Bashkëpunimi Politik Evropian për Politikën e Jashtme”.³⁸ Deri në Aktin Unik Evropian të vitit 1986, BPE-ja nuk kishte asnjë bazë juridike në Traktate³⁹ (Hill dhe Smith, 2000: 98). Në të vërtetë, BPE ishte përtej fushëveprimit të traktateve të Komunitetit dhe, për këtë arsye, jashtë juridiksionit të institucioneve të Komunitetit (Duquette, 2001: 172).

Falë trashëgimisë së mëparshme, e cila dështoi në shumë projekte, Bashkëpunimi Politik Evropian u prit me skepticizëm dhe pasiguri. Në këtë mënyrë, jo vetëm fusha e veprimit të Bashkëpunimit Politik Evropian ishte e papërcaktuar mirë, duke sjellë më shumë konflikt sesa bashkëpunim, por gjithashtu mekanizmat e tij për të nxitur një bashkëpunim të tillë ishin të dobëta dhe të veçanta. Një qëndrim i tillë konfirmohet edhe nga Smith, nëpërmjet argumentit se, Bashkëpunimi Politik Evropian nuk ishte e bazuar në një traktat, as në ndonjë makineri të përhershme organizative, rregullat e tij ishin shumë të paqarta dhe instrumentat e veprimit kolektiv të pakta (2004: 18).

Raporti Davignon ose raporti i Luksemburgut i vitit 1970, Raporti i Kopenhagenit i vitit 1973 dhe Raporti i Londrës i vitit 1981 hodhën bazat dhe themeluan Bashkëpunimin

³⁸ Second Report of the Foreign Ministers to the Heads of State and Government of the Member States of the European Community, *The Copenhagen Report*, 23 July 1973, Copenhagen.

³⁹ Final communiqué of the meeting of heads of Government of the Community, *The Paris Summit*, 9 and 10 December 1974. Paris Bulletin of the European Communities. December 1974, No 12. Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities.

Politik Evropian. Le të shohim këtu shkurtimisht tre raportet kryesore lidhur me Bashkëpunimin Politik Evropian.

Raporti Davignon ose i Luksemburgut, u miratua nga ministrat e jashtëm në 27 tetor të vitit 1970 në Luksemburg. Në vitin 1970, Etien Davignon, drejtor politik i Ministrisë së Jashtme të Belgjikës u ngarkuar të studionte hapat e ardhshëm potencialë në rrugën e integritimit Evropian.⁴⁰ Sipas autorit Wessel (1999: 5) ky raport ishte baza e Bashkëpunimit Politik Evropian, ndërsa sipas Bindit (2010: 19) ky raport institucionalizoi parimin e konsultimit në të gjitha çështjet e mëdha të politikës së jashtme. Argumentet e këtyre autorëve konfirmojnë rëndësinë e këtij raporti lidhur me hartimin e politikës së jashtme evropiane.

Ky raport mbeti në kuadrin e diskutimeve rreth problemeve të politikës së jashtme dhe të sigurisë ndërmjet Shteteve Anëtare në Komunitetet Evropiane. Diskutimet kryesore në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë të zhvilluara deri në Raportin e Luksemburgut ishin shumë të dobishme. Kjo për sa i përket mënyrës dhe tendencës për të përcaktuar problemet e përbashkëta kolektive dhe mekanizmat institucionale për të trajtuar këto probleme (Smith, 2004: 65). Ky problem mund të shmangej nëpërmjet informacionit të rregullt dhe konsultimit, promovimit të një harmonizimi të pikëpamjeve, koordinimit të pozicioneve dhe arritjen e një qasje të përbashkët në raste të veçanta (Wessels, 1982: 2).

Pra, këtu realisht bëhej fjalë për një koordinim dhe jo për një bashkim. Autorët Allen dhe Wallace, gjithashtu në këtë kuptim vërejnë, se Bashkëpunimi Politik Evropian, që në fazat e hershme të zhvillimit nuk përmendi në asnjë rast politikën e përbashkët. Ata

⁴⁰ First Report of the Foreign Ministers to the Heads of State and Government of the Member States of the European Community, *The Davignon or Luxembourg Report*, 27 October 1970, Luxembourg.

vunë në dukje se nuk kishte asnjë plan, por vetëm udhëzime jobindëse për aktivitet të përbashkët (Allen dhe Wallace, 1982: 21).

Raporti i Kopenhagenit u miratua më 23 korrik të vitit 1973, me qëllim përforcimin dhe specifikimin e mëtejshëm të çështjeve të politikës së jashtme.⁴¹ Ky model i thjeshtë do të ishte baza e çdo veprimtarie, që pasoi për politikën e jashtme dhe të sigurisë deri në Traktatin e Maastrichtit (Hill dhe Smith, 2000: 75). Ky raport ishte një procedurë e re në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe një kontribut original evropian për teknikën e arritur në një veprim të përbashkët të Shteteve Anëtare.⁴²

Qëllimet e Raportit të Luksemburgut dhe Raportit të Kopenhagenit ishin që të siguronin një kuptim më të mirë të ndërsjellë të problemit të madh të politikave të jashtme ndërkombëtare. Sipas raportit, qeveritë konsultoheshin me njëra-tjetrën në të gjitha çështjet e rëndësishme të politikës së jashtme dhe punonin për prioritetet e jashtme të Bashkimit Evropian. Shtetet Anëtare duhet të respektonin kritere që kishin të bënin me qëllimin e konsultimit, i cili ishte përcaktimi i problemeve praktike të politikës së përbashkët (Hill dhe Smith, 2000: 75).

Çdo Shtet Anëtar merrte përsipër si një rregull të përgjithshëm, mosmbajtjen e një qëndrimi përfundimtar pa konsultimin paraprak me partnerët e tij evropianë, në kuadër të makinerisë së bashkëpunimit politik.⁴³ Detyrimi i konsultimit më vonë do të përfaqësonte një nga parimet kryesore të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët në Traktatet e Bashkimit Evropian dhe gjithashtu edhe në Traktatin e Lisbonës.

⁴¹ Second Report of the Foreign Ministers to the Heads of State and Government of the Member States of the European Community, *The Copenhagen Report*, 23 July 1973, Copenhagen.

⁴² *The Hague Summit Declaration*, The Hague, 2 December 1969.

⁴³ Second Report of the Foreign Ministers to the Heads of State and Government of the Member States of the European Community, *The Copenhagen Report*, 23 July 1973, Copenhagen.

Raporti i Londrës i miratuar në vitin 1981,⁴⁴ synoi thellimin e procedurave të nevojshme për Bashkëpunimin Politik Evropian, për t'iu përgjigjur efektivisht situatave të papritura ndërkombëtare. Raporti i Londrës ishte produkt i shqetësimeve britanike mbi situatën problematike ndërkombëtare si, ajo e pushtimit sovjetik të Afganistanit në dhjetor të vitit 1979 dhe të krizës së pengjeve iraniane (Hill dhe Smith, 2000: 114). Kështu u propozua vendosja e një mekanizmi për konsultimin e krizës, ku çdo tre nga ministrat e jashtëm mund të thërriste një takim urgjent të të gjithë grupit brenda 48 orëve, për të diskutuar mbi çështjet politike në aspektin e sigurisë.

Deklarata e Stuttgart-it e quajtur ndryshe Deklarata Solemne e Bashkimit Evropian, u mbajt më 19 qershor të vitit 1983.⁴⁵ Kjo Deklaratë zgjeroi fushën e veprimit të BPE dhe përfshiu aspektet politike dhe ekonomike të sigurisë. Në Deklaratën e Stuttgart-it u shpreh nevoja për veprim të përbashkët të Shteteve Anëtare në lidhje me problemet ndërkombëtare të rendit dhe të ligjit,⁴⁶ si dhe u parashikuan dispozita për politikën e jashtme dhe të sigurisë, të cilat më vonë u vendosën në Aktin Unik Evropian. Këto dispozita të propozuara u konsideruan baza ligjore e çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes në Aktin Unik Evropian.

2.2.2. Pozicioni i Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët në Aktin Unik

Evropian

Akti Unik Evropian (AUE) përfaqëson rishikimin e parë të Traktateve Themeluese të Komuniteteve Evropiane.⁴⁷ Akti Unik Evropian kishte si qëllim që brenda dhjetorit të

⁴⁴ Report Issued by the Foreign Ministers of the Ten on European Political Co-operation *The London Report*, 13 October 1981, London.

⁴⁵ Solemn Declaration on European Union by the European Council, *The Stuttgart Declaration*, 19 June 1983, Stuttgart.

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Akti Unik Evropian 17 shkurt 1986, 1987 O.J. (L 169) 1, 25 I.L.M. 506.

vitit 1992 të realizonte tregun unik, një hapësirë pa kufij të brendshëm në të cilën është siguruar lëvizja e lirë e mallrave, e personave, e shërbimeve dhe e kapitaleve (Canaj dhe Bana, 2014: 34). Në këtë akt ligjor u ndërthur metoda komunitare me bashkëpunimin ndërqeveritar (Lloyd dhe Bajwa, 1997: 3). Aktit Unik Evropian nuk ishte dizenuar të bënte ndryshime në politikën e jashtme, ishte e pashmangshme përfshirja e kësaj politike në Aktin Unik Evropian (Nutall, 2000: 17). Pavarësisht se rëndësia e miratimit të një akti të tillë qëndronte në fushën ekonomike, Akti Unik Evropian përfshiu tre fusha kryesore veprimi: reformën e institucioneve të Komunitetit, zgjerimin e fushave të veprimit dhe koordinimin e politikave të jashtme (Canaj dhe Bana, 2014: 34).

Aktin Unik Evropian ishte akti, i cili formalizoi Bashkëpunimin Politik Evropian (Chalmers, Davies dhe Monti, 2010: 20). Akti Unik Evropian parashikoi në nenin 30 bashkëpunimin evropian në fushën e politikës së jashtme. Më 14 shkurt të vitit 1984, Parlamenti Evropian, miratoi një projekt-traktat,⁴⁸ i cili i bënte thirrje një bashkimi të ri evropian.⁴⁹ Një bashkim, të cilit do t'i jepej personalitet juridik ndërkombëtar⁵⁰ dhe një koordinim më të madh të Bashkëpunimit Politik Evropian në marrëdhëniet e jashtme (Bindi, 2010: 24).

Aktin Unik Evropian që në dispozitën e parë të tij legjitimoi Bashkëpunimin Politik Evropian dhe të gjitha raportet që formulonin bashkëpunimin,⁵¹ duke hapur rrugën për

⁴⁸ Draft Treaty establishing the European Union, *Spinelli Draft*, 14 February 1984.

⁴⁹ Bulletin of the European Communities. Office for Official Publications of the European Communities, February 1984, No. 2. Luxembourg, fq. 8-26.

⁵⁰ Spinelli Draft, 14 February 1984, shih citimin origjinal të draft-traktatit sipas të cilit: *The Union shall have legal personality... In international relations, the Union shall enjoy the legal capacity it requires to perform its functions and attain its objectives.*

⁵¹ Neni 1, AUE: “Bashkëpunimi politik rregullohet nga Titulli III. Dispozitat e këtij titulli miratojnë dhe plotësojnë procedurat, për të cilat është rënë dakord në raportet e Luksemburgut (1970), Kopenhagenit (1973),

zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet shteteve në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë.⁵² Megjithatë, Akti Unik Evropian vetëm sa lidhi formalisht Bashkëpunimin Politik Evropian me strukturat Komunitare, sidoqoftë pa dhënë ndonjë kompetencë legislative institucioneve të Komunitetit (Elsuwege, 2010: 991). Në pjesën e tretë dhe përkatësisht në nenin 30, përcaktoheshin qëllimet për vënien në jetë të një politike të jashtme evropiane dhe bashkëpunimin ndërqeveritar.

Shtetet Anëtare kishin përgjegjësinë të formulonin dhe zbatonin një politikë të jashtme evropiane dhe të konsultoheshin me njëri-tjetrin për marrjen e këtyre vendimeve.⁵³ Në këtë dispozitë përcaktoheshin dy elementë kryesorë, konsultimi⁵⁴ dhe veprimi⁵⁵ apo zbatimi i një politike të përbashkët. Akti Unik Evropian nuk e shndërronte në një obligim të detyrueshëm veprimin e përbashkët në fushën e jashtme, pasi çdo shtet ishte sovran në veprimin e tij të jashtëm.

Akti Unik Evropian parashikonte një bashkëpunim të afërt ndërmjet Shteteve Anëtare, duke vepruar brenda tij si një forcë kohezive (Duquette, 2001: 172). Shtetet Anëtare merrnin në konsideratë mendimet e Parlamentit Evropian me qëllim mbajtjen e pozicioneve të përbashkëta në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë.⁵⁶ Për rastet në

Londrës (1981), Deklaratës Soleme të Bashkimit Evropian (1983), si dhe praktikave të krijuara gradualisht ndërmjet Shteteve Anëtare”.

⁵² Neni 30/1, AUE: “Palët e Larta Kontraktuese, në cilësinë e anëtarëve të Komuniteteve Evropiane, bëjnë përpjekje të përbashkëta për formulimin dhe zbatimin e politikës së jashtme evropiane”.

⁵³ Akti Unik Evropian 17 shkurt 1986, 1987 O.J. (L 169) 1, 25 I.L.M. 506.

⁵⁴ Neni 30/2, (a) AUE: “Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër informimin dhe këshillimin e njëra-tjetrës në lidhje me çështje të politikës së jashtme me interes të përgjithshëm, për të siguruar ushtrimin sa më të efektshëm të mundur të ndikimit të tyre të kombinuar nëpërmjet bashkërendimit, konvergencës së qëndrimeve të tyre si edhe zbatimit të veprimeve të përbashkëta”.

⁵⁵ Neni 30/2, (d) AUE: “Palët e Larta Kontraktuese bëjnë përpjekje për shmangien e çdo veprimi apo qëndrimi që dëmton efektivitetin e tyre, si një forcë lidhëse në marrëdhëniet ndërkombëtare apo brenda organizatave ndërkombëtare”.

⁵⁶ Neni 30/4, AUE: “Palët e Larta Kontraktuese sigurojnë që Parlamenti Evropian të ketë lidhje të ngushta me Bashkëpunimin Politik Evropian. Për këtë qëllim, Presidenca informon rregullisht Parlamentin Evropian në

të cilat qëllimet e një Shteti Anëtar përputheshin me pozicionin e përgjithshëm të Shteteve të tjera Anëtare. Në këtë kontekst duhet theksuar gjithashtu, se pjesa e III-të e Aktin Unik Evropian nuk ishte subjekt i shqyrtimit gjyqësor nga GJED-ja, duke mos sjellë transferimin e asnjë kompetence ligjore për institucionet e Komunitetit (Kaczorowska, 2011: 17). Kjo në përputhje me karakterin ndërqeveritar të bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare.

Zgjerimi i Aktin Unik Evropian në çështjet e sigurisë favorizon objektin e studimit për rritjen e rolit dhe identitetit të BE-së,⁵⁷ por në të vërtetë në këtë periudhë Bashkimi Evropian nuk mundi të tregonte se ishte një aktor. Ky bashkëpunim në politikën e jashtme u zgjerua në fushën e sigurisë por jo në atë të mbrojtjes (Canaj dhe Bana, 2014: 35).

2.3. Traktatet që kanë institucionalizuar Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së

Përbashkët si një fushë me vete e Bashkimit Evropian

2.3.1. Traktati i Maastrichtit, nevoja për të qenë aktor ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes

Traktati i Maastrichtit⁵⁸ që zyrtarisht njihet si Traktati i Bashkimit Evropian është traktati i parë që themeloi PJSP-në⁵⁹ dhe specifikoi për herë të parë objektivat e politikës së jashtme (Bargiacchi, 2015: 39). Ndryshimet, që solli ky Traktat ishin domethënëse dhe

lidhje me çështjet e politikës së jashtme që po shqyrtohen në kuadrin e bashkëpunimit politik dhe siguron që pikëpamjet e Parlamentit Evropian të merren në konsideratë në mënyrën e duhur”.

⁵⁷ Neni 30/4, AUE: Palët e Larta Kontraktuese çmojnë që një bashkëpunim më i ngushtë për çështjet e sigurisë evropiane do të përbënte një kontribut thelbësor në zhvillimin e identitetit evropian në çështjet e politikës së jashtme. Ato janë të gatshme të bashkërendojnë më ngushtësisht qëndrimet e tyre në lidhje me aspektet politike dhe ekonomike të sigurisë.

⁵⁸ Traktati i Maastrichtit, TBE ose Traktati i Bashkimit Evropian, 7 shkurt 1992. Traktati i Maastrichtit, u nënshkrua më 7 shkurt të vitit 1992 dhe hyri në fuqi më 1 nëntor të vitit 1993.; Union Treaty or Maastricht Treaty. Treaty on European Union, Feb. 7, 1992, 1992 O.J. (C 191) 1, 31 I.L.M. 253.

⁵⁹ Neni J, TBE, Traktati i Maastrichtit, shih citimin origjinal të nenit J sipas të cilit: *A common foreign and security policy is hereby established which shall be governed by the following provisions.*

shumë të rëndësishme në drejtim të institucionalizimit të një Politike të Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Traktati i Maastrichtit sanksionoi një arkitekturë institucionale unike të kompozuar mbi bazën e tre shtyllave kryesore (Canaj dhe Bana, 2014: 37). Këto shtylla përfshinin tre fusha të veçanta të politikave të Bashkimit Evropian, me dallime të rëndësishme në aspektin e metodës komunitare dhe metodës ndërqeveritare.⁶⁰

Në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes Traktati i Maastrichtit përcaktoi një kuadër institucional dhe ligjor që i qëndroi amendimeve të Traktateve të mëvonshme duke mos ndryshuar thelbin e përcaktuar në këtë traktat. Krahas ndryshime të tjera të rëndësishme⁶¹ në të gjitha fushat,⁶² në aspektin e çështjeve të sigurisë vëmendja u përqëndrua në zbatimin e një politike të jashtme dhe të sigurisë së përbashkët, me predispozitën për të bërë pjesë të kësaj politike edhe mbrojtjen e përbashkët.⁶³ Nëpërmjet nenit B, Traktati theksonte që në hyrje të tij, ndryshimin thelbësor që do të përjetonte Bashkimi Evropian në drejtim të politikës së jashtme dhe të sigurisë (Hill dhe Smith, 2000: 47).

Formalizimi i PJSP-së kishte si qëllim rritjen e rolit dhe identitetit të Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare, dhe nëpërmjet PJSP-së, Bashkimi Evropian do të rriste kapacitetet për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Në këtë kuadër BEP-ja u reformua në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët në një nga tre shtyllat e Bashkimit

⁶⁰ Union Treaty or Maastricht Treaty. Treaty on European Union, Feb. 7, 1992.

⁶¹ Në pjesën e I, neni A, të Dispozitave të përbashkëta të Traktatit të Maastrichtit parashikohej se “nga ky Traktat, Palët e Larta Kontraktuese krijojnë ndërmjet tyre Bashkimin Evropian i quajtur ndryshe Bashkimi (Unioni)”.

⁶² Neni B, TBE, Traktati i Maastrichtit: “Bashkimi Evropian duhet të ndjekë këto objektiva: (a) Të promovojë një progres ekonomik dhe social të ekuilibruar, duke krijuar një hapësirë pa kufij të brendshëm, përf forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe social dhe monetar që do të sjellë përdorimin e një monedhe të vetme; (b) Të përforcijë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të qytetarëve të Shteteve Anëtare me krijimin e shtetësisë së Bashkimit Evropian; (c) Të zhvillohet një bashkëpunim i ngushtë në sektorin e drejtësisë dhe të punëve të brendshme...”.

⁶³ Neni B, TBE, Traktati i Maastrichtit, shih dispozitën B, sipas të cilës: *To assert its identity on the international scene, in particular through the implementation of a common foreign and security policy including the eventual framing of a common defence policy, which might in time lead to a common defence.*

Evropian, përkatësisht në shtyllën e dytë. Në asnjë nga projektet e mëparshme të përmendura më sipër, politika e jashtme dhe e sigurisë nuk merr këto përmasa që mori në këtë Traktat (Jacque, 2010:14).

Ndarja e shtyllave ishte e përcaktuar në këtë mënyrë: (i) *në shtyllën e parë* përfshiheshin Traktatet themeluese të Komuniteteve Evropiane që vepronin në bazë të metodës komunitare⁶⁴ (Canaj dhe Bana, 2014: 37). Në metodën komunitare institucionet, si Këshilli i Ministrave, Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian dhe Gjykata e Drejtësisë luajnë një rol të rëndësishëm. Komisioni zotëron të drejtën e iniciativës ligjvënëse, Parlamenti luan rol aktiv, Këshilli miraton aktet, ndërsa Gjykata Evropiane e Drejtësisë interpreton dhe garanton zbatimin e të drejtës së Bashkimit Evropian.

(ii) *Shtylla e dytë* përfshinte tërësinë e dispozitave, që rregullonin Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Bashkëpunimi në shtyllën e dytë karakterizohet nga e ashtuquajtura metoda ndërqeveritare,⁶⁵ një logjikë veprimi e kundërt me metodën komunitare, përse i përket institucioneve dhe procedurës vendimmarrëse. Metoda ndërqeveritare i referohet bashkëpunimit midis qeverive të Shteteve Anëtare në Bashkimin Evropian, në bazë të ruajtjes së sovranitetit shtetëror.

Shtetet Anëtare dhe Këshilli luanin rol të rëndësishëm, ndërsa institucionet e tjera si Komisioni, Parlamenti dhe Gjykata luanin rol më pak të rëndësishëm. Në rastin e Komisionit e drejta e tij për iniciativën legjislative ndahej me Shtetet Anëtare, Parlamenti luante rol këshillues, ndërsa Gjykata nuk kishte asnjë funksion. Fuqia e vendimmarrjes

⁶⁴ Metoda komunitare nënkupton mënyrën institucionale të veprimit, bazuar në parimin e subsidiaritetit.

⁶⁵ Shtetet Anëtare u ndanë në dy grupe përse i përket legjitimitit të bashkëpunimit ndërmjet tyre: Shtetet në favor të një qasje ndërqeveritare ishin: Franca, Britania e Madhe, Danimarka, Portugalia dhe Irlanda; Ndërsa shtetet që kërkonin përfshirjen e PJSP-së në metodën komunitare ishin: Belgjikë, Holandë, Luksemburg, Greqi, Spanja, Italia dhe Gjermania. Metoda ndërqeveritare triumfoi, kjo si pasojë e mosdelegimit të kompetencave në PJSP.

(Canaj dhe Bana, 2014: 37) në metodën ndërqeveritare në Traktatin e Maastrichtit, i takon Shteteve Anëtare si subjekte sovraane, nëpërmjet një regjimi, që ndjek procedura unanime vendimmarrjeje.⁶⁶ Sipas një pakice të doktrinës, rregullat ndërqeveritare përkufizohen si një proces ligjor që çon në vendime të detyrueshme vetëm me miratimin e palëve ose qeverive (Georgopoulos, 2007: 201).

PJSP-ja është pjesë e Bashkimit Evropian dhe si politikë e saj,⁶⁷ në këtë mënyrë politika e jashtme dhe e sigurisë duhet të veprojë brenda kuadrit të Bashkimit Evropian. Por, meqenëse Shtetet Anëtare nuk ishin të gatshme të delegonin kompetenca dhe sovranitetet në Bashkimin Evropian për çështje të rëndësishme të politikës së jashtme, zgjidhja ishte përdorimi i metodës ndërqeveritare, e cila vepronte mbi bazën e të drejtës ndërkombëtare publike. Shtete Anëtare mund të bashkëpunonin ndërmjet tyre duke përdorur një kuadër ligjor të bazuar në të drejtën ndërkombëtare publike, që nuk kërcënonte pushtetet e tyre sovraane (Denza, 2002: 5).

(iii) *Shtylla e tretë* përfshinte Bashkëpunimin Gjyqësor dhe Policor në Fushën Penale. Gjithashtu, edhe kjo shtyllë ishte pjesë e metodës ndërqeveritare me një proces vendimmarrjeje unanime.

Traktati i Maastrichtit pati një rëndësi të madhe për implementimin e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët, sepse për herë të parë u vunë në dispozicion të institucioneve të Bashkimit Evropian, një grupnormash juridike ose aktesh ligjore. Këto

⁶⁶ Bazat që u hodhën në Traktatin e Maastrichtit për PJSP-në në aspektin e bashkëpunimit ndërmjet shteteve janë të njëjta, ndryshimet janë bërë vetëm në aspektin e objektivave, instrumenteve dhe rolit të institucioneve.

⁶⁷ Themelimi zyrtar i PJSP-së në Bashkimin Evropian në vitin 1993, përfshinte trajtimin e çështjeve ndërkombëtare të nivelit të lartë, çështjet me karakter politik ose diplomatik, dhe çështjet e sigurisë ose ato ushtarake.

instrumente ligjore ishin, pozicionet e përbashkëta (*common position*)⁶⁸ dhe veprimet e përbashkëta (*joint action*)⁶⁹ (Elsuwege, 2010: 991). Pozicionet e përbashkëta dhe veprimet e përbashkëta përbënin bazën kryesore të akteve juridike të vendosura në dispozicion të politikës së jashtme dhe të sigurisë.

Në Traktatin e Maastrichtit u miratuan një sërë objektivash, që përfshinin konfliktin, forcimin e sigurisë ndërkombëtare, nxitjen e bashkëpunimit rajonal, luftën kundër krimit ndërkombëtar, promovimin e demokracisë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut (neni J. 1/2, TBE).⁷⁰ Qëllimi kryesor ishte dhënia e kontributit për garantimin e sigurisë ndërkombëtare, zgjidhjen e konflikteve ndërmjet subjekteve të së drejtës ndërkombëtare.⁷¹ Në këtë periudhë, Bashkimi Evropian ishte kritikuar vazhdimisht si një forcë e dobët, që nuk mund të vepronte në mënyrë të ngjashme me një superfuqi konvencionale për zgjidhjen e konflikteve.⁷²

Në këtë drejtim Bashkimi Evropian duhet të merrte patjetër masa për rritjen e rolit dhe identitetit të tij (Buchan 1993: 4). Një konstatim tjetër i rëndësishëm në kuadër të shqyrtimit të PJSP-së në këtë traktat, ishte bashkimi apo shkrirja e Bashkimit Evropian

⁶⁸ Neni J.2/2, TBE, Traktati i Maastrichtit.

⁶⁹ Neni J.3, TBE, Traktati i Maastrichtit.

⁷⁰ Traktati i Maastrichtit, shih citimin origjinal të nenit J.2, sipas të cilit: *The objectives of the common foreign and security policy shall be: - to safeguard the common values, fundamental interests and independence of the Union; - to strengthen the security of the Union and its Member States in all ways; - to preserve peace and strengthen international security, in accordance with the principles of the United Nations Charter as well as the principles of the Helsinki Final Act and the objectives of the Paris Charter; to promote international cooperation; Treaty on European Union Title V - to develop and consolidate democracy and the rule of law, and respect for human rights and fundamental freedoms.*

⁷¹ Vëmendja e hartuesve të traktateve drejt PJSP-së dhe zgjidhjes së konflikteve, u ndikua edhe për shkak të kërkesave të vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara dhe shteteve të tjera, për ndërhyrjen e BE-së në arenën ndërkombëtare. Në këtë periudhë kohe arena ndërkombëtare dhe kryesisht Evropa në pjesën Qendrore dhe Lindore u përball me ndryshime të rëndësishme, përmbysja e regjimeve komuniste, ndryshimi i kufijve territorial, ndryshime në sistemin politik dhe juridik, rënien e murit të Berlinit, kolapsin e Bashkimit Sovjetik, Jugosllavisë, mbarimin e Luftës së Ftohtë etj.

⁷² Këto ngjarje vunë në provë inefficencën dhe brishtësinë e Bashkëpunimit Politik Evropian për të vepruar në emër të Bashkimit Evropian dhe për të zgjidhur konfliktet ndërkombëtare.

Perëndimor (BEP)⁷³ me Bashkimin Evropian në Traktatin e Maastrichtit.⁷⁴ Organizata e Traktatit të Brukselit e vitit 1948, nëpërmjet miratimit të Traktatit të Brukselit të vitit 1948, krijoi Bashkimin Evropian Perëndimor.⁷⁵ Bashkimin Evropian Perëndimor ushtronte objektivat e tij në përputhje me NATO-n, bashkëpunim i cili do të transferohej edhe me përfshirjen e Bashkimin Evropian Perëndimor në Bashkimi Evropian.⁷⁶

Shtetet Anëtare të saj ranë dakord ndërmjet tyre për rritjen e fuqisë në nivele maksimale në kuadër të NATO-s.⁷⁷ Bashkëpunimi Evropian Perëndimor formonte një pjesë integrale në procesin e mbrojtjes së Bashkimit Evropian dhe rriste kontributin e tij brenda NATO-s.⁷⁸ Nga ana tjetër, Shtetet e Bashkuara dhe shtetet e tjera pro-NATO-s ishin shumë të shqetësuar në lidhje me këtë mundësi dhe e shikonin si një pengesë për NATO-n dhe sigurinë perëndimore (Hill dhe Smith, 2000: 152).

Për pjesën më të madhe të doktrinës por gjithashtu edhe për shtetet kjo risi e Traktatit të Maastrichtit u shoqërua me një skepticizëm të natyrshëm drejtuar zhvillimeve empirike të vendimmarrjes në tre drejtime: strukturave burokratike, përgjegjësisë thelbësore

⁷³ Bashkimi Evropian Perëndimor ishte një organizatë e formuar gjatë Luftës së Ftohtë, e krijuar nga shtatë vende Evropiane, të cilat ishin aleate me USA. Bashkimi Evropian Perëndimor ishte një organizatë ushtarake, detyrat dhe institucionet e së cilës pas përfundimit të Luftës së Ftohtë u bënë pjesë e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Bashkimit Evropian. Ky ishte një proces, i cili nisi në Traktatin e Maastrichtit më 1993 dhe përfundoi në Traktatin e Lisbonës në vitin 2009, nëpërmjet futjes në fuqi të një klauzole solidariteti ndërmjet Shteteve Anëtare të BE-së. Bashkimi Evropian Perëndimor është shpërbërë zyrtarisht më 30 qershor të 2011, duke pushuar së ekzistuari.

⁷⁴ Declaration No. 30. Declaration on Western European Union. Final Act. Maastricht Treaty, TEU or Union Treaty, Treaty on European Union, 7 February 1992. fq. 242-246.

⁷⁵ Protocol Modifying and Completing the Brussels Treaty (Western European Union), 23 October 1954, Paris.

⁷⁶ *Petersberg Declaration*, Western European Union. Council of Ministers, 19 June 1992, Bonn. Shih citimin original të Deklaratës në kuadër të bashkëpunimit me NATO-n: *WEU will form an integral part of the process of the development of the European Union and will enhance its contribution to solidarity within the Atlantic Alliance.*

⁷⁷ Protocol Modifying and Completing the Brussels Treaty (Western European Union), 23 October 1954, Paris.

⁷⁸ Declaration No. 30. Declaration on Western European Union. Final Act. Maastricht Treaty, TEU or Union Treaty, Treaty on European Union, 7 February 1992.

politike dhe fuqisë vendimmarrëse të institucioneve (Tonra dhe Christiansen, 2004: 17). Gjithsesi skepticizmi u shua sepse u bë e qartë që Bashkimi Evropian Perëndimor veptoi si një urë lidhëse me NATO-n (Bindi, 2010: 27) dhe nuk synonte ta konkurronte atë.

Politika e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët bëri pjesë të saj të gjitha çështjet që lidheshin me sigurinë e Bashkimit Evropian, duke përfshirë inkuadrim eventual të një politike të përbashkët të mbrojtjes, që me kalimin e kohës realizoi një mbrojtje të përbashkët.⁷⁹ Përfundimisht u lejua të trajtohej mbrojtja, çështje që deri në atë kohë ishte konsideruar “*tabu*” (Vooren dhe Wessel, 2014: 400).

Bashkimi Evropian Perëndimor kishte përgjegjësinë të vinte në jetë aksionet e Bashkimit Evropian, që kishin implikime në fushën e mbrojtjes. Bashkimi Evropian Perëndimor bëhej kështu krah i armatosur i Bashkimit Evropian (Milo, 2002: 179). Që në vitet e para të futjes në fuqi të Traktatit të Maastrichtit, u evidentuan vështirësi në implementimin e PJSP-së. Bashkimi Evropian nuk mundi të vërtetonte rolin e tij si një aktor global në arenën ndërkombëtare edhe pas sanksionimit të një Politike të Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

Në Traktatin e Maastrichtit u evidentuan probleme në zhvillimin e një politike të jashtme koherente dhe efektive të BE-së. Në vijim radhiten një sërë problemesh për formulimin dhe zbatimin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (Bretherton dhe Vogler, 2002: 172). U identifikuan probleme lidhur me koordinimin e pamjaftueshëm ndërmjet çështjeve të politikave të tjera me politikën e jashtme dhe të sigurisë së Bashkimit Evropian. Ashtu siç e përmendëm edhe më sipër, jo të gjitha vendet e Evropës ishin të gatshme t’ia nënshtronin çështjet e tyre delikate të mbrojtjes dhe të sigurisë, Bashkimit

⁷⁹ Neni J.4/1, TBE, Traktati i Maastrichtit.

Evropian (Devuyst, 2003: 134). Në këtë politikë u konstatuan nivele të ulëta të angazhimit të Shteteve Anëtare dhe tensione ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Komisionit Evropian.

Në kuadër të mbrojtjes së tezës së studimit tonë, *Bashkimi Evropian nuk mundi të identifikohet si një aktor ndërkombëtar për zgjidhjen e konflikteve*. BE-ja dështoi edhe pse miratoi një politikë të jashtme dhe të sigurisë, pasi pesë vjet nga miratimi i Traktatit të Maastrichtit, PJSP-ja rezultoi zhgënjyese (Schirm, 1996: 3).⁸⁰ Roli i Bashkimit Evropian si aktor ndërkombëtar në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë nuk u forcua dhe rasti i Jugosllavisë tregoi se aktivitetet për zgjidhjen vendimtare të konflikteve nuk u arritën nga PJSP-ja (Schirm, 1996: 3).

Një sërë konfliktesh u përshkallëzuan në luftë të armatosur në disa vende të Ballkanit Perëndimor duke nxjerrë në pah problemet proceduriale të politika e jashtme dhe sigurisë. BE-ja nuk zotëroi kapacitetet e duhura për të ndërmarrë operacione ushtarake ose misionet civile për zgjidhjen e konflikteve. Si pasojë e ekzistencës së konflikteve në ish-vendet komuniste, doktrina i referohet me kritikizëm rolit të BE-së pikërisht në vitet e para të krijimit të një politike të jashtme dhe të sigurisë, për këtë shpeshherë përdoret shprehja “mësimi u mësua” (*lessons learned*).

Mungesa e unitetit ndërmjet Shteteve Anëtare demostroi pafuqinë e BE-së për të zgjidhur konfliktet dhe për të afirmuar rolin e tij në arenën ndërkombëtare. Në vijim kjo mungesë uniteti u evidentua në pamundësinë për të arritur një marrëveshje paqeje në Beograd. Në mosnjohjen e pavarësisë së Maqedonisë për shkak të mosmarrëveshjes për emrin me Greqinë, konflikti në Bosnjë, konflikti në Kroaci i cili nuk arriti të zgjidhej edhe pas njohjes së njëanshme të pavarësisë nga Gjermania. Të gjitha këto raste janë argumente

⁸⁰ Një punim i Qendrës për Studime Evropiane në Universitetin e Harvardit nga autori Stefan A. Schirm.

për dështimin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët dhe rolit të Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare.

Zgjidhja e konflikteve në Ballkanin Perëndimor nuk u mundësua nga Bashkimi Evropian, i cili vetëm sa dha asistencë dhe ndihmë në kuadër të OKB-së, NATO-s dhe SHBA-së, aktorët kryesore që kontribuan në zgjidhjen e konflikteve dhe vendosjen e paqes. Megjithatë ndryshime të rëndësishme erdhën më vonë me qëllim forcimin e rolit të Bashkimit Evropian si aktor ndërkombëtar. Mendohet se një nga arsyet kryesore që pengon forcimin e rolit të BE është mungesa e unifikimit të Shteteve Anëtare si pasojë e bashkëpunimit ndërqeveritar.

2.3.2. Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët në Traktatin e Amsterdamt, përpjekjet e para për rritjen e efektivitetit të Bashkimit Evropian

Në dispozitat kalimtare të Traktatit të Maastrichtit në vitin 1993 ishte parashikuar, që pas pesë vitesh do të zhvillohej një Konferencë Ndërqeveritare, e cila do të shikonte ecurinë e objektivave të vendosura në Traktat.⁸¹ Ishte e nevojshme ngritja e strukturave të reja ose zgjerimi i strukturave institucionale dhe ligjore ekzistence, për forcimin e rolit të Bashkimit Evropian, pas dobësive që u evidentuan në periudhën pas miratimit të PJSP-së në Traktatin e Maastrichtit.⁸² (Bindi, 2009: 34).

⁸¹ Ky rishikim i Traktatit ishte parashikuar në nenin N, të Traktatit të Maastrichtit, i cili theksonte se: “në vitin 1996, do të mbledhet një Konferencë e përfaqësuesve të qeverive të Shteteve Anëtare, për të shqyrtuar ato dispozita të Traktatit për të cilat rishikimi është siguruar në përputhje me objektivat e përcaktuara në nenet A dhe B”.

⁸² Ministri spanjoll i çështjeve evropiane, Karlos Westendorp udhëhoqi një grup pune për vendosjen e objektivave kryesore për rishikimin e Traktatit të Maastrichtit.; Conclusions of the Presidency, *Madrid European Council*, 15 and 16 December 1995.; Shih, objektiva e vendosura në Këshillin Evropian të Madritit, të cilat kishin si qëllim kryesor: të bënin Evropën më të rëndësishme në sytë e qytetarëve të saj; të bënin

Konferenca Ndërqeveritare⁸³ mundësoi miratimin e Traktatit të Amsterdimit,⁸⁴ megjithëse në aspektin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët nuk arriti të sillte kohezion dhe unitet të plotë. Mungesa e këtij kohezioni në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes erdhi për shkak të dështimit të negociatave ndërmjet Shteteve Anëtare në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë (Canaj dhe Bana, 2014: 43). Megjithatë, Traktati i Amsterdimit solli një sërë ndryshimesh institucionale dhe ligjore për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët ishte e rregulluar në Titullin V të Traktatit të Amsterdimit dhe përkatësisht nga neni J.1 deri në nenin J.18. Formulimi dhe implementimi i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët zuri një vend të rëndësishëm në dispozitat e këtij traktati. Në këtë kontekst Shtetet Anëtare duhet të mbështesin politikën e jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian pa rezerva, në frymën e besnikërisë dhe solidaritetit të ndërsjellë, si dhe të punonin sëbashku për të rritur dhe zhvilluar në mënyrë të ndërsjellë solidaritetin politik.⁸⁵

Ndër të tjera u përcaktuan disa parime kryesore lidhur me ruajtjen e paqes, forcimin e sigurisë, ruajtja e vlerave të përbashkëta dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e sigurisë (Canaj dhe Bana, 2014: 43). Gjithashtu, Shtetet Anëtare duhet t'i përmbaheshin çdo veprimi që është në kundërshtim me interesat e Bashkimit Evropian ose që mund të

vendimmarrjen e Bashkimit Evropian më shumë efikase; dhe që BE-ja të sigurojë përgjegjësi dhe kapacitet më të madh në çështjet e politikës së jashtme.

⁸³ Konferenca Ndërqeveritare, që filloi në vitin 1996 bëri të mundur miratimin e Traktatit të Amsterdimit. Ky Traktat u nënshkrua më 2 tetor të vitit 1997 dhe hyri në fuqi më 1 maj të vitit 1999.

⁸⁴ Treaty of Amsterdam Amending the Treaty on European Union, the Treaties Establishing the European Communities and Certain Related Acts, Oct. 2, 1997, 1997 O.J. (C 340) 1, 37 I.L.M. 56.

⁸⁵ Neni J.1/2, Traktati i Amsterdimit, shih citimin origjinal të nenit J.1/2, sipas të cilit: *The Member States shall support the Union's external and security policy actively and unreservedly in a spirit of loyalty and mutual solidarity. The Member States shall work together to enhance and develop their mutual political solidarity.*

dëmtojnë efektivitetin e tij si një forcë kohezive në marrëdhëniet ndërkombëtare.⁸⁶ Këto argumente të disiplinuar në dispozitat e Traktatit të Amsterdimit u transferuan edhe në traktatet e mëvonshme nëpërmjet vendosjes së theksit tek mbështetja që Shtetet Anëtare duhet të japin në çdo rast për BE-së dhe njëra-tjetrën në fushën e PJSP-së.

Rëndësia parësore e Traktatit të Amsterdimit në kuadër të shqyrtimit të objektit të këtij studimi konsiston në identifikimin e katër instrumente kryesore të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Instrumentat që përbënin bazën e veprimit dhe formulimit të politikës së jashtme dhe të sigurisë u parashikuan në dispozitat e Traktatit të Amsterdimit.⁸⁷ Krahas dy instrumentave ekzistuese si veprimet e përbashkëta dhe pozicionet e përbashkëta që miratoheshin nga Këshilli me shumicë të cilësuar (Keukeleire dhe Delreux, 2014: 51), u shtuan edhe parimet e përbashkëta dhe strategjitë e përbashkëta.⁸⁸

Qëndrimet e përbashkëta,⁸⁹ përcaktonin një qasje për një çështje të caktuar, veprimet e përbashkëta,⁹⁰ adresonin situata specifike që kërkonin veprim operacional, parimet dhe udhëzimet⁹¹ ofronin drejtimin e përgjithshëm politik në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë, dhe strategjitë e përbashkëta⁹² përcaktonin objektivat dhe mjetet. Mjetet për zbatimin e strategjive të përbashkëta ishin veprimet dhe qëndrimet e përbashkëta

⁸⁶ Neni J.1/2, Traktati i Amsterdimit, shih citimin origjinal të nenit J.1/2, sipas të cilit: *They shall refrain from any action which is contrary to the interests of the Union or likely to impair its effectiveness as a cohesive force in international relations.*

⁸⁷ Neni J.2 dhe Neni J.5, Traktati i Amsterdimit.

⁸⁸ Neni J.2, Traktati i Amsterdimit.

⁸⁹ Neni J.5, Traktati i Amsterdimit, shih citimin origjinal të nenit J.5 sipas të cilit: *The Council shall adopt common positions. Common positions shall define the approach of the Union to a particular matter of a geographical or thematic nature. Member States shall ensure that their national policies conform to the common positions.*

⁹⁰ Neni J.2, Traktati i Amsterdimit, shih nenin J.2 sipas të cilit: *The Union shall pursue the objectives set out in Article J.1 by:...adopting joint actions.*

⁹¹ Neni J.2, Traktati i Amsterdimit, shih nenin J.2 sipas të cilit: *defining the principles of and general guidelines for the common foreign and security policy.*

⁹² Neni J.2, Traktati i Amsterdimit, shih nenin J.2 sipas të cilit: *deciding on common strategies.*

të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët. Që nga hyrja në fuqi e Traktatit të Amsterdimit shumë pak strategji u miratuan për zgjidhjen e konflikteve, vetëm dy strategji kryesore, strategjitë e përbashkëta për Rusinë⁹³ dhe strategjitë e përbashkëta për Ukrainën.⁹⁴

Ndërkohë dhjetëra vendime u miratuan në kuadër të veprimeve të përbashkëta dhe qëndrimeve të përbashkëta për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare me qëllim luajtjen e një roli nga ana e Bashkimit Evropian. Vetëm në Ballkanin Perëndimor u miratuan 5 qëndrime të përbashkëta⁹⁵ dhe 9 veprime të përbashkëta.⁹⁶ Sipas Giorgio Maganza,⁹⁷ Traktati i Amsterdimit përmirësoi mekanizmat në dispozicion të Bashkimit Evropian për të vepruar efektivisht në çështjet e politikës së jashtme (1998: 174).

Traktati sanksionoi një sërë ndryshimesh në aspektin e themelimit të strukturave të reja dhe detyrave të PJSP-së. Nga pikëpamja institucionale ndryshimet më të rëndësishme të Traktatit të Amsterdimit për Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët ishin në lidhje me krijimin e Sekretarit të Përgjithshëm ose Përfaqësuesit të Lartë për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.⁹⁸ Përfaqësuesi i Lartë⁹⁹ asistonte Këshillin dhe

⁹³ Common Strategy of the European Union of 4 June 1999 on Russia 1999/414/CFSP.

⁹⁴ Common Strategy of the European Union of 11 December 1999 on Ukraine 1999/877/CFSP.

⁹⁵ Council Common Position 1999/273/CFSP, për Jugosllavinë; Council Common Position 1999/318/CFSP, për Jugosllavinë; Council Common Position 1999/604/CFSP, për Jugosllavinë; Council Common Position 1999/691/CFSP, për Jugosllavinë; Council Common Position 1999/345/CFSP, për Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore.

⁹⁶ Council Joint Action 1999/665/CFSP, për Jugosllavinë; Council Joint Action 1999/239/CFSP, për Kosovën; Council Joint Action 1999/522/CFSP, për Kosovën; Council Joint Action 1999/864/CFSP, për Kosovën; Council Joint Action 1999/189/CFSP, për Shqipërinë; Council Joint Action 1999/844/CFSP, për Bosnje-Hercegovinën.

⁹⁷ Giorgio Maganza, këshilltar ligjor i Shërbimit Ligjor të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anëtar i Task Forcës për Konferencën Ndërqeveritare, që negocioi dhe miratoi Traktatin e Amsterdimit, në një shkrim të tij në vitin 1998 analizon ndryshimet kryesore të PJSP në Traktatin e Amsterdimit.

⁹⁸ Neni J.16, Traktati i Amsterdimit.

⁹⁹ Javier Solana u caktua Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, më parë Solana ishte Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.

Presidencën në formulimin, përgatitjen dhe implementimin e vendimeve në çështjet e ardhshme në kuadër të politikave të jashtme dhe të sigurisë së përbashkët.¹⁰⁰

Një ndryshim tjetër thelbësor që solli ky Traktat i dedikohet themelimit të Planifikimit të Politikave dhe të Njësive të Paralajmërimit të Hershëm (Duquette, 2001: 180). Ky organ i ri vepronte nën autoritetin e Sekretarit të Përgjithshëm duke qenë subjekt i administratës së Këshillit (Keukeleire dhe Delreux, 2014: 51). Detyrat e tij përfshinin monitorimin dhe vlerësimin e zhvillimeve ndërkombëtare, vlerësimin e jashtëm të BE-ja dhe interesat e politikave të sigurisë. Pjesë e përgjegjësisë të Planifikimit të Politikave dhe të Njësive të Paralajmërimit të Hershëm ishin gjithashtu dhe zbulimi, paralajmërimi i hershëm i ngjarjeve, që mund të ketë një efekt në PJSP-së dhe prodhimi i dokumenteve të politikave rekomanduar strategjive të PJSP-së për BE-në (Monar, 1997: 430).

Gjatë shqyrtimit të ndryshimeve të mundshme të dispozitave mbi PJSP-në shqetësimet kryesore kanë qenë për përmirësimin e vendimmarrjes dhe zbatimin e kësaj politike. Në çdo rast si në Traktatin e Maastrichtit ashtu edhe në traktatet e mëvonshme, vendimet miratoheshin nga Këshilli duke vepruar me unanimitet, dhe abstenimet e Shteteve Anëtare të pranishme personalisht ose me përfaqësues nuk pengonin miratimin e vendimeve të tilla.¹⁰¹ Këshilli merr vendimet e nevojshme për përcaktimin dhe zbatimin e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët në bazë të udhëzimeve të përgjithshme të

¹⁰⁰ Neni J.16, Traktati i Amsterdimit, shih citimin origjinal të nenit J.16 sipas të cilit: *The Secretary-General of the Council, High Representative for the common foreign and security policy, shall assist the Council in matters coming within the scope of the common foreign and security policy, in particular through contributing to the formulation, preparation and implementation of policy decisions, and, when appropriate and acting on behalf of the Council at the request of the Presidency, through conducting political dialogue with third parties.*

¹⁰¹ Neni J. 13, Traktati i Amsterdimit, shih citimin origjinal të dispozitës, sipas të cilës: *Decisions under this Title shall be taken by the Council acting unanimously. Abstentions by members present in person or represented shall not prevent the adoption of such decisions.*

përcaktuara nga Këshilli Evropian.¹⁰² Këshilli duhet të sigurojë unitetin, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e veprimeve të Bashkimit Evropian.¹⁰³

Presidenti përfaqëson BE-në në të gjitha çështjet e ardhshme në kuadër të parametrave të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.¹⁰⁴ Presidenti është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët dhe përfaqëson Bashkimin Evropian në forumet ndërkombëtare.¹⁰⁵ Sipas Traktatit të Amsterdimit, Presidenca ndihmohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit,¹⁰⁶ i cili për qëllim të çështjeve të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët quhet Përfaqësuesi i Lartë dhe ka si detyrë përmirësimin e përfaqësimit të jashtëm të Bashkimit Evropian (Duquette, 2001: 175).

Traktati i Amsterdimit forcoi marrëdhënien ndërmjet Bashkimit Evropian Perëndimor dhe Bashkimit Evropian.¹⁰⁷ Nëpërmjet forcimit të kësaj marrëdhënieje me BEP-së, roli i Bashkimit Evropian si një aktor global po rritej në sferën e funksioneve paqeruajtëse dhe humanitare. Sipas doktrinës, Traktati i Amsterdimit i dha Bashkimit Evropian një politikë të jashtme të njohur për herë të parë (Keane, 2005: 91). Një

¹⁰² Neni J. 3/1, Traktati i Amsterdimit, shih dispozitën sipas të cilës: *The European Council shall define the principles of and general guidelines for the common foreign and security policy, including for matters with defence implications.*

¹⁰³ Neni J. 3/3, Traktati i Amsterdimit, shih citimin origjinal të dispozitës sipas të cilës: *The Council shall ensure the unity, consistency and effectiveness of action by the Union.*

¹⁰⁴ Neni J. 8/2, Traktati i Amsterdimit.

¹⁰⁵ Neni J. 8/2, Traktati i Amsterdimit, shih citimin origjinal të dispozitës, sipas të cilës: *The Presidency shall be responsible for the implementation of decisions taken under this Title; in that capacity it shall in principle express the position of the Union in international organisations and international conferences.*

¹⁰⁶ Neni J.8/3, Traktati i Amsterdimit, shih dispozitën sipas të cilës: *The Presidency shall be assisted by the Secretary-General of the Council who shall exercise the function of High Representative for the common foreign and security policy.*

¹⁰⁷ Declaration No. 3, Declaration relating to Western European Union. Declaration of Western European Union on the role of Western European Union and its relations with the European Union and with the Atlantic Alliance.

argumentim i tillë vjen, si pasojë e veprimit më të shpeshtë të Bashkimit Evropian në zgjidhjen e konflikteve.

Bashkimi Evropian fitoi akses në kapacitetin operacional të Bashkëpunimit Evropian Perëndimor. Kapaciteti operacional i Bashkimit Evropian u zhvillua në drejtim të sferës humanitare dhe detyrave të shpëtimit, detyrave paqeruajtëse dhe forcës ushtarake në menaxhimin e krizave. Ky kapacitet operacional dhe të ashtuquajturat “Petersberg Tasks” (detyrat e Petërsburgut),¹⁰⁸ janë detyra që sot përfaqësojnë një aspekt shumë të rëndësishëm të zgjidhjes së konflikteve nga Bashkimi Evropian (Keukeleire dhe Delreux, 2014: 52). Petersberg Tasks paraqesin një listë të detyrave paqeruajtëse, të sigurisë dhe mbrojtjes të krijuara nga Bashkëpunimi Evropian Perëndimor në qershor të vitit 1992.

Petersberg Tasks, u bënë për herë të parë pjesë e Bashkimit Evropian në Traktatin e Amsterdimit duke rritur rolin dhe kompetencat e tij në fushën e zgjidhjes së konflikteve. Bashkëpunimi Evropian Perëndimor, ashtu si dhe në Traktatin e Maastrichtit ishte një pjesë integrale e zhvillimit të Bashkimit Evropian në aspektin e mbrojtjes. Sipas nenit J.7 të Traktatit të Amsterdimit, (ish-neni J.4, Traktati i Maastrichtit), Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian duhet të respektonin detyrimet e atyre Shteteve Anëtare, të cilat e shikonin mbrojtjen e tyre në kuadrin e NATO-s.

Kjo dispozitë parashikon që Shtetet Anëtare në Bashkimin Evropian, anëtare gjithashtu edhe në NATO mund të sigurojnë mbrojtjen e tyre nëpërmjet NATO-s, një zgjedhje e tillë nuk përbën shkak për diskriminim nga ana e Shteteve të tjera Anëtare. Në asnjë rast dhe në asnjë dispozitë të Traktateve të Bashkimit Evropian nuk është synuar ndërtimi i një fuqie ushtarake e krahasueshme me NATO-n apo që të zëvendësojë NATO-n.

¹⁰⁸ *Petersberg Declaration*, Western European Union. Council of Ministers, 19 June 1992, Bonn.

Bashkimi Evropian ka një marrëdhënie të ngushtë me Aleancën e Atlantikut, përse i përket mbrojtjes dhe sigurisë¹⁰⁹ (Dehousse, 1998: 528). Shtetet Anëtare në kuadrin e forcimit të bashkëpunimit mundësuan, që nëpërmjet një deklarate të posaçme, me vendimi unanim të Këshillit Evropian, të konfirmojë se Bashkëpunimi Evropian Perëndimor mund të integrohej në Bashkimin Evropian.¹¹⁰ Një qëndrimi i tillë përforcohet edhe në nenin J. 7/1 të Traktatit të Amsterdimit. Kjo mundësi integrimi sipas Hill dhe Smith, ishte një vendim i rëndësishëm, si praktikisht ashtu edhe simbolikisht (2000: 170). Në aspektin institucional Traktati i Amsterdimit parashikonte një rol më të zgjeruar për Këshillin Evropian.

Funksioni i Këshillit nuk ishte vetëm për të përcaktuar parimet dhe udhëzimet e përgjithshme të PJSP-së, por edhe të vendoste mbi strategjitë e përbashkëta që zbatoheshin nga BE-ja në fushat ku Shtetet Anëtare kishin interesa të përbashkëta¹¹¹ (Maganza, 1998: 176). Traktati i Amsterdimit paraqiste një problem të rëndësishëm në lidhje me mundësinë e zgjerimeve të ardhshme të Bashkimit Evropian. Në një situatë të tillë, ky traktat nuk ishte në gjendje të përballonte problemet institucionale, që mund të lindnin. Për këtë u krijuan hapësirat për zhvillimin e një tjetër projekti, i cili mund të rregullonte mangësitë e Traktatit të Amsterdimit në lidhje me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

Në këtë periudhë kohe doktrina e parashtron konceptin e Bashkimit Evropian për politikën e jashtme si paradoksale (Zielonka, 1998: 11). Sipas Zielonkës, Bashkimi Evropian dëshiron të bëhet një aktor i rëndësishëm ndërkombëtar pa u bërë një supershtet

¹⁰⁹ Shih: Kreun VII, 7.1. “Bashkëpunimi ndërmjet Bashkimit Evropian dhe NATO-s në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare” të këtij studimi.

¹¹⁰ Arrangements for enhanced cooperation between the European Union and the Western European Union under the protocol on article 17 of the Treaty on European Union, L 153/2 Official Journal of the European Communities 19. 6. 1999.

¹¹¹ Neni J. 3/1 dhe 2, Traktati i Amsterdimit.

Bashkimi Evropian shpreson të ketë një ndikim të fortë në Evropë dhe pjesën tjetër të botës, pa i bazuar këto aspirata në një strategji të mirë-definuar, të përcaktuar dhe të qëndrueshme. Qëllimet e tij të shumta përfshijnë parandalimin dhe menaxhimin e konfliktit, por pak është bërë për të përfshirë një dimension ushtarak në politikën e tij të jashtme (Zielonka, 1998: 11). Në këto kushte nisën procedurat për përgatitjen e një tjetër Traktati, i cili do të plotësojë boshllëqet në lidhje me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, si dhe mangësitë strukturore dhe institucionale për çështjet e tjera të Bashkimit Evropian.

2.3.3. Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët në Traktatin e Nicës

Në kushtet e zgjerimeve të reja që mund të përjetonte Bashkimi Evropian, në vitin 2000 u ngrit një Konferencë e re Ndërqeveritare me qëllim rishikimin e traktateve.¹¹² Amendime të reja të Traktatit të Bashkimit Evropian në drejtim të politikës së jashtme dhe të sigurisë janë realizuar me miratimin e Traktatit të Nicës në vitin 2003.¹¹³ Në këtë traktat u trajtuan çështje të cilat nuk ishin diskutuar në Traktatin e Amsterdamt dhe përmbanin dispozita të reja të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

Si në çdo traktat tjetër edhe gjatë hartimit të Traktatit të Nicës projektuesit krahas çështjeve të tjera i kushtuan vëmendje të veçantë fushës së sigurisë dhe mbrojtjes me qëllim rritjen e rolit të Bashkimit Evropian si një aktor global në zgjidhjen e konflikteve. Megjithë sintezën e krijuar, Traktati i Nicës nuk mori tjetër dimension në kuadër të përcaktimit të rendit juridik në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, ndryshimet e përcaktuara prej tij ishin thjesht ndryshime teknike (Sari, 2012: 19).

¹¹² Traktati i Nicës, u miratua në 26 shkurt të vitit 2001 dhe hyri në fuqi në 1 shkurt të vitit 2003.

¹¹³ Treaty of Nice Amending the Treaty on European Union, the Treaties Establishing the European Communities and Certain Related Acts, Feb. 26, 2001, 2001 O.J. (C 80) 1.

Nëpërmjet rishikimit në tërësi të Traktatit, kuadri ligjor i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët u parashikuar në nenin 17 të Traktatit të Nicës. Ky traktat, në mënyrë të ngjashme me traktatet e mëparshme ruajti ndarjen në tre shtylla, bashkëpunimin ndërqeveritar dhe u karakterizua nga paqartësia (Austin, 2011: 3). Situata ndërkombëtare ishte ende më e tensionuar,¹¹⁴ të gjithë aktorët ndërkombëtarë duhet të mbanin përgjegjësi për garantimin e sigurisë dhe stabilitetit.

Mungesa e koherencës dhe koordinimit ndërmjet Shteteve Anëtare pengoi forcimin e rolit të Bashkimit Evropian si një aktor global. Ishte e nevojshme ndërtimi i mekanizmave dhe sistemeve të reja për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Kështu një vëmendje të veçantë në Traktatin e Nicës e mori krijimi i një sistemi të menaxhimit të krizave dhe instrumentit të bashkëpunimit të intensifikuar (*enhanced cooperation*).¹¹⁵ Traktati i Nicës nëpërmjet bashkëpunimit të intensifikuar kërkonte të pohonte identitetin e Bashkimit Evropian si një forcë koherente në skenën ndërkombëtare.¹¹⁶

Krahas bashkëpunimit të intensifikuar që shërbente për zbatimin e veprimeve dhe qëndrimeve të përbashkëta, ndër të tjera, Traktati i Nicës rriti fushën e votimit me shumicë të cilësuar¹¹⁷ dhe rishikoi procedurën që rregullon lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare.¹¹⁸ Procedurat e reja të ndërmarra për politikën e jashtme dhe të sigurisë, me qëllim forcimin e aftësive operationale të BE-së, krijuan organe dhe agjenci të ndryshme (Anand, 2009).

¹¹⁴ Mjafton të përmendim sulmin e 11 shtatorin të vitit 2001, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sulm që sfidoi sigurinë globale edhe në vendet më të sigurta.

¹¹⁵ Neni 27(a) dhe (e), TBE, Nicë.

¹¹⁶ Neni 27(a)/1, TBE, Nicë, shih citimin origjinal të dispozitës, sipas të cilës: *Enhanced cooperation in any of the areas referred to in this Title shall be aimed at safeguarding the values and serving the interests of the Union as a whole by asserting its identity as a coherent force on the international scene.*

¹¹⁷ Neni 23, TBE, Nicë.

¹¹⁸ Neni 24, TBE, Nicë.

Ngritja e këtyre organeve mundësonte Bashkimit Evropian të zhvillonte operacione të menaxhimit të krizave në vendet e treta, nëpërmjet përdorimit të operacioneve ushtarake dhe civile (Sari, 2012: 20). Për shembull, Komiteti Politik dhe i Sigurisë u autorizua që nën përgjegjësinë e Këshillit të ushtronte kontrollin politik dhe drejtimin strategjik të operacioneve të menaxhimit të krizave.¹¹⁹ Në mënyrë, që institucionet të pajiseshin me procedura më të thjeshta dhe efektive vendimmarrjeje (Canaj dhe Bana, 2014: 45), Traktati i Nicës rregullonte çështje, që lidheshin me përbërjen e Komisionit, ponderimin e votave në Këshill dhe zgjerimin e rasteve të votimit me shumicë të cilësuar¹²⁰ (Jacque, 2010: 16-17).

Krijimi i Politikës Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes në vitin 1999¹²¹ mundësoi një përfshirje të rëndësishme politike dhe ushtarake të Shteteve Anëtare të BE-së (Gross, 2009: 2). Traktati i Nicës¹²² solli një bashkëpunim më të ngushtë në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, (Salmon dhe Shepherd, 2003) me përjashtim të fushës ushtarake dhe të politikës së mbrojtjes (Vermeulen dhe Bondt, 2014: 88). Për shkak të opozitës britanike, bashkëpunimi në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes nuk mori përmasat e dëshiruara, ky bashkëpunim u kufizua dukshëm në çështjet e mbrojtjes (Cremona, 2006: 2).

Traktati sanksionoi instrumente e legjitimuara në Traktatin e Amsterdimit, që konsistonin në përkufizimin e parimeve dhe udhëzimeve të përgjithshme për politikën e

¹¹⁹ Neni 25, TBE, Nicë, shih citimin origjinal të dispozitës, sipas të cilës: ... *the Treaty establishing the European Community, a Political and Security Committee shall monitor the international situation in the areas covered by the common foreign and security policy and contribute to the definition of policies by delivering opinions to the Council at the request of the Council or on its own initiative... this Committee shall exercise, under the responsibility of the Council, political control and strategic direction of crisis management operations....*

¹²⁰ Neni 27, TBE, Nicë, shih citimin origjinal të dispozitës, sipas të cilës: ...*the Council shall act by a qualified majority.*

¹²¹ Joint Declaration on European Defence, Joint Declaration issued at the British-French Summit, 4 December 1998, Saint-Malo.

¹²² Neni 17, TBE, Nicë.

jashtme dhe të sigurisë (Rutten, 2001: 8). Instrumente mbeten të rëndësishme edhe për traktatet e mëvonshme.

Megjithatë një pjesë e doktrinës mbrojnë argumente pozitive në drejtim të rritjes së rolit të Bashkimit Evropian. Cameron, argumentonte se, politika e jashtme është ndoshta zona ku Bashkimi Evropian ka avancuar më shumë në vitet e fundit. Sipas tij, Bashkimi Evropian vepron, si një subjekt politik në trajtimin e çështjeve të ndryshme të zgjidhjes së konflikteve (2007: 204). Këto çështje përfshijnë terrorizmin, çështjet e Ballkanit, përhapjen e armëve, procesin e paqes në Lindjen e Mesme, zhvillimin e Afrikës dhe shumë çështje të tjera.

Sidoqoftë për pjesën tjetër të doktrinës, ky progres i Bashkimit Evropian ishte shoqëruar me mangësi të rëndësishme në lidhje me mungesën e lidershit, vazhdimësisë, qëndrueshmërisë dhe burimeve diplomatike (Crowe, 2006: 107-114). Crowe theksonte, se ky është rezultat i mungesës të të menduarit strategjik, vendimmarrjes proaktive dhe veprimit koherent, duke përcaktuar kështu peshën e politikës së jashtme. Për më tepër në aspektin e kornizës institucionale, ende ekzistojnë tensionet ndërmjet shtyllave. Shtyllat funksiononin mbi bazën e metodave të ndryshme dhe zgjerimi i metodës ndërqeveritare të një shtylle do të thoshte zvogëlim i zonës së kompetencës të metodës tjetër (asaj komunitare) duke rritur kështu, tensionet brenda kornizës institucionale.

Megjithatë një pjesë e doktrinës argumentonte se pavarësisht përplasjeve dhe kundërshtimeve ndërmjet metodave me njëra-tjetrën, ato duhet të punojnë së bashku brenda kuadrit të Bashkimit Evropian (Rummel dhe Wedemann, 1998: 9). Në këtë kontekst vendimmarrësit në vazhdimësi do të përpiqeshin për krijimin e një kuadri më të sofistikuar institucional dhe ligjor në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

2.4. Risitë e Traktatit të Lisbonës për forcimin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët

Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët ishte padyshim një nga zonat më të nxehta, korrente dhe në qendër të debateve në procesin kushtetues të Bashkimit Evropian ndërmjet vitit 2002 dhe vitit 2007 (Verola, 2009: 41).¹²³ Në 15 dhjetor të vitit 2001, Këshilli Evropian i Laeken-it¹²⁴ mbajti një deklaratë që njihet si Deklarata e Laeken-it, qëllimi i së cilës ishte hartimi i një konvente të posaçme.¹²⁵ Deklarata e Laeken-it krijoi në vitin 2003, Konventën mbi të Ardhmen e Evropës, me qëllim përpilimin e një projekt-kushtetute.¹²⁶

Në Traktatin që themelon një Kushtetutë për Evropën,¹²⁷ struktura ekzistuese e tre shtyllave të Bashkimit Evropian u zëvendësua në një Traktat i vetëm, një Kushtetutë për Evropën (Weatherill, 2014: 18), e cila nuk arriti të hynte në fuqi.¹²⁸ Më 13 dhjetor të vitit 2007, Këshilli Evropian mbahet në Lisbonë dhe miraton Traktatin e Reformës, i cili zëvendësoi Traktatin e braktisur Kushtetues.¹²⁹ Një nga objektivat kryesorë të Traktatit të Lisbonës, që ndjek mandatin e Deklaratës së Laeken, ishte të sillte një koherencë dhe qëndrueshmëri në marrëdhëniet e jashtme të Bashkimit Evropian dhe fuqizimit të

¹²³ Shih gjithashtu: Cremona, (2011: 55).

¹²⁴ Presidency Conclusions, European Council meeting in Laeken 14 and 15 december 2001.

¹²⁵ Laeken Declaration on the future of the European Union, 15 December 2001.

¹²⁶ Treaty Establishing a Constitution for Europe, Rome, 29 October 2004, 2004 O.J. (C310) 1.

¹²⁷ Ky projekt-kushtetutë do të thjeshtonte traktatet ekzistuese, kompetencat dhe aktet, si dhe do t'i jepte vlerë kushtetuese Kartës të të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian e miratuar në dhjetor të vitit 2000.

¹²⁸ European Council 2007, The Intergovernmental Conference Mandate, 26 June 2007, Brussels.; Pezullimi i procesit të ratifikimit nga disa shtete solli braktisjen dhe dështimin e miratimit të Kushtetutës Evropiane. Jacques parashtron, se arsyeja e dështimit të Komunitetit Evropian të Mbrojtjes dhe Kushtetutës, tregon një lloj ngurrimi nga ana e Bashkimit Evropian për të ndjekur një rrugë të ndryshme nga ajo e integritit funksional (2010: 20). Në Këshillin Evropian, të vitit 2007 në Bruksel, krerët e shteteve dhe qeverive ranë dakord për një Konferencë të re Ndërqeveritare, për hartimit të një Traktati të ri duke nënkuptuar kështu heqjen dorë përfundimisht nga ambiciet kushtetuese.

¹²⁹ Treaty Establishing a Constitution for Europe, Rome, 29 October 2004, 2004 O.J. (C310) 1.

Bashkimit Evropian si aktor global (Craig dhe De Burca, 2011: 424). Në kontrast me Traktatin e vitit 2004 që nuk hyri në fuqi, Traktati i Lisbonës nuk i zëvendësoi traktatet aktuale, por i modifikoi ato. Traktati i reformës u shndërrua në Traktatin e Lisbonës,¹³⁰ duke hyrë në fuqi më 1 dhjetor të vitit 2009.

Miratimi i Traktatit të Lisbonës erdhi pas dështimit të Kushtetutës, si pasojë e referendumeve negative në Francë dhe Holandë, duke treguar kështu sipas Devuyst, se përparimi i shpejtë i Bashkimit Evropian nuk është gjithmonë i mirëpritur në Evropë (2008: 261). Risitë që solli Traktati i Lisbonës ishin të shumta, traktati realizoi shkrirjen e tre shtyllave, por gjithsesi Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët mbeti shtyllë më vete, kjo politikë mbeti ende në nivel bashkëpunimi ndërqeveritar.¹³¹

Nga pikëpamja juridike Traktati i Lisbonës ndryshon nga traktatet e mëparshme, ai ndahet në Traktatin e Bashkimit Evropian (TBE) dhe në Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).¹³² Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët është e vendosur në Traktatin e Bashkimit Evropian. Traktati rregulloi Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët në Titullin V të “Dispozitave të Përgjithshme për Veprimin e Jashtëm të Bashkimit Evropian dhe Dispozitave të Veçanta për Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët”.

Titulli V ndahet në dy krerë kryesorë, në Kreun 1, që rregullon “Dispozitat e përgjithshme për veprimin e jashtëm të Bashkimit Evropian” dhe në Kreun 2, që rregullon “Dispozitat e veçanta për Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët”. Në Kreun 2,

¹³⁰ Traktati i Bashkimit Evropian, Traktati i Lisbonës. (2009). Versioni i Konsoliduar, 13 dhjetor 2007, O.J. (C306) 17.12.2007.

¹³¹ Sipas autorit Maragas (2010), kuadri institucional i mëparshëm i ndarë në tre shtylla, sillte një strukturë që ishte një mbivendosje e përgjegjësisë dhe ngurtësisë burokratike.

¹³² Ndryshe nga dy traktatet e mëparshme të Amsterdams dhe të Nicës, Traktati i Lisbonës në këndvështrimin ligjor është një akt i vetëm juridik.

disiplinohen dy seksionet për fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, në Seksionin 1, parashikohen “Dispozitat e Përbashkëta” dhe në Seksioni 2, parashikohen “Dispozitat për Politikën e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët”.

Kuadri ligjor i politikës së jashtme dhe të sigurisë përfshin nenet 21-41 të Traktatit të Bashkimit Evropian, ndërsa në nenet 42-46, TBE rregullohet Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët. Struktura kushtetuese e së drejtës së BE-së për marrëdhëniet ndërkombëtare para Traktatit të Lisbonës ishte e ndërlikuar dhe komplekse. Traktati i Lisbonës prezantoi një tërësi dispozitash të hartuara për të nënvizuar rolin e BE-së si një aktor global dhe për të fuqizuar koherencën e sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare (Cremona, 2008:11).

Një sërë dispozitash rregullojnë PJSP-në, neni 3/5 TBE, thekson rolin e vlerave të marrëdhënieve ndërkombëtare të BE-së, ndërsa neni 205 TFBE, krijon një lloj *kapele* për Pjesën e V të Traktatit lidhur me marrëdhëniet e jashtme të BE-së, duke mos përfshirë vetëm PJSP-në (Craig dhe De Burca, 2011: 426). Titullit i V i TBE fillon me nenin 21, i cili për herë të parë përmbledh dhe artikulon objektivat kryesore të politikave të jashtme të BE-së, duke ju referuar kryesisht PJSP-së. Këto dispozita synojnë të kontribuojnë në krijimin e një kornize të integruar dhe të artikulojnë krahas vlerave të vendosura në nenin 3/5 TBE një set parimesh dhe objektivash të përbashkëta për marrëdhëniet ndërkombëtare (Craig dhe De Burca, 2011: 426).

Traktati i Lisbonës është traktati që forcoi rolin e Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare. Bashkimi Evropian nëpërmjet kësaj politike i atribuon vetes një rol të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare. Politika e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët i jep Bashkimit Evropian një zë më të unifikuar në fushën e çështjeve të jashtme, duke theksuar

kështu rolin e Bashkimit Evropian, si një aktor global në zgjidhjen e konflikteve (Austin, 2011: 19).

Traktati konfirmoi ndryshime të rëndësishme për fuqizimin e koherencës së PJSP-së dhe rritjes së rolit të Bashkimit Evropian në ruajtjen e paqes dhe ndaj kërcënimit të sigurisë globale. Traktati i Lisbonës iu referua zgjidhjes së konflikteve ndërkombëtare si një nga parimet kryesore të veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian.¹³³ Bashkimi Evropian është një aktor tashmë që përcakton dhe ndjek politika dhe veprime të përbashkëta për parandalimin e konflikteve, zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare dhe menaxhimin e krizave.¹³⁴

Bashkimi Evropian legjitimoi në dispozitat e traktateve të tij fuqizimin e sigurisë ndërkombëtare. Ai punon për një shkallë të lartë bashkëpunimi në të gjitha fushat e marrëdhënieve ndërkombëtare për ruajtjen e paqes dhe parandalimin e konfliktet.¹³⁵ Traktati i Lisbonës kishte, si qëllim krijimin e një Bashkimi Evropian më demokratik, më koherent dhe më shumë transparent. Traktati i Lisbonës konfirmon nëpërmjet objektivave të tij hipotezën e studimit, për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare në kuadër të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

Objektivat e këtij traktati ishin të siguronin krijimin e strukturave institucionale, sa më efikase dhe më fleksibile për të përmbushur sfidat, që rridhnin nga rritja e numrit të Shteteve Anëtare; të forconin demokracinë evropiane duke rritur legjitimitetin e Bashkimit Evropian në mesin e qytetarëve të saj; dhe të rrisnin veprimin evropian në nivel

¹³³ Zgjidhja e konflikteve është parashikuar në neni 21/2, a (c), TBE.

¹³⁴ Neni 21/2, TBE: “Bashkimi përcakton dhe ndjek politika dhe veprime të përbashkëta dhe punon për një shkallë të lartë bashkëpunimi në të gjitha fushat e marrëdhënieve ndërkombëtare”.

¹³⁵ Neni 21/2, (c), TBE: “...të ruajë paqen, të parandalojë konfliktet dhe të fuqizojë sigurinë ndërkombëtare...”.

ndërkombëtar, në mënyrë më koherente dhe të dukshme, veçanërisht me anë të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (Comelli dhe Pirozzi, 2013:2).

Pra nga sa përmendëm më sipër, një nga qëllimet kryesore të këtij Traktati ishte të krijonte struktura të reja institucionale, për të kapërcyer mungesën e kohezionit dhe efektivitetit, që ekzistonte nga traktatet e mëparshme. Traktati i Lisbonës, gjithashtu ndryshoi nomenklaturën e instrumenteve të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, por jo statusin e tyre juridik.¹³⁶ Përtej krijimit të detyrave të reja legislative, lidhur me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, Traktati i Lisbonës krijoi aktorë të rinj institucionalë, së bashku me kompetenca të reja për aktorët ekzistues, që kanë përgjegjësi në fushën e politikës e jashtme dhe sigurisë së përbashkët.

Risite më të rëndësishme ishin ato në drejtim të krijimit a) të Përfaqësuesit të Lartë, b) të Presidentit të Këshillit Evropian, dhe c) të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian (SHVJE).¹³⁷ Krijimi i Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian dhe postit të Përfaqësuesit të Lartë, në Traktatin e Lisbonës janë parë shpesh, si zgjidhje e mungesës së kapacitetit të Bashkimit Evropian për të vepruar, si një aktor global në arenën ndërkombëtare (Bretherton dhe Vogler, 2006).¹³⁸

Traktati i Lisbonës rikonceptoi instrumentet e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët në katër lloje vendimesh, në objektivat dhe interesat strategjike të Bashkimit Evropian; në pozicionet, që duhet të ndërmerren nga Bashkimi Evropian; në veprimet që duhet të ndërmerren nga Bashkimi Evropian; dhe në procedurat për zbatimin e veprimeve

¹³⁶ House of Lords, European Union Committee, 2008. The Treaty of Lisbon: an impact assessment, the 10th report of the session. Vol. I: Report. London: The authority of the House of Lords, fq. 181.

¹³⁷ Shih: Kreun V. 5.4. “Organet kryesore për veprimtarinë e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë të Përbashkët” të këtij studimi.

¹³⁸ Shih gjithashtu: Jupille dhe Caporaso, (1998).

dhe qëndrimeve të Bashkimit Evropian.¹³⁹ Traktati nuk ndryshoi qëllimin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët dhe nuk transferoi ndonjë kompetencë shtesë për Bashkimin Evropian në këtë fushë.

Dispozitat e reja në Traktatin e Lisbonës kanë çuar në një rol më aktiv për Bashkimin Evropian në fushën e PJSP, por ky rol aktiv në çdo rast varet nga “shkalla e konsensusit” që mund të arrihet ndërmjet Shteteve Anëtare.¹⁴⁰ Shkalla e konsensusit është elementi kryesor për suksesin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Pavarësisht sfidave, që përjetoi politika e jashtme dhe e sigurisë përgjatë traktateve, në të gjitha rastet iu kushtua vëmendje për shkak të natyrës, që e karakterizonte këtë politikë. Sepse, politika e jashtme dhe e sigurisë së përbashkët ka një natyrë të veçantë në krahasim me politikat e tjera të Bashkimit Evropian (Verola, 2009: 41).

¹³⁹ Shih: Kreun IV. 4.2 “Natyra detyruese e dispozitave të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët” të këtij studimi.

¹⁴⁰ House of Lords, European Union Committee, 2008, fq. 182.

KREU III. PARIMET, NORMAT DHE NDARJA E KOMPETENCAVE MIDIS BASHKIMIT EVROPIAN DHE SHTETEVE ANËTARE NË FUSHËN E POLITIKËS SË JASHTME, SIGURISË DHE MBROJTJES

3.1. Kuadri ligjor, normat dhe parimet e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian

Traktati i Lisbonës ka zgjeruar dhe strukturuar në mënyrë të efektshme objektivat e jashtme të Bashkimit Evropian. Këto objektiva përfaqësojnë parimet e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian dhe në të njëjtën kohë parimet e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Traktati i referohet shtrirjes së politikës së jashtme dhe të sigurisë në terma shumë të gjera, si e shtrirë në të gjitha hapësirat e politikës së jashtme dhe të sigurisë (Craig dhe De Burca, 2011: 447). Parimet e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian janë sanksionuar në nenin 3/5 TBE¹⁴¹ dhe nenin 21 TBE.¹⁴²

Neni 32 TBE përcakton ndërlidhjen midis politikave të jashtme të Bashkimit Evropian në një listë të plotë të objektivave për të gjithë gamën e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian. Garantimi i të drejtave të njeriut, sigurimi i një sistemi demokratik të konsoliduar, shteti i së drejtës, sundimi i ligjit, zgjidhja e konflikteve, parandalimi i tyre, menaxhimi i krizave dhe sigurimi i paqes, këto dhe të tjera në këtë kontekst përfaqësojnë parimet që përbëjnë thelbin e ekzistencës së Bashkimit Evropian. Hipoteza e studimit për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian pas Traktatit të Lisbonës në një masë të gjërë

¹⁴¹ Neni 3/5, TBE: “Në marrëdhëniet me botën, Bashkimi Evropian... kontribuon për paqen, sigurinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Tokës, solidaritetin dhe respektin e ndërsjellë midis popujve...”.

¹⁴² Neni 21/1, TBE: “Veprimi i Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare orientohet nga parimet që kanë frymëzuar krijimin, zhvillimin dhe zgjerimin e tij dhe të cilat ai kërkon t’i çojë përpara në mbarë botën: demokracia, shteti i së drejtës, të drejta dhe liri themelore të njeriut për të gjithë dhe në mënyrë të pandarë, respektimi i dinjitetit njerëzor, parimet e barazisë dhe solidaritetit dhe respektimi i parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe i së drejtës ndërkombëtare”.

mbështetet edhe nga një pjesë e doktrinës. Sipas autorit Larik, Traktati i Lisbonës ka zgjeruar në mënyrë të efektshme objektivat globale të BE-së si në aspektin e substancës ashtu edhe në kuadrin ligjor, me qëllim transformimin e fuqisë së BE-së jo vetëm ndërmjet Shteteve Anëtare por edhe përreth botës së tij (2013: 11).

Këto parimi udhëheqin Bashkimin Evropian në arenën ndërkombëtare dhe përherë dhe më tepër vihet re konsolidimi i tij dhe perceptimi si një faktor i rëndësishëm në qeverisjen globale (Van Vooren, Blockmans dhe Wouters, 2013).¹⁴³ Parimet e përcaktuara në Traktatin e Lisbonës për PJSP-së orientohen drejt veprimit të jashtëm të BE-së në mënyrë më gjithpërfshirëse, shumëplanëshe dhe të qëndrueshme (Comelli dhe Pirozzi, 2013: 4). Këto parime krijojnë mundësinë për arritjen e koherencës, që në vetvete përbën parimin kryesor të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

Natyra ligjore e PJSP-së është e ndryshme nga instrumentet e tjera legislative, të miratuara nga BE-ja. Në rendin juridik të Bashkimit Evropian e drejta e Politikës së Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët është një e drejtë detyruese e cila ndahet në të drejtën parësore dhe të drejtën dytësore. *E drejta parësore* e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët e vendos theksin tek dy parime kryesore, në *parimin e bashkëpunimit sistematik* dhe në *parimin e bashkëpunimit të singertë*. Ndërsa *e drejta dytësore* i referohet dy instrumentave kryesorë të politikës së jashtme dhe të sigurisë, *vendimeve të përbashkëta* dhe *qëndrimeve të përbashkëta* (Schmidt, 2009: 249),¹⁴⁴ (Hillion dhe Wessel, 2008: 81).¹⁴⁵

¹⁴³ Shih gjithashtu: Wessel, (2015: 16).

¹⁴⁴ Autorja Julia Schmidt, shqyrton natyrën detyruese të së drejtës së PJSP (Binding nature of CFSP law) në një punim të saj të titulluar: “Common foreign and security policy and European security and defence policy after the Lisbon Treaty – Old problems solved?”.

¹⁴⁵ Autorët Hillion dhe Wessel, kanë trajtuar këtë çështje në punimin e tyre të titulluar *Restraining External Competences of EU Member States under CFSP* (The Binding Nature of Primary CFSP Norms); Shih gjithashtu: Wessel, (2015), në punimin *Resisting Legal Facts: Are CFSP Norms as Soft as They Seem?*

a) E drejta parësore e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët

E drejta parësore përfshin dy parimet që janë thelbësore për ekzistencën e politikës së sigurisë dhe mbrojtjes dhe në të njëjtën kohë për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian si aktor ndërkombëtar në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Thelbi i këtyre dy parimeve është se Shtetet Anëtare duhet të frenohen nga çdo veprim që është në kundërshtim me interesat e Bashkimit Evropian apo që mund të dëmtojnë efektivitetin e tij për të folur në “një zë” në arenën ndërkombëtare (Craig dhe De Burca, 2011: 449). Parimi i parë është *parimi i bashkëpunimit sistematik* dhe procedura për aplikimin e këtij parimi rregullohet në nenin 32, TBE.¹⁴⁶

Kjo dispozitë disiplinon bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare dhe detyrimin për t’u konsultuar me njëra-tjetrën në çështjet e jashtme të sigurisë dhe mbrojtjes. Sipas një pakice të doktrinës detyrimi i konsultimit në të drejtën ndërkombëtare përfshin detyrimin për të shmangur mbajtjen e një qëndrimi, i cili merret para konsultimit të çështjes me partnerët e tjerë (Hillion dhe Wessel, 2008: 82). Neni 32, TBE nuk tregon ndonjë devijim nga ky koncept i konsultimit.

Detyrimi i konsultimit i përcaktuar në parimin e bashkëpunimit sistematik përfshin detyrimin negativ për Shtetet Anëtare. Detyrimi negativ përcakton obligimin e Shteteve Anëtare për të mos bërë publike një qëndrim të brendshëm me interes të përgjithshëm në fushën e PJSP-së, përpara se kjo çështje të jetë diskutuar në kuadër të kornizës së PJSP-së (Schmidt, 2009: 249). Mosrespektimi i detyrimit negativ dhe mungesa e konsultimit ndërmjet Shteteve Anëtare cënon themelet e bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe në mënyrë të

¹⁴⁶ Neni 32, TBE: “Shtetet Anëtare konsultohen me njëri-tjetrin brenda Këshillit Evropian dhe Këshillit për çdo çështje të politikës së jashtme dhe të sigurimit, me interes të përgjithshëm, në mënyrë që të vendosin një qasje të përbashkët”.

drejtpërdrejt forcën e BE-ja, si aktor në skenën ndërkombëtare. Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare, bën që BE-ja të shikohet nga vendet e treta si jo-efektive për të folur në një zë të vetëm.

Mungesa e konsultimit rrezikon drejtpërsëdrejti efektivitetin dhe koherencën e Bashkimit Evropian. Për këtë arsye, përpara se Shtetet Anëtare të përfshihen në menaxhimin e krizave dhe zgjidhjen e konflikteve ose të ndërmarrin një veprim në arenën ndërkombëtare, çdo shtet duhet paraprakisht të konsultohet me shtetet e tjera brenda Këshillit Evropian ose brenda Këshillit.¹⁴⁷ Shtetet Anëtare kujdesen përmes konvergjencës së veprimeve të tyre,¹⁴⁸ që Bashkimi Evropian të jetë në gjendje të flasë në një zë të vetëm, të unifikuar për garantimin e interesave dhe vlerave të tij në arenën ndërkombëtare (Paczolay, 2013: 1077).

Parimi i dytë është *parimi i bashkëpunimit të sinqertë*, dhe ky parim rregullohet nga neni 24/3 dhe nga neni 4/3 TBE.¹⁴⁹ Parimi i bashkëpunimit të sinqertë në dispozitat e mësipërme nënkupton bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare, pa rezerva, aktivisht, në mënyrë të sinqertë dhe me një frymë besnikërie (Eckes, 2015: 20).¹⁵⁰ Bashkëpunimi i sinqertë përbën një parim të përgjithshëm të rendit ligjor të Bashkimit Evropian, që mbulon të gjitha degët e veprimit të jashtëm të BE-së duke përfshirë këtu dhe PJSP-së (Casolar, 2012: 13). Parimi i bashkëpunimit të sinqertë i rregulluar në nenin 4/3, i referohet në

¹⁴⁷ Neni 32, TBE: “Përpara se të ndërmarrin një veprim në arenën ndërkombëtare ose përpara se të hyjnë në një angazhim i cili mund të prekë interesat e Bashkimit Evropian, çdo Shtet Anëtar konsultohet me të tjerët brenda Këshillit Evropian ose brenda Këshillit”.

¹⁴⁸ Neni 32, TBE: “Shtetet Anëtare kujdesen, përmes konvergjencës së veprimeve të tyre, që Bashkimi Evropian të jetë në gjendje të mbështesë interesat dhe vlerat e tyre në arenën ndërkombëtare”.

¹⁴⁹ Neni 4/3, TBE: “Në bazë të parimit të bashkëpunimit të sinqertë, Bashkimi Evropian dhe Shtetet Anëtare, bazuar në respektin e ndërsjellë, e mbështetin njëri-tjetrin në kryerjen e detyrave që rrjedhin nga Traktatet”.

¹⁵⁰ Shih gjithashtu: Wessels dhe Bopp, (2008: 11).

mënyrë të përgjithshme të gjitha politikave të Bashkimit Evropian ndërsa neni 24 është hartuar me qëllim disiplinimin e parimit të bashkëpunimit të sinqertë në fushën e PJSP-së.

Lidhur me këtë parim është shprehur edhe Gjykata e Drejtësisë, në çështjen *Pupino*.¹⁵¹ Në këtë rast bëhej fjalë për shtyllën e tretë dhe jo për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, megjithatë ky parim aplikohet edhe për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (Hillion dhe Wessel, 2008: 94). Në rastin *Pupino*, Gjykata e Drejtësisë shprehet se, nëse Bashkimi Evropian nuk vepron në bazë të bashkëpunimit të sinqertë është shumë e vështirë që të veprojë si një aktor efektiv.¹⁵²

Parimi i bashkëpunimit të sinqertë, si parim themelor për politikën e jashtme dhe të sigurisë krahas bashkëpunimit në të gjitha fushat, në bazë të dispozitave të përmendura më sipër përfshin në të njëjtën kohë detyrimin pozitiv dhe detyrimin negativ. Detyrimi pozitiv,¹⁵³ u kërkon Shteteve Anëtare që të punojnë së bashku në mënyrë aktive për të rritur dhe për të zhvilluar politikën e jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian (Hillion dhe Wessel, 2008: 92).¹⁵⁴ Ndërsa detyrimi negativ,¹⁵⁵ kërkon që Shtetet Anëtare të përmbahen nga çdo veprim i cili bie ndesh me interesat e Bashkimit Evropian ose i cili ka të ngjarë të çënojë efektivitetin e tij (Schmidt, 2009: 261).

¹⁵¹ Vendimi C-105/03 *Pupino* [2005] ECR I-5285.

¹⁵² Vendimi C-105/03 *Pupino* [2005] ECR I-5285, shih citimin origjinal të paragrafit 42, sipas të cilit: *It would be difficult for the Union to carry out its task effectively if the principle of loyal cooperation, requiring in particular that Member States take all appropriate measures, whether general or particular, to ensure fulfilment of their obligations under European Union law, were not also binding in the area of police and judicial cooperation in criminal matters, which is moreover entirely based on cooperation between the Member States and the institutions, as the Advocate General has rightly pointed out in paragraph 26 of her Opinion.*

¹⁵³ Neni 24/3, TBE: “Shtetet Anëtare e mbështetin aktivisht dhe pa rezerva politikën e jashtme dhe të sigurimit të Bashkimit Evropian, me frymën e besnikërisë dhe solidaritetit të ndërsjellë dhe e respektojnë veprimin e Bashkimit Evropian në këtë fushë”.

¹⁵⁴ Shih gjithashtu: Schmidt, (2009: 261).

¹⁵⁵ Neni 24/3, TBE: “Ato nuk kryejnë asnjë veprim që bie ndesh me interesat e Bashkimit ose që ka të ngjarë ta ulë efektshmërinë e tij si një forcë kohezive në marrëdhëniet ndërkombëtare”.

b) E drejta detyruese e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët

Në rend të dytë të natyrës detyruese bëjnë pjesë dispozitat detyruese të veprimeve të përbashkëta dhe qëndrimeve të përbashkëta. Veprimet e përbashkëta dhe qëndrimet e përbashkëta përbëjnë *instrumentet* kryesore të politikës së jashtme dhe të sigurisë. Veprimet dhe qëndrimet e përbashkëta janë themeluar që në Traktatin e Maastrichtit, ndërkohë në amendimet e Traktatit të Amsterdimit, bëhet një përcaktim më i qartë i instrumenteve në dispozicion të PJSP-së. Sipas një pakice të doktrinës në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, veprimet e përbashkëta shërbejnë për qëllime operative, ndërsa pozicionet e përbashkëta janë qëndrimet e përgjithshme ndaj rajoneve gjeografike ose temave të politikës së jashtme (Winn dhe Lord, 2001: 45).

Objektivi real i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët për Bashkimin Evropian ka qenë dhe mbetet rënia dakord e Shteteve Anëtare mbi një qëndrim të përbashkët në politikën ndërkombëtare (të flasin me një zë të vetëm). Traktati i Lisbonës është përpjekur të thjeshtëzojë tipologjinë e akteve duke i zëvendësuar qëndrimet e përbashkëta dhe veprimet e përbashkëta me vendime (Jacque, 2010:366). Traktati i Lisbonës si dhe doktrina në përgjithësi kanë rënë dakord se ndarja ndërmjet veprimeve dhe qëndrimeve të përbashkëta është e paqartë si në praktikë ashtu dhe në teori (Eeckhout, 2011:473).

Veprimet e përbashkëta, pjesë e natyrës detyruese të të drejtës detyruese të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, rregullohen në nenin 28 TBE. Sipas kësaj dispozite në rastet kur Bashkimi Evropian duhet të ndërhyjë për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare, ndërmarrjen e misioneve apo operacioneve, veprimet e përbashkëta

miratohen vetëm nëpërmjet Këshillit.¹⁵⁶ Për shembull, në rastet e një situatë krize, konflikti ndërmjet shteteve në një rajon, apo kërcënimi i sigurisë ndërkombëtare është Këshilli ai i cili miraton vendimet e nevojshme për veprimet e përbashkëta që duhet të merren (Sari, 2013: 981-1017).

Pas marrjes së një vendimi, Shtetet Anëtare janë të obliguara të respektojnë vendimin. Nëse situata apo konflikti përshkallëzohet dhe rrethanat që kanë ndikim mbi vendimin e marrë ndryshojnë për shtete të veçanta, në kuadër të nenit 28/2, paragrafi 2, është Këshilli që shqyrton situatën dhe merr vendimet e nevojshme. Vetëm Këshilli vendos se si duhet të veprohet në rast se një Shtet Anëtar kërkon ndryshimin e vendimit në përputhje me interesat e politikave të jashtme kombëtare.

Vendimi i Këshillit i marrë në kuadër të nenit 28, TBE për veprimet e përbashkëta, përcakton detyrimin e Shteteve Anëtare për të respektuar vendimin e marrë, në mënyrë të ngjashme me Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve.¹⁵⁷ Sipas Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve dhe sipas nenit 28, TBE, në rastet kur situata është ndryshuar rrënjësisht në krahasim me kohën e miratimit të vendimit¹⁵⁸ nuk mund të përdoret si justifikim nga shtetet për tërheqjen nga vendimi.

Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve përcakton dy raste përjashtimore,¹⁵⁹ ndërsa në rastin e obligimeve në kuadër të nenit 28/4, TBE, Shtetet Anëtare mund të marrin

¹⁵⁶ Neni 28/1, TBE: “Kur situata ndërkombëtare kërkon veprim operativ nga Bashkimi Evropian, Këshilli miraton vendimet e nevojshme”.

¹⁵⁷ Konventa e Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve 1969.

¹⁵⁸ Miratimit të “traktatit” në rastin e Konventës për të Drejtën e Traktateve.

¹⁵⁹ Shih nenin 62/1 paragrafi a, b i Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve, sipas të cilës: *The criteria to justifiably invoke this provision include: the fundamental change of circumstances was not foreseen by the parties and (a) the existence of those circumstances constituted an essential basis of the consent of the parties to be bound by the treaty; dhe (b) the effect of the change is radically to transform the extent of obligations still to be performed under the treaty.*

masa urgjente për shkak të situatës, por duke informuar menjëherë Këshillin dhe duke vepruar në bazë të objektivave të përgjithshme të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.¹⁶⁰ Në rast se një Shtet Anëtar është i detyruar të ndryshojë vendim e miratuar, për shkak se ky vendim prek drejtpërdrejt politikën e tij kombëtare, kjo nuk nënkupton që shteti në fjalë të anashkalojë detyrimet e Bashkimit Evropian.

Në çdo rast obligimet e një Shteti Anëtar kundrejt një vendimi të përbashkët të Bashkimit Evropian është i vlefshme. Sipas dispozitave të TBE, planifikimet e qëndrimeve kombëtare të Shteteve Anëtare në politikën e tyre të jashtme duhet të bëhen vetëm pasi Shtetet Anëtare kanë dhënë informacionin paraprak në Këshill.¹⁶¹ Gjithashtu nëse një shtet nuk disponon kapacitetet e duhura për zbatimin e vendimit kjo nuk mund të përdoret si shkak për moszbatimin e vendimit, obligimet e tyre qëndrojnë dhe është Këshilli që vendos për ndryshimet e mundshme.¹⁶²

Qëndrimet e përbashkëta parashikohen në nenit 29 të Traktatit të Bashkimit Evropian, në këtë dispozitë Këshilli është organi që miraton vendime. Vendimet merren nga Këshilli në rastet kur përcaktohet qasja e Bashkimit Evropian për një çështje të veçantë me natyrë gjeografike ose tematike.¹⁶³ Shtetet Anëtare kujdesen, që politikat e tyre kombëtare të përputhen me qëndrimet e Bashkimit Evropian. Qëndrimet e përbashkëta

¹⁶⁰ Neni 28/4, TBE: “Në rast se lind një nevojë e ngutshme nga ndryshimet e situatës dhe nëse nuk arrihet një shqyrtim i vendimit të Këshillit siç kërkohet në paragrafin 1, Shtetet Anëtare marrin masat e duhura për shkak të nevojës urgjente, duke mbajtur në konsideratë objektivat e përgjithshme të këtij vendimi. Shteti Anëtar në fjalë e informon menjëherë Këshillin për masa të tilla”.

¹⁶¹ Neni 28/3, TBE: “Sa herë që ka një plan për miratimin e një qëndrimi kombëtar ose merret një qëndrim kombëtar sipas një vendimi të përmendur në paragrafin 1, Shteti Anëtar në fjalë jep informacion në kohë për të mundësuar, nëse është nevoja, konsultime paraprake brenda Këshillit. Detyrimi për të dhënë informacion paraprak nuk zbatohet për masat të cilat janë thjesht transpozim kombëtar i vendimeve të Këshillit”.

¹⁶² Neni 28/5, TBE: “Nëse ka vështirësi madhore në zbatimin e një vendimi të parashikuar në këtë nen, një Shtet Anëtar ia raporton ato Këshillit, i cili diskuton për to dhe kërkon zgjidhjet e duhura. Zgjidhje të tilla nuk duhet të bien ndesh me objektivat e vendimit të parashikuar në paragrafin 1 apo nuk duhet t’ia ulë efektshmërinë një vendimi të tillë”.

¹⁶³ Neni 29, TBE.

ashtu si veprimet e përbashkëta janë të detyrueshme për Shtete Anëtare. Pikërisht natyra detyruese e qëndrimeve të përbashkëta është konfirmuar nga Gjykata e Drejtësisë në rastin *Segi* të vitit 2007.¹⁶⁴

Në çështjen *Segi*,¹⁶⁵ janë shqyrtuar masat e marra nga Bashkimi Evropian për zbatimin e Rezolutës 1373 të vitit 2001 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së,¹⁶⁶ në këtë rezolutë kërkohej ngrirja e fondeve të individëve të përfshirë në aktivitetet terroriste (Bogdandy, Wolfrum, Bernstorff, Dann, Goldmann, 2010: 872). Çështja kishte të bënte me një vendim të kontestuar për vendosjen e qëndrimeve të përbashkëta¹⁶⁷ të bazuara në shtyllën e dytë dhe shtyllën e tretë.

Sipas vendimit të Gjykatës të Drejtësisë e drejta për të bërë një referencë në Gjykatën e Drejtësisë për një vendim paraprak, ekziston në lidhje me të gjitha masat e miratuara nga Këshilli, çfarëdo qoftë natyra apo forma e tyre, të cilat janë të destinuara të kenë efekte ligjore në marrëdhënie me të tretët.¹⁶⁸ Gjykata konfirmon në këtë mënyrë se një qëndrim i përbashkët duhet të jetë subjekt i mundësisë së një reference paraprake nga një gjykatë kombëtare dhe të anulimit të procedurës së bërë nga Komisioni ose Shtetet Anëtare (Eeckhout dhe Tridimas, 2009: 573).

¹⁶⁴ Vendimi C-355/04 *P. Segi dhe të tjerë kundër Këshillit* [2007] ECR I-01657.

¹⁶⁵ Rasti kishte të bënte me shtyllën e tretë për Bashkëpunimin Gjyqësor dhe Policor në Fushën Penale, çështja merret si një rast analog edhe për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, ndryshe si shtylla e dytë.

¹⁶⁶ Security Council resolution 1373 (2001) Threats to international peace and security caused by terrorist acts.

¹⁶⁷ Qëndrim i Përbashkët i Këshillit 2008/347/PJSP i 29 prill 2008 për ndryshimin e Qëndrimit të Përbashkët 2007/871/PJSP për përditësimin e Qëndrimeve të Përbashkëta 2001/931/PJSP për zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin (*Council Common Positions 2008/347/CFSP*).

¹⁶⁸ Vendimi C-355/04 *P. Segi dhe të tjerë kundër Këshillit* [2007] ECR I-01657, shih citimin original të paragrafit 53, sipas të cilit: *The right to make a reference to the Court of Justice for a preliminary ruling must therefore exist in respect of all measures adopted by the Council, whatever their nature or form, which are intended to have legal effects in relation to third parties*; Shih rastet analoge të GJED-së: Vendimi 22/70 Komisioni kundër Këshillit (ERTA) [1971] ECR 263, paragrafi 38 deri te 42; dhe Vendimi C-57/95 *Franca kundër Komisioni* [1997] ECR I-1627, paragrafi 7.

Gjykata e Drejtësisë sqaron se një qëndrim i përbashkët kërkon bashkëpunimin e Shteteve Anëtare në bazë të parimit të detyrimit të bashkëpunimit në mirëbesim.¹⁶⁹ Shtetet Anëtare duhet të marrin të gjitha masat e duhura, qoftë të përgjithshme ose të veçantë, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas ligjit të Bashkimi Evropian.¹⁷⁰ Parimi i shprehur në çështjen *Segi* të vitit 2007, është vendosur në nenin 24, të Traktatit të Bashkimit Evropian në Traktatin e Lisbonës.¹⁷¹

3.1.1. Normat e detyrueshme të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët

Rritja e rolit të Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare kërkon ekzistencën e një politike të jashtme dhe të sigurisë efektive mbi baza të forta ligjore.¹⁷² Meqënëse Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët i nënshtrohet bashkëpunimit ndërqeveritar¹⁷³ të Shteteve Anëtare dhe jo të drejtës së komunitetit, normat e PJSP-së kategorizohen si norma *soft law* ose norma të ligjit të butë (Saurugger dhe Terpan, 2015).¹⁷⁴

Bashkëpunimi ndërqeveritar nuk prek përgjegjësitë dhe bazën ligjore të Shteteve Anëtare për politikën e brendshme të sigurisë.¹⁷⁵ Doktrina është e ndarë në dy pjesë përsa i

¹⁶⁹ Vendimi C-355/04 *P. Segi dhe të tjerë kundër Këshillit* [2007] ECR I-01657, paragrafi 52.

¹⁷⁰ Vendimi C-355/04 *P. Segi dhe të tjerë kundër Këshillit* [2007] ECR I-01657, shih citimin origjinal të paragrafit 52, sipas të cilit: *Member States are to take all appropriate measures, whether general or particular, to ensure fulfilment of their obligations under European Union law.*

¹⁷¹ Neni 24/3, TBE: “Shtetet Anëtare e mbështetin aktivisht dhe pa rezerva politikën e jashtme dhe të sigurimit të Bashkimit Evropian, me frymën e besnikërisë dhe solidaritetit të ndërsjellë dhe e respektojnë veprimin e Bashkimit Evropian në këtë fushë”.

¹⁷² Për rolin e BE-së si një aktor ndërkombëtar shih: Taylor, (1982); Cameron, (1998); Ginsberg, (1999); Bretherton and Vogler, (2006); Greiçevci, (2007); Smith, (2004).

¹⁷³ Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane çështja *Lisbona* 2 BvE 2/08 from 30 June 2009, paragrafi 390.

¹⁷⁴ Shih: Wessel, (2015).

¹⁷⁵ Deklarata Nr. 13 dhe Deklarata Nr. 14 në lidhje me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë: “...nuk prekin as përgjegjësitë e Shteteve Anëtare, në formën e tyre ekzistuese për të formuluar dhe zhvilluar politikën e tyre të jashtme, dhe as përgjegjësitë e përfaqësuesve të tyre kombëtarë në vende të treta dhe organizata ndërkombëtare...”; Deklarata Nr. 14 në lidhje me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë: “...nuk prekin bazën ligjore, përgjegjësitë dhe kompetencat ekzistuese të asnjë Shteti Anëtar për të formuluar dhe zhvilluar politikën e tij të jashtme...”

përket ligjit të butë të PJSP-së. Sipas një pakice të doktrinës ligji që karakterizohet si *soft law*, mund të definohet edhe si “jo-ligj” në vetvete apo një normë jo ligjore (Shelton, 2000: 4). Ndërsa pjesa tjetër e doktrinës që jep argumentet e kundërta pohon se ligji i butë gjendet ndërmjet dy ekstremeve, të ligjit dhe politikës. Gjithashtu normat e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët janë norma kryesisht procedurale në natyrë (Hillion dhe Wessel, 2008: 4).

Politika e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët përjashtohet nga miratimi i akteve legislative,¹⁷⁶ por kjo nuk i heq akteve të PJSP-së natyrën e tyre juridike. Sipas doktrinës nga pikëpamja kushtetuese, instrumentet e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët kanë padyshim një bazë ligjore por natyra e tyre e vërtetë ligjore është disi e ndryshme nga ajo e instrumenteve legislative të miratuara në BE (Craig dhe De Burca, 2011: 450). Normat e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët nuk qëndrojnë jashtë botës ligjore, pavarësisht rregullave, procedurave specifike dhe rolit të ndryshëm të Gjykatës së Drejtësisë (Wessel, 2015: 8).¹⁷⁷

Një ndarje e prerë e sistemit ligjor të Unionit nga sistemi ligjor i Komunitetit është i pamundur (Craig dhe De Burca, 2011: 448). Aktet që merren në kuadër të PJSP-së janë të detyrueshme dhe karakter i detyrueshëm i vendimeve të PJSP-së rrjedh nga neni 28, i TBE,¹⁷⁸ nëpërmjet angazhimi të BE-së në garantimin e sigurisë globale dhe dhënies së kontributit të tij për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Vendimet e PJSP-së pasi janë miratuar kufizojnë lirinë e Shteteve Anëtare në politikat e tyre individuale. Gjithsesi, statusi

¹⁷⁶ Neni 24/2, TBE.

¹⁷⁷ Shih gjithashtu: Van Elsuwege, (2010: 9).

¹⁷⁸ Neni 28/2, TBE: “Vendimet e përmendura në paragrafin 1 i angazhojnë Shtetet Anëtare në qëndrimet që miratojnë dhe në zhvillimin e veprimtarisë së tyre”.

i Bashkimit Evropian, si aktor ndërkombëtar përmirësohet vetëm nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Shtetet e tij Anëtare (Emerson, 2011: 4). Me qëllim forcimin e BE-së, unifikimin e tij dhe veprimin në një zë të vetëm në arenën ndërkombëtare është e nevojshme kufizimi i lirisë apo kompetencave të Shteteve Anëtare.

Përfshirja e akteve legislative (neni 28/2, TBE) sjell parasysh natyrën ndërqeveritare të PJSP-së. Aktet e miratuara në kuadrin e PJSP-së mund të krijojnë detyrim ligjor, por ato nuk janë akte legislative, çka nënkupton një propozim të Komisionit Evropian, një rol të fortë të Parlamentit Evropian dhe mbledhje publike të Këshillit (Terpan, 2013: 919). Gjithashtu në interpretimin e kësaj dispozite nuk përcaktohet se aktet ligjore, që në kuptim të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët i referohemi si instrumenta,¹⁷⁹ janë të përjashtuara, por nënkupton miratimin e këtyre instrumenteve sipas një procedure legislative që shndërron këto instrumente në akte legislative (Terpan, 2013: 919).

Mënyra se si procedohet për marrjen e vendimeve është se fillimisht këto instrumente përfshijnë objektivat e përgjithshme të miratuara nga Këshilli Evropian, vendimet e miratuara nga Këshilli, qëndrimet e mbajtura nga Këshilli dhe masat për zbatimin e dy kategorive të fundit të vendimeve. Midis instrumenteve të tjera, që kontribuojnë në formulimin e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët janë; informacioni dhe konsultimi për çdo çështje të politikës së jashtme dhe të sigurisë, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare (Craig dhe De Burca, 2011: 448).

Në kohën e sotme ekziston një prezumim në favor të një uniformiteti të ligjshëm, që mbizotëron procedurën e vendimmarrjes dhe ekzistencës së natyrës ndërqeveritare të PJSP-

¹⁷⁹ Instrumentet janë parashikuar në nenin 288 TFBE.

së (Koehler, 2010: 61-62). Ky supozim i ri në favor të uniformitetit juridik vendos karakterin ndërqeveritar të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët nën presione të konsiderueshme (Sari, 2012).¹⁸⁰ Gjykata e Shkallës së Parë në çështjen *Kadi*¹⁸¹ konstatoi se pavarësisht objektivave të përbashkëta, Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët dhe Komuniteti Evropian janë dy rende juridike të integruara por të ndara nga njëra-tjetra.¹⁸² E drejta komunitare udhëhiqet nga një grup i instrumenteve ligjore që përfshin rregullore, direktiva, ndërsa Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët si pjesë e bashkëpunimit ndërqeveritar përbëhet nga instrumente ligjore shumë të ndryshme nga e drejta komunitare (Comelli dhe Pirozzi, 2013: 4).

Politika e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët udhëhiqet nga instrumente ligjore të tilla si, vendimet e Këshillit, strategjitë e përbashkëta, qëndrimet e përbashkëta dhe veprimet e përbashkëta. Në kuadër të bashkëpunimit ndërqeveritar aktet e miratuara në Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët, janë përshkruar si marrëveshje midis Shteteve Anëtare të ngjashme me traktatet tradicionale të së drejtës publike (Terpan, 2013: 917). Instrumentet e PJSP-së kuptohen më mirë si “vendime të së drejtës ndërkombëtare”, e cila ka përsëri një ngjashmëri të madhe me të drejtën e Komunitetit, për faktin që janë të dyja të detyrueshme si për Shtetet Anëtare ashtu edhe institucionet e BE-së (Craig dhe De Burca, 2011: 450).

Sipas një pakice të doktrinës një instrument ligjor përbën një komunitet ligjor në rast se normat që vijnë nga faktet institucionale përbëjnë një element të vlefshëm të sistemit

¹⁸⁰ Shih gjithashtu: Denza, (2004).

¹⁸¹ Vendimi T-315/01 *Kadi kundër Këshillit dhe Komisionit* [2005] ECR II-3649.

¹⁸² Vendimi T-315/01 *Kadi kundër Këshillit dhe Komisionit* [2005] ECR II-3649, shih paragrafin 120, sipas të cilit: *In particular, the Court considers that the coexistence of Union and Community as integrated but separate legal order,...*

ligjor që rregullojnë komunitetin (Ruiter dhe Wessel, 2012: 162–184). Krijimi i normave të PJSP-së varet nga vullneti politik i Shteteve Anëtare dhe pasi këto norma janë përcaktuar, ato kanë si qëllim të kufizojnë lirinë tradicionale, që gëzojnë Shtetet Anëtare në marrëdhëniet e tyre të jashtme. Pikërisht, lejimi i Shteteve Anëtare që të ndikojnë ose të kundërshtojnë normat e përbashkëta të vendosura nga marrëveshjet ndërkombëtare të BE-së do të bënin, që shumica e dispozitave të PJSP-së dhe PSMP-së në Traktatin e BE-së të jenë thuajse të padobishme (Wessel, 2011: 44).

Vazhdimisht doktrina ka shprehur vështirësi për sensin e natyrës juridike të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Vështirësia i dedikohet rolit të ulët që kanë institucionet e Bashkimit Evropian në këtë politikë dhe fakti që vendimet nuk bazohen në rregullore apo vendime, çka përbëjnë dhe bazën e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Ndoshta më i rëndësishëm për shumë studiues ligjorë ishte mungesa e dy nocioneve kyçe të së drejtës së Bashkimit Evropian në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, *doktrina e përparësisë dhe efekti i drejtpërdrejtë* (Wessel, 2015).¹⁸³

Në rastin e parë *doktrina e përparësisë*¹⁸⁴ (*Costa kundër Enel*), (*Simmenthal*), (*Solange I dhe II*), etj., përfshin idenë se ligji i Bashkimit Evropian duhet t'i jepet përparësi ndaj të drejtës së brendshme të Shteteve Anëtare në rastet e mosmarrëveshjeve. Në Politikën e jashtme dhe të sigurisë së përbashkët e drejta i përket Shteteve Anëtare si subjekte sovrane. Elementi i dytë i referohet *efektit të drejtpërdrejtë*, këtu kihet parasysh se Shtetet Anëtare gjykohen në bazë të dispozitave të traktateve të Bashkimit Evropian.¹⁸⁵ Një

¹⁸³ Shih gjithashtu: Sari, (2012).

¹⁸⁴ Jurisprudenca e GJED-së në një sërë rastesh trajton doktrinën e përparësisë. Në këtë studim doktrina e përparësisë trajtohet në rastin e koherencës vertikale.

¹⁸⁵ Shih gjithashtu: Denza, (1999); Bono, (2006); Hermann, (2008); Baere, (2008); Wessel, (2009).

nga rastet historike më të famshme dhe më të rëndësishme për zhvillimin e parimit të efektit të drejtpërdrejtë ishte vendimi *Van Gend en Loos* në vitin 1963.¹⁸⁶ Në këtë vendim GJED-ja shprehu se dispozitat e Traktatit themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian ishin të aftë të krijojnë të drejtat ligjore të cilat mund të zbatohen si nga personat fizikë ashtu dhe nga personat juridikë para gjykatave të Shteteve Anëtare të Komunitetit.

Ekzistenca e një sërë aktesh ligjore na ndihmojnë për të konsideruar PJSP-në pjesë të sistemit ligjor të Bashkimit Evropian, këto akte ligjore sipas një pakice të doktrinës (Wessel, 2015) janë:¹⁸⁷ *Aktet ligjore deklarative*, një shembull të një akti deklarativ mund të përmendim nenin 1, TBE,¹⁸⁸ Shtete Anëtare deklarojnë se janë pjesë e BE-së dhe i japin kompetenca për të zhvilluar ndër të tjera dhe një politikë të jashtme dhe të sigurisë. *Aktet ligjore vetë-detyruese*,¹⁸⁹ Shtetet Anëtare me vullnetin e tyre të lirë krijojnë dhe mbështesin politikën e jashtme dhe të sigurisë së përbashkët. *Aktet ligjore të qëllimshme*, akte të përcaktuara në preambulën e Traktateve të Bashkimit Evropian, në lidhje me politikën e jashtme dhe të sigurisë së përbashkët.¹⁹⁰ *Aktet ligjore të domosdoshme*, aktet që parashikojnë themelimin e funksionit të Përfaqësuesit të Lartë për të përmbushur objektivat e PJSP-së dhe për të rritur rolin e Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare.¹⁹¹ *Aktet ligjore nxitës*, në rastet e miratimit të akteve që nxitin shtetet Anëtare për bashkëpunim dhe

¹⁸⁶ Vendimi C-26/62 *Van Gend en Loos kundër Nederlandse Administratie der Belastingen* [1963] ECR 1.

¹⁸⁷ Shih gjithashtu: Ruiten, 1993.

¹⁸⁸ Neni 1, TBE: “Me anë të këtij Traktati, Palët e Larta Kontraktuese, themelojnë ndërmjet tyre një Bashkim Evropian, të cilit Shtetet Anëtare i japin kompetenca për të arritur objektivat e tyre të përbashkëta”.

¹⁸⁹ Neni 24/3, TBE: “Shtetet Anëtare e mbështetin aktivisht dhe pa rezerva politikën e jashtme dhe të sigurimit të Bashkimit, me frymën e besnikërisë dhe solidaritetit të ndërsjellë dhe e respektojnë veprimin e Bashkimit Evropian në këtë fushë”

¹⁹⁰ Preambula e TBE: “të vendosur për të zbatuar një politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, përfshirë edhe përcaktimin progresiv të një politike të përbashkët për mbrojtjen, e cila mund të çojë në një mbrojtje të përbashkët...”

¹⁹¹ Neni 27/2, TBE.

veprim për zgjidhjen e një konflikti. *Aktet ligjore ekspresive*, si p.sh, në rastet kur Bashkimi Evropian shpreh shqetësimin e tij për shkak të situatave të rënda të vendeve në konflikt, ose dënon situata e përdorimit të dhunës dhe forcës. *Aktet e sigurta ligjore*, kur Bashkimi Evropian shpreh për ndërhyrje nëpërmjet misionëve civile ose të japë kontributin e tij nëpërmjet ndërmjetësimit.¹⁹²

Aktet që rregullojnë Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët nuk mund të trajtohen të izoluara dhe të shkëputura nga tërësia e normave dhe rendi juridik i Bashkimit Evropian. Këtu nënkuptojmë se Bashkimi Evropian nuk i heq të drejtat Shteteve Anëtare, për aq kohë sa nuk vijnë në kundërshtim me aktet e miratuara nga Bashkimi Evropian. Gjithashtu Jacque, shton se veprimtaria kombëtare është gjithmonë e nevojshme, sepse aktet e Bashkimit Evropian nuk sjellin efekte të drejtpërdrejta (2010:141).

3.1.2. Koherenca, parimi themelor i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët në rendin ligjor të Bashkimit Evropian

Hipoteza e studimit mbron pikëpamjen, se rritja e koherencës është në korrelacion të drejtpërdrejtë me rritjen e rolit të Bashkimit Evropian në skenën ndërkombëtare. Pra, sa më shumë koherente të jenë veprimet e Bashkimit Evropian në politikën e jashtme, aq më shumë kapacitet zotëron Bashkimi Evropian në zgjidhjen e konflikteve. Tema e koherencës është në qendër të vëmendjes së Bashkimit Evropian dhe të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, prandaj dhe është përshkruar si tema e vërtetë periodike e politikës së jashtme europiane (Craig dhe De Burca, 2011: 426).

¹⁹² Analiza e akteve është zhvilluar nga autori Wessel, i cili në punimin e tij i referohet autorit Ruiten, shtatë aktet sipas autorëve në citimin e tyre origjinal janë: *Declarative legal acts*, *Self-obligating (or 'commissive') legal acts*, *Purposive legal acts*, *Imperative legal acts*, *Hortatory legal acts*, *Expressive legal acts*, *Assertive legal acts*.

Rritja e koherencës dhe efektivitetit të Bashkimit Evropian në skenën ndërkombëtare, ndër vite ka marrë vëmendjen e juristëve dhe hartuesve të Traktateve të Bashkimit Evropian (Oeter, 2013: 867).¹⁹³ Ata e konceptuan koherencën, si parimin themelor të veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian (Nugent, 2002: 154). Sipas doktrinës, efektiviteti dhe koherenca janë elementë thelbësorë për të evidentuar rolin e BE-së, si aktor lider dhe i vetëm në zgjidhjen e konflikteve.

Autorë si, Wessel, (2000: 1135), Pilegaard, (2003) dhe Stetter, (2004) mbrojnë argumentin, se në hartimin e politikave të jashtme, BE-ja shpeshherë është kritikuar për shkak të mungesës së koherencës. Mungesa e koherencës personifikohet me inefikasitet në politikën e jashtme (Allen, 1998, 2004) dhe rol të ulët në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare (Nuttall, 2005). Traktati i Lisbonës prezantoi një tërësi dispozitash të hartuara për të nënvizuar rolin e BE-së si një aktor global dhe për të fuqizuar koherencën e sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare (Craig dhe De Burca, 2011: 426).

Paraqitja e parë e koherencës në një dokument zyrtar ishte në Komunikatën e Samitit të Parisit në vitin 1974.¹⁹⁴ Akti Unik Evropian i vitit 1987,¹⁹⁵ përmbante një nxitje për të siguruar koherencë mes marrëdhënieve të jashtme të Komunitetit dhe koordinimin e politikave të jashtme ndërmjet Shteteve Anëtare (Portela dhe Raube, 2009: 8). Akti Unik Evropian parashikonte se, organet kryesore, të cilat ngarkoheshin me përgjegjësi për

¹⁹³ Personalitetet, që kanë formuar doktrinën dhe që e kanë parë koherencën, si konceptin bazë të rritjes së efektivitetit të Bashkimit Evropian në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët janë: Tietje, (1997); Wessel, (2000); Christiansen, (2001); Smith, (2004); Nutall, (2005); Stetter, (2004), (2007); Cremona, (2006), (2008), (2011); Hillion, (2008); Hillion dhe Wessel, (2008); Portela dhe Raube, (2008); Wessel, (2015) etj.

¹⁹⁴ Sipas kësaj Komunikate për të siguruar konsistencë në aktivitetet e Komunitetit dhe vazhdimësinë e punës, Ministrat e Punëve të Jashtme, në takimet me Këshillin e Komunitetit, veprojnë si iniciatorë dhe koordinatorë.

¹⁹⁵ Në nenin 30/5, Akti Unik Evropian, parashikon një formë e koherencës vertikale, sipas këtij neni në politikën e jashtme të Komunitetit Evropian dhe politikën e miratuar nga Bashkëpunimi Politik Evropian duhet të jenë konsistente.

koherencën ishin Komisioni dhe Këshilli i Ministrave¹⁹⁶ (Duke, 2011: 24). Në Traktatin e Maastrichtit, për herë të parë, Traktatet kishin krijuar një detyrim për konsistencën (Koehler, 2010: 58). Sipas Traktatit të Maastrichtit, Bashkimi Evropian duhet të sigurojë koherencë në veprimet e tij të jashtme.¹⁹⁷

Në përpjekje për të përmirësuar koherencën në marrëdhëniet e jashtme të BE-së, Traktati i Amsterdimit përfshiu instrumente të reja, si Përfaqësuesin e Lartë dhe strategjitë e përbashkëta. Ndërsa në Traktatin e Nices rriti bashkëpunimin, koherencën në menaxhimin e krizave dhe krijoi Politikën Evropiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, e cila prodhoi më tej sfidat për konsistencë (Missiroli 2001:10).

Në Deklaratën e Laeken-it të vitit 2001, vëmendja u përqëndrua në mënyrë të veçantë tek krijimi i politikave të jashtme dhe sigurisë më koherente (Oeter, 2013: 867), duke miratuar gjithashtu edhe një Komunikatë për këtë qëllim.¹⁹⁸ Traktati i Lisbonës ishte traktati që rriti koherencën në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së përbashkët. Ky Traktat themeloi marrëveshje të reja institucionale dhe mekanizma, që kishin për qëllim rritjen e koherencës dhe efikasitetin e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian.

Krijimi i një kuadri ligjor dhe institucional efektiv ishte i domosdoshëm, sepse mbështetja vetëm tek vullneti i shteteve ishte i pamjaftueshëm për të drejtuar një Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët konsistente dhe të suksesshme. Krijimi i një sërë strukturash institucionale në Traktatin e Lisbonës, u krijuan në funksion të forcimit të

¹⁹⁶ Neni 30/5, AUE: “Organet e veçanta janë përgjegjëse për të siguruar koherencën, Presidenca dhe Komisioni, secili në fushën e vet të kompetencave kishte përgjegjësi të siguronte konsistencë”.

¹⁹⁷ Neni C TBE, Traktati i Maastrichtit theksonte se: “Këshilli i Ministrave dhe Komisioni do të jenë përgjegjëse për të siguruar konsistencën”. Sanksionimi i parimit të koherencës dhe krijimi i shtyllës së dytë të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, ishte një hap i rëndësishëm për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian në zgjidhjen e konflikteve.

¹⁹⁸ EC Commission, Communication to the European Council, ‘Europe in the World – Some Practical Proposals for Greater Coherence, Effectiveness and Visibility’, 8 June 2006, fq. 278.

koherencës në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Në mënyrë të vazhdueshme kërkohej unitet dhe koherencë sepse rritja e saj në PJSP dhe rendin juridik të BE-së ishte një proces shumë i vështirë që kërkonte kohë dhe maturi. Për këtë në vitin 2010, Këshilli Evropian¹⁹⁹ ritheksoi nevojën për të rritur koherencën dhe komplementaritetin ndërmjet politikave të brendshme dhe të jashtme të Bashkimit Evropian.

Koordinimi i ngushtë dhe i rregullt ndërmjet të gjithë aktorëve të ndryshëm institucionalë është i nevojshëm për të përcaktuar në mënyrë koherente pozicionet e përbashkëta, interesat strategjike dhe objektivat e Bashkimit Evropian. Megjithatë pavarësisht risive, një sërë problemesh evidentohen në kuadër të vendosjes së një koherence më të madhe në strukturat institucionale të PJSP-së. Në këtë traktat u miratua një tablo institucionale ku roli koordinues i koherencës në marrëdhëniet e jashtme nuk i jepet vetëm një aktori, por disa aktorëve.²⁰⁰

Rasti kur kompetencat e aktorëve përplasen me njëri-tjetër është p.sh, në përfaqësimin e jashtëm të Bashkimit Evropian. Përfaqësuesi i Lartë dhe Presidenti i Këshillit Evropian, përfaqësojnë Bashkimin Evropian në marrëdhënie me jashtë.²⁰¹ Nga ana tjetër, Komisioni siguron përfaqësimin e jashtëm të Bashkimit Evropian, por pa përfshirë Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.²⁰² Këshilli në kuadër të Këshillit të Punëve të Jashtme së bashku me Përfaqësuesin e Lartë është përgjegjës për përputhjen e parimeve të lojalitetit dhe solidaritetit në PJSP.

¹⁹⁹ European Council Conclusions 16 October 2010, Brussels, shih konkluzionet e Këshillit Evropian sipas të cilave: *In this regard the European Union should further enhance the coherence and complementarity between its internal and external policies.*

²⁰⁰ Përfaqësuesit të Lartë, Presidentit të Këshillit Evropian dhe Komisionit.

²⁰¹ Neni 15/6, TBE.

²⁰² Neni 17/1, TBE.

Këtu vërejmë, se kemi disa institucione, të cilat sigurojnë përfaqësimin e jashtëm të Bashkimit Evropian, por pavarësisht paqartësive, në dispozitat e traktatit janë parashikuar dhe qartësuar rastet në të cilat secili nga institucionet siguron përfaqësimin e jashtëm të Bashkimit Evropian.

a) Kuadri ligjor, koncepti i parimit të koherencës dhe dykuptimësia e zbatimit të këtij parimi në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian

Traktati i Lisbonës sanksionoi në një sërë dispozitash parimin e koherencës në marrëdhëniet e jashtme të Bashkimit Evropian dhe përkatësisht në nenin 7, nenin 13, nenin 21, nenin 24, TBE dhe në nenin 275, TFBE. Këto dispozita nuk janë shteruese sepse në të gjithë veprimin e jashtëm dhe në pjesën ku rregullohen PJSP-ja dhe PSMP-ja parashikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë parimi i koherencës. Parimi i koherencës përmendet në mënyrë të përgjithshme në traktatet e BE-së (neni 7, TFBE), me qëllim sigurimin e koherencës në të gjitha politikat e Bashkimit Evropian.²⁰³

Parimi i koherencës përmendet veçanërisht në dispozitat për institucionet (neni 13, TBE), ky parim konsiderohet si një nga elementët kryesore për zbatimin e efektshëm të politikave të Bashkimit Evropian.²⁰⁴ Lidhur me objektin e studimit për politikën e sigurisë dhe mbrojtjes, parimi i koherencës evidentohet në dispozitat e veprimit të jashtëm (neni 21/3 TBE). Në fushën e veprimit të jashtëm duke përfshirë këtu Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët dhe Politikën e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët, Bashkimi

²⁰³ Neni 7, TFBE: “Bashkimi Evropian siguron konsistencën midis politikave dhe aktiviteteve të tij, duke marrë në konsideratë të gjitha objektivat e tij, në përputhje me parimin e delegimit të kompetencave”.

²⁰⁴ Neni 13/1, TBE: “Bashkimi Evropian ka një kuadër institucional, që ka si qëllim të promovojnë vlerat e tij, të çojë përpara objektivat e tij, ... dhe të sigurojë konsistencën, efektivitetin dhe vazhdimësinë e politikave dhe veprimeve të tij”.

Evropian siguron koherencën²⁰⁵ nëpërmjet institucioneve të tij.²⁰⁶ Sigurimi i koherencës për Bashkimin Evropian, politikat dhe institucionet e tij nënkupton veprimin si një i vetëm në arenën ndërkombëtare për zgjidhjen e konflikteve. Mungesa e koherencës siç është treguar në të shkuarën (rasti i Ballkanit Perëndimor) ul pritshmëritë e BE-së, si një aktor i rëndësishëm për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare.

Konsistenca ose koherenca shfaqet si një parim, nëpërmjet të cilit kuptohen detyrime të procedurës ligjore, të cilat ndiqen nga veprime politike (Portela dhe Raube, 2009: 4). Ndërkohë, Koehler shton se koncepti i koherencës është parakusht i domosdoshëm për efikasitetin e politikës së jashtme dhe të sigurisë, jo vetëm për Bashkimin Evropian, por edhe për të gjithë aktorët e tjerë ndërkombëtarë (2010: 58).

Koherenca nuk është një element ekskluziv vetëm për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Ajo mund të konsiderohet si baza për një PJSP efektive, megjithatë koherenca shtrihet edhe në zona të ndryshme të veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian duke përfshirë edhe aspektin ekonomik, tregtinë, zhvillimin, politikat bujqësore etj., (Duke, 2011:17). Gjithsesi, koherenca shtrihet kryesisht në fusha të tilla si: asistencë humanitare, parandalimi i konflikteve, ndërtimi i paqes, menaxhimi i krizave, dispozitat e mbrojtjes, PJSP-së dhe aspekte të marrëdhënieve të jashtme.

Këtu konfirmojmë, që pjesa më e madhe e fushave, që mbulon koherenca kanë të bëjnë me zgjidhjen e konflikteve dhe Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Për këtë arsye analiza e saj merr një rëndësi të veçantë në këtë studim. Në një studim më të

²⁰⁵ Neni 21/3, TBE: “Bashkimi Evropian siguron qëndrueshmëri (koherencë) midis fushave të ndryshme të veprimit të jashtëm dhe midis këtyre fushave dhe politikave të tjera të tij”.

²⁰⁶ Neni 21/3, TBE: “Këshilli dhe Komisioni të asistuar nga Përfaqësuesi i Lartë për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit garantojnë këtë qëndrueshmëri (koherencë) dhe bashkëpunojnë për këtë qëllim”.

thelluar doktrina evidenton katër aspekteve kryesore të parimit të koherencës: së pari, koherenca negative dhe koherenca pozitive; së dyti, koherenca substanciale/materiale dhe koherenca institucionale; së treti, koherenca vertikale dhe koherenca horizontale; së katërti, koherenca politike dhe koherenca juridike (Vooren dhe Wessel, 2014).

Me koherencë negative kuptojmë mungesën e kontradiktave në aktivitetet e jashtme të Bashkimit Evropian (Hillion, 2008: 18). Për shembull, koherenca negative perceptohet, si mungesa e konfliktit ndërmjet një deklarate politike të bërë nga Përfaqësuesi i Lartë në kuptim të PJSP-së për Rusinë dhe Ministrit të Jashtëm të Gjermanisë në kontekstin e marrëdhënieve personale me Rusinë (Vooren dhe Wessel, 2014).

Ndërsa me koherencën pozitive kuptojmë parimin e bashkëpunimit (Hillion, 2008: 27). Sipas Hillion, me koherencë pozitive kuptohet bashkëpunimi ndërmjet Shteteve Anëtare dhe institucioneve të BE-së, me qëllim sigurimin e koherencës dhe konsistencës në veprimin dhe përfaqësimin e Bashkimit Evropian (2008: 27-35).

Koherenca vertikale është marrëdhënia ndërmjet Bashkimit Evropian, si një person juridik dhe Shteteve Anëtare. Ndërsa, koherenca horizontale është lidhja ndërmjet Bashkimit Evropian, si person juridik dhe institucioneve të Bashkimit Evropian. Koherenca horizontale nënkuptohet edhe si koherenca institucionale, p.sh, se si komunikon Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian me shërbimin diplomatik të Shteteve Anëtare ose me Komisionin Evropian) dhe koherenca ndërmjet kompetencave politike të TBE-së dhe TFBE-së (që quhet koherenca materiale).

Parimi i koherencës është zhvilluar, si nga shkenca politike ashtu edhe nga shkenca juridike. Ndërmjet autorëve ka pasur përplasje në lidhje me përkatësinë e këtij parimi. Gauttier në vitin 2004, konfirmon karakterin politik të konceptit të koherencës duke e

përkufizuar si mungesën e kontradiktave ndërmjet Komunitetit Evropian (BE) dhe PJSP-së (Gauttier, 2004: 23–41). Ndërsa, Tietje nga ana tjetër afirmon edhe më shumë karakterin ligjor të koherencës duke shprehur, se ajo është *një nga vlerat kryesore kushtetuese të BE-së* (1997: 211).

Nuk ka dyshim, që parimi i koherencës është pjesë e dy disiplinave, të cilat gjithashtu janë pjesë e këtij punimi për shkak të karakterit të këtij studimi. Interpretimi i koherencës dhe konsistencës duhet të jetë sa më i saktë dhe i qartë, në mënyrë që të rritet bashkëpunimi ndërmjet Shteteve Anëtare dhe që përfshirja e tyre në zgjidhjen e konflikteve të rezultojë e suksesshme. Problemet, që shoqërojnë uljen e kapacitetit të BE-së nuk i dedikohen vetëm mungesës së vullnetit të shteteve apo mangësive strukturore, por edhe dykuptimësisë së konceptit të koherencës.

Në Bashkimin Evropian koncepti i *koherencës* ngatërrohet në interpretim me *konsistencën*, kjo si pasojë e sistemeve të ndryshme të secilit Shtet Anëtar.²⁰⁷ Interpretimi i ndryshëm i të njëjtit koncept nga Shtetet Anëtare, sjell probleme në koordinimin e politikave të jashtme të Shteteve Anëtarë me ato të Bashkimit Evropian. Bashkimi Evropian mund të luajë një rol të rëndësishëm në parandalimin e konflikteve ose në zgjidhjen e tyre vetëm në rastet, kur ky entitet funksionon në një kohezion të plotë, pasi çdo paqartësi e këtyre parimeve cënon efikasitetin e Bashkimit Evropian si aktor global.

Doktrina²⁰⁸ dhe GJED-ja²⁰⁹ sqarojnë dhe dallojnë dy konceptet nga njëra-tjetra.²¹⁰ Sipas Cremonës (2011: 60),²¹¹ versionet e ndryshme gjuhësore të Traktateve nuk përdorin

²⁰⁷ Në Shqipëri, termi më i përshtatshëm për të përdorur dy konceptet është qëndrueshmëri.

²⁰⁸ Shih: Tietje, (1997: 212); Wessel, (2000: 1150); Christiansen, (2001); Missiroli, (2001: 4); Koutrakos, (2001:39); Bretherton dhe Vogler, (2006); Hoffmeister, (2008); Cremona, (2008, 2011); Hillion, (2008); Duke, (2011: 17);

të njëjtin term, ndërsa sipas Hillion (2008: 12) koncepti i koherencës përmban një dykuptimësi, një ambiguitet. Në legjislacionin e Bashkimit Evropian nuk ekziston një rregull për versionet e ndryshme gjuhësore (Hillion, 2008: 12), ndërsa Gjykata e Drejtësisë ka konfirmuar, se çdo version i parimit të koherencës është në parim unik.²¹² Doktrina ka bërë të qartë kuptimin e dy konceptet, kështu sipas autorëve të ndryshmëm *konsistenca* është një koncept statik, që do të thotë se dispozitat ligjore janë ose nuk janë konsistente.²¹³ Ndërsa *koherenca* është një çështje shkallësh, që do të thotë se një politikë e caktuar apo një veprim mund të jetë më shumë ose më pak koherent.²¹⁴

Konsistenca i referohet mungesës së kundërshtimit (Hoffmeister, 2008: 161) dhe shënon shkallën në të cilën politikat e jashtme dypalëshe të Shteteve Anëtare janë konsistente (të qëndrueshme) me njëra- tjetrën dhe plotësojnë atë të BE-së (Bretherton dhe Vogler, 2006: 31). Ndërsa *koherenca* lidhet më shumë me një sinergji kreative pozitive (Hoffmeister, 2008: 161) dhe i referohet proceseve të politikës së brendshme të Bashkimit Evropian (Bretherton dhe Vogler, 2006: 32). Sipas Duke (2011: 2), mungesa e kontradiktave midis Bashkimit Evropian dhe PJSP-së, ose ndërmjet Bashkimit Evropian dhe PSMP-së është një *çështje e konsistencës*, ndërsa nevoja për një lidhje pozitive

²⁰⁹ Vendimi C- 283/81 *CILFIT* [1982] ECR 3415; Vendimi C-265/03 *Simutenkov* [2005] ECR I-2579.

²¹⁰ Një numër i madh autorësh vënë në dukje problemet që lindin në interpretimet e ndryshme gjuhësore të Shteteve Anëtare duke i dhënë koherencës të përcaktuar në Traktatet e Bashkimit Evropian një kuptim të ndryshëm në shtete të ndryshme.

²¹¹ Cremona, një ndër studiueset më të spikatura të konceptit të koherencës, argumenton dallimin kryesor të koherencës dhe konsistencës në pikëpamjet e ndryshme gjuhësore. Për shembull, në frëngjisht përdoret termi “cohérence”, në gjermanisht përdoret termi “kohärenz”, në italisht ‘coerenza’. Ndërsa, në këto versione gjuhësore do të kuptohet, si “koherencë”, në versionin e gjuhës angleze do të interpretohet, si “konsistencë” në vend të kuptimit të koherencës, që ka në gjuhën angleze. Pra, ajo që interpretohet, si “koherencë” në tre shtetet e mësipërme do të interpretohet, si “konsistencë” në gjuhën angleze.

²¹² Vendimi C- 283/81 *CILFIT* [1982] ECR 3415; Vendimi C-265/03 *Simutenkov* [2005] ECR I-2579.

²¹³ Shih: Tietje, (1997: 212); Wessel, (2000: 1150); Koutrakos, (2001:39); Cremona, (2011: 60).

²¹⁴ Shih: Tietje, (1997: 212); Wessel, (2000: 1150); Koutrakos, (2001:39); Missiroli, (2001: 4); Cremona, (2011: 60).

ndërmjet fushave të politikave është më shumë një *çështje e koherencës*. Koherenca është një koncept më i gjerë dhe më fleksibël se konsistenca (Cremona, 2008:12).

Në bazë të interpretimeve të ndryshme të doktrinës, përkufizimi i prodhuar nga këto konkluzione për dy konceptet respektive mund të formulohet në këtë mënyrë, me konceptin *konsistencë* do të kuptojmë qëndrueshmërinë, që duhet të dominojë në dispozitat e TBE-së dhe në politikat e Bashkimit Evropian për zgjidhjen e konflikteve. Ndërsa me *koherencë* do të kuptojmë lidhjen harmonike, ndërmjet instrumenteve kryesore të zgjidhjes së konflikteve, që përsëri mund të jenë dispozitat dhe politikat e jashtme dhe të sigurisë. Në këtë studim, dy nocionet do të përdoren në një kuptim të vetëm, si sinonime të njëra-tjetrës.

Gjykata e Drejtësisë,²¹⁵ nuk është shprehur për dallimin ndërmjet konceptit të koherencës dhe konsistencës, por Gjykata i drejtohet të dyja koncepteve si të ndara nga njëra-tjetra. Në interpretimin e dy çështjeve *Komisionit kundër Luksemburgut*²¹⁶ dhe *Komisionit kundër Gjermanisë*²¹⁷ të viteve 2005, Gjykata thekson nevojën për të bashkëpunuar me institucionet e Komunitetit për të siguruar si koherencën ashtu dhe konsistencën.²¹⁸ Në të dyja këto çështje Gjykata e Drejtësisë, parashtron një paragraf të njëjtë ku kërkohet miratimi i vendimeve të Komisionit nga Shtetet Anëtare lidhur me marrëveshjet shumëpalëshe me qëllim sigurimin e koherencës dhe konsistencës

²¹⁵ Vendimi C-266/03 *Komisioni kundër Luksemburgut* [2005] ECR I-4805; Vendimi C-433/03 *Komisioni kundër Germanisë* [2005] ECR I-6985.

²¹⁶ Vendimi C-266/03 *Komisioni kundër Luksemburgut* [2005] ECR I-4805, paragrafi 60.

²¹⁷ Vendimi C-433/03 *Komisioni kundër Germanisë* [2005] ECR I-6985, paragrafi 66.

²¹⁸ Vendimi C-266/03 *Komisioni kundër Luksemburgut*, shih citimin origjinal të paragrafit 60, sipas të cilit: *The adoption of a decision authorising the Commission to negotiate a multilateral agreement on behalf of the Community marks the start of a concerted Community action at international level and requires, for that purpose, if not a duty of abstention on the part of the Member States, at the very least a duty of close cooperation between the latter and the Community institutions in order to facilitate the achievement of the Community tasks and to ensure the coherence and consistency of the action and its international representation.*

(qëndrueshmërisë) në veprimin e jashtëm të Komunitetit.²¹⁹ Gjykata e Drejtësisë në aspektin e trajtimit të konsistencës dhe koherencës, në disa çështje të saj, të Komisionit me Shtetet Anëtare sugjeron se dy nocionet ato të konsistencës dhe koherencës nuk mund të ngatërrohen me njëra-tjetrën. Gjykata e Drejtësisë në këto vendime shton, se dy konceptet zëvendësojnë njëra-tjetrën dhe se këto duhet të kuptohen, si koncepte të dallueshme nga njëra-tjetra (Hillion, 2008: 13).

3.1.3. Dimensionet e koherencës në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Parimi i koherencës në kuadër të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit Evropian identifikohet në disa dimensione.²²⁰ Në këtë studim koherenca trajtohet në tre dimensione: në koherencën vertikale, horizontale dhe multilaterale (të shumanshme ose koherencë ndërshtetërore). Krahas dimensioneve, një rëndësi të veçantë për studim merr analiza e niveleve të koherencës.

Parimi i koherencës, si vlerë e së drejtës së Bashkimit Evropian zhvillohet në tre nivele. Në nivelin e parë, janë *rregullat e hierarkisë* (Cremona, 2011: 60-61), këtu përfshihen rregullat për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet normave. Kështu, *koherenca vertikale* do të jetë pjesë e nivelit të parë, sepse koherenca vertikale do të përqëndrohet në sundimin e përparësisë së legjislacionit të Bashkimit Evropian mbi legjislacionin e Shteteve Anëtare. Rregullat e hierarkisë përcaktojnë, se kur normat janë në konflikt legjislacioni i

²¹⁹ Vendimi C-433/03 *Komisioni kundër Germanisë*, shih citimin origjinal të paragrafit 66, sipas të cilit:... *the Community institutions in order to facilitate the achievement of the Community tasks and to ensure the coherence and consistency of the action and its international representation.*

²²⁰ Marise Cremona është autorja që ka përcaktuar dimensionet e koherencës në aspektin ligjor. Shih: Cremona, (2006), (2008), (2011). Shih gjithashtu autorët: Hillion, (2008); Duke, (2011).

Bashkimit Evropian mbizotëron mbi legjislacionin kombëtar të Shteteve Anëtare.²²¹ Në të njëjtën mënyrë, *koherenca horizontale* do të analizohet në bazë të rregullave të hierarkisë. Në bazë të koherencës horizontale, legjislacioni i Bashkimit Evropian (këtu kemi parasysh Traktatet e BE) do të mbizotërojë mbi aktet e miratuara nga institucionet e Bashkimit Evropian.

Në nivelin e dytë, janë *rregullat e delimitimit* (Oeter, 2013: 867). Ky nivel i koherencës përfaqësohet nga rregullat e delimitimit, nëpërmjet të cilave kuptojmë ndarjen e qartë të kompetencave dhe mosndërhyrjen e një institucioni në kompetencat e një insitucioni tjetër. Kështu për shembull, Bashkimi Evropian jo vetëm duhet të veprojë sipas kompetencave, që i kanë dhënë Shtetet Anëtare në Traktate (neni 5, TBE), por secili institucion i Bashkimit Evropian duhet të veprojë brenda kufijve të kompetencave të tij (neni 13/2, TBE). Gjykata e Drejtësisë është shprehur në rastin *Partia Ekologjike (Les Verts) kundër Parlamentit Evropian* se Shtetet Anëtare dhe institucionet e Komunitetit duhet të veprojnë në përputhje me Traktatet.²²²

Në nivelin e tretë, janë *parimet e bashkëpunimit dhe të komplementaritetit* (plotësueshmërisë), (Cremona, 2008: 13). Ky nivel i tretë i koherencës nënkupton sinergjinë midis normave, aktorëve dhe instrumenteve të Bashkimit Evropian. Parimi i bashkëpunimit të sinqertë (neni 4/3, TBE), interpretohet si koherencës vertikale, ndërsa parimi i bashkëpunimit të sinqertë të ndërsjellë (neni 13/2, TBE) interpretohet si koherencë

²²¹ Pra, në rastet kur normat e Shteteve Anëtare bien në konflikt me normat e Bashkimit Evropian, atëherë normat e Bashkimit Evropian prevalojnë mbi normat kombëtare të shteteve Anëtare.

²²² Vendimi C-294/83 *Parti Ecologiste ('Les Verts') kundër Parlamentit Evropian* [1986] ECR 1339, shih citimin origjinal të paragrafit 23, sipas të cilit: ... *inasmuch as neither its Member States nor its institutions can avoid a review of the question whether the measures adopted by them are in conformity with the basic constitutional charter, the treaty...*

horizontale (Cremona, 2011: 61). Koherenca ndahet në tre dimensione kryesore, në koherencën vertikale në koherencën horizontale dhe koherencën multilaterale

(i) *Koherenca vertikale* trajton koherencën ndërmjet dy lloje politikash, nga njëra anë janë politikat e jashtme të Bashkimit Evropian dhe nga ana tjetër janë politikat e jashtme kombëtare të Shteteve Anëtare. Neni 24/3 TBE, është dispozita kryesore që parashikon koherencën vertikale. Ndërmjet Shteteve Anëtare dhe BE-së ka koherencë, atëherë kur Shtetet Anëtare hartojnë politikat e tyre në përputhje të plotë me objektivat dhe politikat e BE-së.²²³ Kjo koherencë i referohet marrëdhënieve, ndërmjet Shtetit Anëtar dhe veprimit të jashtëm të BE-së, në veçanti mosmarrëveshjet ku Shtetet Anëtare dhe BE-ja mund të veprojnë në të njëjtën kohë në raport me të njëjtën politikë ose lëndë (Cremona, 2008: 16).

Koherenca vertikale si pjesë e nivelit të parë, në kuadër të *rregullave të hierarkisë* përqendrohet në sundimin e përparësisë së legjislacionit të Bashkimit Evropian mbi legjislacionin e Shteteve Anëtare. Doktrina e përparësisë është definuar nga jurisprudenca e Gjykatës të Drejtësisë në një sërë rastesh, në *Costa kundër Enel*,²²⁴ *Simmenthal*,²²⁵ *Solange I*²²⁶ dhe *Solange II*²²⁷ etj. Megjithëse duhet theksuar se rendet kushtetuese të Shteteve Anëtare kanë kontestuar në një sërë rastesh supremacinë e të drejtës së Bashkimit Evropian. Lidhur me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët nuk mund të flasim për

²²³ Neni 24/3, TBE: “Shtetet Anëtare e mbështesin aktivisht dhe pa rezerva politikën e jashtme dhe të sigurimit të Bashkimit Evropian, me frymën e besnikërisë dhe solidaritetit të ndërsjelltë dhe e respektojnë veprimin e Bashkimit Evropian në këtë fushë”.

²²⁴ Vendimi C-6/64, *Falminio Costa kundër ENEL* [1964] ECR 585, 593

²²⁵ Vendimi C-106/77 *Simmenthal* [1978] ECR 629.

²²⁶ Vendimi C-11/70 *Internationale Handelsgesellschaft* [1970] ECR 1125; Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Solange I (Internationale Handelsgesellschaft von Einfuhr- und Vorratsstelle für Getreide und Futtermittel)* BVerfGE 37, 271 [1974] CMLR 540.

²²⁷ Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Solange II* BVerfGE 73, 339 2 BvR 197/83.

jurisprudencën e GJED-së dhe për supremacinë e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Shtetet Anëtare si Franca,²²⁸ Mbretëria e Bashkuar,²²⁹ Italia,²³⁰ Gjermania etj., kanë kundërshtuar në disa raste supremacinë e të drejtës komunitare.

Sipas jurisprudencës së GJED-së rregullat e hierarkisë përcaktojnë se kur normat janë në konflikt, legjislacioni i Bashkimit Evropian mbizotëron mbi legjislacionin kombëtar të Shteteve Anëtare.²³¹ Pra, në rastet kur normat e Shteteve Anëtare bien në konflikt me normat e Bashkimit Evropian, atëherë normat e Bashkimit Evropian prevalojnë mbi normat kombëtare të Shteteve Anëtare. Doktrina e epërsisë i kërkon gjykatave kombëtare të mos aplikojnë, një ligj kombëtar që është konfliktual me të drejtën e Komunitetit.²³²

Në këtë studim nuk është rasti të ndalemi në një analizë të zgjatur të doktrinës së supremacisë, (e cila është zhvilluar në fushën ekonomike) por në kuadër të përcaktimit të koherencës vertikale le t'i referohemi dy raste të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane.

²²⁸ Vendim i Gjykatës Supreme Administrative të Francës (Conseil d'Etat), çështja *Syndicat Général de Fabricants de Semoules de France* [1970] CMLR 395; Vendim i Gjykatës Supreme Administrative të Francës (Conseil d'Etat), çështja *Raoul Georges Nicolo* [1975] 2 CMLR 336; Gjykata Supreme e gjykatave të zakonshme, Gjykata e Kasacionit (Cour de Cassation), çështja *Administration des Douanes kundër Société 'Cafes Jacques Vabre' et SARL Wiegel et Cie* [1975] 1 CMLR 173.

²²⁹ Vendim i Dhomës së e Lordëve (House of Lords), çështja *R (Factortame Ltd) kundër Secretary of State for Transport* (No 2) [1991] 1 AC 603; Vendim i Lord Denning (Britani e Madhe), çështja *Shields kundër Coomes (Holdings) Ltd* [1979] 1 ALL ER 456, 461; Vendim i Gjykatës së Apelit Anglez, çështja *Macarthys kundër Smith* (1979) 3 ALL ER 325, 329; Vendim i Dhomës së Lordëve (House of Lords), çështja *Garland kundër British Rail* [1983] 2 AC 751, 771.

²³⁰ Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane, çështja *Frontini kundër Ministero delle Finanze* [1974] 2 CMLR 372, 384.

²³¹ Vendimi C-6/64, *Falminio Costa kundër ENEL* [1964] ECR 585, 593; Vendimi 106/77 *Simmenthal* [1978] ECR 629; Vendimi C-106/89 *Marleasing* [1991] ECR I-7321; Vendimi C-11/70 (1970) ECR 1125.

²³² Vendimi C-106/77 *Simmenthal* [1978] ECR 629, shih citimin origjinal të paragrafit 3, sipas të cilit: *In accordance with the principle of the precedence of community law, the relationship between provisions of the treaty and directly applicable measures of the institutions on the one hand and the national law of the member states on the other is such that those provisions and measures not only by their entry into force render automatically inapplicable any conflicting provision of current national law but - in so far as they are an integral part of, and take precedence in, the legal order applicable in the territory of each of the member states - also preclude the valid adoption of new national legislative measures to the extent to which they would be incompatible with community provisions.*; Vendimi C-213/89 *R kundër Secretary of State for Transport ex parte Factortame* [1990] ECR I-02433.

Një rast i veçantë studimi lidhet me doktrinën *Solange*²³³ për përparësinë e të drejtës komunitare ndaj të drejtës së brendshme. Çështja *Solange I* në vitin 1974 është një çështje e debatuar nga Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane. Çështja kishte si subjekt vlefshmërinë e disa neneve të Rregulloreve të Këshillit dhe Komisionit²³⁴ në fushën ekonomike (interpretimi i çështjes zhvillohet në kuadrin e doktrinës së përparësisë, në aspektin ekonomik pa marrë parasysh PJSP-në).

Në këtë vendim Gjykata e Drejtësisë konstatoi se referimi i normave juridike ose koncepte të ligjit kombëtar për të gjykuar vlefshmërinë e masave të miratuara nga institucionet e Komunitetit kanë efekt negativ mbi uniformitetin dhe efikasitetin e të drejtës së komunitetit.²³⁵ Sipas aplikantit dispozitat e dy rregulloreve të institucioneve të komunitetit ishin në kundërshtim me parimet e të drejtës kushtetuese kombëtare, në këtë rast të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane.

Arsyetimi i GJED-së ndaj këtij pretendimi ishte se vlefshmëria e masave të tilla mund të gjykohej vetëm në dritën e të drejtës komunitare.²³⁶ Sipas GJED-së e drejta që rrjedh nga Traktatet nuk mundet që për shkak të natyrës së saj të kapërcehet nga rregullat e të drejtës së brendshme, dhe për këtë vlefshmëria e një mase komunitare ose efekti i saj

²³³ Vendimi C-11/70 (1970) ECR 1125; Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Solange II* BVerfGE 73, 339 2 BvR 197/83.

²³⁴ *Council Regulation (EC) No 120/67/EEC* of 12 March 1973 concerning the Community arrangements applicable to the Channel Islands and the Isle of Man for trade in agricultural products (dispozita e kontestuar: nënparagrafi i tretë i nenit 12/1 i Rregullores); *Commission Regulation (EC) No 473/67/EEC* of 21 august 1967 on import and export licences for cereals and processed cereal products, rice, broken rice and processed rice products (dispozita e kontestuar: neni 9 i Rregullores).

²³⁵ Vendimi C-11/70 (1970) ECR 1125, paragrafit 3.

²³⁶ Vendimi C-11/70 (1970) ECR 1125, shih citimin origjinal të paragrafit 3, sipas të cilit: *in fact, the law stemming from the treaty, an independent source of law, cannot because of its very nature be overridden by rules of national law, however framed, without being deprived of its character as community law and without the legal basis of the community itself being called in question. therefore the validity of a community measure or its effect within a member state cannot be affected by allegations that it runs counter to either fundamental rights as formulated by the constitution of that state or the principles of a national constitutional structure.*

brenda një Shteti Anëtar nuk mund të ndikohet nga pretendimet që bien ndesh me parimet kushtetuese kombëtare.²³⁷

Pas dhënies së vendimit të GJED-së, Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane vendos në këtë çështje,²³⁸ se pretendimi i përparësisë së ligjit të KE-së mbi të drejtën kushtetuese të Shteteve Anëtare nuk mund të tolerohet dhe të merret si i mirëqenë për aq kohë sa parimet kushtetuese gjermane janë të mbrojtura në nivel kombëtar.²³⁹ Në rastin *Solange I*, Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane vendos se në një konflikt ndërmjet të drejtës komunitare dhe garantimit të të drejtave themelore nga kushtetuta Gjermane, të drejtat kushtetuese gjermane mbizotërojnë mbi të gjitha standardeve kontradiktore të së drejtës së Komunitetit.²⁴⁰ Duke kundërshtuar në këtë mënyrë doktrinën e përparësisë të përcaktuar në vendimin *Costa kundër ENEL*.

Një qëndrim më të zbutur mbajti Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane në vendimin e mëvonshëm *Solange II*,²⁴¹ të vitit 1986 dhe në vendimin e njohur si çështja e *Maastrichtit*²⁴² në vitin 1993. Në këto çështje Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane duke pranuar juridiksionin e saj në fushën e të drejtave themelore shprehu se, pranonte përparësinë e të drejtës komunitare për aq kohë sa e drejta komunitare siguron mbrojtje efektive të të drejtave themelore.²⁴³

²³⁷ Vendimi C-11/70 (1970) ECR 1125, shih paragrafin 3, sipas të cilit: *the validity of such measures can only be judged in the light of community law*.

²³⁸ Çështja *Solange I* BVerfGE 37, 271 [1974] CMLR 540.

²³⁹ Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Solange II* BVerfGE 73, 339 2 BvR 197/83.

²⁴⁰ Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Solange I* (*Internationale Handelsgesellschaft von Einfuhr- und Vorratsstelle für Getreide und Futtermittel*) BVerfGE 37, 271 [1974] CMLR 540, paragrafi 4.

²⁴¹ Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Solange II* BVerfGE 73, 339 2 BvR 197/83.

²⁴² Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Maastricht* BVerfGE 89, 155/93; Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane BvR 2134/92 dhe 2159/92 *Brunner dhe të tjerë kundër Traktatit të Bashkimit Evropian* CMLR [1994] 57.

²⁴³ Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Solange II* BVerfGE 73, 339 2 BvR 197/83, shih citimin origjinal të paragrafit 2, sipas të cilit: *As long as the European Communities, in particular European Court*

Problematika e shtruar në sy rastet *Solange*, tregon që Shtetet Anëtare me shumë vështirësi kanë njohur përparësinë e legjislacioni të Bashkimit Evropian ndaj të drejtës së tyre, për çështje specifike. Situata ndryshon në rastin e politikës së jashtme dhe të sigurisë, përparësia e legjislacionit të shteteve është ajo që sundon. Megjithatë Shtetet Anëtare kanë detyrimin të hartojnë dhe zbatojnë politika të jashtme dhe të sigurisë në përputhje me objektivat e Bashkimit Evropian.

Problematika e koherencës vertikale del në plan të parë kryesisht kur politikat kombëtare të Shteteve Anëtare rrezikojnë politikat e Bashkimit Evropian (Nuttall, 2005: 106). Shtetet Anëtare nuk mund të ndjekin politika të jashtme, të cilat vijnë në kundërshtim me frymën dhe politikat e miratuara nga Bashkimi Evropian.²⁴⁴ Shtetet Anëtare kanë obligimin e promovimit dhe mbështetjes së Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit Evropian.

Traktati i Lisbonës identifikon një lidhje të qartë mes natyrës së brendshme të Bashkimit Evropian dhe projeksionit të tij të jashtëm, nëpërmjet identifikimit të qëllimit të tij primar për të ofruar mbrojtje, paqe dhe siguri në arenën ndërkombëtare (Tocci, 2011). Rritja e rolit të Bashkimit Evropian, si aktor global në zgjidhjen e konflikteve mund të realizohet vetëm nëse ekziston dhe zbatohet në mënyrë të drejtë koherenca vertikale. Sipas autorëve Bergmann dhe Niemann (2015: 9) një shkallë e ulët e koherencës vertikale ka një efekt negativ mbi efektivitetin e ndërmjetësit të Bashkimit Evropian në zgjidhjen e konflikteve për dy arsye:

case law, generally ensure effective protection of fundamental rights..., the Federal Constitutional Court will no longer exercise its jurisdiction to decide on the applicability of secondary Community legislation cited as the legal basis for any acts of German courts or authorities within the sovereign jurisdiction of the Federal Republic of Germany, and it will no longer review such legislation by the standard of the fundamental rights contained in the Basic Law.

²⁴⁴ Neni 24/3, TBE.

Së pari, në qoftë se BE-ja nuk ka mbështetjen e veçantë të një Shteti Anëtar apo mbështetjen e një grupi Shtetesh Anëtare për një politikë të jashtme, për parandalimin apo zgjidhjen e një konflikti, palët ndërluftuese do të kenë dyshime në lidhje me aftësinë e BE-së për zgjidhjen e konfliktit. Palët në konflikt do të kenë dyshime në aftësinë e tij për të mbajtur premtimet që janë dhënë gjatë procesit të negociatave, për shembull, ndihmë financiare që iu ofron Bashkimi Evropian palëve, si një nxitje pozitive për të bërë lëshime me palën tjetër në konflikt.

Së dyti, niveli i ulët i koherencës së politikave të jashtme të Shteteve Anëtare me ato të Bashkimit Evropian, në cilësinë e ndërmjetësuesit mund të gjenerojë ose të intensifikojë probleme, të cilat jo vetëm nuk zgjidhin konfliktin, por mund të përshkallëzojnë nivelin e tij.

(ii) *Koherenca horizontale* i referohet qëndrueshmërisë ndërmjet politikave të Bashkimit Evropian më konkretisht në kuadër të objektit tonë të shqyrtimit, koherenca ndërmjet PJSP, PSMP dhe politikave të tjera të Bashkimit Evropian. Kuadri ligjor i kësaj koherence mund të perifrazohet në tre dispozita të Traktateve të Bashkimit Evropian, përkatësisht në nenin 21/3, TBE, në nenin 3, TBE dhe nenin 7, TFBE. Këto dispozita rregullojnë pajtueshmërinë midis politikave dhe aktiviteteve të Bashkimit Evropian. Para miratimit të Traktatit të Lisbonës, koherenca horizontale analizohej në kuadrin e marrëdhënies ndërmjet shtyllave (Cremona, 2011: 76). Për këtë arsye koherenca horizontale konsiderohet si ekuivalent i koherencës ndërmjet shtyllave (Gebhard, 2011: 107).

Traktati i Lisbonës, nëpërmjet eliminimit të tre shtyllave solli ndryshime të rëndësishme në rritjen e koherencës horizontale, koherencës dhe unitetit ndërmjet

politikave të Bashkimit Evropian. Megjithëse, ndarja formale ndërmjet tre shtyllave është zhdukur, dallime të rëndësishme evidentohen ndërmjet politikave të Bashkimit Evropian. Këto dallime shtrihen kryesisht në aspektin e roleve të institucioneve të ndryshme (Cremona, 2011: 76). Koherenca horizontale i referohet bashkëpunimit ndërqeveritar të Shteteve Anëtare duke nënkuptuar shkallën, në të cilën politikat e ndryshme të jashtme të BE-së janë koherente me njëra-tjetrën.

Në fushën e politikës së jashtme janë bërë përpjekje për të rritur koherencën, nëpërmjet krijimit të një grupi parimesh dhe objektivash të përbashkëta për të gjithë PJSP-në të Bashkimit Evropian. Koherenca nuk ka parasysh heqjen e dallimeve ndërmjet politikave dhe strukturave institucionale, ajo pranon ekzistencën e dallimeve, por me kusht që këto dallime të mos pengojnë harmoninë ndërmjet dy aspekteve, aspektet ndër-institucionale dhe aspektet ndër-politike (Cremona, 2008: 11–36).

Koherenca horizontale në lidhje me PJSP-në dhe institucionet, që ushtrojnë veprimtarinë e kësaj politike përbëjnë një nga qëllimet kryesore të Traktatit të Lisbonës. Këtu theksohet roli i Përfaqësuesit të Lartë, si përgjegjës për sigurimin e koherencës institucionale (Koehler, 2010: 59). Koherenca horizontale trajtohet gjithashtu edhe si koherencë institucionale. Koherenca horizontale është ndoshta qasja më e trajtuar nga akademikët për shkak të kapacitetit të BE-së për të ndikuar shtetet e tjera dhe të kapacitetit të tij për të vepruar, si një njësi e vetme (Aggestam, Anesi, Edwards, Hill, dhe David, 2008:12).

Ashtu si në koherencën vertikale edhe në koherencën horizontale doktrina ka evidentuar disa probleme në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare nga Bashkimi Evropian dhe në menaxhimin e krizave. Në vijim të kësaj ideje, sipas autorëve Keukeleire, Kalaja,

Collaku (2011: 202) politika e Bashkimit Evropian drejt Kosovës pasqyron mungesën e koherencës ndërmjet Shteteve Anëtare, kjo si pasojë me mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës nga të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së.²⁴⁵ Kjo mungesë mund të çojë në kontestimin e rolit të Bashkimit Evropian, si aktor global.

Por, pavarësisht prej pengesave dhe inkoherencës së Bashkimit Evropian për të rritur rolin e tij, si aktor global, Traktati i Lisbonës ka sjellë ndryshime të rëndësishme për koherencën horizontale (Portela dhe Raube, 2011: 20). Në kuadër të analizës së koherencës institucionale miratimi i Përfaqësuesit të Lartë, Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian në Traktatin e Lisbonës, në vend të tejkalimit të konfliktit të kompetencave në administrimin e krizave civile, institucionalizon koordinimin e institucioneve dikur të ndara (Portela dhe Raube, 2011: 20).

Koherenca institucionale është një sfidë në dy situata: kur një zonë e vetme politike, ushtrohet nga dy grupe të aktorëve, me procedura të ndryshme (koherenca ndër-institucionale) dhe kur aktorë të ndryshëm brenda të njëjtës organizatë kanë qasje të ndryshme në axhendë (Nuttall, 2005: 99-103). Krahas interpretimit të perspektivës politike të koherencës horizontale/institucionale një vend të rëndësishëm për interpretim i rezervohet jurisprudencës së GJED-së e cila në një sërë rastesh pasqyron mosmarrëveshje ndërmjet institucioneve të BE-së.

Gjykata e Drejtësisë në çështjen *ECOWAS*²⁴⁶ të vitit 2008, anuloi një vendim të Këshillit për një veprim të përbashkët, lidhur me një mosmarrëveshje ndërmjet Komisionit

²⁴⁵ Shih: Kreun VII, 7.3 “c) Raste praktike të ndërmjetësimit nga Bashkimi Evropian” të këtij studimi.

²⁴⁶ Vendimi C-91/05 *Komisioni kundër Këshillit* (ECOWAS), [2008] ECR, I-3651.

dhe Këshillit, për shkeljen e kompetencave ndërmjet të drejtës komunitare dhe PJSP-së.²⁴⁷ Në këtë çështje Këshilli ndërmorri një veprim të përbashkët (*join action*)²⁴⁸ dhe më pas miratoi një vendim²⁴⁹ në kuadër të PJSP-së, që prekte aspekte të sigurisë dhe të mbrojtjes. Ndërkohë Komisioni kishte konkluduar se ky vendim nuk duhet të miratohej në kuadrin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët sepse i përkiste të drejtës komunitare (shtyllës së parë në atë kohë).²⁵⁰ Komisioni paraqiti një padi përpara Gjykatës së Drejtësisë për anulimin e vendimit në fjalë, duke marrë parasysh se ky vendim ishte miratuar në mënyrë të pasaktë ligjore.

Gjykata e Drejtësisë konkludoi se miratimi i një vendimi në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, marrja e një mase që ka efekt ligjor në këtë politikë, ndikon dispozitat e Traktatit të KE në kuptim të nenin 47 (pas Lisbonës neni 40, TBE) nëse është miratuar në bazë të Traktatit të KE.²⁵¹ Gjykata theksoi se, në bazë të nenit 47, TBE-së, një masë që mund të miratohet në bazë të Traktatit të KE nuk mund të miratohet në kuadër të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, edhe nëse çështja përfshin komponentë, apo objektiva të PJSP, kur ajo gjithashtu bie brenda një kompetence të

²⁴⁷ ECOWAS (Komuniteti Ekonomik i Shteteve të Afrikës Perëndimore). Në vitin 2000 Bashkimi Evropian nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi të quajtur Marrëveshja Cotonou me Afrikën, Karaibet dhe Shtetet e Paqësorit. Marrëveshja parashikonte marrjen e masave për ndërtimin e paqes, zgjidhjes së konflikteve, me një monetarium të mbështetur nga OKB për importin dhe eksportin e armëve të vogla në Afrikën Perëndimore. Bashkimi Evropian zhvilloi një program asistence teknike të projektuar për të ndihmuar shtetet e ECOWAS për eliminimin e armëve të vogla të tepërta dhe municioneve brenda territoreve të tyre. Këto masa u miratuan nën shtyllën e dytë duke sjellë dhe mosmarrëveshjen ndërmjet institucioneve të BE.

²⁴⁸ Veprim i Përbashkët i Këshillit 2002/589/PJSP i 12 korrikut 2002, mbi kontributin e Bashkimit Evropian për akumulimet destabilizuese dhe përhapjen e armëve të vogla dhe armëve të lehta, që shfuqizon veprimin e përbashkët 1999/34/PJSP (*Council Joint Action 2002/589/CFSP*).

²⁴⁹ Vendim i Këshillit 2004/883/PJSP i 2 dhjetorit 2004 për zbatimin e Veprimit të Përbashkët 2002/589/PJSP për kontributin e Bashkimit Evropian në ECOWAS në kuadër të Moratoriumit mbi Armët e Vogla dhe të Lehta (*Council Decision 2004/833/CFSP*).

²⁵⁰ Instrumenti i Bashkimit Evropian për të cilën lindi mosmarrëveshja ndërmjet institucioneve të BE-së ishte për kontributin financiar të ECOWAS që përfshinte në të njëjtën kohë si bashkëpunimin për zhvillim ashtu edhe paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

²⁵¹ Vendimi C-91/05 *Komisioni kundër Këshillit* (ECOWAS), [2008] ECR, I-3651, paragrafi 60.

akorduar nga Traktati i KE-së.²⁵² Neni 47 TBE, që ishte kryesor për vendimin e Gjykatës në *ECOWAS*, tanimë është zëvendësuar nga neni 40 TBE.

Kjo dispozitë asiston politikën e jashtme dhe të sigurisë në politikat e tjera të BE-së dhe përcakton se asnjë fushë nuk ndikon në zbatimin e procedurave, ose në zgjerimin e ushtrimit të pushtetit të tjerëve. Ky ndryshim ishte pjesë e marrëveshjes midis negociatorëve të Traktatit të Lisbonës, për integrimin e plotë të PJSP-së brenda kornizës së përgjithshme të BE-së. Për përmirësimin dhe zgjerimin e statusit të PJSP-së si politikë e një fushe autonome me tërësinë e saj të normave, sidomos në marrëdhënien e saj me pjesën tjetër të së drejtës së BE-së dhe kornizës së politikave (Craig dhe De Burca, 2011).

Gjykata bëri të qartë se marrja e masave në bazë të kompetencave të Komunitetit, duke përfshirë dhe kompetencat jo ekskluzive si p.sh, bashkëpunimi për zhvillim, bëjnë që çdo masë e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët të jetë ilegale.²⁵³ Për më tepër, çështja nëse dispozitat e një mase të tillë të miratuar nga Bashkimi Evropian bien brenda kompetencës së Komunitetit lidhet me cilësimin për vetë ekzistencën e kësaj kompetence, dhe jo natyrën e saj si kompetencë ekskluzive apo të përbashkët.²⁵⁴

(iii) *Koherenca multilaterale* rregullohet nga neni 11, TBE dhe neni 208, TFBE në titullin “Bashkëpunimi për Zhvillim”. Koherenca multilaterale përcakton qëndrueshmërinë apo koherencën, ndërmjet veprimeve të jashtme të Bashkimit Evropian dhe aktorëve të tjerë ndërkombëtarë në të njëjtën fushë si p.sh, zgjidhja e konflikteve. Ndjekja e objektivave të

²⁵² Vendimi C-91/05 *Komisioni kundër Këshillit* (ECOWAS), [2008] ECR, I-3651.

²⁵³ Në lidhje me mosmarrëveshjen ndërmjet shtyllave dy raste shumë të ngjashme me çështjen ECOWAS janë çështjet: *Environmental Criminal Law*, Vendimi C-176/03 *Komisioni kundër Këshillit* [2005] ECR I-7879 dhe çështja *Ship-Source Pollution*, Vendimi C-440/05 *Komisioni kundër Këshillit* [2007] ECR I-9097. Këto dy vendime të GJED-së nuk trajtohen këtu për shkak se nuk përfshijnë si objekt të tyre Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

²⁵⁴ Vendimi C-91/05 *Komisioni kundër Këshillit* (ECOWAS), [2008] ECR, I-3651, paragrafi 62. Gjithashtu shih: Vendimin C-459/03 *Komisioni kundër Irlandës* [2006] ECR I-4635, paragrafi 93.

njëjta ose të ngjashme ndërmjet Bashkimit Evropian dhe organizatave ndërkombëtare si OKB-ja, NATO etj., në menaxhimin apo parandalimin e një gjëndje konfliktuale. Koherenca multilaterale përqendrohet në bashkëpunimin ndërmjet Bashkimit Evropian dhe aktorëve të tjerë ndërkombëtarë për çështje, të cilat kanë interes të përgjithshëm ndërkombëtar.

Bashkimi Evropian duhet të mbajë qëndrim të njëjtë me aktorët e tjerë ndërkombëtarë në rastet e ndërhyrjes për menaxhimin e krizave dhe ndalimin e përshkallëzimit të konfliktit në dhunë të ashpër. Sipas nenit 11, TBE nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar është qëllim i rëndësishëm i veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian. Ndërsa në dispozita të tjera parashikohet gatishmëria e Bashkimit Evropian për të bashkëpunuar me organizata të tjera ndërkombëtare,²⁵⁵ p.sh, me OKB-në (në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes), me NATO-n (në fushën e misionëve civile dhe ushtarake), si dhe një numër i madh organizatash ndërkombëtare, të ngritura në fusha të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme.

Në çdo rast në traktatet e Bashkimit Evropian nënvizohet respektimi dhe bashkëpunimi me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare.²⁵⁶ Në nenin 208 parashikohet se Bashkimi Evropian përmbush objektivat në kuadër të OKB, me qëllim bashkëpunimin për parandalimin, zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare dhe menaxhimin e krizave. Bashkëpunimi i Bashkimit Evropian me organizatat e tjera ndërkombëtare, nuk synon realizimin vetëm të ndihmës humanitare dhe

²⁵⁵ Neni 208, TFBE.

²⁵⁶ Neni 208/2, TFBE: “Bashkimi Evropian dhe Shtetet Anëtare përmbushin angazhimet dhe marrin në konsideratë objektivat, që kanë miratuar në kuadër të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave ndërkombëtare kompetente”.

bashkëpunimin me vendet e treta, por edhe bashkëpunimin me qëllim zgjidhjen e konflikteve të llojeve të ndryshme, konflikteve me karakter territorial, fetar, politik, ekonomik, etnik dhe ideologjik.

3.2. Kapaciteti i jashtëm dhe natyra e kompetencave të veçanta të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët

Analiza e argumentave lidhur me kompetencat, kapacitetin dhe personalitetin juridik na ofrojnë tablonë e duhur, për t'u njohur me figurën e Bashkimit Evropian në favor të objektit të këtij studimi. Kompetencat përbëjnë një element përcaktues të rolit të Bashkimit Evropian, dhe është Gjykata Evropiane e Drejtësisë e cila nëpërmjet jurisprudencës së saj,²⁵⁷ ka dhënë verdiktin përfundimtar të kompetencave të jashtme të Bashkimit Evropian.

Megjithatë, duhet të sqarojmë që GJED-ja nuk ka juridiksion në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë dhe se vendimet që analizohen në kuadër të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, janë vendime që trajtojnë mosmarrëveshje në fusha të ndryshme të Bashkimit Evropian në drejtim të kompetencave të jashtme. Shqyrtimi i kompetencave të Bashkimit Evropian dhe ndarja e kompetencave me Shtetet Anëtare përcaktojnë kapacitetin e BE-së për të vepruar si një aktor ndërkombëtar, aftësinë e BE-së për të folur në një zë të vetëm, si dhe rolin e BE-së në arenën ndërkombëtare. Një çështje e rëndësishme që përcakton kapacitetin e jashtëm të Bashkimit Evropian dhe aftësinë e tij për

²⁵⁷ Ka një sërë vendimesh të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë lidhur me ndrajen e kompetencave ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare, shih: Vendimin C-91/05 *Komisioni kundër Këshillit (ECOWAS)* [2008] I-3651; Vendimin C-300/89, *Titanium dioxide* [1991] ECR I-2867; Vendimin C-336/00 *Huber* [2002] ECR I-7699; Vendimin C-176/03 *Komisioni kundër Këshillit* ECR [2005] I-7879; Vendimin C-440/05 *Komisioni kundër Këshillit* ECR [2007] I-9097; Vendimin C-268/94 *Portugalia kundër Këshillit* [1996] ECR I-6177.

të luajtur një rol në arenën ndërkombëtare lidhet me personalitetin juridik të Bashkimit Evropian.

3.2.1. Personaliteti juridik si element i rëndësishëm për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare

Në përcaktimin e rolit të Bashkimit Evropian si një aktor i vetëm ndërkombëtar, nisur nga perspektiva juridike, doktrina shpeshherë i është referuar personalitetit juridik të Bashkimit Evropian. Mbi bazën e këtij argumenti një dobësi themelore ligjore për ndërtimin e rolit të Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare lidhet me paqartësinë që rrjedh nga personaliteti juridik i BE-së. Bashkimi Evropian, shpeshherë është kritikuar, se nuk kishte një personalitet juridik dhe se aktet e tij i përkisnin bashkësisë së Shteteve Anëtare (Jacque, 2010: 144).

Gjykata e Drejtësisë nëpërmjet vendimit të saj të hershëm, *Costa kundër ENEL* argumentoi lidhur me sistemin juridik të Komunitetit Evropian dhe theksoi se KE-ja zotëron personalitetin e vet, kapacitetin e vet ligjor dhe kapacitetin për përfaqësimin në planin ndërkombëtar.²⁵⁸ Komuniteti Evropian dhe Euratomi kishin secili personalitet juridik, kurse Traktati i Bashkimit Evropian në Traktatin e Maastrichtit nuk përmbante asnjë dispozitë për personalitetin juridik (Bindi, 2010:41). Megjithëse personaliteti juridik i Bashkimit Evropian nuk përmendet shprehimisht në Traktatin e Maastrichtit askush nuk e vë në dyshim gëzimin e kësaj cilësie prej tij (Krisafit, 2015: 286).

²⁵⁸ Vendimi C-6/64 *Costa kundër ENEL* [1964] ECR 585, shih citimin origjinal të paragrafit 13, sipas të cilit: *By creating a community of unlimited duration, having its own institutions, its own personality, its own legal capacity and capacity of representation on the international plane and, more particularly, real powers stemming from a limitation of sovereignty or a transfer of powers from the states to the community, the member states have limited their sovereign rights and have thus created a body of law which binds both their nationals and themselves.*

Një ndryshim domethënës së këtë aspekt erdhi me miratimin e Traktatit të Lisbonës, i cili krijoi një aktor të vetëm ndërkombëtar, Bashkimi Evropian. Traktati i Bashkimit Evropian, parashikon se, *Bashkimi Evropian ka personalitet juridik*.²⁵⁹ Bashkimi Evropian përforcoi aftësinë e tij për të vepruar në skenën ndërkombëtare, pas absorbimit të KE dhe delegimit të personalitetit juridik mbi Bashkimin Evropian (Sari, 2012:3). Sipas doktrinë, me këtë shprehje supozohet, se thuhet personalitet juridik ndërkombëtar (Chalmers, Davies dhe Monti, 2010: 634). Pra, personalitet juridik ndërkombëtar në këtë mënyrë nënkupton, jo më shumë se të qenit subjekt i së drejtës ndërkombëtare publike (Hafner, 1998: 259).

Nocioni i personalitetit juridik është definuar nga Gjykata e Drejtësisë në çështjen e famshme *ERTA*,²⁶⁰ dhe në Opinionin Këshillimor lidhur me rastin për *Riparimin e dëmtimeve të pësuar në shërbimin e Kombeve të Bashkuara*.²⁶¹ Në përputhje me opinionin këshillimor të *Riparimit të dëmtimeve të pësuar në shërbim të Kombeve të Bashkuara*,²⁶² doktrina shpreh se personaliteti ligjor i organizatave ndërkombëtare buron prej instrumenteve të tyre dhe nga pëlqimi ose vullneti i krijuesit të tyre, qoftë i manifestuar shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar. Në kuadër të këtij personaliteti Bashkimi Evropian ka tagrin për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare, për t'u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare, apo për të dërguar delegacione në shtetet jo-anëtare të tij.

Bashkimit Evropian i njihet e drejta për të hyrë në marrëdhënie juridike më të tretët dhe për të qenë subjekt i së drejtës ndërkombëtare dhe i gjykatave ndërkombëtare.

²⁵⁹ Neni 47, TBE.

²⁶⁰ Vendimi 22/70 *Komisioni kundër Këshillit (ERTA)* [1971] ECR 263, shih paragrafin 13, sipas të cilit: *Article 210 provides that the community shall have legal personality*.

²⁶¹ *Reparation for Injuries Suffered in the Service of the United Nations* (Advisory Opinion) (1949) ICJ Rep. 174.

²⁶² Shih gjithashtu: Rama dhe Montaldo, (1970, 111–131); Bederman, (1995–1996); Amerasinghe, (2005, 77–86); White, (2005, 68–69); Akande, (2006, 282); Klabbers, (2009, 46–51); Sands dhe Klein, (2009, 473–480).

Ndërkohë që personaliteti juridik nuk është gjë tjetër veçse një subjekt i pavarur brenda rendit ligjor ndërkombëtar (Wessel, 2000: 510). Personaliteti juridik mund të përkufizohet, si aftësia e mundshme për të ushtruar të drejta të caktuara dhe për të përmbushur detyrime të caktuara (Bekker, 1994: 53).

Personaliteti juridik i organizatave ndërkombëtare del nga instrumentet e tyre përbërëse me pëlqimin ose vullnetin e krijuesit të tyre (shtetet), (Sari, 2012:2). Mirëpo krijimi i personaliteti juridik për Bashkimin Evropian dhe krijimi i një personi juridik, pavarësisht parashikimit në dispozita, nuk redukton problemet e bazës ligjore²⁶³ që lindin në kontekstin ndër-shtyllor²⁶⁴ ose ndërmjet BE-së dhe PJSP-së. Gjithsesi në kontekstin e kompetencave, kapacitetit dhe personaliteti juridik të Bashkimit Evropian vërehet aftësia e BE-së për të nënshkruar marrëveshje dhe për të vepruar si një aktor ndërkombëtar.

Lidhur me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, rregullimi i qartë i personalitetit juridik të Bashkimit Evropian ka të paktën dy rrjedhoja: *së pari*, ajo ka të bëjë me personin, i cili vepron si një palë në marrëdhëniet ndërkombëtare, Përfaqësuesin e Lartë, veçanërisht si “palë kontraktuese evropiane” në marrëveshjet ndërkombëtare, dhe *së dyti*, kjo korrespondon me mjetet (instrumentet) e jashtme të Bashkimit Evropian për zbatimin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (Koehler, 2010: 63). Në këtë drejtim vëmëndja drejtohet natyrshëm tek marrëveshjet ndërkombëtare dhe ndarja e përgjegjësisë midis Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

²⁶³ Opinion 2/2000 (re *Cartagena Protocol*) [2001] ECR I-9713; Vendimi C-281/01 *Komisioni kundër Këshillit* (Energy Star Agreement) [2002] ECR I-12049; Vendimi C-94/03 *Komisioni i Komuniteteve Evropiane kundër Këshillit* [2006] ECR I-1.

²⁶⁴ Vendimi C-176/03 *Komisioni kundër Këshillit* [2005] ECR I-7879; Vendimi C-403/05 *Parlamenti Evropian kundër Komisionit* (Philippines Border Management Project) [2007] ECR I-9045; Vendimi C-91/05 *Komisioni kundër Këshillit* (ECOWAS) [2008] ECR I-3651.

Ashtu siç e përmendëm më sipër marrëveshjet në fushën e PJSP-së dhe PSMP-së nënshkruhen nga Bashkimi Evropian. Marrëveshja e parë e nënshkruar nga BE-ja në kuadër të PJSP-së ishte vendimi i Këshillit në lidhje me përfundimin e marrëveshjes me Republikën Federale të Jugosllavisë mbi aktivitetet e Bashkimit Evropian për misioni vëzhgues EUMM.²⁶⁵ Konfirmimi i qartë i personalitetit juridik të BE-së në Traktatin e Lisbonës nuk ka ndryshuar asgjë të substancës (De Baere dhe Wessel, 2015: 8) në lidhje me PJSP-në. Në këtë rast është Bashkimi Evropian ai që mban përgjegjësinë parësore nëse zbatimi i një vendimi në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes rezulton një akt ndërkombëtar i gabuar i zbatuar nga institucionet e Bashkimit Evropian ose nga Shteteve Anëtare (Sari, 2008: 53).

Problematika që shtrohet në vijim është se, ndryshe nga të gjitha politikat e tjera të BE-së, vendimet dhe udhëzimet për PJSP-në dhe PSMP-në vështirë të kërkojnë ndonjëherë zbatimin e drejtpërdrejtë nga Shtetet Anëtare. Kur Shtetet Anëtare ndërmarrin aktivitete në bazë të detyrimeve të brendshme të BE-së, situata është e njëjtë me rastin kur Shtetet Anëtare veprojnë në bazë të vendimeve të BE-së (Wessel, 2011: 40-41). Vendimet e PJSP-së dhe PSMP-së nuk janë vetëm të detyrueshme për institucionet, por edhe për Shtetet Anëtare.

Këto vendime zbatohen me pëlqimin e Shteteve Anëtare por zbatohen nga Bashkimi Evropian, i cili është subjekti përgjegjës për zbatimin e këtyre vendimeve nëpërmjet strukturave të tij. Kështu, pavarësisht nga personaliteti juridik i PJSP-së mbetet e veçuar nga fushat e tjera të veprimtarisë së BE dhe drejtohet nga një tërësi rregullash të ndryshme

²⁶⁵ Vendimi i Këshillit 2001/352/PJSP i datës 9 prill 2001 në lidhje me përfundimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) mbi aktivitetet e Misionit Monitorues të Bashkimit Evropian (EUMM) në RFJ (*Council Decision 2001/352/CFSP*).

institucionale dhe procedurale (Craig dhe De Burca, 2011: 446). Fakti se personaliteti juridik i BE-së tani është njohur zyrtarisht në bazë të nenit 47, TBE thjeshtëson statusin e tij dhe duket si një hap i rëndësishëm drejt sigurisë juridike (Pernice, 2009: 396).

Ekziston një shqetësim nga ana e disa Shteteve Anëtare, nëse tagri që gëzon BE-ja, mund të rrezikojë sovranitetin e tyre të brendshëm. Në Deklaratën Nr. 24, Deklaratë në lidhje me personalitetin juridik të Bashkimit Evropian²⁶⁶ theksohet se Bashkimi Evropian nuk vepron jashtë kompetencave, që i janë dhënë atij nga Shtetet Anëtare.²⁶⁷ Bashkimi Evropian mund të veprojë në arenën e jashtme vetëm kur atij i janë dhënë kompetenca për të vepruar nga vetë Shtetet Anëtare (Chalmers, Davies & Monti, 2010: 634).

Miratimi i Traktatit të Lisbonës dhe afirmimi i personalitetit juridik të BE-së, sqaroi lidhjen ndërmjet marrëdhënieve diplomatike të BE-së dhe statusit të institucioneve të saj, duke forcuar pozicionin e Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare, sipas të drejtës ndërkombëtare (Koehler, 2010: 62). Me fjalë të tjera, Bashkimi Evropian është padiskutim një aktor sipas të drejtës ndërkombëtare (Koehler, 2010: 62). Personaliteti juridik ndërkombëtar konsiston në të drejtën e Bashkimit Evropian për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare, për t'u bërë anëtare e organizatave ndërkombëtare dhe mundësinë për të akredituar misione diplomatike.

Akreditimi i misioneve diplomatike sigurohet nga Protokolli për imunitetet dhe privilegjet (Jacque, 2010: 146). Delegacionet e Komisionit u bënë delegacionet e Bashkimit Evropian nën autoritetin e Përfaqësuesit të Lartë dhe janë pjesë e strukturës së Shërbimit

²⁶⁶ Deklarata Nr. 24,: “Konferenca konfirmon se fakti, që Bashkimi Evropian ka një personalitet ligjor, në asnjë mënyrë nuk autorizon Bashkimin Evropian të bëjë ligje ose të veprojë përtej kompetencave, që i janë dhënë atij nga Shtetet Anëtare në Traktate.”

²⁶⁷ Neni 5/2, TBE.

Evropian të Veprimit të Jashtëm.²⁶⁸ Më konkretisht, këto kompetenca të BE-së parashikohen në nenin 218 TFBE.²⁶⁹ Një nga institucionet e rëndësishme për veprimin e jashtëm të BE-së është SHVJE, i cili nuk ka personalitet juridik. Pozita e Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian për të hyrë në marrëdhënie juridike pa patur personalitet juridik të akorduar ishte analoge me atë të vetë BE-së përpara Traktatit të Lisbonës.

Në mënyrë të ngjashme, mungesa e personalitetit eksplicit ligjor i SHVJE nuk ishte një zgjedhje ligjore, por politike (Van Vooren, 2010: 14), pasi Shtetet Anëtare nuk ishin të përgatitura të njihnin BE-në, si një aktor ndërkombëtar.²⁷⁰ Mungesa e personalitetit juridik të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian, nënkupton që pozita e tij është zyrtarisht e ndryshme nga ajo e agjensive rregullatore (Van Vooren, 2010: 15).

3.2.2. Ndarja e kufijve të kompetencave të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët

Përcaktimi i natyrës së kompetencave të veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian, është një faktor i rëndësishëm për ndarjen e përgjegjësisë ndërkombëtare (Hoffmeister, 2010: 743). Komuniteti Evropian, nuk i kushtoi shumë hapësirë ndarjes së kompetencave dhe përgjegjësisë ndërmjet Komunitetit dhe Shteteve Anëtare të tij. Zhvillimet në këtë fushë në një masë të madhe janë drejtuar nga praktika e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (Andrea Ott dhe Wessel, 2006: 19). Traktati i BE-së nuk përcakton llojin e kompetencave të përfshira në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, dhe as nuk sqaron ndarjen

²⁶⁸ Council of the European Union, Presidency Report to the European Council on the European External Action Service, 23 October 2009, 14930/09, Brussels.

²⁶⁹ Neni 218/2, TFBE: “Këshilli autorizon hapjen e negociatave, miraton direktivat për negociatat, autorizon nënshkrimin e marrëveshjeve dhe i lidh ato”.

²⁷⁰ Westendorp Report, ‘Report by the Reflection Group: A Strategy for Europe, presented to the European Council’, 5 December 1995.

e kompetencave të PJSP-së dhe PSMP-së, ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare.

Kompetenca e BE-së në drejtim të PJSP-së janë parashikuar shprehimisht në TFBE, duke qenë dhe traktati që ka sanksionuar kompetencat e Bashkimit Evropian. Këtu, është specifikuar se BE-ja ka në kompetencë të plotë të tij, caktimin e një politikë të jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes (neni 2/4, TFBE).²⁷¹ Dispozitat që rregullojnë kompetencat e BE-së duke përfshirë tre llojet e kompetencave, janë të përcaktuara në TFBE.²⁷² Për rrjedhojë PJSP-ja duke qenë e rregulluar në TBE nuk ka një kuadër të mirëpërcaktuar të kompetencave në TFBE. Pra, PJSP-së dhe PSMP-së në dallim me të gjitha fushat e tjera të Bashkimit Evropian paraqesin një natyrë të veçantë, sepse këto dy politika nuk gjejnë bazat e tyre në TFBE, por në TBE (Evans dhe Koutrakos, 2013: 339-358).

Ndarja e kompetencave ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Bashkimit Evropian në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët është e paqartë. Depërtim në këtë ndarje është bërë më i rëndësishëm në funksion të rritjes së rolit të BE-së si një aktor global (Emerson, 2011).²⁷³ Duket qartë që ka një mbivendosje të kompetencave midis fushës së Shtyllës së Dytë dhe politikave të jashtme të KE-së (Cannizzaro, 2002).

Sipas autorëve Craig dhe De Burca (2011), meqë ndryshimet midis procedurave, kompetencave të institucioneve, garancive për individët dhe natyrës së të drejtës së BE-së (në veçanti të efektit të saj të drejtpërdrejtë dhe, me sa duket, të përparësisë së saj) dhe

²⁷¹ Neni 2/4, TFBE: “Bashkimi Evropian ka kompetencën, sipas dispozitave të Traktatit për Bashkimin Evropian, të caktojë një politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, duke përfshirë edhe shprehjen progresive të një politike të përbashkët të mbrojtjes”.

²⁷² Neni 1/1, TBE: “Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, rregullon funksionimin e Bashkimit Evropian, duke përcaktuar fushat, kufijtë dhe masat organizative për ushtrimin e kompetencave të tij”.

²⁷³ Shih gjithashtu: Wessel, (2011: 34).

fushave të tjera të së drejtës së BE-së që janë aq të rëndësishme, çështja e vijës ndarëse midis PJSP-së dhe kompetencave të Komunitetit është vendimtare.

Kufijtë e kompetencave të Shteteve Anëtare, kur veprojnë jashtë shtrirjes së Komunitetit, ishin trajtuar fillimisht nga Gjykata e Drejtësisë për çështjet më të hershme se krijimi i PJSP-së, kur drejtimi nga Shtetet Anëtare i politikës së tyre të jashtme ishte subjekt i Bashkëpunimit Politik Evropian i rregulluar nga Akti Unik Evropian. Në çështjen *Centro-Com*,²⁷⁴ lidhur me veprimin e Shteteve Anëtare në zbatim të sistemit të sanksioneve të OKB-së kundër Serbisë dhe Malit të Zi, GJED-ja vendosi se kompetencat e Shteteve Anëtare duhet të ushtroheshin në përputhje me të drejtën e Komunitetit.

Edhe nëse ata kishin objektiva të jashtëm dhe të sigurisë, masat që kufizonin eksportin e produkteve nuk mund të trajtoheshin sikur shtriheshin jashtë fushës së Politikës së Përbashkët Tregtare, por duhet të respektonin dispozitat e saj. I zbatuar në kontekstin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, vendimi në këtë rast tregon se, madje dhe kur veprojnë brenda shtrirjes së politikës së jashtme dhe të sigurisë, Shtetet Anëtare duhet të respektojnë të drejtën e Bashkimit Evropian (Craig dhe De Burca, 2011).

Ndarja e kufijve të kompetencave të politikës së jashtme dhe të sigurisë, gjendet në interpretimin e gjerë të GJED-së në *çështjen ECOWAS*²⁷⁵ të shqyrtuar në kuadër të koherencës horizontale. Në gjykimin e kësaj çështjeje Gjykata shprehu ndarjen e qartë të kufijve ndërmjet kompetencave të së drejtës komunitare dhe të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët.

²⁷⁴ Vendimi C-124/95 *The Queen, ex parte Centro-Com Srl kundër HM Treasury and Bank of England* [1997] ECR I-81, paragrafi 25.

²⁷⁵ Vendimi C-91/05 *Komisioni kundër Këshillit (ECOWAS)* [2008] I-3651.

Në këtë vendim, pavarësisht elementëve të sigurisë, masa e marrë nga Këshilli kishte të bënte me fushën për zhvillim dhe bashkëpunim, fushë e cila vepron në kuadër të rendit juridik komunitar. Ndarja e kufijve në PJSP-në përbën një rast të vështirë që sjell mungesën e kritereve të paqarta për përcaktimin e aktiviteteve të saj. Në këtë mënyrë, pavarësisht formulimit standard të Gjykatës se zgjedhja e një baze ligjore duhet të bazohet në faktorë objektivë të përshtatshëm për shqyrtimin gjyqësor,²⁷⁶ kjo nuk është gjithmonë e lehtë të arrihet në fushën e marrëdhënieve të jashtme të BE-së (Elsuwege, 2010).

3.2.3. Natyra e kompetencave. Kompetencat ekskluzive, kompetencat e përbashkëta dhe kompetencat mbështetëse lidhur me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët

Kompetencat e Bashkimit Evropian, ndahen në kompetenca ekskluzive (neni 3, TFBE),²⁷⁷ kompetenca të përbashkëta (neni 4, TFBE)²⁷⁸ dhe kompetenca mbështetëse (neni 5 dhe neni 6, TFBE).²⁷⁹

Në rastet e (i) *kompetencave ekskluzive*,²⁸⁰ e drejta për të nxjerrë akte të detyrueshme i përket Bashkimit Evropian, Shtetet Anëtare mund të nxjerrin ligje dhe akte detyruese

²⁷⁶ Vendimi C-300/89 *Titanium dioxide* [1991] ECR I-2867, paragrafi 10; Vendimi C-336/00 *Huber* [2002] ECR I-7699, paragrafi 30; Vendimi C-176/03 *Komisioni kundër Këshillit* ECR [2005] I-7879, paragrafi, 45; Vendimi C-440/05 *Komisioni kundër Këshillit* ECR [2007] I-9097, paragrafi 61.

²⁷⁷ Neni 2/1, TFBE-së “Kur Traktatet i japin BE kompetencë ekskluzive në një fushë të caktuar, vetëm BE mund të miratojë legjislacion dhe akte me fuqi ligjore detyruese, ndërsa Shtetet Anëtare mund ta bëjnë një gjë të tillë vetëm nëse këtë të drejtë ia jep BE ose për zbatimin e akteve të BE”.

²⁷⁸ Neni 2/2, TFBE-së: “Kur Traktatet i japin BE një kompetencë të përbashkët me Shtetet Anëtare në një fushë të caktuar, BE dhe Shtetet Anëtare mund të miratojnë legjislacion dhe akte me fuqi ligjore detyruese. Shtetet Anëtare e ushtrojnë kompetencën e tyre në masën dhe për aq sa BE nuk ka ushtruar kompetencën e tij. Shtetet Anëtare e ushtrojnë, gjithashtu kompetencën e tyre për aq sa dhe kur BE ka vendosur të pushojë së ushtruar kompetencën e tij”.

²⁷⁹ Neni 2/5, TBE: “Në disa fusha të caktuara dhe sipas kushteve të përcaktuara në Traktatet, BE ka kompetencën për të kryer veprime për të mbështetur, bashkërenduar ose plotësuar veprimet e Shteteve Anëtare, pa e kapërcyer përmes tyre kompetencën e Shteteve Anëtare, në këto fusha. Aktet me fuqi ligjore detyruese të BE të miratuara në bazë të dispozitave të Traktateve, lidhur me këto fusha, nuk kërkojnë harmonizim të akteve ligjore ose nënligjore të Shteteve Anëtare”.

vetëm nëse këtë të drejtë ua jep Bashkimi Evropian. Mbështetur në konstatimet e mësipërme, lind natyrshëm një pyetje lidhur me mundësinë e zotërimit të kompetencave ekskluzive të BE-së në fushën e PJSP-së? Neni 3, TFBE specifikon qartë rastet, në të cilat Bashkimi Evropian zotëron kompetencë ekskluzive duke përfshirë fusha të veçanta të sferës ekonomike si, bashkimin doganor, konkurrencën, politikën monetare, politikën e përbashkët tregtare etj.²⁸¹

Shprehimisht PJSP-ja përjashtohet nga kompetencat ekskluzive të Bashkimit Evropian. Mungesa e kompetencave ekskluzive të Bashkimit Evropian në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, mund të jetë një nga shkaqet kryesore, të cilat pengojnë arritjen e koherencës duke reduktuar rolin e Bashkimit Evropian, si një aktor global. Mungesa e kompetencës ekskluzive ngjall konfuzionin se Bashkimi Evropian flet në shumë zëra, i varur gjithmonë nga vullneti politik i Shteteve Anëtare.

Një çështje me interes studimi, konstatohet në raportin ndërmjet kompetencave ekskluzive të BE dhe Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët lidhur me marrëveshjet ndërkombëtare. Gjykata e Drejtësisë nëpërmjet jurisprudencës së saj shumë të gjerë, ka luajtur një rol të rëndësishëm për përcaktimin e këtij raporti dhe për përcaktimin e kompetencave të jashtme të Bashkimit Evropian.²⁸² Lidhur me kompetencat e jashtme dhe

²⁸⁰Neni 3/1, TFBE: “Bashkimi Evropian ka kompetencë ekskluzive në fushat e mëposhtme: (a) Bashkimin doganor; (b) Vendosija e rregullave të konkurrencës të nevojshme për funksionimin e tregut të brendshëm; (c) Politika monetare për Shtetet Anëtare, monedha e të cilave është Euro; (d) Ruajtja e burimeve biologjike detare në kuadër të politikës së përbashkët për peshkim; (e) Politika e përbashkët tregtare”.

²⁸¹ Në këtë drejtim vëmendja përqendrohet natyrshëm në një pozicion kritik të hipotezës së studimit se Bashkimi Evropian është një aktor i fuqishëm në aspektin ekonomik, por nëse është i tillë edhe në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, mbetet për tu shqyrtuar.

²⁸² Bëhet fjalë për çështjen e famshme *ERTA*: Vendimi 22/70 *Komisioni kundër Këshillit (ERTA)* [1971] ECR 263 dhe *Open Skies* një marrëveshje bilaterale të transportit ajror ndërmjet Shteteve Anëtare të BE dhe Shteteve të Bashkuara, çështjet e GJED për *Open Skies* janë: Vendimi C-466/98 *Komisioni kundër Britanisë së Madhe* [2002] ECR I-9427; Vendimi C-467/98 *Komisioni kundër Danimarkës* [2002] ECR I-9519; Vendimi C-468/98 *Komisioni kundër Suedisë* [2002] ECR I-9575; Vendimi C-469/98 *Komisioni kundër*

më konkretisht me marrëveshjet ndërkombëtare, përfshirë këtu marrëveshjet në fushën e PJSP, Bashkimi Evropian disponon kompetenca ekskluzive.

Doktrina *Erta* ndjek logjikën e parimit të përparësisë të Bashkimit Evropian ndaj Shteteve Anëtare (De Baere, 2010: 8). Në këtë kuptim Shtetet Anëtare nuk lejohen të veprojnë ndërkombëtarisht në një mënyrë që të ndikojë të drejtën ekzistuese të Bashkimit Evropian. Shtetet Anëtare e kanë të pamundur të veprojnë, sepse e drejta ekskluzive për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare i takon BE-së përfshirë kjo edhe politikën e jashtme dhe të sigurisë.

Marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me politikën e jashtme dhe të sigurisë së përbashkët nënshkruhen ekskluzivisht nga Bashkimi Evropian (216, TFBE).²⁸³ Kjo përcakton përgjegjësinë primare të Bashkimit Evropian, duke përjashtuar ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare për marrëveshjet ndërkombëtare (Wessel, 2011). Lidhur me interpretimin e nenit 216, TFBE në shprehjen “kur këtë marrëveshje e parashikojnë Traktatet” kuptohet që kompetenca për lidhjen e një marrëveshje nuk kufizohet vetëm në TFBE, por edhe në TBE, në të cilën është parashikuar PJSP-ja.

Procedura për arritjen e një marrëveshjeje në kuadër të PJSP-së rregullohet nga neni 218 TFBE. Në këtë nen parashikohet se Përfaqësuesi i Lartë ka kompetenca ekskluzive për të lidhur marrëveshje në kuadër të PJSP-së. Sipas procedures Këshillit miraton vendimet për hapjen e negociatave në rastet kur marrëveshja e parashikuar ka të bëjë me PJSP-në pas

Finlandës [2002] ECR I-9627; Vendimi C-471/98 *Komisioni kundër Belgjikës* [2002] ECR I-9681; Vendimi C- 472/98 *Komisioni kundër Luksemburgut* [2002] ECR I-9741; Vendimi C-475/98 *Komisioni kundër Austrisë* [2002] ECR I-9797; Vendimi C-476/98 *Komisioni kundër Germanisë* [2002] ECR I-9855.

²⁸³ Neni 216/1, TFBE: “Bashkimi Evropian mund të lidhë një marrëveshje ndërkombëtare me një ose më shumë vendeve të treta apo organizatat ndërkombëtare, kur këtë e parashikojnë Traktatet...”.

një rekomandimi të paraqitur para tij nga Përfaqësuesi i Lartë ose Komisioni (neni 218/3, TFBE). Kufizimet e mundshme mbi lirinë e Shteteve Anëtare për të përfunduar një marrëveshje ndërkombëtare në fushën e PJSP-së, rrjedhin nga Traktatet dhe nga masat dytësore të lidhura me PJSP-në (Koutrakos, 2011). Kur BE-ja ushtron kompetencat e tij, Shtetet Anëtare duhet të respektojnë aktet e miratuara dhe të marrin masat e nevojshme për zbatim, dhe në këto fusha BE-së nuk ka kompetencë ekskluzive (Jacque, 2010:141).

Me (ii) *kompetenca të përbashkëta*,²⁸⁴ kuptohet mundësia që kanë dy vendimmarrës të ndryshëm për të ndarë ndërmjet tyre të drejtën për të vendosur dhe për të nxjerrë akte ligjore në çështje të caktuara. Në kompetencat e përbashkëta përfshihen kategori të ndryshme të politikave si në aspektin ekonomik, të mjedisit, të bujqësisë etj., por shprehimisht në këto kompetenca të Bashkimit Evropian janë përjashtuar PJSP-ja dhe PSMP-ja.

Doktrina²⁸⁵ ka zhvilluar një debat lidhur me përfshirjen e PJSP-së në kompetencat e përbashkëta. Konventa Evropiane e vitit 2002²⁸⁶ ka dhënë një argument të gabuar në lidhje me përfshirjen e PJSP-së në kompetencat mbështetëse të BE-së.²⁸⁷ Doktrina është përgjigjur se një kategorizim i tillë i PJSP-së është i gabuar dhe pengon Shtetet Anëtare të

²⁸⁴ Neni 4/1, TFBE: “Bashkimi Evropian ka kompetencë të përbashkët me Shtetet Anëtare kur Traktatet i japin një kompetencë, e cila nuk lidhet me fushat e përmendura në nenet 3 dhe 6”; Neni 4/2, TFBE: “Kompetenca e ndarë midis Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare zbatohet në fushat e mëposhtme parësore: (a) Tregu i brendshëm; (b) Politikat sociale për aspektet e përcaktuara në këtë Traktat; (c) Kohezioni ekonomik, territorial dhe social; (d) Bujqësia dhe peshkimi, pa përfshirë ruajtjen e burimeve biologjike detare; (e) Mjedis; (f) Mbrojtja e konsumatorit; (g) Transporti; (h) Rrjetet Trans-Evropiane; (i) Energjetika; (j) Zona e lirë, sigurisë dhe drejtësisë; (k) Shqetësimet e përbashkëta për sigurinë në çështjet e shëndetit publik, për aspektet e përcaktuara në këtë Traktat”.

²⁸⁵ Bëhet fjalë për autorin Aurel Sari, argumentet e të cilit mbështeten nga një sërë autorësh të tjerë të së drejtës së PJSP të Bashkimit Evropian.

²⁸⁶ The European Convention, CONV 17/02. Delimitation of competence between the European Union and the Member States – Existing system, problems and avenues to be explored, Brussels, 15 May 2002.

²⁸⁷ Citimi original i Konventës, fq. 8: *Legislative Competence, (b) Concurrent (or shared) competence. Most Union/Community powers fall within this category: ...– Title V of the TEU (common foreign and security policy), with the exception of defence...*

ushtrojnë kompetencat në politikën e tyre të jashtme kombëtare (Sari, 2012: 27). PJSP-ja nuk është një zonë e hartimit të ligjeve të përgjithshme, ose e veprimit normativ, ku aktet e BE-së të kenë efekt parandalues në kompetencat kombëtare (Biondi, Eeckhout dhe Ripley, 2012: 268).

Një argument i tillë për përfshirjen e PJSP-së në kompetencat e përbashkëta të Bashkimit Evropian nuk gjen mbështetje si në aktet ligjore ashtu edhe në praktikë (Sari, 2012: 28). Përdorimi i një kompetence të përbashkët në fushën e PJSP-së nuk duket e përshtatshme ndoshta për shkak të rëndësisë që paraqet politika e jashtme dhe e sigurisë në një shtet. Pozicioni kritik që mbahet nga doktrina në lidhje me legjitimitimin e kompetencave të përbashkëta edhe në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët është se kompetenca e përbashkët kufizon hapësirën e shteteve për të vendosur mbi një çështje të caktuar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes (Evans dhe Koutrakos, 2013: 339-358).

Kufizimi i kompetencave në këtë sektor çënon fuqinë e shteteve në arenën ndërkombëtare, duke mos pranuar ndarjen e tyre me një vendimmarrës tjetër, qoftë edhe me Bashkimin Evropian në të cilën ato janë anëtare. Për këtë arsye Traktati i Lisbonës ka dhënë një zgjidhje për çështjen e sigurisë kombëtare. Sipas këtij traktati në kuadër të ndarjes së kompetencave, siguria kombëtare është një kompetencë e shteteve kombëtare (neni 4/ 2, TBE),²⁸⁸ një shprehje kjo që nuk ishte parashikuar në Traktatin Kushtetues. Shtetet Anëtare mund të ushtrojnë kompetencën vetëm në masën, që Bashkimi Evropian nuk e ka ushtruar vetë atë (Wessel, 2011: 34). Kjo sepse në një kompetencë të përbashkët kur Shtetet Anëtare dhe Bashkimi Evropian ndajnë të drejtën për të vendosur me njëra-

²⁸⁸ Neni 4/2, TBE: “Siguria kombëtare mbetet përgjegjësi e vetme e secilit Shtet Anëtar”.

tjetrën, Shteti Anëtar e humbet të drejtën për të marrë vendimet, atëherë kur për këtë çështje vendos Bashkimi Evropian.²⁸⁹

Në rastet e (iii) *kompetencave mbështetëse*, BE-ja mund të ndërhyjë vetëm për të mbështetur, për të koordinuar apo për të plotësuar veprimin e Shteteve Anëtare (neni 6 TFBE). Rrjedhimisht, BE-ja nuk ka fuqi legislative në këto fusha dhe nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e këtyre kompetencave të rezervuara për Shtetet Anëtare.²⁹⁰ Politikat në të cilat Bashkimi Evropian ka kompetenca mbështetëse përfshijnë politikat ekonomike, sociale, të punësimit,²⁹¹ arsimin, kulturës, turizmit etj.²⁹² Fusha e veprimit të PJSP-së bën që kjo politikë të mos përfshihet në këto dispozita. Veçoritë e PJSP-së kushtëzojnë krijimin e rregullave të veçanta për përcaktimin dhe ushtrimin e kompetencave nga BE-ja dhe Shtetet Anëtare (Kaczorowska, 2011: 97).

Kompetencat mbështetëse i referohen fushave, në të cilat Shtetet Anëtare nuk kanë deleguar kompetenca tek Bashkimi Evropian, por kanë vendosur të veprojnë nëpërmjet tij. Në rastet kur BE-ja ka disa kompetenca, por vetëm të dobëta, ai do të jetë një vëzhgues i zakonshëm (Emerson, 2011: 4). Në dispozitat përkatëse të Traktatit Kushtetues (që nuk hyri në fuqi), PJSP-ja ishte vendosur ndërmjet kompetencave të përbashkëta dhe kategorisë së

²⁸⁹ Në këtë mënyrë, legjislacioni i Bashkimit Evropian nuk zëvendëson përmbajtjen e një akti kombëtar të Shteteve Anëtare, por ai ka të drejtën për të nxjerrë akte, duke ia hequr këtë të drejtë shteteve për një çështje të caktuar.

²⁹⁰ Në këto fusha Bashkimi Evropian mbështet, koordinon, inkurajon ose plotëson masat e marra në nivel kombëtar. Në fushat e përcaktuara në bazë të kompetencave mbështetëse Bashkimi Evropian mund të përcaktojë kuadrin e koordinimit, por i ndalohej marrja e çfarëdo veprimi të cilin është lejuar normalisht të marrë në lidhje me fushat, në të cilat ai ushtron kompetencat mbështetëse.

²⁹¹ Neni 5/1, TFBE: “Shtetet Anëtare i bashkërendojnë politikat e tyre ekonomike brenda Bashkimit Evropian.”; Neni 5/2, TFBE: “Bashkimi Evropian merr masa për të siguruar bashkërendimin e politikave të punësimit të Shteteve Anëtare, ...”; Neni 5/3, TFBE: “Bashkimi Evropian merr nisma për të siguruar bashkërendimin e politikave sociale të Shteteve Anëtare”.

²⁹² Neni 6, TFBE: “Bashkimi Evropian ka kompetencë për kryerjen e veprimeve për të mbështetur, bashkërenduar ose plotësuar veprimet e Shteteve Anëtare. Fushat e një veprimi të tillë, në nivel Evropian, janë: (a) mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit të njeriut; (b) industria; (c) kultura; (d) turizmi; (e) arsimi, formimi profesional, rinia dhe sporti; (f) mbrojtja civile; (g) bashkëpunimi administrativ”.

kompetencave mbështetëse (Wessels dhe Bopp, 2008: 10), por situata ndryshon me miratimin e Traktatit të Lisbonës. Tre llojet e kompetencave të parashikuara në dispozitat e Traktateve nuk aplikohen në rastin e politikës së jashtme dhe të sigurisë.

Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët nuk përfshihet as në fushën e kompetencave ekskluzive, as në kuadër të kompetencave të përbashkëta dhe as në kompetencat mbështetëse. Në kuadër të analizës së ndarjes së kompetencave, një ndarje tjetër e kompetencave është ajo në kompetenca të shprehura dhe në kompetenca të nënkuptuara. Kompetenca të shprehura janë ato, të cilat janë të përcaktuara qartë në dispozitat e Traktatit ose të specifikuara nga aktet ligjore të BE-së.

Kompetencat e nënkuptuara janë kompetencat që nuk rezultojnë drejtpërdrejt dhe shprehimisht nga një dispozitë ose një numër i dispozitave të Traktateve, por nga objektivat e përgjithshme të përcaktuara në Traktate. Në interpretimet e Gjykatës të Drejtësisë kompetencat e nënkuptuara janë të njohura si kompetenca të vetëkuptueshme.²⁹³ Në vendimin e GJED-së në *çështjen ERTA* të vitit 1971, *Komisioni kundër Këshillit të Komuniteteve Evropian*, u themeluan doktrina e kompetencave të nënkuptuara në fushën e marrëdhënieve të jashtme (Kuijper, 2007: 1571).²⁹⁴

Traktati i Lisbonës evidenton tri dallime lidhur me kompetencat e PJSP-së (Sari, 2012:4). *Së pari*, ai dallon kompetencën e Bashkimit Evropian në PJSP, nga kompetencat në fusha të tjera të politikave. *Së dyti*, deklaron se PJSP-ja i nënshtrohet rregullave të veçanta. *Së treti*, parashikon që zbatimi i politikave të tjera të Bashkimit Evropian nuk duhet të ndikojë në zbatimin e procedurave dhe shtrirjen e kompetencave të institucioneve

²⁹³ Vendimi 22/70 *Komisioni kundër Këshillit ERTA* [1971] ECR 263.

²⁹⁴ Shih gjithashtu: De Baere, (2010: 8), Hillion, (2010: 225).

për ushtrimin e kompetencave të Bashkimit Evropian, nën Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (Neni 40, TBE).²⁹⁵

Dispozitat që shprehin lidhjen midis PJSP-së dhe pjesës tjetër të veprimtarisë së Bashkimit Evropian në skenën ndërkombëtare kanë për qëllim të garantojnë konsekuencën dhe një shkallë të rëndësishme autonomie të PJSP-së (Craig dhe De Burca, 2011:447). Në parim, këto zhvillime duhet të bëjnë veprimet e jashtme të BE-së më koherente dhe në këtë mënyrë rritjen e efektivitetit të tij, si një aktor ndërkombëtar (Sari, 2012:3). Mungesa e kompetencave të BE-së në fushën e PJSP-së nuk nënkupton dështimin e politikës së sigurisë dhe mbrojtjes, sepse siç e kemi përmendur, politika e jashtme dhe e sigurisë bazohet tek një rend ligjor për veprimtarinë e saj.

Lidhur me mungesën e efektivitetit të PJSP-së, doktrina është e ndarë në dy kategori, një pjesë fajëson karakterin ndërqeveritar dhe mungesën e kompetencave të BE në këtë fushë, ndërsa të tjerët i referohen mungesës së vullnetit politik dhe jo mangësive në instrumentat apo procedurat e kësaj politike.

3.3. Raporti i të drejtës së Bashkimit Evropian me të drejtën ndërkombëtare publike në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Çështja *Kadi I*, *Kadi II* dhe *Kadi III*.

Bashkimi Evropian është një “krijesë” e të drejtës ndërkombëtare publike, për këtë veprimi në arenën ndërkombëtare (përfshirë fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë)

²⁹⁵ Neni 40, TBE (ish-neni 47, TBE: “Zbatimi i politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit nuk e prek zbatimin e procedurave dhe shtrirjen e kompetencave të institucioneve të parashikuara nga Traktatet për ushtrimin e kompetencave të Bashkimit, të përmendura në nenet nga 3 deri në 6 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Në mënyrë të ngjashme, zbatimi i politikave të parashikuara në nenet e lartpërmendura nuk e prek zbatimin e procedurave dhe shtrirjen e kompetencave të institucioneve të parashikuara nga Traktatet për ushtrimin e kompetencave të Bashkimit sipas këtij Kreu”.

përbën qëllimin e tij kryesor. Sipas autorëve Barnard dhe Peers, Bashkimi Evropian është krijesë e të drejtës ndërkombëtare, megjithëse përfaqëson një të drejtë shumë të veçantë dhe të avancuar të së drejtës ndërkombëtare (2014: 174). Origjina e rendit juridik të Bashkimi Evropian gjendet në të drejtën ndërkombëtare publike (McMahon, 1961: 320, 329) rend i cili filloi si një organizatë ndërkombëtare në kuptimin tradicional, edhe pse përfshinte disa tipare unike që në fillimi të tij (Weiler dhe Haltern, 1996: 411).

Sipas De Witte, BE-ja është *objekt* dhe *subjekt* i së drejtës ndërkombëtare publike (2014: 192). Bashkimi Evropian është objekt i të drejtës ndërkombëtare i krijuar nga të tjerët, nga Shtetet Anëtare dhe është gjithashtu subjekt që ka fituar të drejtën që të bëjë një të drejtë ndërkombëtare të re (De Witte, 2014: 192). Ekziston një pikpamje mbizotëruese lidhur me natyrën e Bashkimit Evropian, kjo për shkak të karakteristikave të tij institucionale të ndara në rendin ndërkombëtar dhe rendin komunitar (Weiler dhe Haltern, 1996: 411).

Analiza e raportit ndërmjet të drejtës së Bashkimit Evropian dhe të drejtës ndërkombëtare publike është e nevojshme të shqyrtohet sepse pikërisht Politika e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët funksionon në një rend juridik ndërkombëtar për shkak të natyrës ndërqeveritare të saj. Politika e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët si një politikë e Bashkimit Evropian duhet të veprojë në kuadër të rendit juridik të BE-së, e drejtë që nga ana tjetër garantohet nëpërmjet Gjykatës të Drejtësisë.

Megjithatë edhe pse GJED-ja nuk ka juridiksion mbi Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, kjo politikë nuk e përjashton Gjykatën e Drejtësisë nga referimi i parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare publike (Kaczorowska, 2011: 206). Respektimi nga ana e Bashkimit Evropian të parimeve të së drejtës ndërkombëtare publike

parashikohet në dispozitat e TBE-së.²⁹⁶ Në shumë raste Gjykata e Drejtësisë ka deklaruar se rregullat e së drejtës ndërkombëtare zakonore janë të detyrueshme për Bashkimin Evropian.²⁹⁷

Raporti i Bashkimit Evropian me të drejtën ndërkombëtare konstatohet nga jurisprudenca e gjerë e Gjykatës të Drejtësisë në një sërë rastesh.²⁹⁸ Në rastin *Van Gend en Loos kundër Holandës*, Gjykata i referohet Bashkimit Evropian *si një rend i ri* juridik në të drejtën ndërkombëtare, rend në të cilën shtetet kanë kufizuar të drejtat e tyre sovrane, megjithëse brenda fushave të kufizuara.²⁹⁹

(i) Çështja *Kadi I*: është ndoshta rasti më i dukshëm dhe interesant i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë për marrëdhëniet e jashtme në vitet e fundit (Kokott dhe Sobotta, 2012: 1015). Çështja e famshme *Kadi*³⁰⁰ është një rast që ka provokuar reagime të ashpra ndërmjet raportit të së drejtës së BE-së dhe të drejtës ndërkombëtare publike. Kjo çështje kishte të bënte me ligjshmërinë e sanksioneve të buta (Graig dhe De Burca 2011: 449)³⁰¹ të BE për vendosjen e rregullave që imponojnë sanksione antiterroriste mbi individët.³⁰² Këshilli i Sigurimit kishte identifikuar Kadi si mbështetës të mundshëm të Al-Kaidës.

²⁹⁶ Neni 3/5, TBE: “Bashkimi Evropian kontribuon në ... zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare...” etj.

²⁹⁷ Vendimi C-162/96 *Racke GmbH & Co. kundër Hauptzollamt Mainz* (1998), ECR I-3655, shih citimin origjinal të paragrafit 46, sipas të cilit: *It follows that the rules of customary international law concerning the termination and the suspension of treaty relations by reason of a fundamental change of circumstances are binding upon the Community institutions and form part of the Community legal order.*

²⁹⁸ Vendimi T-115/94 *Opel Austria GmbH kundër Këshillit* [1997] ECR II-39, paragrafi 77; Vendimi C-286/90 *Poulsen dhe Diva Navigation* [1992] ECR I-6019, paragrafi 9.

²⁹⁹ Vendimi 26/62 *Van Gend en Loos kundër Nederlandse Administratie der Belastingen* [1963] ECR 1. shih vendimin, sipas të cilit: *the conclusion to be drawn from this is that the community constitutes a new legal order of international law for the benefit of which the states have limited their sovereign rights, albeit within limited fields, and the subjects of which comprise not only member states but also their nationals.*

³⁰⁰ Vendimi T-304/01 *Yusuf and Al Barakaat International Foundation kundër Këshillit dhe Komisionit*; Case T-315/01 *Kadi kundër Këshillit dhe Komisionit Evropian*, 2005, ECR II-3649.

³⁰¹ Shih gjithashtu: De Burca, (2010), Eckes, (2009).

³⁰² Gjykata u shpreh se përfshirja e një individi dhe të një fondacioni në një listë terroriste, ka shkelur të drejtat e mbrojtjes dhe në veçanti e drejta për t'u dëgjuar, parimin e mbrojtjes efektive gjyqësore dhe të drejtës e pronës sipas ligjit evropian.

Rezoluta e Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara përfshiu z. Kadi në listën e atyre personave që i ngrinë të gjitha asetet.³⁰³ Në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 881/2002, Komisioni miratoi Rregulloren Nr. 1190/2008,³⁰⁴ që përfshinte *Kadi* në listën e atyre personave që i ngrinë të gjitha asetet.

Në rastet *Kadi* dhe *Jusuf*, Gjykata e Shkallës së Parë vendosi se ajo nuk mund të rishikonte zbatimin nga ana e BE-së të Rezolutës së Këshillit të Sigurisë së OKB-së, që ngrinte asetet e individëve të dyshuar për përfshirjen në akte terroriste, për pajtueshmëri me parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare. Gjykata e Shkallës së Parë nuk mund ta bënte atë rishikim sepse, ndonëse BE-ja nuk është e detyruar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Karta e OKB-së, është e detyruar indirekt nga dispozitat e Traktatit të BE-së për zbatimin e Kartës së OKB-së po aq sa edhe Shtetet Anëtare.³⁰⁵

Megjithatë, Gjykata e Shkallës së Parë vendosi se ajo mund ta rishikonte indirekt rezolutën e OKB-së për pajtueshmëri me parimet *ius cogens* të së drejtës ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.³⁰⁶ Në çështjen *Kadi I*, Bashkimi Evropian u kritikua për mungesën e besnikërisë ndaj të drejtës ndërkombëtare publike (De Burca, 2010: 44). Gjykata në thelb duhet të vendoste, nëse një rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së duhet të gëzonte përparësi mbi të drejtën e Bashkimit Evropian (Kokott

³⁰³ Ndër arsyet e tjera që jepnin Kombet e Bashkuara në vitin 2009 për miratimin e rezolutës që ngrinte pasuritë e z.Kadi, përfshihej edhe fakti se z.Kadi ishte pronar i disa firmave në Shqipëri, ku dyshohej se kanalizonte paratë e ekstremistëve apo për të punësuar ekstremistë në pozita që kontrollonin fondet e firmës. Për më tepër Kombet e Bashkuara kishin prova se Bin Laden ofronte kapitalin qarkullues të paktën për pesë nga kompanitë e z. Kadi në Shqipëri.

³⁰⁴ *Commission Regulation (EC) No 1190/2008*, e 28 nëntorit 2008 që amendon për të 101 herë Rregulloren e të Këshillit 881/2002 për vendosjen e disa masave specifike restriktive drejtuar kundër disa personave dhe subjekteve të lidhura me Usama bin Laden, rrjetin Al-Kaida dhe talibanët.

³⁰⁵ Vendimi T-315/01 *Kadi kundër Këshillit dhe Komisionit* [2005] ECR II-3649, paragrafi 192-208, 221-225.

³⁰⁶ Vendimi T-315/01 *Kadi kundër Këshillit dhe Komisionit* [2005] ECR II-3649, paragrafi 226-232; Vendimi T-306/01 *Yusuf & Al Barakaat International Foundation kundër Këshillit dhe Komisionit Evropian*, 2005 ECR II-3533, paragrafi 277-283.

dhe Sobotta, 2012: 1015). Në këtë rast, Gjykata u shpreh se, detyrimet e imponuara nga një marrëveshje ndërkombëtar (në këtë rast Karta e OKB-së), nuk mund të ketë efektin e cënimit të parimeve kushtetuese të Traktatit të KE.³⁰⁷

Gjykata e Drejtësisë është shprehur se të gjitha aktet e Komunitetit duhet të respektojnë të drejtat themelore.³⁰⁸ Të drejtat themelore qëndrojnë mbi çdo vendim tjetër, që rrjedhin nga rezolutat ndërkombëtare qoftë kjo edhe për vendime, që vijnë nga Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Gjykata e Përgjithshme hodhi poshtë vendimin e Gjykatës të Shkallës së Parë për rastin *Kadi I*³⁰⁹ dhe *Yusuf*,³¹⁰ si dhe rregulloren e Këshillit të Sigurimit 881/2002 për vendosjen e disa masave specifike restriktive drejtuar kundër disa personave dhe subjekteve të lidhura me Usama bin Laden, rrjetin Al-Kaida dhe talibanët.³¹¹

(ii) Çështja *Kadi II*: çështja u dërgua për shqyrtim në Gjykatën e Përgjithshme të GJED-së, duke u njohur si çështja *Kadi II*.³¹² Komisioni Evropian, Këshilli i Bashkimit Evropian, Franca dhe Britania e Madhe apeluan në Gjykatë duke kërkuar që vendimi i Gjykatës së Përgjithshme të lihet mënjanë. GJED-ja hodhi poshtë ankesat e apeluesve në çështjen *Kadi II* dhe la në fuqi anulimin e Gjykatës së Përgjithshme në rastin *Kadi I* me

³⁰⁷ Vendime të përbashkëta C-402/05 P dhe C-415/05 P *Yassin Abdullah Kadi dhe Al Barakaat International Foundation kundër Këshillit dhe Komisionit Evropian*, shih paragrafin 285, sipas të cilit: “*It follows from all those considerations that the obligations imposed by an international agreement cannot have the effect of prejudicing the constitutional principles of the EC Treaty...*”

³⁰⁸ Vendime të përbashkëta C-402/05 P dhe C-415/05 P *Yassin Abdullah Kadi dhe Al Barakaat International Foundation kundër Këshillit dhe Komisionit Evropian*, shih citimin origjinal të paragrafit 285, sipas të cilit: “*...which include the principle that all Community acts must respect fundamental rights, that respect constituting a condition of their lawfulness which it is for the Court to review in the framework of the complete system of legal remedies established by the Treaty.*”

³⁰⁹ Vendimi T-315/01 *Kadi kundër Këshillit dhe Komisionit Evropian*, 2005, ECR II-3649.

³¹⁰ Vendimi T-306/01 *Yusuf & Al Barakaat International Foundation kundër Këshillit dhe Komisionit Evropian*, 2005 ECR II-3533.

³¹¹ *Council Regulation (EC) No 881/2002*, e 27 maj 2002 për vendosjen e disa masave specifike kufizuese drejtuar kundër disa personave dhe subjekteve të lidhura me Usama bin Laden, rrjetin Al-Kaida dhe talibanët, dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit Nr. 467/2001 për ndalimin e eksportit të disa mallrave dhe shërbimeve për Afganistanin dhe zgjerimin e ngrirjes së fondeve dhe burimeve të tjera financiare në lidhje me talibanët e Afganistanit, OJ 2002 (L 139) 9 (EC).

³¹² Vendimi T-85/09 *Yassin Abdullah Kadi kundër Komisionit Evropian* [2010] ECR II-5177.

arsyetimin se asnjë nga arsyet e dhëna në përmbledhjen e OKB-së për lidhjen e *Kadi* me terrorizmin nuk është vërtetuar.

Gjykata anuloi Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 1190/2008 të datës 28 nëntor 2008 për ndryshimin për Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 881/2002. Ideja e një Gjykate rajonale, e cila mund të kontrollojë vlefshmërinë e rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, provoi se ishte burim i një debati të nxehtë akademik (Palchetti, 2011). Në vitin 2013, Gjykata pohoi se ajo do të vazhdojë të shqyrtojë listimet e Bashkimit Evropian për zbatimin e rreptë të detyrimeve të Këshillit të Sigurimit. Ky vendim ishte një lehtësim për studiuesit, të cilët ishin të shqetësuar në lidhje me mbrojtjen ligjore të Bashkimit Evropian në fushën e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë dhe për detyrimet e OKB-së.

(iii) Çështja *Kadi III*: në vendimin e Gjykatës të 13 qeshorit 2013 i njohur si çështja *Kadi III*, Gjykata hodhi poshtë apelet e bëra nga Komisioni Evropian, Këshilli dhe disa Shtete Anëtare të Bashkimit Evropian kundër vendimit të vitit 2010, *Kadi II* të Gjykatës së Përgjithshme. Ankuesit, pretendonin se Gjykata e Përgjithshme ka gabuar në shqyrtimin e saj në lidhje me shkeljen e të drejtat e mbrojtjes të Kadi dhe të drejtën e tij për mbrojtje gjyqësore efektive, dhe në lidhje me cenimin e parimit të proporcionalitetit.³¹³ Këshilli, i mbështetur nga Irlanda dhe Republika e Italisë, pohon se refuzimi për dhënien e imunitetit të kontestuar rregullore është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.³¹⁴ Këshilli dhe Shtetet Anëtare këmbëngulin se vendimi i dhënë nga Gjykata injoron tërësisht faktin se është Këshilli i Sigurimit, ai i cili ka përgjegjësinë kryesore për përcaktimin e masave të

³¹³ Vendime të Përbashkëta C-584/10 P, C-593/10 dhe C-595/10P *Komisioni, Këshilli, Mbretëria e Bashkuar kundër Kadi (Kadi III)*, [2013], paragrafi 59.

³¹⁴ Vendime të Përbashkëta C-584/10 P, C-593/10 dhe C-595/10P *Komisioni, Këshilli, Mbretëria e Bashkuar kundër Kadi (Kadi III)*, [2013], paragrafi 61.

nevojshme për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare duke injoruar përparësinë e detyrimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara.³¹⁵

Shtetet Anëtare në Bashkimin Evropian anëtare dhe në Kombet e Bashkuara ishin të shqetësuar për faktin se kjo qasje shkon deri në shqyrtimin e ligjshmërisë së rezolutave të Këshillit të Sigurimit në dritën e ligjit të Bashkimit Evropian duke rrezikuar uniformitetin, zbatimin pa kushte dhe të menjëhershëm të këtyre rezolutave.³¹⁶ Shtetet të cilat janë anëtare në të dyja organizatat gjejnë veten në një pozitë të pamundur për sa i përket përmbushjes së detyrimeve të tyre ndërkombëtare.³¹⁷ Shtetet kundërshtuese shprehen se Gjykata nuk merr parasysh nevojën për të arritur një ekuilibër ndërmjet ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, në njërën anë, dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore nga ana tjetër.³¹⁸ Megjithatë Gjykata i qëndron vendimit të mëparshëm për respektimin e parimeve dhe vlerave kryesore të së drejtës së Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Pavarësisht, nga vendimi i GJED-së në rastin *Kadi* BE-ja padyshim i konsideron shumë prej veprimeve të tij pjesë të rëndësishme të programit të qeverisjes globale (Blockmans dhe Wessel, 2011: 77). Bashkimi Evropian zhvillon veprimtarinë e tij në

³¹⁵ Vendime të Përbashkëta C-584/10 P, C-593/10 dhe C-595/10P *Komisioni, Këshilli, Mbretëria e Bashkuar kundër Kadi (Kadi III)*, [2013], shih citimin origjinal të paragrafit 61, sipas të cilit: *That refusal wholly ignores the fact that it is the Security Council which has primary responsibility for determining the measures necessary for the maintenance of international peace and security and ignores the primacy of obligations under the United Nations Charter over those arising under any other international agreement.*

³¹⁶ Vendime të Përbashkëta C-584/10 P, C-593/10 dhe C-595/10P *Komisioni, Këshilli, Mbretëria e Bashkuar kundër Kadi (Kadi III)*, [2013], shih citimin origjinal të paragrafit 61, sipas të cilit: *It amounts to reviewing the legality of Security Council resolutions in the light of European Union law. The uniform, unconditional and immediate application of those resolutions is jeopardised.*

³¹⁷ Vendime të Përbashkëta C-584/10 P, C-593/10 dhe C-595/10P *Komisioni, Këshilli, Mbretëria e Bashkuar kundër Kadi (Kadi III)*, [2013], shih citimin origjinal të paragrafit 61, sipas të cilit: *States which are members both of the United Nations and of the European Union find themselves in an impossible position as regards meeting their international obligations.*

³¹⁸ Vendime të Përbashkëta C-584/10 P, C-593/10 dhe C-595/10P *Komisioni, Këshilli, Mbretëria e Bashkuar kundër Kadi (Kadi III)*, [2013], paragrafi 62.

përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare publike dhe në marrëdhënie të ngushtë me parimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

KREU IV. KUADRI INSTITUCIONAL DHE PROCESI I VENDIMMARRJES NË FUNKSION TË PËRFORCIMIT TË ROLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN NË ARENËN NDËRKOMBËTARE

4.1. Institucionet përgjegjëse që përcaktojnë Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët dhe që forcojnë rolin e Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare

Struktura institucionale e Bashkimit Evropian është një strukturë unike, e bazuar në shtatë institucione kryesore.³¹⁹ Analiza e raportit ndërinstitutional është e rëndësishme për përkufizimin e rolit të Bashkimit Evropian si një aktor ndërkombëtar dhe informimit rreth dobësive që shoqërojnë këtë rol të BE-së. Nga institucionet e BE-së vetëm disa prej tyre kanë një impakt më të madh dhe luajnë rol një rol të ndryshëm në miratimin dhe implementimin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Për të dhënë një tablo të qartë, në vijim trajtohen institucione të veçanta në funksion të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët dhe rritjes së rolit të BE-së në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare.

4.1.1. Këshilli Evropian

Këshilli Evropian bëhet formalisht pjesë e institucioneve të Bashkimit Evropian, me të drejta të plota, në Traktatin e Lisbonës. Më parë, Këshilli Evropian nuk mendohej si një mekanizëm komunitar, fillesat e tij datojnë në Samitet e Shteteve Anëtare, me qëllim

³¹⁹ Neni 13/1, TBE: “Bashkimi Evropian ka një kuadër institucional që ka si qëllim të promovojë vlerat e tij, të çojë përpara objektivat e tij, t’u shërbejë interesave të tij, të qytetarëve të tij dhe të Shteteve Anëtare dhe të sigurojë njëtrajtshmërinë, efektshmërinë dhe vijimësinë e politikave dhe masave të tij”; Institucionet e Bashkimit Evropian: Këshilli Evropian, Këshilli i Ministrave, Parlamenti Evropian, Komisioni Evropian, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, Gjykata e Audituesve dhe Banka Qendrore Evropiane.

forcimin e bashkëpunimit politik. Traktati i Lisbonës, sanksionoi institucionalizimin dhe rolin e tij të veçantë lidhur me fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Këshilli Evropian përbëhet nga kryetarët e shteteve ose qeverive të Shteteve Anëtare, nga presidenti i Këshillit Evropian, presidenti i Komisionit dhe nga Përfaqësuesi i Lartë.³²⁰

Këshilli Evropian luan një rol shumë të rëndësishëm në përcaktimin e interesave strategjike, objektivave specifike dhe udhëzimeve të përgjithshme të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.³²¹ Këshilli Evropian është organi qendror, i cili vendos axhendën për caktimin e qëllimeve, objektivave, kohëzgjatjen dhe mjetet për çdo veprim të jashtëm të BE-së³²² (Chalmers, Davies dhe Monti, 2010: 630-631). Lidhur me veprimin e jashtëm Këshilli Evropian jep drejtimin politik dhe përcakton prioritetet e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (Kaczorowska, 2011: 114).

Këshilli Evropian është një organ shumë i rëndësishëm për të përcaktuar objektivat për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare. Këshilli Evropian përfaqëson autoritetin politik të nivelit më të lartë të Bashkimit Evropian.³²³ Ai mbledhet dy herë në çdo gjashtë muaj (në Samitin e BE-së) dhe më shpesh nëse përlligjet nga rrethana të jashtëzakonshme (neni 15/3, TBE).³²⁴ Gjatë takimeve të tij, Këshilli Evropian mund të miratojë vendimet e Këshillit mbi qëndrimet e përbashkëta dhe konkluzionet e Këshillit.

³²⁰ Neni 15/2, TBE.

³²¹ Neni 22/1, TBE: “Këshilli Evropian identifikon interesat dhe objektivat strategjike të Bashkimit Evropian”.

³²² Neni 22/1, TBE: “Vendimet e Këshillit Evropian përcaktojnë kohëzgjatjen e objektivave strategjikë dhe mjetet, që duhet të vihen në dispozicion nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet Anëtare”.

³²³ EPLO Briefing Paper 1/2012, Common Foreign and Security Policy structures and instruments after the entry into force of the Lisbon Treaty.

³²⁴ Neni 15/3, TBE: “Këshilli Evropian i thirrur nga Presidenti i tij, mbledhet dy herë çdo gjashtë muaj. Kur e kërkon rendi i ditës, anëtarët e Këshillit Evropian mund të vendosin që të mbështeten secili prej tyre nga një ministër dhe, në rastin e Presidentit të Komisionit, nga një anëtar i Komisionit. Kur e kërkon situata, Presidenti thërret një mbledhje të posaçme të Këshillit Evropian”.

Vendimet për veprimin e jashtëm merren mbi bazën e konsensusit (Mix, 2013: 5). Këshilli Evropian luan një rol të rëndësishëm gjithashtu, për të vendosur mbi strategjitë që duhet të ndërmarrë Bashkimi Evropian kur përballlet me kriza ndërkombëtare (Comelli dhe Pirozzi, 2013: 11). Roli i Këshillit Evropian është deciziv dhe i rëndësishëm për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare dhe për koordinimin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët në funksion të rritjes së këtij roli.

4.1.2. Këshilli i Ministrave

Këshilli i Ministrave i Bashkimit Evropian ose i njohur thjesht si Këshilli³²⁵ është një nga organet kryesore, që përcakton dhe zbaton Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Këshilli është një organ ndërqeveritar, i rëndësishëm në sistemin institucional të Bashkimit Evropian dhe në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë. Ai është i përbërë nga përfaqësuesit e Shteteve Anëtare.³²⁶ Ai ushtron pushtetin legjislativ vetëm ose me parlamentin dhe është titullar i pushtetit ekzekutiv.³²⁷

Këshilli i Ministrave luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e konsensusit politik dhe në procesin e vendimmarrjes së Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Këshilli i Ministrave mbledhet në varësi të axhendës. Këshilli i Ministrave është një entitet i vetëm juridik dhe plotësohet nga 10 konfigurime të ndryshme,³²⁸ në varësi të subjektit që

³²⁵ Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Maastrichtit, Këshillit të Ministrave, iu referua shpesh në Traktate, thjesht si “Këshilli”, miratuar me Vendim të Këshillit 93/591 i 8 nëntor 1993 në lidhje me emrin që do ti jepet Këshillit pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Bashkimit Evropian. (*Council Decision 93/591/EC*).

³²⁶ Këshilli përbëhet nga një përfaqësues i çdo Shteti Anëtar në nivel ministror, i cili mund të angazhojë qeverinë e Shtetit Anëtar përkatës dhe të votojë për të.

³²⁷ Neni 16/4, TBE: “Këshilli ushtron bashkërisht me Parlamentin Evropian funksione legjislative dhe buxhetore. Këshilli kryen funksione të politikbërjes dhe bashkërendimit, sikurse parashikohen në Traktate.”

³²⁸ Vendim i Këshillit 2009/937/BE i 1 dhjetor 2009 për miratimin e Rregullores së Procedurës së Këshillit (*Council Decision 2009/937/EU*).

diskutohet,³²⁹ përfshirë këtu dhe Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Lista e konfigurime miratohet në përputhje me nenin 236³³⁰ të TFBE (neni 16/6, TBE). Në veprimtarinë e tij në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, Këshilli asistohet nga organe të tjera ndihmëse.

Struktura e tij institucionale konfigurohet nga Këshilli për Punët e Jashtme dhe Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm (COREPER). Nuk ka hierarki midis konfigurimeve të Këshillit të Ministrave edhe pse Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme ka një rol të veçantë koordinues dhe është përgjegjës për çështjet institucionale, administrative dhe horizontale. Këshilli i Punëve të Jashtme ka gjithashtu një përgjegjësi të veçantë.³³¹ Këshilli ka disa organe të cilët ndihmojnë koordinimin, formulimin dhe marrjen e vendimeve në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

(i) *Këshilli për Punët e Jashtme* përpunon veprimin e jashtëm të Bashkimit Evropian, mbështetur në udhëzimet strategjike të parashikuara nga Këshilli Evropian. Ky Këshill siguron qëndrueshmërinë e veprimit të Bashkimit Evropian (neni 16/6, TBE). Këshilli për Punët e Jashtme ushtron kompetenca në të gjithë veprimin e jashtëm të Bashkimit Evropian, duke përfshirë PJSP-në dhe PSMP-në,³³² bashkëpunimin e zhvillimit dhe ndihmën humanitare.³³³ Ky Këshill për Punët e Jashtme kryesohet nga Përfaqësuesi i

³²⁹ Këshilli i Ministrave. Konfigurimet e Këshillit. <http://www.consilium.europa.eu/en/council-eu/configurations>.

³³⁰ Neni 236, TBE: “Këshilli Evropian miraton me shumicë të cilësuar: (a) një vendim ku përcaktohet lista e konfigurimeve të Këshillit, me përjashtim të atyre të Këshillit për Çështje të Përgjithshme dhe të Këshillit për Punët e Jashtme, në zbatim të nenit 16(6) të Traktatit për Bashkimin Evropian; (b) një vendim për konfigurimet e Presidencës së Këshillit, me përjashtim të atij të Punëve të Jashtme, në përputhje me nenin 16(9) të Traktatit për Bashkimin Evropian”.

³³¹ *Council Decision 2009/937/EU*.

³³² Vendim i Këshillit Evropian 2010/594/BE i 16 shtator 2010 për ndryshimin e listës së konfigurimeve të Këshillit (*European Council Decision 2010/594/EU*).

³³³ *Council Decision 2009/937/EU*.

Lartë i Bashkimit Evropian³³⁴ dhe është i përbërë nga 28 ministrat e punëve të jashtme të Shteteve Anëtare.

Këshilli për Punët e Jashtme luan rol kryesor vendimmarrës dhe ndërmerr shumicën e vendimeve për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (Puetter, 2014). Ai shërben për të koordinuar dhe përforcuar bazën institucionale të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Ky Këshill siguron konsistencën në të gjithë instrumentet e veprimit të jashtëm të BE-së së bashku me Këshillin e Çështjeve të Përgjithshme.

(ii) *Komiteti Politik dhe i Sigurisë (KSP)* është organ i Këshillit nën përgjegjësinë e Përfaqësuesit të Lartë,³³⁵ i cili merret me situatat e krizës dhe shqyrton të gjitha mundësitë që mund të konsiderohet si përgjigje e BE-së.³³⁶ Komiteti Politik dhe i Sigurisë monitoron situatën ndërkombëtare në fushat e mbuluara nga PJSP-ja dhe PSMP-ja. Komiteti Politik dhe i Sigurisë është përgjegjës për PJSP-në dhe PSMP-së (Kaczorowska, 2011: 116). Neni 38, TBE rregullon veprimtarinë e KPS. Ky Komitet luan një rol qendror në përcaktimin dhe asistimin e reagimit të Bashkimit Evropian ndaj një krize ndërkombëtare.

KPS i propozon Këshillit objektivat politike dhe rekomandon opinione për marrjen e vendimeve në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Pa paragjykuar rolin e Komisionit, Komiteti Politik dhe i Sigurisë mbikëqyr zbatimin e masave të marra nga Këshilli dhe vlerëson efektet e tyre.³³⁷ Komisioni dhe Shtetet Anëtare informojnë KPS

³³⁴ Vendim i Këshillit 2013/746/BE i 10 dhjetor 2013 për miratimin e Rregullores së Procedurës së Këshillit. (*Council Decision 2013/746/EU*).

³³⁵ Neni 38, TBE: “Ky Komitet ndjek edhe vënien në zbatim të politikave të miratuara, pa cenuar kompetencat e Përfaqësuesit të Lartë. Brenda fushës së veprimit të këtij Kreu, Komiteti Politik dhe i Sigurimit ushtron, nën përgjegjësinë e Këshillit dhe të Përfaqësuesit të Lartë, kontrollin politik dhe drejtimin strategjik të operacioneve për trajtimin e krizave”.

³³⁶ Vendim i Këshillit 2001/78/PJSP i 22 janar 2001 për ngritjen e Komitetit Politik dhe të Sigurisë (*Council Decision 2001/78/CFSP*).

³³⁷ Vendim i Këshillit 2009/937/BE i 1 dhjetor 2009 për miratimin e Rregullores së Procedurës së Këshillit.

për masat e marra, ose për masat që po planifikojnë të marrin. Më konkretisht Komiteti Politik dhe i Sigurisë ka kompetenca të tilla si monitorimin e situatës ndërkombëtare,³³⁸ jep opinione për Këshillin, në mënyrë që të ndihmojë në përcaktimin e politikave (neni 38, TBE); koordinon, mbikëqyr dhe monitoron punën e udhëhequr nga grupet e ndryshme të Këshillit që punojnë në fushën e PJSP-së; shqyrton përfundimet e propozuara nga Këshilli për Çështjet e Përgjithshme; rekomandon qasje strategjike dhe alternative të politikës së punës së Këshillit; ofron udhëzime për Komitetin Ushtarak, Grupin Politik-Ushtarak dhe Komitetin për aspektet civile të menaxhimit të krizave; siguron kontrollin politik dhe drejtimin strategjik të operacioneve të menaxhimit të krizave (neni 43, TBE).

(iii) *Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm i quajtur COREPER*,³³⁹ shërben për të përgatitur punën e Këshillit dhe kryerjen e detyrave që i ngarkohen nga Këshilli. Detyrat e tij përcaktohen në nenin 16 të TBE³⁴⁰ dhe në nenin 240 të TFBE.³⁴¹ COREPER është i përbërë nga përfaqësues të përhershëm të Shteteve Anëtare të BE-së.³⁴² Çdo Shtet Anëtar ka një delegacion të përhershëm në Bruksel të përbërë nga nëpunës civilë kombëtare në nivel ambasadorial. Objektivi kryesor i COREPER³⁴³ është të përgatisë propozime, të cilat negociohen në takimet e Këshillit të Ministrave (Kaczorowska, 2011: 138). Komiteti i

³³⁸ Neni 38, TBE: “një Komitet Politik dhe i Sigurimit ndjek situatën ndërkombëtare në fushat që mbulon politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurimit dhe kontribuon në përcaktimin e politikave, duke i dhënë opinione Këshillit me kërkesë të Këshillit ose të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, ose me nismën e vet”.

³³⁹ Vendim i Këshillit 2009/937/BE i 1 dhjetor 2009 për miratimin e Rregullores së Procedurës së Këshillit, neni 19 (COREPER, Komitetet dhe palët e punës) (*Council Decision 2009/479/EU*).

³⁴⁰ Neni 16/7, TBE: “Një Komitet i Përfaqësuesve të Përhershëm të Qeverive të Shteteve Anëtare është përgjegjës për përgatitjen e punës së Këshillit”.

³⁴¹ Neni 240/1, TFBE: “Një komitet i përbërë nga Përfaqësuesit e Përhershëm të Qeverive të Shteteve Anëtare është përgjegjës për përgatitjen e punës së Këshillit dhe për realizimin e detyrave që ia ngarkon ky i fundit. Komiteti mund të miratojë vendime procedurale në rastet e parashikuara në Rregulloren e Brendshme të Këshillit”.

³⁴² Këta përfaqësues të përhershëm janë diplomat karriere.

³⁴³ Për informacion të zgjeruar rreth COREPER, shih: Jacque, 2010.

Përfaqësuesve të Përhershëm përgatit punën për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët dhe luan një rol të rëndësishëm në vendimarrjen e kësaj politike nëpërmjet sigurimit të koherencës së përgjithshme. COREPER ndahet në dy formacione kryesore.³⁴⁴

(iv) *Korrespondenca Evropiane (COREU)*, shërben për të lidhur Shtetet Anëtare me Këshillin e Ministrave, SHVJE dhe Komisionin. COREU³⁴⁵ është një rrjet ndërlidhës ndërmjet ministrave të jashtme në trajtimin e punëve të ndryshme në fushën e PJSP-së (Jacque, 2010: 366). Nëpërmjet COREU Shtetet Anëtare shkëmbejnë informacion të sigurtë në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Ky rrjet shërben gjithashtu për të kryer një sërë funksionesh që përfshijnë marrjen e vendimeve, monitorimin dhe zbatimin në fushën e PJSP (Bicchi dhe Carta, 2010). COREPER dhe COREU janë organe që përveç detyrave të tjera veprojnë edhe për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

4.2. Institucionet komunitare që kanë rol të kufizuar në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët

4.2.1. Komisioni Evropian

Komisioni Evropian është institucioni që ushtron pushtetin ekzekutiv, nëpërmjet garantimit të zbatimit të Traktateve dhe akteve të organeve të BE-së.³⁴⁶ Komisioni Evropian mbart disa kompetenca,³⁴⁷ që përfshijnë përfaqësimin e jashtëm të BE-së me

³⁴⁴ COREPER I- i përbërë nga zëvendëspërfaqësuesit e përhershëm, të cilët përqendrohen në çështjet të ndryshme; dhe COREPER II- i përbërë nga përfaqësuesit e përhershëm, të cilët fokusohen në çështjet e përgjithshme dhe politike.

³⁴⁵ CFSP Guide 18 June 2008, 10898/08, PESC 813, RELEX 459. (Udhëzues i PJSP i 18 qershor 2008, 10898/08, PSC 813, RELEX 459).

³⁴⁶ Neni 17, TBE.

³⁴⁷ Neni 17/1, TBE: “Komisioni promovon interesin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian dhe, për këtë qëllim, merr nismat e duhura. Ai siguron zbatimin e Traktateve dhe të masave të miratuara nga institucionet në zbatim të tyre. Ai mbikëqyr zbatimin e së drejtës së Bashkimit Evropian nën kontrollin e Gjykatës së

përfashtim të politikës së jashtme dhe të sigurisë.³⁴⁸ Në Traktatin e Lisbonës, Komisioni nuk e ka më të drejtën për iniciativë në fushën e PJSP-së që në Traktatet e mëparshme³⁴⁹ e ushtronte bashkë me Shtetet Anëtare. Me qëllim forcimin e rolit të Bashkimit Evropian dhe unifikimit të pozicionit të tij duhet që Komisioni të disponojë një kompetencë të tillë. Ndërkohë pas Lisbonës, e drejta për iniciativë i përket çdo Shteti Anëtar, Përfaqësuesit të Lartë në mënyrë individuale dhe Përfaqësuesit të Lartë me mbështetjen e Komisionit.³⁵⁰

Pikërisht mungesa e një të drejte ekskluzive e iniciativës të Komisionit është një nga karakteristikat kryesore që dallon PJSP-në nga politikat e tjera. Traktati i Lisbonës ndryshoi gjithashtu, formulimin e mëparshëm nën Traktatin e Maastrichtit, sipas të cilit, funksioni i Komisionit ishte i lidhur plotësisht me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Ish-Direktorati i Përgjithshëm për Marrëdhëniet me Jashtë, ishte një organ i Komisionit, që mbante përgjegjësi për politikën e jashtme. Më pas ky Direktorat i Përgjithshëm u bashkua tërësisht me Shërbimin e Veprimit të Jashtëm Evropian.

Gjithsesi, Komisioni ka të drejtë që t'i paraqesë Këshillit propozime për veprim e jashtëm të BE-së, e drejtë që e ndan bashkarisht me zëvendëspresidentin e Komisionit ose Përfaqësuesin e Lartë (Jacque, 2010: 36). Shërbimi i Instrumenteve të Politikës së Jashtme përgjegjës për planifikimin dhe administrimin financiar të Instrumentit të Stabilitetit,

Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Ai zbaton buxhetin dhe administron programet. Ai ushtron funksione bashkërenduese, ekzekutuese dhe administruese, që parashikohen në Traktatet. Ai çel programimin vjetor dhe shumëvjeçar të Bashkimit Evropian, me qëllim arritjen e marrëveshjeve ndërinstitucionale”.

³⁴⁸ Neni 17/1, TBE: “Me përfashtim të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, dhe të rasteve të tjera të parashikuara nga Traktatet, ai siguron përfaqësimin e jashtëm të Bashkimit Evropian”.

³⁴⁹ Në Traktatin e Maastrichtit Shtetet Anëtare dhe Komisioni kishin të drejtën e iniciativës. Sipas nenit J.8 të TBE të Maastrichtit: “Komisioni nuk ushtronte më të drejtën e tij ekskluzive të iniciativës ligjvënëse, por Komisioni e ndante këtë të drejtë me Shtetet Anëtare”; Neni J.8 i Traktatit të Maastrichtit, në lidhje me të drejtën e iniciativës nuk u ndryshua as në Traktatin e Amsterdams as në Traktatin e Nisës, ndryshimet u shfaqën në Traktatin që themelonte një Kushtetutë për Evropën. Ashtu si çdo ndryshim i rëndësishëm i miratuar në Traktatin e Lisbonës edhe e drejta për iniciativën ligjvënëse është formuluar sipas ndryshimeve të Traktatit Kushtetues.

³⁵⁰ Neni 30, ish-neni 22 TBE.

mbetet një shërbim i Komisionit. Gjithsesi i raporton drejtpërdrejt Përfaqësuesit të Lartë në rolin e zëvendës-presidentit të Komisionit. Përkundër këtyre kufizimeve, Komisioni Evropian ende luan një rol të rëndësishëm në veprimin e jashtëm të Bashkimit Evropian dhe si pasojë në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

Komisioni Evropian është përgjegjës për hartimin e propozimit për buxhetin e BE-së, duke përfshirë alokimet për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Roli i tij është rritur në këtë aspekt pas krijimit të Politikës Evropiane të Fqinjësisë, ku zhvillimi dhe ndihma humanitare mbeten në fushëveprimin e Komisionit. Komisioni dhe Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian bashkarisht planifikojnë strategjitë e shpenzime të përgjithshme për veprimin e jashtëm të Bashkimit Evropian.

4.2.2. Parlamenti Evropian

Parlamenti Evropian ushtron bashkarisht me Këshillin funksione legislative dhe buxhetore (neni 14/1, TBE).³⁵¹ Ai është organi i përfaqësuesve të popujve të Shteteve Anëtare dhe në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë ka një rol të kufizuar. Parlamenti Evropian ka rol në procesin vendimmarrës në përgjithësi por nuk e ka një të tillë në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Roli i tij kufizohet në tre aspekte kryesore: informim, konsultim dhe debat (Schmidt-Radefeldt, 2013: 1120).

Sipas nenit 36 TBE, Parlamenti Evropian në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë, konsultohet dhe mbahet i informuar. Parlamenti ka të drejtën t'i drejtojë pyetje ose rekomandime Këshillit ose Përfaqësuesit të Lartë në fushën e Politikës së Jashtme dhe të

³⁵¹ Neni 14/1, TBE: “Parlamenti Evropian ushtron bashkërisht me Këshillin funksione legislative dhe buxhetore. Parlamenti ushtron funksione të kontrollit politik dhe të konsultimit, sikurse parashikohet në Traktatet. Ai zgjedh Presidentin e Komisionit”.

Sigurisë së Përbashkët. Përfaqësuesi i Lartë nga ana tjetër ka përgjegjësinë të informojë Parlamentin Evropian.³⁵² Në Traktatin e Lisbonës, roli i Parlamentit Evropian është përforcuar më shumë në krahasim me traktatet e mëparshme. Roli i tij mbikqyrës³⁵³ është përforcuar edhe në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, duke siguruar të drejtën për t'u konsultuar rregullisht mbi aspektet kryesore dhe zgjidhjet themelore të PJSP dhe PSMP.³⁵⁴

Roli i fortë konsultativ i Parlamentit Evropian konsiston në rritjen e debateve nga një herë në vit në dy herë në vit, mbi ecurinë e zbatimit të PJSP dhe PSMP.³⁵⁵ Parlamenti mund të miratojë rezoluta jo-legjislative dhe rekomandime dhe lëshon një raport vjetor dhe rekomandime për zhvillimin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.³⁵⁶ Parlamenti ushtron një lloj forme kontrolli juridiksional për politikën e jashtme dhe të sigurisë veçanërisht duke përdorur kompetencën e tij për votimin e shpenzimeve si formë presioni ndaj Këshillit (Jacque, 2010:367).

Gjithsesi roli i Parlamentit në PJSP është i kufizuar dhe kjo përveç dispozitave të traktateve është konfirmuar edhe nga GJED-ja. Në një rast të Gjykatës Evropian të Drejtësisë, *Parlamenti Evropian kundër Këshillit*, Parlamenti Evropian kërkoi para GJED-së³⁵⁷ anulimin e një Rregulloreje të Këshillit³⁵⁸ për vendosjen e masave kufizuese në

³⁵² Neni 36, ish-neni 21 TBE: "Përfaqësuesi i Lartë konsultohet rregullisht me parlamentin, e informon atë se si zhvillohen këto politika dhe kujdeset që të merren si duhet në konsideratë pikëpamjet e parlamentit".

³⁵³ Në një studim informues nga Zyra Koordinuese Evropiane e Ndërtimit të Paqes me titull "Struktura dhe instrumentet e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës", theksohet forcimi i rolit të Parlamentit.

³⁵⁴ EPLO Briefing Paper 1/2012. Common Foreign and Security Policy structures and instruments after the entry into force of the Lisbon Treaty, April 2012.

³⁵⁵ Neni 36, ish-neni 21 TBE.

³⁵⁶ EPLO Briefing Paper 1/2012. Common Foreign and Security Policy structures and instruments after the entry into force of the Lisbon Treaty, April 2012.

³⁵⁷ Vendimi C-130/10 *Parlamenti Evropian kundër Këshillit të Bashkimit Evropian* [2012] ECR I-472, paragrafi 5.

drejtim të personave dhe subjekteve të caktuara. Rregullorja e kontestuar u miratua nga Këshilli më 22 dhjetor 2009, bazuar në nenin 215/2, TFBE³⁵⁹ dhe i referohet një propozimi të përbashkët të Përfaqësuesit të Lartë dhe Komisionit. Pretendimet e Parlamentit Evropian për anulimin e rregullores bazoheshin në faktin se baza ligjore e miratimit të këtij vendimi³⁶⁰ ishte e gabuar, pasi baza e saktë ligjore ishte neni 75 TFBE.³⁶¹ GJED-ja hodhi poshtë kërkesën e bërë nga Parlamenti Evropian se rregullorja e miratuar nga Këshilli duhej të ishte miratuar në bazë të nenit 75 TFBE në lidhje me zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.³⁶²

Gjykata nëpërmjet vendimit, përsëriti jurisprudencën e saj në themelimin e një baze të dyfishtë ligjore, duke theksuar se, nuk mund të ketë një kombinim ndërmjet një baze ligjore të një politike të jashtme dhe të sigurisë dhe të një politike jo të tillë (Kuijper, Wouters, Hoffmeister, De Baere dhe Ramopoulos, 2015: 657). Kjo për shkak të papajtueshmërisë së bazës procedurale ligjore përkatëse. GJED-ja konkludon gjithashtu se, dallimi ndërmjet nenit 75 TFBE dhe nenit 215 TFBE, duke sjellë në pah dhe shqetësimin e Parlamentit Evropian në lidhje me çështjen, është rezultat i zgjedhjes së bërë nga hartuesit e

³⁵⁸ Rregullorja e Këshillit (BE), Nr. 1286/2009 i 22 dhjetorit 2009 për ndryshimin e Rregullores (KE) Nr. 881/2002 vendosjen e masave të caktuara specifike kufizuese të drejtuara kundër personave të caktuar dhe subjekteve të lidhura me Osama bin Laden, rrjeti Al-Kaedës dhe talebanëve (OJ 2009 L 346, f. 42, rregullorja e kontestuar), (*Council Regulation (EU) No 1286/2009*).

³⁵⁹ Neni 215/2, TFBE: “Kur e parashikon një vendim i miratuar në përputhje me Kreun 2 të Titullit V të Traktatit për Bashkimin Evropian, Këshilli mund të miratojë masa kufizuese sipas procedurës të përmendur në paragrafin 1, kundër personave fizikë ose juridikë dhe grupimeve ose subjekteve joshitetërore”.

³⁶⁰ Neni 215, TFBE.

³⁶¹ Neni 75, TFBE: “Kur është e nevojshme për të arritur objektivat e parashikuara në nenin 67, lidhur me parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit dhe veprimtarive të lidhura me të, Parlamenti Evropian vendos përmes rregulloreve sipas procedurës së zakonshme legislative, një kuadër për masat administrative lidhur me lëvizjet e kapitalit dhe pagesat, siç janë ngrirja e fondeve, pasurive financiare ose fitimeve ekonomike që u përkasin ose janë në pronësi të personave fizikë ose juridikë, grupimeve ose subjekteve jo shtetërore. Këshilli, me propozim të Komisionit, miraton masat për vënien në zbatim të kuadrit të përmendur në paragrafin e parë.

³⁶² Zona e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë (Area of freedom, security and justice) synon të sigurojë liri të vërtetë të lëvizjes së njerëzve në territorin e Bashkimit Evropian dhe një veprim më të efektshëm kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik. Kjo zonë përfshin çështje që lidhen me drejtësinë, bashkëpunimin policor dhe punët e brendshme, të cilat para Traktatit të Lisbonës i përkisnin shtyllës së tretë.

Traktatit të Lisbonës, që i kanë dhënë një *rol të kufizuar* Parlamentit lidhur me veprimin e Bashkimit Evropian nën politikën e jashtme dhe të sigurisë.³⁶³

4.3. Gjykata Evropiane e Drejtësisë dhe roli i saj i kufizuar lidhur me Politikën e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët

Gjykata e Drejtësisë *nuk ka juridiksion në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët* (neni 24/1, TBE). Komisioni Evropian ka shpjeguar se Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët është vendosur jashtë juridiksionit të GJED-së, pasi politika e sigurisë është *së pari një çështje e vendimeve politike dhe më pak një çështje gjyqësore*.³⁶⁴ Përfshirja e juridiksionit të GJED-së në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, është konfirmuar menjëherë nga Gjykata e Drejtësisë në çështjen *Grau Gomis dhe të tjerë*³⁶⁵ të vitit 1995 (Vooren dhe Wessel, 2014: 376). Roli i Gjykatës të Drejtësisë në PJSP ka qenë subjekt i analizës ligjore përgjatë viteve nga autorë të ndryshëm.³⁶⁶

Sipas autorëve Gisella dhe Ketvel, përfshirja e juridiksionit të Gjykatës të Drejtësisë për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, mund të jetë problematike nga perspektiva e sundimit të ligjit (2006: 118). Megjithatë përfshirja e juridiksionit të GJED-së nuk nënkupton mungesën e sundimit të ligjit në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, nuk nënkupton që kjo politikë nuk i nënshtrohet të drejtës.

³⁶³ Vendimi C-130/10 *Parlamenti Evropian kundër Këshillit të Bashkimit Evropian* [2012] ECR I-472, shih paragrafin 82, sipas të cilit: *Nevertheless, the difference between Article 75 TFEU and Article 215 TFEU, so far as the Parliament's involvement is concerned, is the result of the choice made by the framers of the Treaty of Lisbon conferring a more limited role on the Parliament with regard to the Union's action under the CFSP.*

³⁶⁴ EU Commission - SEC Document. Initial contribution by the Commission to the Intergovernmental Conference on Political Union. Composite working paper. SEC (91) 500 final, 15 May 1991.

³⁶⁵ Vendimi C-167/94 *Grau Gomis dhe të tjerë* [1995] ECR I-1023.

³⁶⁶ Shih: Eeckhout, (2004); Tridimas, (2004); Eeckhout, (2005); Hillion dhe Wessel, (2008); Van Ooik, (2008); De Baere, (2008); Hinarejos, (2009); Saltinyte, (2010); De Baere dhe Koutrakos, (2012); Griller, (2013).

Juridiksioni i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët ka qenë i kufizuar që herët në nenin 31 të Aktin Unik Evropian.³⁶⁷ Një përcaktim i ngjashëm u paraqit edhe në nenin L të Traktatit të Maastrichtit.

Kjo dispozitë prezantoi listën e fushave në të cilat GJED-ja kishte juridiksion dhe Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët nuk ishte e përfshirë. Përjashtimi i juridiksionit të GJED-së në politikën e jashtme dhe të sigurisë u transferua edhe në traktatet e mëvonshme në nenin 46 të Traktatit të Amsterdamt³⁶⁸ dhe më pas në Traktatin e Lisbonës. Ndërkohë Traktati i Lisbonës solli ndryshime të rëndësishme për përmbajtjen dhe mënyrën e rregullimit të juridiksionit të GJED-së mbi PJSP-së.

GJED-ja nuk luan rol të rëndësishëm në PJSP, pasi aktet normative miratohen vetëm nëpërmjet TFBE (Eeckhout, 2011: 479), ndërsa PJSP-ja vepron në kuadër të vendimmarrjes në nivel ndërqeveritar (Arnall, 2013: 780). Sipas mendimit të Elsuwege (2010: 992), përjashtimi i juridiksionit të Gjykatës të Drejtësisë mund të shpjegohet nga dëshira e Shteteve Anëtare për të ruajtur një fleksibilitet shumë të gjerë në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Traktati i Lisbonës ka krijuar një bazë ligjore që pavarësisht përjashtimit të juridiksioni të GJED-së në fushën e PJSP-së, ajo mirëmban kompetenca të konsiderueshme për shqyrtimin e Instrumentave të miratuara në titullin V të TBE-së. GJED-ja ka juridiksion në PJSP të paktën në dy çështje kryesore. *Së pari*, GJED-ja ka juridiksion të sigurojë që Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët nuk shkel mbi politikat apo kompetencat e

³⁶⁷ Vendimi C-253/94 P, *Olivier Roujanski* [1995] ECR I-0007, paragrafi 4.

³⁶⁸ Vendimi T-14/98, *Heidi Hautala kundër Këshillit* [1999] ECR II-2489, shih paragrafin 4, sipas të cilit: *The Court of First Instance further found that Article 31 of the Single European Act, which was in force when the contested declaration was adopted, expressly excluded the application to the European Council of the provisions of the EEC Treaty concerning the jurisdiction of the Community judicature and that the exclusion was maintained by Article L of the Treaty on European Union.*

tjera të Bashkimit Evropian dhe anasjelltas (neni 40, TBE).³⁶⁹ Së dyti, të shqyrtojë ligjshmërinë e sanksioneve të vendosura ndaj personave fizikë dhe juridikë në kuadër të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (neni 275, TFBE).³⁷⁰

(i) Lidhur me neni 40 TBE, në të cilin GJED-ja garanton ndarjen e kufijve ndërmjet kompetencave të jashtme të Bashkimit Evropian përfshirë këtu edhe PJSP-në, rastet e para të shqyrtuara prej saj kishin të bënin me shtyllën e tretë.³⁷¹ Në këto çështje të trajtuara në kuadrin e shtyllës së tretë GJED-ja bëri shqyrtimin e akteve që shkelnin kompetencat ndërmjet institucione duke hedhur dritë edhe mbi politikën e jashtme dhe të sigurisë.³⁷²

Gjykata e Drejtësisë duke përjashtuar shprehimisht juridiksionin e saj në PJSP, në vendimet e hershme të saj, në çështjen *The Queen, ex parte Centro-Com Srl kundër HM Treasury and Bank of England* është shprehur se, Shtetet Anëtare mund të miratojnë marrjen e masave në politikën e jashtme dhe të sigurisë në kuadër të kompetencave të tyre kombëtare, megjithatë këto masa nuk mund të shkelin dispozitat e miratuara nga Komuniteti.³⁷³ Në shqyrtimin e nenit 40 TBE, Gjykata e Drejtësisë shpreh se implementimi

³⁶⁹ Neni 40, TBE: “Zbatimi i politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit nuk e prek zbatimin e procedurave dhe shtrirjen e kompetencave të institucioneve të parashikuara nga Traktatet për ushtrimin e kompetencave të Bashkimit Evropian”.

³⁷⁰ Neni 275, TFBE: “Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian nuk ka kompetencë lidhur me dispozitat që kanë të bëjnë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë dhe as lidhur me aktet e miratuara në mbështetje të këtyre dispozitave. Por, Gjykata ka kompetencë të vëzhgojë respektimin e nenit 40 të Traktatit për Bashkimin Evropian dhe të vendosë mbi proceset e hapura në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin e katërt të nenit 263 të këtij Traktati, duke shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve që parashikojnë masa kufizuese kundër personave fizikë dhe juridikë të miratuara nga Këshilli në mbështetje të Kreut 2 të Titullit V të Traktatit për Bashkimin Evropian”; Shih: nenin 215, TFBE.

³⁷¹ Vendimi C-170/96, *Komisioni kundër Këshillit* (Airport Transit Visas) [1998] ECR I-2763; Vendimi C-176/03, *Komisioni kundër Këshillit* (Environmental penalties)[2005] ECR I-7879; Vendimi C-440/05, *Komisioni kundër Këshillit* (Ship Source Pollution)[2006] ECR I-9097;

³⁷² Vendimi C-91/05, *Komisioni kundër Këshillit* (Small Arms and Light Weapons), (ECOWAS) [2008] ECR I-3651.

³⁷³ Vendimi C-124/95 *The Queen, ex parte Centro-Com Srl kundër HM Treasury and Bank of England* [1997] ECR I-81, paragrafi 27, citimi origjinal i paragrafit: *Consequently, while it is for Member States to adopt measures of foreign and security policy in the exercise of their national competence, those measures*

i PJSP-së nuk ndikon në zbatimin e procedurave dhe shtrirjen e kompetencave të institucioneve të përcaktuara nga traktatet.³⁷⁴

Në dy rastet e GJED-së, në rastin *Svenska Journalistförbundet* të vitit 1998³⁷⁵ dhe *Hautala kundër Këshillit* të vitit 1999³⁷⁶ në lidhje me shqyrtimin e akteve për akses publik në fushën e PJSP-së, gjykata konfirmoi juridiksionin e saj. Sipas vendimit të GJED-së, fakti që Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka juridiksion në shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve brenda Titullit V, në fushën e PJSP-së, nuk nënkupton përjashtimin e juridiksionit të saj, për të vendosur për aksesin publik të këtyre akteve.³⁷⁷ Juridiksioni i GJED-së në shqyrtimin e nenit 40, TBE e bën të qartë se kompetencat e PJSP-së nuk duhet të shkelë mbi kompetencat e tjera të Bashkimit Evropian.

(ii) GJED-ja ka zhvilluar një juridiksion të gjerë lidhur me kompetencën e përcaktuar në nenin 275, TFBE dhe nenin 215/2, TFBE,³⁷⁸ se GJED-ja brenda kompetencave të saj ka juridiksion të shqyrtojë aktet e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Gjykimi i GJED-së në rastin *Kadi*³⁷⁹ (të diskutuar në kërret më sipër) përbën një pikë referimi për shtrirjen e juridiksionit të GJED-së në masat kufizuese të miratuara nga

must nevertheless respect the provisions adopted by the Community in the field of the common commercial policy provided for by Article 113 of the Treaty.

³⁷⁴ Vendimi T-174/95, *Svenska Journalistförbundet* [1998] ECR II-2289; Vendimi T-14/98, *Hautala kundër Këshillit* [1999] ECR II-2489; Vendimi T-47/03, *Jose Maria Sison kundër Këshillit* [2007] ECR II-0073.

³⁷⁵ Vendimi T-174/95, *Svenska Journalistförbundet* [1998] ECR II-2289 paragrafi 80 dhe 82.

³⁷⁶ Vendimi T-14/98, *Hautala kundër Këshillit* [1999] ECR II-2489, paragrafi 41-42;

³⁷⁷ Vendimi T-14/98, *Hautala kundër Këshillit* [1999] ECR II-2489, shih paragrafin 42, sipas të cilit: *The fact that under Article L of that Treaty the Court of First Instance does not have jurisdiction to assess the lawfulness of acts falling within Title V thus does not exclude its jurisdiction to rule on public access to those acts.*

³⁷⁸ Neni 215/2, TFBE: “Kur e parashikon një vendim i miratuar në përputhje me Kreun 2 të Titullit V të Traktatit për Bashkimin Evropian, Këshilli mund të miratojë masa kufizuese sipas procedurës të përmendur në paragrafin 1, kundër personave fizikë ose juridikë dhe grupimeve ose subjekteve joshitetërore”.

³⁷⁹ Vendimet e Përbashkëta C-402/05P dhe C-415/05P, *Yassin Abdullah Kadi dhe Al Barakaat International Foundation kundër Këshillit dhe Komisionit* [2008] ECR I-6351; Vendimet e Përbashkëta C-584/10P, C-593/10 and C-595/10P *Komisioni, Këshilli, Mbretëria e Bashkuar kundër Kadi (Kadi II)*, [2013].

Këshilli kundër personave fizikë ose juridikë dhe grupimeve ose subjekteve joshtetërore. Në rastin *Kadi* të vitit 2005, 2008 dhe 2013, të shqyrtuar në përputhje me nenin 275 TFBE, theksohet se të drejtat themelore zbatohen në mënyrë të barabartë me PJSP-në dhe rasti *Kadi* zbulon se të drejta themelore të njeriut duhet të respektohen në përputhje me masat kufizuese.

Në lidhje me shqyrtimin e ligjshmërisë së masave të kufizuara kundër personave fizikë dhe juridikë, Gjykata e Drejtësisë kohët e fundit ka shprehur se akoma nuk ka patur mundësinë të përcaktojë shkallën në të cilën juridiksioni i saj është i kufizuar në çështjen e Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.³⁸⁰

4.4. Aktorët institucional që kanë ridimensionuar kapacitetin e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët për të vepruar në arenën ndërkombëtare

4.4.1. Përfaqësuesi i Lartë për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët

Krijimi i postit të Përfaqësuesit të Lartë që në Traktatin e Amsterdami dhe zhvillimi i këtij posti në Traktatin e Lisbonës, u perceptua, si një mekanizëm efikas për të rritur rolin e Bashkimit Evropian për të folur në një “zë të vetëm” në skenën ndërkombëtare. Dhënia e një zëri Bashkimit Evropian, në çështjet ndërkombëtare ka qenë një shqetësim kryesor për Shtetet Anëtare të paktën, që nga krijimi i BPE (Gross, 2009:11). Kur ideja e një traktati të ri filloi të marrë formë, kishte shumë aktorë të cilët insistonin në

³⁸⁰ Opinion 2/13 of the Court of Justice of 18 December 2014, the European Union's accession to the European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms, ecli: EU: C: 2014: 2454, shih paragrafin 251, sipas të cilit: *...it must be noted that the Court has not yet had the opportunity to define the extent to which its jurisdiction is limited in CFSP matters as a result of those provisions.*

përmirësimin e funksioneve të Përfaqësuesit të Lartë, me qëllim rritjen e koherencës në PJSP. Sistemi i vjetër ishte përshkruar si i paqëndrueshëm dhe si i nevojshëm për ndryshim (Norman, 2005: 92).

Shumë nene të Traktatit të Lisbonës janë të njëjta me ato të dispozitave të Projekt-Kushtetutës, por ndërkohë ndryshime të dukshme janë bërë. Ndryshimi i parë është ndryshimi i emrit nga Ministri i Punëve të Jashtme të Bashkimit Evropian, në Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit (Përfaqësuesin e Lartë). Ky ndryshim erdhi, si pasojë e insistimeve të kundërshtimeve britanike dhe Shteteve Anëtare për të përfshirë të gjitha referencat ndaj simboleve shtetërore në traktatin e amenduar (Wouters, Coppens dhe Meester, 2008: 150), (Kaddous, 2008: 206).

Përfaqësuesi i Lartë është a) Presidenti i Këshillit të Punëve të Jashtme³⁸¹ dhe b) Zëvendës President i Komisionit,³⁸² nga dy Zëvendës Presidentë, përgjegjës për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Politikën Evropiane të Fqinjësisë. Në rastin e parë, Përfaqësuesi i Lartë vepron, si përfaqësues i Këshillit Evropian me të drejtën e iniciativës, në rastin e dytë, Përfaqësuesi i Lartë vepron sipas parimit të kolegjalitetit, si pjesë përbërëse e Komisionit Evropian.

Sipas Verolës, Përfaqësuesi i Lartë kombinon përgjegjësitë e “dy kapeleve,” e Përfaqësuesit të Lartë dhe Komisionerit të BE-së për marrëdhëniet e jashtme (Verola, 2009: 44). Ndërsa, sipas autorëve të tjerë si, Kaczorowska (2011: 112), Vooren dhe Wessel (2014: 19), De Baere dhe Wessel (2014: 10), Përfaqësuesi i Lartë mbart përgjegjësinë e

³⁸¹ Neni 18/3, TBE: “Përfaqësuesi i Lartë drejton Këshillin për Punët e Jashtme”; Neni 27/1 TBE: “Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,... drejton Këshillin për Punët e Jashtme”.

³⁸² Neni 18/4, TBE: “Përfaqësuesi i Lartë është njëri prej Zëvendëspresidentëve të Komisionit”.

“tre kapeleve”, këta autorë i referohen rolit drejtues të Këshillit të Punëve të Jashtme. Sipas doktrinës përgjegjësia e tre kapeleve mund të jetë shumë e mirë në teori, por tepër e rënduar në praktikë (De Baere dhe Wessel, 2014: 10). Përfaqësuesi i Lartë formon një urë ndërmjet PJSP-së dhe elementëve të tjerë të marrëdhënieve të jashtme të BE-së, me qëllim sigurimin e një koherencë më të madhe ndërmjet elementëve të ndryshëm të veprimit të jashtëm të BE-së.³⁸³

Traktati i Lisbonës krijoi një Përfaqësues të Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, përgjegjës për dy institucione, Komisionin dhe Këshillin, duke sjellë aspekte të ndryshme të veprimit të jashtëm të BE-së. Sipas autorëve Chalmers, Davies dhe Monti, ky pozicion ku një person është anëtar njëkohësisht i dy institucioneve të BE-së *është unik* në të drejtën e Bashkimit Evropian (2010: 663). Në këtë mënyrë afirmohet teoria e autorit Jacques, se në Bashkimin Evropian nuk ka ndarje të pushteteve në kuptimin klasik të konceptit por bashkim të pushteteve (2010: 165-166).

Një element tjetër për t’u përmendur është se, Përfaqësuesi i Lartë është paraqitur si një *person*, por ai gjithashtu mund të mendohet si një *organizatë*, që konkurren me Komitetin e Sigurisë Politike (Chalmers, Davies dhe Monti, 2010: 664). Përfaqësuesi i Lartë shikohet edhe si truri i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Në linjë logjike me hipotezën e studimit, sipas argumentave të sipërpërmendur konfirmojmë se, krijimi i organeve të reja në Traktatin e Lisbonës, kishte si qëllim dhe ndikoi në rritjen e rolit të BE-së, si aktor global në zgjidhjen e konflikteve. Krijimi i rolit të Përfaqësuesit të Lartë është projektuar për t’i dhënë BE-së një zë më koherent dhe vendimtar në arenën

³⁸³ Final report of Working Group VII on External Action, (CONV 459/02, WG VII 17) 16 December 2002, Brussels.

ndërkombëtare.³⁸⁴ Këshilli Evropian është organi i cili emëron Përfaqësuesin e Lartë, por nëpërmjet një procedure që i nënshtrohet votimit me një shumicë të cilësuar, pas miratimit të Presidentit të Komisionit Evropian.³⁸⁵

Ndërsa për emërimin e tij si zëvendës president i Komisionit, duhet që sëbashku me Presidentin e Komisionit Evropian dhe anëtarët e tjerë të Komisionit t'i nënshtrohen votëpëlqimit të Parlamenti Evropian.³⁸⁶ Parlamenti Evropian ka në kompetencë të tij dhënien e mocionit të mosbesimit ndaj Komisionit, në këtë rast Përfaqësuesi i Lartë, si organ jep dorëheqjen nga detyra që kryen në Komision, si Zëvendës President i Komisionit, por jo nga detyra e tij si Përfaqësues i Lartë.³⁸⁷

Përfaqësuesi i lartë ka kompetenca, të cilat trajtohen në aspektin e vendimmarrjes ndërqeveritare, gjithashtu zotëron kompetenca edhe sipas metodës komunitare (Henokl, 2014: 383). Duke marrë parasysh kompetencat e gjera të Përfaqësuesit të Lartë, disa Shtete Anëtare kanë frikë, se shumë fuqi i është dhënë një individi të vetëm. Megjithatë, në Deklaratën Nr. 14 janë sqaruar kompetencat dhe pozicioni i Përfaqësuesit të Lartë si një organ që kurrë nuk cënon kompetencat dhe përgjegjësitë e brendshme të Shteteve Anëtare.³⁸⁸ Përfaqësuesi i Lartë nuk ndikon në formulimin e politikës së jashtme kombëtare

³⁸⁴ European Parliament. Directorate-General for External Policies of the Union 2011. Implementing the EU Concept on Mediation: Learning from the Cases of Sudan and the Great Lakes, fq. 14.

³⁸⁵ Neni 18/1, TBE: “Këshilli Evropian, me shumicë të cilësuar, me miratimin e Presidentit të Komisionit, emëron Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit. Këshilli Evropian mund t'i japë fund mandatit të tij duke ndjekur të njëjtën procedurë.”

³⁸⁶ Neni 17/7, TBE: “Presidenti, Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit dhe anëtarët e tjerë të Komisionit i nënshtrohen si organ votëpëlqimit nga Parlamenti Evropian.”

³⁸⁷ Neni 17/8, TBE: “Komisioni si organ jep llogari përpara Parlamentit Evropian. Në përputhje me nenin 234 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, Parlamenti Evropian mund të votojë një mocion mosbesimi ndaj Komisionit. Nëse mocioni miratohet, anëtarët e Komisionit japin dorëheqjen si organ dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit jep dorëheqjen nga detyrat që kryen në Komision”.

³⁸⁸ Deklaratën Nr. 14: “dispozitat që prekin Përfaqësuesin e Lartë nuk prekin bazën ligjore, përgjegjësitë dhe kompetencat ekzistuese të asnjë Shteti Anëtar për të formuluar dhe zhvilluar politikën e tij të jashtme,

të çdo shteti anëtar në Bashkimin Evropian. Përfaqësuesi i Lartë ka kompetenca të ndryshme në varësi të funksionit që ai zotëron. Në rolin e tij si Zëvendës President i Komisionit, Përfaqësuesi i Lartë është përgjegjës për marrëdhëniet e jashtme. Përfaqësuesi i Lartë siguron qëndrueshmërinë dhe koordinon të gjithë veprimtarinë dhe detyrat që ushtron Komisioni në marrëdhëniet e jashtme.³⁸⁹

Si Përfaqësues i Lartë për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, ai ka një sërë kompetencash thelbësore për hartimin dhe funksionimin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë të Përbashkët.

Së pari, Përfaqësuesi i Lartë është organi kryesor që vë në jetë³⁹⁰ PJSP-në, nëpërmjet përdorimit të burimet kombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian.³⁹¹ *Së dyti*, garanton së bashku me Këshillin respektimin e parimeve të solidaritetit të ndërsjelltë, për mbështetjen aktive dhe pa rezerva të politikës së jashtme dhe të sigurisë, duke përjashtuar veprimet, të cilat ulin efektshmërinë e Bashkimit Evropian, si një forcë kohezive në marrëdhëniet ndërkombëtare.³⁹² *Së treti*, garanton unitetin, qëndrueshmërinë dhe efektshmërinë e veprimit të jashtëm BE-së së bashku me Këshillin.³⁹³ *Së katërti*, Përfaqësuesi i Lartë përfaqëson Bashkimin Evropian për çështjet, që kanë të bëjnë me PJSP, ai zhvillon dialog politik me të tretët dhe shpreh qëndrimin e Bashkimit Evropian në

shërbimin e tij diplomatik kombëtar, marrëdhëniet me vendet e treta dhe pjesëmarrjen në organizata ndërkombëtare”.

³⁸⁹ Neni 18/4, TBE: “Brenda Komisionit Evropian mban përgjegjësi për marrëdhëniet e jashtme, si dhe për bashkërendimin e aspekteve të tjera të veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian”

³⁹⁰ Neni 24/1, TBE: “Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët vihet në jetë nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit dhe nga Shtetet Anëtare në përputhje me Traktatet”

³⁹¹ Neni 26/3, TBE: “Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurimit vihet në jetë nga Përfaqësuesi i Lartë dhe nga Shtetet Anëtare, duke përdorur burimet kombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian”.

³⁹² Neni 24/3, TBE.

³⁹³ Neni 26/2, TBE.

organizatat dhe konferencat ndërkombëtare.³⁹⁴ Pra, Përfaqësuesi i Lartë përfaqëson Bashkimin Evropian para Këshillit të Sigurimit të OKB-së. *Së pesti*, Përfaqësuesi i Lartë dërgon nisma ose propozime për hartimin e PJSP-së, dërgimin e misioneve civile dhe garanton zbatimin e vendimeve të PJSP-së,³⁹⁵ propozon përdorimin e burimeve kombëtare dhe të instrumenteve të Bashkimit Evropian.³⁹⁶ Përfaqësuesi i Lartë paraqet propozime për fondit fillestar, dhe përdor fondin nën autoritetin e Këshillit të Ministrave.³⁹⁷ Gjithashtu Përfaqësuesi i Lartë propozon emërimin e një Përfaqësuesi të Posaçëm për çështje të veçanta të politikave me një mandat të caktuar nën autoritetin e tij.³⁹⁸ *Së gjashti*, vepron si një ndërmjetës, në rastet kur një Shtet Anëtar kundërshton miratimin e një vendimi, që duhet marrë me shumicë të cilësuar, Përfaqësuesi i Lartë në konsultim të ngushtë me shtetin në fjalë kërkon gjetjen e një zgjidhje të pranueshme.³⁹⁹ *Së fundmi*, konsultohet dhe informon Parlamentin Evropian për aspektet kryesore dhe alternativat bazë të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët dhe të Politikës së Sigurisë dhe të Mbrojtjes së Përbashkët.⁴⁰⁰

Përfaqësuesi i Lartë në funksionin e tij si *President i Këshillit të Punëve të Jashtme* bën propozime dhe kryeson mbledhjen e Këshillit të Punëve të Jashtme. Përfaqësuesi i

³⁹⁴ Neni 27/2, TBE.

³⁹⁵ Neni 27/1, TBE: ‘Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, i cili drejton Këshillin për Punët e Jashtme, kontribuon me propozimet e tij për hartimin e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit dhe garanton zbatimin e vendimeve që miraton Këshilli Evropian dhe Këshilli.’

³⁹⁶ Neni 42/4, TBE: ‘Përfaqësuesi i Lartë mund të propozojë përdorimin e burimeve kombëtare dhe të instrumenteve të Bashkimit Evropian, së bashku me Komisionin, sipas rastit.’

³⁹⁷ Neni 41/3, TBE: ‘Këshilli miraton, me shumicë të cilësuar, me propozim të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe për Politikën e Sigurimit, vendime ku përcaktohen: (a) procedurat për ngritjen dhe financimin e fondit fillestar, sidomos shumat që i kalojnë fondit; (b) procedurat për përdorimin e fondit fillestar; (c) procedurat e kontrollit financiar.’

³⁹⁸ Neni 33, TBE.

³⁹⁹ Neni 31/2, TBE.

⁴⁰⁰ Neni 36, TBE.

Lartë, si President i Këshillit të Punëve të Jashtme mbledh kryesisht ose me mocion të një shteti të veçantë një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit të Ministrave.⁴⁰¹

Përfaqësuesi i Lartë, gjithashtu ka një rol të rëndësishëm në Politikën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë së Përbashkët, duke mbajtur rolin drejtues në këtë politikë. Përfaqësuesi i Lartë kontribuon për zhvillimin e PSMP nëpërmjet propozimeve të kërkuara nga Këshilli i Ministrave.⁴⁰² Kjo politikë është analizuar në mënyrë të hollësishme në Kreun VI.

4.4.2. Presidenti i Këshillit Evropian

Nisur nga arsyetimi i mësipërm dhe dispozitat e shumta, që rregullojnë Përfaqësuesin e Lartë, kuptohet se ky i fundit është organi kryesor, i cili përfaqëson Bashkimin Evropian në skenën ndërkombëtare. Megjithatë, Presidenti i Këshillit Evropian është një organ tjetër që në nivelin dhe me cilësinë e tij, garanton përfaqësimin e jashtëm të BE në fushën e PJSP-së, por pa cënuar kompetencat e Përfaqësuesit të Lartë.⁴⁰³ Konventa për të Ardhmen e Evropës⁴⁰⁴ propozoi idenë e kryetarit të zgjedhur nga Këshilli Evropian me shumicë të cilësuar për një periudhë kohe dy vjet e gjysëm, që mund të përsëritet vetëm një herë. Ky model u aplikua edhe nga Traktati i Lisbonës, duke zëvendësuar presidencën gjashtë mujore me rotacion.

Presidenti i Këshillit Evropian është një figurë politike e konceptuar nga ligjvënësit evropiane, me synimin për të siguruar vazhdimësinë dhe konsistencën e Bashkimit Evropian në veprimin ndërkombëtar (Comelli dhe Pirozzi, 2013: 2). Presidenti i Këshillit Evropian është i ngarkuar në menaxhimin e punës së tij, duke *lehtësuar* konsensusin dhe

⁴⁰¹ Neni 30/2, TBE.

⁴⁰² Neni 18/2, TBE.

⁴⁰³ Neni 15/6, TBE.

⁴⁰⁴ Laeken Declaration on the future of the European Union, 15 December 2001.

kohezionin,⁴⁰⁵ duke *ndihmuar* në sigurimin e vazhdimësisë së politikave, duke *shërbyer* si zëdhënës i grupit (Mix, 2013: 5) dhe duke *siguruar* nxitje për punën e Këshillit Evropian (Kaczorowska, 2011:114). Pra, përgjegjësitë dhe kompetencat e Presidentit të Këshillit Evropian janë: të lehtësojë, të ndihmojë, të shërbejë dhe të sigurojë. Kështu, ai ka një ndikim të madh në punën e Këshillit Evropian në të gjitha fushat e aktivitetit të BE-së, duke përfshirë edhe veprimin e jashtëm të BE-së.⁴⁰⁶

Presidenti i Këshillit Evropian nuk mban një post në nivel kombëtar dhe pozicioni i tij nuk është gjithashtu, as një post ceremonial (Helwig, 2014: 1). Presidenti i Këshillit Evropian ka të drejtë të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme në përputhje me zhvillimet e reja ndërkombëtare. Sipas Alina Kaczorowska (2011:114) është e paqartë nëse shpërndarja e përgjegjësiave të përfaqësimit të jashtëm të Presidentit të Këshillit Evropian do të *përmirësojë* koherencën e veprimit të jashtëm, apo do të bëhet një burim i *konfuzionit* të brendshëm dhe të jashtëm, madje dhe një burim konflikti ndërmjet Përfaqësuesit të Lartë dhe Presidentit.

Shpeshherë, është ngritur çështja se Bashkimi Evropian ka dy shefa (lidera) për politikën e jashtme dhe të sigurisë dhe se, kjo mund të paraqesë një rrezik për Shtetet Anëtare (Helwig, 2014: 1). Ky rrezik përjashtohet pasi ndarja e punës është e koordinuar në bazë të niveleve dhe nuk i nënshtrohet çështjeve të caktuara duke iu referuar shprehjes së Corbett, se në këtë ndarje të përgjegjësiave nuk ka “luftëra për territor” (2011: 5). Përfaqësuesi i Lartë përfaqëson Bashkimin Evropian *në nivel ministror*, ndërsa Presidenti i Këshillit Evropian përfaqëson Bashkimin Evropian *në nivelin e kryetarëve të shteteve apo*

⁴⁰⁵ Neni 15/6, (c) TBE: “...bën përpjekje për të mundur kohezionin dhe konsensusin brenda Këshillit Evropian”.

⁴⁰⁶ Neni 22, TBE.

të qeverive. Ndërmjet pushtetit të Presidentit të Këshillit Evropian dhe Përfaqësuesit të Lartë ekziston një marrëdhënie asimetrike (Dijkstra, 2011:4).

Dijkstra thekson gjithashtu, se Përfaqësuesi i Lartë është një “asistent”, që zhvillon veprimtarinë e përditshme mbi kriteret e përcaktuara nga Presidenca. Presidenti i Këshillit Evropian është një pozicion me shumë më pak përgjegjësi se ajo e Përfaqësuesit të Lartë dhe Presidenca ka shumë më pak ndikim ligjor në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Në Traktatin e Lisbonës, vetëm dy detyrime konkrete përbëjnë detyrat e Presidentit në PJSP-së, të kryesojë Këshillin Evropian dhe për të përfaqësojë kushtet në fushën e PJSP-së për një afat prej dy vjet e gjysëm (Austin, 2011: 25).

Në lidhje me rëndësinë dhe rolin e Presidentit të Këshillit Evropian në fushën e PJSP, autorët janë ndarë në dy pjesë, disa argumentojnë me skepticizëm rolin e tij, të tjerët afirmojnë me optimizëm rëndësinë e madhe. Për shembull, autorë si Wessels dhe Bopp, argumentojnë se roli potencial i Kryesisë, si post është i një rëndësie të madhe, por se detyrat dhe funksionet e saj nuk janë shumë të qarta (2008: 18). Ndërsa Dagand argumenton se efektiviteti i rolit pjesërisht varet nga personaliteti i Presidentit dhe shkallën në të cilën Shtetet Anëtare e lejojnë atë të marrë iniciativën në politikën e jashtme (2008: 5).

Presidenti i Këshillit Evropian nuk siguron një detyrim ligjor më të integruar (Austin, 2011: 26) për PJSP-në, por thjesht Presidenti i Këshillit të Evropës gëzon të drejtën për të drejtuar rendin e ditës dhe për të caktuar axhendën. Ai përcakton axhendën dhe çështjet për diskutim, vendos nëse çështjet për politikën e jashtme dhe të sigurisë do të

diskutohen gjatë mbledhjeve. Presidenti i Këshillit Evropian ka autoritetin për të vendosur për diskutimin ose mosdiskutimin mbi këtë çështje.⁴⁰⁷

4.4.3. Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian

Risia e tretë, që vjen nga Traktati i Lisbonës në fushën e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët është krijimi i Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian, i cili u zyrtarizua në dhjetor të vitit 2010.⁴⁰⁸ Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian përmendet vetëm në dispozitën 17/3 TBE. Ky nen specifikon rolin dhe rëndësinë e këtij organi. Sipas këtij neni, në përmbushjen e mandatit të tij Përfaqësuesi i Lartë mbështetet nga Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian.

Ky organ i ri mundëson përgatitjen, koordinimin dhe zbatimin e politikave në marrëdhëniet e jashtme nën kujdesin e Përfaqësuesit të Lartë (Vooren dhe Wessel, 2014: 20). Organizimi dhe funksionimi i Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian ka qënë subjekt për një kohë të gjatë i përpjekjeve dhe negociatave ndërinstitucionale. Në këto negociata Parlamenti Evropian arriti të përforcojë kontrollin e tij ende të kufizuar në Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (Comelli dhe Pirozzi, 2013: 1).

Integrimi i këtij shërbimi në kuadrin institucional është orientuar sipas mandatit të Përfaqësuesit të Lartë,⁴⁰⁹ dhe Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian i cili vendoset nën autoritetin e Përfaqësuesit të Lartë.⁴¹⁰ Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian punon së bashku me shërbimet diplomatike të Shteteve Anëtare, i cili përbëhet nga zyrtarë të

⁴⁰⁷ Neni 15/6, TBE.

⁴⁰⁸ Vendimi i Këshillit 2010/427/BE i 26 korrikut 2010 për themelimin e organizimit dhe funksionimit të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian (*Council Decision 2010/427/EU*).

⁴⁰⁹ European Integration Working Group, 2009.

⁴¹⁰ Council Decision 2010/427/EU.

drejtorive përkatëse të Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit dhe të Komisionit, si dhe nga nëpunës të caktuar nga shërbimet diplomatike kombëtare të Shteteve Anëtare.⁴¹¹

Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian ishte një trup i ri diplomatik struktura e të cilit, sipas nenit të mësipërm pasqyron një koncept të bashkimit institucional ndërmjet Komisionit Evropian dhe Këshillit të Ministrave. Një e treta e personelit të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian është përbërë nga Komisioni, një e treta nga sekretariati i Këshillit të Bashkimit Evropian, dhe një e treta është deleguar nga shërbimet diplomatike kombëtare të Shteteve Anëtare (Mix, 201: 3).

Krijimi i Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian fillimisht ishte i diskutueshëm dhe ashtu si organet e tjera të reja (p.sh, Përfaqësuesi i Lartë) në Traktatin e Lisbonës, u pa si kërcënuese për shërbimet e jashtme kombëtare të Shteteve Anëtare (Kaczorowska, 2011: 114). Sipas Përfaqësueses së Lartë, Catherine Ashton,⁴¹² Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian është diçka e re dhe unike, që bashkon të gjitha politikat dhe instrumentat e përbashkëta të Bashkimit Evropian për të promovuar vlerat dhe interesat e BE-së në të gjithë botën (2013: 3). Në këtë mënyrë, Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian ofron një mundësi për të rritur koherencën në marrëdhëniet e jashtme të BE-së.⁴¹³

Në rritjen e kësaj koherence dhe rolit të Bashkimit Evropian, si një aktor global në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare Përfaqësuesi i Lartë dhe Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian luajnë një “rol shumë të rëndësishëm” (Vooren dhe Wessel, 2014: 19). Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian siguron garantimin efektiv dhe në kohë të politikës së jashtme të BE-së nëpërmjet një rrjeti global të delegacioneve, strukturave të

⁴¹¹ Neni 17/3, TBE.

⁴¹² Përfaqësuesja e parë e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët.

⁴¹³ European Integration Working Group, 2009.

menaxhimit të krizave dhe misionëve të Politikës së Mbrojtjes dhe Sigurisë së Përbashkët.⁴¹⁴ Organizimi dhe funksionimi i Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian miratohet me vendim të Këshillit. Këshilli vepron me propozim të Përfaqësuesit të Lartë, pasi konsultohet me Parlamentin Evropian dhe pasi merr pëlqimin e Komisionit.⁴¹⁵

4.5. Procesi i vendimmarrjes në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët

Këshilli Evropian dhe Këshilli i Ministrave janë dy organet kryesore të vendimmarrjes në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Neni 30 dhe neni 31 i Traktatit të Bashkimit Evropian përbëjnë dy dispozita që formojnë thelbin e procedurës së vendimmarrjes duke përfshirë respektivisht, iniciativën ligjvënëse⁴¹⁶ dhe rregullat e votimit.⁴¹⁷ Këto dy elementë sipas autorëve Wessel dhe Bottner janë të rëndësishëm sepse përcaktojnë *natyrën e veçantë* të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët në krahasim me politikat e tjera të BE-së (2013: 1042).

Procedura e vendimmarrjes ndërmjet Komunitetit dhe PJSP-së edhe shpeshherë është e ndryshme, sepse në të drejtën komunitare vendimmarrja është me bashkë-vendimmarrje (co-decision) ndërsa në PJSP është me unanimitet në Këshill. Unanimiteti është rregull për marrjen e vendimeve në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Sipas nenit 24 TBE, PJSP-ja rregullohet nga dy organe kryesore nga Këshilli

⁴¹⁴ Declaration by High Representative Catherine Ashton on behalf of the European Union on the ICJ advisory opinion. Press Statement 12516/10, 22 July 2010, Brussels.

⁴¹⁵ Neni 17/3, TBE.

⁴¹⁶ Neni 30/1, TBE (ish-neni 22 TBE): “Çdo Shtet Anëtar, Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, ose Përfaqësuesi i Lartë me mbështetjen e Komisionit, mund të përcjellin çështje që lidhen me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit në Këshill dhe mund t’i paraqesin këtij të fundit, respektivisht, nisma ose propozime”; Neni 30/2, TBE: “Në rastet kur duhet një vendim i shpejtë, Përfaqësuesi i Lartë mbledh kryesisht ose me mocion të një Shteti Anëtar një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit brenda 48 orëve ose, në rast urgjent, brenda një periudhe më të shkurtër”.

⁴¹⁷ Neni 31/1, TBE: “Vendimet e parashikuara në këtë Krye merren nga Këshilli Evropian dhe Këshilli duke vepruar unanimisht, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Krye. Përfshihet miratimi i akteve legjislative”.

Evropian dhe Këshilli nëpërmjet procedurës së unanimitetit.⁴¹⁸ Ndërkohë procesi i vendimmarrjes dhe mënyrat e votimit përcaktohen nga një tjetër dispozitë e TBE-së, duke shtuar këtu mënyra të tjera të marrjes së vendimit krahas atij me unanimitet (këtu bëhet fjalë për nenin 31 TBE).

Përdorimi i unanimitetit dhe nënshtrimi i procesit të vendimmarrjes, rregullave të veçanta në Traktatin e Lisbonës sipas Jacque (2010: 366), erdhi si pasojë dhe nevojë, e ruajtjes së specifikës së veçantë që kishte PJSP-ja. Procedurat për miratimin e akteve ligjore të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët mund të përmbledhet në tre fjali kryesore të cilat do të analizohen përgjatë studimit. *Së pari*, procedurat për miratimin e akteve ligjore të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët rregullohen nga neni 31, TBE; *së dyti*, procesi i vendimmarrjes është një prerogativë e Këshillit të Ministrave; *së treti*, parimi që ndiqet në procesin e vendimmarrjes është ai i unanimitetit, përveç rasteve kur vetë Traktati parashikon ndryshe.

Neni origjinal i cili rregullonte procedurën e vendimmarrjes me unanimitet është neni J.8/2, TBE, në Traktatin e Maastrichtit⁴¹⁹ (Murphy, 1998: 885–886). Sipas kësaj dispozite Këshilli i Ministrave merrte vendime në mënyrë unanime, me përjashtim të çështjeve procedurale të përcaktuara ndryshe.⁴²⁰ Takimi i Këshillit Evropian në vitin

⁴¹⁸ Neni 24/1, TBE: “Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurimit u nënshtrohet rregullave dhe procedurave të caktuara. Ajo përcaktohet dhe zbatohet nga Këshilli Evropian dhe Këshilli, duke vepruar unanimisht, nëse nuk parashikohet ndryshe nga Traktatet”.

⁴¹⁹ Neni J.8/2, Traktati i Maastrichtit, shih nenin J.8/2, sipas të cilit: *The Council shall take the decisions necessary for defining and implementing the common foreign and security policy on the basis of the general guidelines adopted by the European Council. It shall ensure the unity, consistency and effectiveness of action by the Union. The Council shall act unanimously except for procedural questions and in the case referred to in Article J.3(2).*

⁴²⁰ Pavarësisht miratimit të vendimit unanim në politikën e jashtme dhe të sigurisë në Traktatin e Maastrichtit u diskutua gjithashtu edhe në lidhje me votimin me shumicë. Në Titulli V të Traktatit të Bashkimit Evropian në Traktatin e Maastrichtit, Këshilli kishte përgjegjësi të ndryshme në lidhje me PJSP, duke përfshirë autoritetin për të miratuar vendime ligjorisht detyruese.

1990,⁴²¹ vendosi që të përfshinte një dispozitë që do të lejonte vendimmarrjen pavarësisht mospjesëmarrjes apo abstenimit të disa Shteteve Anëtare⁴²² (Koutrakos, 2001: 20).

Traktati i Amsterdimit, shtoi një klauzolë të re lidhur me vendimmarrjen. Në këtë traktat u paraqit mundësia e abstenimeve, që lejonte marrjen e vendimeve edhe nëqoftëse jo të gjithë anëtarët nuk do të votonin në favor (Peterson dhe Sjursen, 1998: 56). Kjo klauzolë ndryshe nënkuptonte mosparandalimin e një vendimi të marrë me unanimitet (Schermers dhe Blokker 2003: 553). Traktati i Amsterdimit shtoi edhe një element tjetër atë të abstenim konstruktiv, pikërisht në nenin 23 të Traktatit të Amsterdimit. Nëpërmjet kësaj procedure të abstenimit konstruktiv një Shtet Anëtar çlirohej nga detyrimi i vendimit dhe nga ana tjetër abstenimet nuk pengonin marrjen e vendimeve nga Këshilli i Ministrave.⁴²³

Traktati Kushtetues i parashikoi të dyja vendimet, marrjen e vendimit me unanimitet dhe rregullat e abstenimit. Rishikimi i Traktatit Kushtetues që përfundimisht çoi në Traktatin e Lisbonës ka përfshirë një risi të madhe. Përveç Këshillit të Ministrave, neni 31 i Traktatit të Bashkimit Evropian është i vlefshëm edhe për Këshillin Evropian, si pasojë e këtij të fundit për t'u bërë një institucion i Bashkimit Evropian.⁴²⁴

Kështu unanimiteti është ende rregull, i cili qëndron në kontrast të fortë me politikat e tjera të BE-së, ku votimi me shumicë të cilësuar është themeluar si rregull i votimit të parazgjedhur (Wessel dhe Bottner, 2013: 1054). Neni 31, TBE përmban rregulla të ndryshme të vendimmarrjes me unanimitet dhe vendimmarrjes me shumicë të cilësuar dhe

⁴²¹ Conclusions of the Rome European Council, 14 and 15 December 1990, Brussels.

⁴²² Megjithatë, supozohet në përgjithësi se mundësia e votimit me shumicë të cilësuar nuk u përdor kurrë në praktikë dhe se unanimitet ishte në bazë të bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare.

⁴²³ Neni 23/1, TBE të Amsterdimit: “vendimet merren nga Këshilli i Ministrave duke vepruar në mënyrë unanime, dhe abstenimet nga anëtarët e pranishëm personalisht ose të përfaqësuar nuk pengojnë miratimin e vendimeve të tilla”.

⁴²⁴ Neni 13/1, TBE.

përfshin procedurat për çështjet e PJSP-së. Këto përfshijnë gjithashtu çështjet e PSMP-së, se si kjo politikë është pjesë integrale e PJSP-së.⁴²⁵

Marrja e vendimeve në PJSP ndikon drejtpërdrejt në sovranitetin e brendshëm të Shteteve Anëtare, për këtë arsye vendimmarrja me unanimitet është e vështirë për Shtetet Anëtare, duke penguar kështu marrjen e vendimeve të rëndësishme. Sipas autorëve Wessel dhe Bottner, shkak kryesor për një proces të ngadalshëm të PJSP-së në ditët e para të krijimit (bëhet fjalë për Traktatin e Mastrichtit) ishte pikërisht për shkak të sundimit të unanimitet. Sepse vetëm një Shtet Anëtar mund të mbante peng tërë procesin e vendimmarrjes (2013: 1054).

Shtetet Anëtare mund të mbajnë peng procesin e vendimmarrjes sepse nuk janë të gatshëm dhe kurrë nuk mund të jenë të gatshëm, të heqin dorë nga pushteti i tyre ekskluziv (Kaczorowska, 2011:111). Sidomos kur bëhet fjalë për çështje kaq të nxehta që kanë të bëjnë me *fuqinë*, *pushtetin* dhe *aftësinë*⁴²⁶ në çështjet e sigurisë, çështje të cilat prekin sovranitetin. Shtetet Anëtare kurrësi nuk dëshirojnë të humbasin fuqinë dhe ndikimin në arenën ndërkombëtare, për këtë arsye politika e jashtme dhe çështjet e sigurisë janë delikate dhe shumë të rëndësishme për shtetet sovrane.

Pra, për shkak të rëndësisë së madhe që paraqesin çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes nuk lejohet marrja e asnjë forme tjetër vendimi përveçse asaj me unanimitet. Për këtë një dispozitë e veçantë e TBE-së disiplinon shprehimisht se miratimi i një vendimi me

⁴²⁵ Neni 41/1, TBE.

⁴²⁶ Fuqia, shpesh përkufizohet si aftësia për të bërë që një aktor tjetër të bëjë atë, çka në kushte të tjera nuk do ta kishte bërë. Aftësia e fuqive u lejojnë aktorëve që të ushtrojnë ndikime brenda një kohe të shkurtë. Forcat ushtarake janë një aftësi e tillë, ndoshta lloji më i rëndësishëm i saj. Për një informacion të detajuar të koncepteve “aftësi” dhe “fuqi” të një shteti, shih: Goldestein (2001).

shumicë të cilësuar nuk aplikohet në rastet që kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes.⁴²⁷

Mekanizmi i abstenimit konstruktiv iu bashkangjit Traktatit të Lisbonës në fushën e vendimmarrjes së Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Ai parashikon mundësinë që një Shtet Anëtar të mund ta përdorë në rastet kur nuk është dakord me marrjen e një vendimi. Në këtë mënyrë nuk pengohen vendimet e marra unanimisht nga Këshilli. Megjithatë shteti i cili përdor abstenimin konstruktiv ka përgjegjësinë që të plotësojë procedurat e vendosura.

Këto procedura konsistojnë në hartimin e një deklarate formale (neni 31/1 TBE), sipas të cilës ai nuk do të zbatojë vendimin e marrë me unanimitet nga Këshilli. Por ky largim nuk e përjashton shtetin në fjalë në mosrespektimin e parimeve të politikës së jashtme dhe të sigurisë, për të mos ju larguar detyrimit të tij për të vepruar mbi bazën e bashkëpunimit dhe solidaritetit. Për këtë arsye ky shtet nuk mund të ndërmarrë veprime që bien ndesh dhe dëmtojnë interesat e përgjithshme të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian që kanë miratuar këtë vendim.

Mbi të gjitha detyrimi i shtetit që ka përdorur abstenimin konstruktiv për solidaritet vazhdon, Shtetet Anëtare duhet të respektojnë qëndrimin e tij. Në rastet kur abstenimet konstruktive i kalojnë një të tretën e Shteteve Anëtare që kanë të paktën një të tretën e popullsisë, vendimi nuk miratohet.⁴²⁸ Kjo shërben si garanci që çdo veprim i Bashkimit Evropian të ketë mbështetjen e një bërthame të rëndësishme Shtetesh Anëtare. Kjo procedurë u zbatua nga Qipro për vendimet në Kosovë. Kur Këshilli *voton me shumicë të*

⁴²⁷ Neni 31/4, TBE.

⁴²⁸ Neni 31/1, TBE.

cilësuar, një Shtet Anëtar mund të paraqesë një arsye jetësore të politikës kombëtare për ta kundërshtuar vendimin (Jacque, 2010: 368).

Vendimet miratohen me unanimitet, por mund të derogohet ndaj vendimit me unanimitet dhe mund të përdoret votimi me shumicë të cilësuar në katër raste të parashikuara në nenin 31/2, TBE.⁴²⁹ Në rastet kur kërkohet mbajtja e një qëndrimi të Bashkimit Evropian, për objektiva të përcaktuara nga Këshilli Evropian apo të propozuara nga Përfaqësuesi i Lartë, vendimi mund të merret me shumicë të cilësuar. Gjithashtu një vendim i tillë mund të merret në rastin e emërimit të një Përfaqësuesi të posaçëm për një rajon të caktuar për zgjidhjen e konfliktit apo menaxhimin e krizave.

Në mënyrë përmbledhëse, theksojmë rolin e secilit nga institucionet në procesin e marrjes së vendimeve për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Këshilli Evropian dhe Këshilli i Ministrave luajnë rol përcaktues në formulimin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Komisioni dhe Parlamenti Evropian luajnë rol minimal, ndërsa Gjykata e Drejtësisë nuk ka juridiksion.

Detyrat e Bankës Qendrore Evropiane nuk janë të lidhura me PJSP, ndërsa funksionet e Gjykatës së Audituesve shtrihet në të gjitha shpenzimet e Bashkimit Evropian, duke përfshirë dhe financat e shpenzuara për politikën e jashtme dhe të sigurisë⁴³⁰ (Wessel,

⁴²⁹ Neni 31/2, TBE: “Si përjashtim nga dispozitat e paragrafit 1, Këshilli vepron me shumicë të cilësuar: kur miraton një vendim në të cilin përcaktohet veprimi ose qëndrimi i Bashkimit Evropian mbi bazën e një vendimi të Këshillit Evropian në lidhje me interesat dhe objektivat strategjikë të Bashkimit Evropian, sikurse thuhet në nenin 22(1); kur miraton një vendim në të cilin përcaktohet veprimi ose qëndrimi i Bashkimit Evropian, nisur nga propozimi që ka paraqitur Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, pas një kërkesë të caktuar nga Këshilli Evropian, me nismën e tij ose të Përfaqësuesit të Lartë; kur miraton çdo vendim që zbaton një vendim në të cilin përcaktohet veprimi ose qëndrimi i Bashkimit Evropian; Kur emëron një përfaqësues të posaçëm në përputhje me nenin 33”.

⁴³⁰ Neni 287/1, TFBE: “Gjykata e Audituesve shqyrton llogaritë e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve publike të Bashkimit Evropian. Ajo shqyrton gjithashtu edhe llogaritë e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të të gjitha organeve, zyrave ose agjencive të krijuara nga Bashkimi Evropian për aq sa instrumenti përkatës themelues nuk e ndalon një shqyrtim të tillë”.

2015). Shpenzimet e veprimeve në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët financohen nga shpenzimet e buxhetit të Bashkimit Evropian, në këtë mënyrë Gjykata e Audituesve mund të ushtrojë kontroll.⁴³¹

⁴³¹ Neni 287 TFBE.

KREU V. POLITIKAT E BASHKIMIT EVROPIAN PËR ZGJIDHJEN E KONFLIKTEVE NDËRKOMBËTARE

5.1. Politikat e Bashkimit Evropian për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare

Ky kapitull shqyrton politikat e mundshme të Bashkimit Evropian, të cilat synojnë zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Zgjidhja e konflikteve ndërkombëtare nga Bashkimi Evropian rregullohet nga tre politika kryesore, “Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët”, “Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët” dhe “Politika Evropiane e Fqinjësisë” (PEF). PJSP-ja është politika kryesore që mbulon marrëdhëniet e jashtme të Bashkimit Evropian, për këtë arsye studimi i kësaj politike, si instrumenti kryesor i BE-së i përket një tjetër kategorie studimi e zhvilluar në të gjithë kapitujt e punimit.

Krahas PJSP-së dy politikat e tjera që dispijlojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë konfliktet ndërkombëtare janë “Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët” dhe “Politika Evropiane e Fqinjësisë”. PSMP-ja është krijuar në kuadrin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, si instrumenti kryesor i saj që mbulon aspektin mbrojtës të BE-së. Politika Evropiane e Fqinjësisë ka si qëllim vendosjen e marrëdhënieve të veçanta me ato vende fqinje për të cilat anëtarësimi në BE është një perspektivë e largët dhe kontribuon për zgjidhjen e konflikteve në këto vende.

Potenciali i këtyre politikave është gur themeli për arritjen e koherencës dhe rritjen e rolit të Bashkimit Evropian si aktor në arenën ndërkombëtare. Efikasiteti i këtyre politikave dhe përfshirja e tyre drejtpërdrejt në zgjidhjen e konflikteve dhe menaxhimin e krizave afirmojnë rolin e Bashkimit Evropian. Për këtë arsye një rëndësi të veçantë në

konkretizimin e hipotezës së punimit për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian në zgjidhjen e konflikteve do të ketë analiza e këtyre politikave.

5.2. Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët

5.2.1. Kuptimi dhe formalizimi i Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët

Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët është kategorizuar, si një nga komponentët më të rëndësishëm, *dominues* (Chalmers, Davies dhe Monti, 2010: 670), *vitale* (Kaczorowska, 2011: 118) dhe pjesë integrale e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët.⁴³² Qëllimi i Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët konsiston në forcimin e aftësive të veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian, nëpërmjet zhvillimit të aftësive civile dhe ushtarake,⁴³³ për parandalimin e konflikteve dhe menaxhimin e krizave ndërkombëtare (Gross, 2009: 6).

Nëpërmjet kësaj politike Bashkimi Evropian ndërhyt drejtpërdrejt në konflikt, duke përcaktuar këtu rolin e tij si një aktor global dhe jo rolin e Shteteve Anëtare. PSMP-ja përfaqëson operacionet e armatosura të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Mirëpo, pavarësisht elementëve të saj ushtarakë dhe të mbrojtjes, PSMP-ja nuk përfaqëson ekskluzivisht natyrën ushtarake të Bashkimit Evropian. Kjo politikë nuk nënkupton shndërrimin e BE-së në një forcë ushtarake⁴³⁴ sepse detyrimi është vetëm për të dhënë

⁴³² Neni 42/1, TBE (ish-neni 17 TBE): “Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët është pjesë integrale e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët”.

⁴³³ Neni 42/1, TBE: “PSMP i ofron Bashkimit Evropian kapacitetin veprues duke u mbështetur në mjetet civile dhe ushtarake. Bashkimi Evropian mund t’i përdorë ato për misionet jashtë Bashkimit për ruajtjen e paqes për parandalimin e konflikteve dhe fuqizimin e sigurisë ndërkombëtare...”.

⁴³⁴ Për informacion të zgjeruar shih: Sheehan, (2008: 251).

ndihmë dhe asistencë⁴³⁵ dhe jo për t'u bashkuar kolektivisht në luftë të armatosur kundër agresorit.⁴³⁶

Traktati i Bashkimit Evropian nuk imponon një detyrim të rreptë për të gjitha Shtetet Anëtare dhe sigurisht përfshin një detyrimin i cili është më e dobët se angazhimet për sigurinë kolektive të bëra në kontekstin e NATO-s (Vooren dhe Wessel, 2014: 403). Ky detyrim i Shteteve Anëtare përforcohet në dy paragrafe të nenit 42 të Traktatit të Bashkimit Evropian, në paragrafin 2⁴³⁷ dhe në paragrafin 7.⁴³⁸

Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët miraton kursin e mbrojtjes evropiane nën flamurin evropian, dhe për këtë Shtetet Anëtare janë të detyruara që të angazhohen ushtarakisht me njëra-tjetrën.⁴³⁹ PSMP më shumë sesa zhvillimin e operacioneve konvencionale ushtarake në praktikë i referohet aktiviteteve civile si policia, trajnimet gjyqësore (sundimi i ligjit) dhe reformat e sektorit të sigurisë.

Konkretisht Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët trajton 5 lloje misionesh civile, aktivitetet për ruajtjen e paqes, parandalimin e konflikteve, menaxhimin e krizave, stabilitetin postkonflikt dhe misionet humanitare (Mix, 2013: 10). Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët nuk është një politikë e jashtme që ka qëllim të menjëhershëm mbrojtjen e territorit kombëtar, por ajo ka të bëjë me operacionet, të cilat ndodhin larg

⁴³⁵ Neni 42/7, TBE: “Nëse një Shtet Anëtar është viktimë e një agresioni të armatosur në territorin e tij, Shtetet e tjera Anëtare kanë për detyrim ta ndihmojnë dhe mbështetin me të gjitha mjetet që kanë në dorë...”.

⁴³⁶ Dhoma e Lordëve, Komiteti i Bashkimit Evropian, 2008. Traktati i Lisbonës: një vlerësim i ndikimit, Raporti i 10-të sesionit. Vol. I: Raporti. Londër: Autoriteti i Dhomës së Lordëve, fq. 7,113-117.

⁴³⁷ Neni 42/2, TBE: “... PSMP i respekton detyrimet e Shteteve të caktuara Anëtare, të cilat mbrojtjen e tyre të përbashkët e shohin të realizuar në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO)...”.

⁴³⁸ Neni 42/7, TBE: “Angazhimet dhe bashkëpunimi në këtë fushë duhet të pajtohen me angazhimet që rrjedhin nga NATO, e cila, për ato Shtete që janë anëtare të saj, mbetet baza e mbrojtjes së përbashkët të tyre dhe forumi për zbatimin e saj”.

⁴³⁹ Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Lisbona* BvE 2/08 [2009], shih citimin original të paragrafit 103, sipas të cilit: *The common security and defence policy is alleged deliberately to adopt the course of a European defence under the European flag. The Member States are alleged to be forced to engage in a military build-up.*

territorive të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian (Chalmers, Davies dhe Monti, 2010: 670).

Secili Shtet Anëtar i BE-së si subjekt i së drejtës ndërkombëtare, disponon kapacitetet e duhura ushtarake dhe forcën e armatosur për të siguruar integritetin e kufinjve territorialë. Për këtë PSMP-ja nuk nënkupton krijimin e një force të përbashkët evropiane për të siguruar kufijtë e BE-së, ajo shihet më shumë si një politikë ndërkombëtare e sigurisë, për të ruajtur rendin dhe garantuar sigurinë në të gjithë arenën ndërkombëtare. Sipas Traktatit të Lisbonës funksionet shtetërore themelore të Shteteve Anëtare, integriteti territorial, ruajtja e ligjit, rendit dhe veçanërisht mbrojtja e sigurisë kombëtare është përgjegjësi dhe kompetencë e vetme e secilit Shtet Anëtar në Bashkimin Evropian.⁴⁴⁰

Ky argument mbron pikpamjen se Bashkimi Evropian nëpërmjet një politike të tillë imponon prezencën e tij në arenën ndërkombëtare dhe afirmon rolin e tij si aktor ndërkombëtar. Krahas një argumenti të tillë qëndron dhe një pozicion kritik për rolin e BE-së dhe se gjithashtu Bashkimi Evropian nuk mund të krahasohet me OKB-në apo NATO-n të cilët shihen si garantuesit e paqes dhe të sigurisë në arenën ndërkombëtare. Për të kuptuar më mirë Politikën e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët dhe rëndësinë që ka për rritjen e rolit të BE në arenën ndërkombëtare analizojmë këtë politikë që në hapat e parë të krijimit të saj.

PSMP-ja e ka zanafillën në Bashkimin Evropian Perëndimor, kjo organizatë siç e kemi shprehur dhe në kapitujt më sipër transferohet në Traktatin e Maastrichtit.⁴⁴¹ Politika

⁴⁴⁰ Neni 4/2, TBE.

⁴⁴¹ Neni J.4/1, Traktati i Maastrichtit, shih citimin origjinal të paragrafit, sipas të cilit: *The common foreign and security policy shall include all questions related to the security of the Union, including the eventual framing of a common defence policy, which might in time lead to a common defence.*

Evropiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes ishte paraardhëse e Politikës së Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët (ndryshuar në Traktatin e Lisbonës). Duke filluar nga viti 1999, BE-ja ka punuar për të krijuar dhe zhvilluar PESM-në (Webber, 2011:218). Në takimin e Këshillit Evropian të Këlnit⁴⁴² u nënvizua nevoja e zotërimit të kapaciteteve ushtarake për veprim autonom, dhe për tu përgjigjur në kohën e krizave ndërkombëtare.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit,⁴⁴³ politika e mbrojtjes në Bashkimin Evropian u shndërrua nga një *mundësi* në një *objektiv* (Dyson dhe Konstadinides, 2013: 62).⁴⁴⁴ Detyrat e Petersburgut mbartën një dykuptimësi konstruktive nga ana e Shteteve Anëtare, ato i dhanë interpretime të ndryshme shkallës së ndërmarrjes së operacioneve. Franca iu referua një interpretimi ambicioz, duke synuar rritjen e shkallës së forcës dhe operacioneve⁴⁴⁵ në kuadrin e PESM, ndërsa Britania e Madhe iu referua vetëm një elementi, siç ishte ai i menaxhimit të krizave, si dhe iu referua Operacioneve të Forcave Aleate (Garden, Clarke dhe Quille, 2001). Ndërsa vendet e tjera si Italia dhe Suedia i interpretonin detyrat e Petersburgut në përputhje me faktin se nevojitej një mandat ligjor, në mënyrë specifike i Kombeve të Bashkuara për të ndërmarrë një operacion.⁴⁴⁶

Interpretimi ndryshe dhe mospërputhja ndërmjet interesave të dallueshme të Shteteve Anëtare krijonte vështirësi në koordinim dhe rritjen e rolit të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, u krijuan struktura të përhershme ushtarake dhe politike, përgjegjëse për një politikë autonome dhe operacionale mbrojtëse të Bashkimit Evropian. Këto struktura ishin

⁴⁴² Conclusions of the European Council Meeting in Cologne, 3–4 June 1999, ‘The Bremen Declaration’.

⁴⁴³ Neni J. 4 i Traktatit të Maastrichtit u amendua në nenin J.7 të Traktatit të Amsterdimit, shih paragrafin J.7, sipas të cilit: *The common foreign and security policy shall include all questions relating to the security of the Union, including the progressive framing of a common defence policy...*

⁴⁴⁴ Shih gjithashtu: Vooren dhe Wessel, (2014: 422).

⁴⁴⁵ European Parliament, Directorate-General for external policies of the Union Directorate B. (2006). The European Security and Defence Policy: from the Helsinki Headline Goal to the EU Battlegroups.

⁴⁴⁶ Po aty.

Komiteti Politik dhe i Sigurisë (KPS), Komiteti Ushtarak i Bashkimit Evropian (KUBE) dhe Shtabi Ushtarak i Bashkimit Evropian (SHUBE), (Vooren dhe Wessel, 2014: 422).⁴⁴⁷ Vështirësia e afirmimit të një roli të Bashkimit Evropian qëndronte në kuadrin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet Shteteve Anëtare (Freire, 2008: 12).⁴⁴⁸

Traktati i Nicës përfshiu politikën e mbrojtjes së përbashkët⁴⁴⁹ duke lënë të pandryshuar raportin ndërmjet PJSP-së dhe PESM-së, por nuk do të përfshinte paragrafin në të cilin parashikohej Bashkimi Evropian Perëndimor.⁴⁵⁰ Bashkimi Evropian do të vepronte në fushën e mbrojtjes brenda gamës së plotë të detyrave të Petërburgut. Këto detyra të cilat qëndrojnë të tilla edhe në Traktatin e Lisbonës përfshijnë detyrat humanitare dhe të shpëtimit, detyrat paqeruajtëse dhe detyrat e forcave luftarake në menaxhimin e krizave, përfshirë dhe paqen.⁴⁵¹

Në vitin 2003, Këshilli Evropian miratoi Strategjinë Evropiane të Sigurisë,⁴⁵² qëllimi i të cilës ishte që BE-ja të merrte përgjegjësi më të madhe në mbrojtjen e sigurisë globale (Duke, 2004: 459).⁴⁵³ Zhvillimi i nocionit të sigurisë në BE, në kuadrin e PESM-së kishte, si qëllim shndërrimin e Bashkimit Evropian në një *superfuqi të sigurisë* në kuptimin

⁴⁴⁷ Në Këshillin Evropian të Helsinkit vitit 1999, ishte marrë vendimi për të vënë në vend infrastrukturën institucionale të Politikës Evropiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes. Por, edhe pas përpjekjeve dhe përparimit të Samitit të Helsinkit mungonin kapacitetet dhe organet për menaxhimin e krizave civile. Komisioni Politik dhe i Sigurisë, Komisioni Ushtarak i Bashkimit Evropian dhe Shtabi Ushtarak i Bashkimit Evropian filluan punën e tyre, megjithëse fillimisht në baza joformale.

⁴⁴⁸ Presidency Conclusions, Helsinki European Council, 10 and 11 December 1999.

⁴⁴⁹ Ky Traktat, në nenin 17 të tij rregullonte Politikën Evropiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes.

⁴⁵⁰ Traktati i Nicës i dha Komisionit Politik dhe të Sigurisë kompetenca për operacionet e menaxhimit të krizës nën përgjegjësinë e Këshillit. Pavarësisht ndryshime të rëndësishme për rritjen e rolit të BE, ky rol shihej me skepticism. Kjo si pasojë e mospërfshirjes aktive dhe në mënyrë të vazhdueshme të BE-së në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare kryesisht në tragjeditë e Ballkanit. Kështu, u morën masa të tjera për forcimin dhe rritjen e kapaciteteve për ndërmarrjen e misionëve civile dhe ushtarake.

⁴⁵¹ Neni 17/2, TBE, Nicë.

⁴⁵² EU Council, A Secure Europe in a Better World: European Security Strategy, Brussels, 12 December 2003.

⁴⁵³ Në Deklaratën e Laeken-it, ku u iniciua procesi i reformës kushtetuese në dhjetor të vitit 2001 thuhej se: *Lufta e Ftohtë ka mbaruar dhe ne jemi duke jetuar në një botë të globalizuar dhe shumë të fragmentarizuar, Evropa duhet të mbajë mbi supe përgjegjësitë e veta në qeverisjen globale.*

tradicional (Salmon, 2005: 359). Strategjia synonte përmbushjen e sfidave të sigurisë kolektive nga Shtetet Anëtare⁴⁵⁴ në përputhje me ‘Koncepti Strategjik’⁴⁵⁵ të NATO-s.

Që nga periudha e zhvillimit të operacionit të parë në vitin 2003, PESM-ja ka rezultuar e suksesshme në misionet civile (Kurowska, 2008: 25). Sipas Blockmans dhe Wessel, arsyeja që shumica e operacioneve të Bashkimit Evropian janë të suksesshme ishte për shkak të tre elementëve, së pari, sepse ato ishin misione *afatshkurtëra*; së dyti, sepse ato kishin një *fushëveprimi të kufizuar* dhe së treti sepse ato ishin të *kufizuara në madhësi* (2009: 10). Ndërhyrja e parë e operacioneve të Politikës Evropiane të Sigurisë dhe të Mbrotjtjes ishte në shtetet e ish-Jugosllavi-së, në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë.

BE-ja ishte përpjekur për të ndërmjetësuar edhe më herët në luftërat jugosllave, por pa kapacitet të saj ndërhyrës. Vendet e BE-së ndërhynë si pjesë e forcave paqeruajtëse të OKB-së, dhe më pas nën udhëheqjen e Shteteve të Bashkuara, si pjesë e forcave të NATO-s, por jo nën përfaqësinë e Bashkimit Evropian. Pas krijimit të PESM-së, Bashkimi Evropian mund të fillonte operacione ushtarake dhe misione civile. Në janar të vitit 2003, BE-ja dërgoi misionin policor (EUPM) të Bashkimit Evropian në Bosnjë dhe Hercegovinë,⁴⁵⁶ si operacionin e parë civil të menaxhimit të krizave brenda kuadrit të PESM-së. Ndërsa në mars të vitit 2003, BE-ja dërgoi Operacionin Konkordia,⁴⁵⁷ misioni i

⁴⁵⁴ European Parliament, Directorate-General for external policies of the Union Directorate B. (2006). The European Security and Defence Policy: from the Helsinki Headline Goal to the EU Battlegroups.

⁴⁵⁵ NATO, ‘The Alliance’s Strategic Concept’, Press release NAC-S(99)65, 24 Apr. 1999.

⁴⁵⁶ Vendimi i Këshillit 2002/845/PJSP i datës 30 shtator 2002 në lidhje me përfundimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Bosnjë dhe Hercegovinës në aktivitetet e Misionit Policor të Bashkimit Evropian (EUPM) në Bosnjë dhe Hercegovinën (*Council Decision 2002/845/CFSP*).

⁴⁵⁷ Vendimi i Këshillit 2003/202/PJSP të 18 marsit 2003 në lidhje me nisjen e operacionit ushtarak të BE-së në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (*Council Decision 2003/202/CFSP*); Shih: Blanke dhe Mangiameli, (2013: 1210).

parë ushtarak i Bashkimit Evropian. Ky operacion ushtarak u zëvendësua me misionin policor të Bashkimit Evropian i quajtur Operacioni Proxima.⁴⁵⁸ Operacioni Konkordia u vendos në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë nën kontrollin e NATO-s.

Gjithashtu atë vit BE-ja ndërmorri një operacion të menaxhimit të krizave (Artemis) në Republikën Demokratike të Kongos,⁴⁵⁹ misioni i parë jashtë Evropës. Kështu, pas operacionit të parë civil dhe ushtarak për menaxhimin e krizave, Bashkimi Evropian ka ndërmarrë një sërë operacionesh të tjera pas vitit 2003, duke pohuar aftësinë e tij në shumë vende dhe kontinente, duke përfshirë këtu Afrikën, Azinë, Lindjen e Mesme dhe vetë Evropën, konkretisht Ballkanin Perëndimor. Rritja e rolit të Bashkimit Evropian në aspektin mbrojtës dhe zhvillimi i Politikës Evropiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes mori padyshim një tjetër dimension me miratimin e Traktatit të Lisbonës, dimension ky i cili do të trajtohet pjesërisht në vijim.

5.2.2. Kuadri ligjor dhe institucional i Politikës së Sigurisë dhe të Mbrojtjes së Përbashkët

a) Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët në dispozitat e Traktatit të Lisbonës. Çështja Lisbona.

Traktati i Lisbonës forcoi Politikën e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët duke rritur kapacitetin veprues të BE-së në menaxhimin e krizave dhe zgjidhjen e konflikteve.

Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët rregullohet nga dispozitat e vendosura në

⁴⁵⁸ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2003/681/PJSP i datës 29 shtator 2003 mbi misionin policor të Bashkimit Evropian në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë EUPOLIN “Proxima” (*Council Joint Action 2003/681/CFSP*).

⁴⁵⁹ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2003/423/PJSP i 5 qershor 2003 mbi operacionin ushtarak të Bashkimit Evropian në Republikën Demokratike të Kongos (*Council Joint Action 2003/423/CFSP*); Shih gjithashtu: Dietrich, (2006: 466); Lindstrom, (2004: 119); Blanke dhe Mangiameli, (2013: 1210).

Titullin V, Kreun 2 të “Dispozitave të veçanta për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët”, dhe në Seksionin 2 të “Dispozitave për Politikën e Sigurimit dhe të Mbrojtjes së Përbashkët”. Kuadri ligjor i PSMP-së përfshin nenet 42-46 të TBE dhe nenin 222 të TFBE.

PSMP-ja nuk është e përfshirë në TFBE duke theksuar këtu karakterin e veçantë të kësaj politike njëloj si PJSP-ja. Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkë është përshtatur, gjithashtu edhe në Protokollet Nr. 10 dhe Nr. 11, dhe Deklaratat Nr.13 dhe Nr. 14. Moelling, vë në dukje se, nëse PSMP-ja do të vazhdojë apo jo të jetë një histori suksesi, kjo do të varet jo aq shumë nga dispozitat e Traktatit të Lisbonës, se sa nga vullneti politik i Shteteve Anëtare për të zbatuar përgjegjësitë e përbashkëta ndaj sfidave të sigurisë (2008: 3).

Instrumentet ligjore bazë që rregullojnë çdo operacion të Bashkimit Evropian janë vendimet e Këshillit të Ministrave (*Council decision*), të miratuara në bazë të nenit 43 TBE,⁴⁶⁰ në bashkëpunim me nenin 28 TBE⁴⁶¹ dhe në përputhje me rregullat e votimit të përcaktuara në nenin 31 TBE.⁴⁶² Duhet të theksohet se këto akte, janë akte të nxjerra nga Bashkimi Evropian dhe jo thjesht vendime të miratuara bashkërisht nga Shtetet Anëtare⁴⁶³ (Naert, 2011: 5). Në kuptim të ndarjes së përgjegjësisë ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Bashkimit Evropian, vendimet e marra nga BE në fushën e Politikës së Sigurisë dhe

⁴⁶⁰ Neni 43/2, TBE: “Këshilli miraton vendime lidhur me detyrat e përmendura në pikën 1, ku përcaktohen objektivat dhe fusha e veprimit të tyre si dhe kushtet e përgjithshme për zbatimin e tyre”.

⁴⁶¹ Neni 28/1, TBE: “Kur situata ndërkombëtare kërkon veprim operativ nga ana e Bashkimit Evropian, Këshilli miraton vendimet e nevojshme. Në to përcaktohen objektivat, fusha e veprimit, mjetet që i vihen në dispozicion Bashkimit Evropian, nëse është nevojë kohëzgjatjen e tyre, si dhe kushtet për zbatimin e tyre”.

⁴⁶² Neni 31/1, TBE: “Vendimet e parashikuara në këtë Krye merren nga Këshilli Evropian dhe Këshilli duke vepruar unanimisht.”

⁴⁶³ Decision of the Representatives of the Governments of the Member States 2008/836 of 29 October 2008 on the treatment of documents of EU civilian crisis management missions and military operations (OJ 2008 L 299/34).

Mbrojtjes së Përbashkët nuk i detyron Shtetet Anëtare, ose të paktën ti autorizojë ato, të marrin një veprim të caktuar (Wessel, 2011: 41). Sipas marrëveshjeve, një mision civil ose ushtarak i PSMP-së gëzon statusin e një misioni diplomatik sipas Konventës të vitit 1961 të Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (Koutrakos, 2011).

Vendimet e Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët në kuadër të procedurave dhe sistemit të menaxhimit të krizës janë katër. Vendimet janë: a) vendimi për mjetet/instrumentet e menaxhimit të krizës, që duhet të përdoren. Organeve vendimmarrëse, që përfshihen në këtë vendim janë Komisionerët përkatës, Anëtarët e Shteteve dhe Përfaqësuesi i Lartë; b) vendimi për të vendosur një mision/operacion, vendimi merret nga Këshilli përmes Komitetit Politik dhe të Sigurisë; c) vendimi për të nisur një mision/operacion, vendimi merret nga Këshilli përmes Komitetit Politik dhe të Sigurisë; d) vendimi për të zgjatur, rifokusuar ose për të përfunduar një mision/operacion, vendimi merret nga Këshilli përmes Komitetit Politik dhe të Sigurisë (Rehrl dhe Glume, 2015: 27). Të gjitha misionet e PSMP-së të BE-së veprojnë duke respektuar të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut. Pikërisht në këto fusha del në pah dhe ndarja e përgjegjësisë ndërmjet BE dhe Shteteve Anëtare (Naert, 2011).

Ashtu si dhe e përmendën rol të rëndësishëm në marrjen e këtyre vendimeve luan Këshilli i Ministrave. Puna e Këshillit është përgatitur nga një sërë organe përgatitore dhe nga Përfaqësuesi i Lartë i cili ndihmohet nga Shërbimi i Veprimit të Jashtëm Evropian. Traktati i Lisbonës ka sjellë një sërë risish për PSMP-në. Traktati i Lisbonës ndryshon emrin nga “Politika Evropiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes” në “Politikën e Jashtme dhe të Mbrojtjes së Përbashkët”. PSMP-ja bën pjesë në kornizën institucionale të PJSP-së, duke

krijuar një nëngrup institucional të veçantë, i ngarkuar me planifikimin dhe kryerjen e operacioneve të menaxhimit të krizave (Grevi, Helly dhe Keohane, 2009).

Një risi tjetër e Traktatit të Lisbonës në drejtim të PSMP-së ishte *zgjerimi i detyrave të Petërburgut*, nëpërmjet të cilave Bashkimi Evropian mund të përdorë mjete civile dhe ushtarake. Detyrat e Petërburgut të zgjeruara janë parashikuar në nenin 43, paragrafi 1, TBE.⁴⁶⁴ Kjo dispozitë legjitimon ndërmarrjen e operacione civile dhe ushtarake për një sërë aspektesh të zgjidhjes së konflikteve ndërkombëtare, duke përfshirë një gamë të gjërë të një situate konfliktuale. Sipas këtij neni përdorimi i mjeteve civile dhe ushtarake realizohet në kuadër të ndërmarrjes së misioneve për parandalim e konflikteve, ndërveprim i armatosur në konflikt, stabilitetin postkonfiktual, çarmatim të shoqërisë si dhe këshillim për ndërtimin e paqes dhe sigurisë në vend.

Këto detyra sipas Chalmers, Davies dhe Monti, (2010: 671) kanë pak të bëjnë me mbrojtjen në një kuptim të ngushtë, dhe me sigurimin e një rendi më liberal në botë në një kuptim më të gjërë. Nga ana tjetër, detyra kryesore e Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët është që të garantojë sigurinë në arenën ndërkombëtare dhe rritjen e rolit të BE-së (Fischer dhe Thym, 2013: 1206).

Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët, si pjesë e PJSP i nënshtrohet *bashkëpunimit ndërqeveritar* të Shteteve Anëtare. Procedurat mbi të cilat vihen në jetë dhe merren vendimet e kësaj politike, janë të njëjta, me ato të PJSP që konfirmojnë përfshirjen e Politikës së Sigurisë dhe të Mbrojtjes së Përbashkët në kompetencat e Shteteve Anëtare.

⁴⁶⁴ Neni 43/1, TBE: “Bashkimi Evropian mund të përdorë mjete civile dhe ushtarake, përfshijnë operacionet e përbashkëta të çarmatimit, detyrat humanitare dhe të shpëtimit, detyrat e këshillimit dhe asistencës ushtarake, detyrat e parandalimit të konflikteve dhe ruajtjes së paqes, detyrat e forcave luftuese në trajtimin e krizave, duke përfshirë arritjen e paqes dhe stabilizimin në periudhën pas konfliktit. Të gjitha këto detyra mund të kontribuojnë në luftën kundër terrorizmit, duke përfshirë mbështetjen e vendeve të treta në luftën kundër terrorizmit në territoret e tyre”.

Pozicioni ligjor i Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët dhe karakteri i saj ndërqeveritar shpjegohet më së miri Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane në çështjen *Lisbona*.

(i) *Çështja Lisbona*, Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane në këtë vendim ka dalë në konkluzionin, se PSMP-ja nuk është *subjekt i të drejtës komunitare*⁴⁶⁵ dhe se Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët në mënyrë të ngjashme me PJSP-në, *nuk bie në bazë të ligjit mbikombëtar* (Blanke dhe Mangiameli, 2013: 528).⁴⁶⁶ Gjykata mban një qëndrim kritik, nëpërmjet vendosjes së kufizimeve të rrepta ndaj operacioneve ushtarake në bazë të sistemit të sigurisë kolektive dhe për formimin e një ushtrie evropiane (Trybus dhe Rubini, 2012: 311).

Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane sqaron se Bashkimi Evropian ende nuk ka marrë një hap drejt një sistemi të sigurisë kolektive të ndërsjelltë nën formulimin aktual të ligjit parësor dhe në bazë të ligjit, pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës.⁴⁶⁷ Nëse Shtetet Anëtare vendosin të miratojnë një vendim lidhur me këtë çështje, detyrimi i bashkëpunimit ushtarak të Shteteve Anëtare do të ekzistonte vetëm në kontekstin e ligjit ndërkombëtar.⁴⁶⁸ Formulimi i Traktatit të Lisbonës nuk i detyron Shtetet Anëtare të sigurojnë forca të armatosura kombëtare për vendosjen e trupave ushtarake nga Bashkimi Evropian.⁴⁶⁹

Formulimi dhe historia legislative e neneve 42 të Traktatit të Lisbonës tregojnë qartë qëllimin e Shteteve Anëtare për të mbajtur vendimin sovran për vendosjen e forcave

⁴⁶⁵ Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Lisbona* BvE 2/08 [2009], paragrafi 390.

⁴⁶⁶ Shih nenin 24.1, nenin 40 Lisbonës TBE, nenin 2.4 TFBE dhe Deklaratën Nr. 14 për sa i përket Politikës të Jashtme dhe të Siguri së Përbashkët aneksuar në Aktin Final të Traktatit të Lisbonës.

⁴⁶⁷ Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Lisbona* BvE 2/08 [2009], paragrafi 390.

⁴⁶⁸ Po aty.

⁴⁶⁹ Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Lisbona* BvE 2/08 [2009], shih paragrafin 384, sipas të cilit: *The wording of the Treaty of Lisbon does not oblige the Member States to provide national armed forces for military deployments by the European Union.*

të tyre të armatosura e përcaktuar edhe në rendet kushtetuese të Shteteve Anëtare. Traktati i Lisbonës (neni 31/1, 4 dhe neni 42/4 TBE) garanton se asnjë Shtet Anëtar nuk mund të detyrohen të marrin pjesë në një operacion ushtarak të Bashkimit Evropian.⁴⁷⁰ Në një rast të tillë, kërkesa për miratim parlamentar në bazë të dispozitave të ligjit bazë nuk mund të shfuqizohet me një traktat amendamenti të zakonshëm (neni 48/2 deri tek neni 48/5 TBE) e cila do të shfuqizonte parimin e unanimitetit në favor të votimit me shumicë të cilësuar.⁴⁷¹ Gjykata konkludon se Republika Federale e Gjermanisë është e ndaluar me kushtetutë të marrë pjesë në një amendim të tillë të traktatit.⁴⁷²

Lidhur me mbrojtjen kombëtare të shteteve, në të drejtën parësore të Bashkimit Evropian është parashikuar një dispozitë që rregullon shprehimisht sigurinë kombëtare dhe industrinë e mbrojtjes (neni 346, TFBE).⁴⁷³ Kjo dispozitë mund të interpretohet në dy aspekte kryesore: nga njëra anë siguria e shteteve dhe produktet në këtë fushë duken si potencialisht të pakufizuara, nga ana tjetër rrethanat në të cilat Shtetet Anëtare mund të devijojnë nga e drejta e BE-së shikohen thjesht si një tregues i industrisë së mbrojtjes të lidhur direkt me sovranitetin kombëtar (Koutrakos, 2011: 247). Përfshirja e këtij neni në të drejtën komunitare i jep juridiksion GJED-së për të gjykuar raste të tilla, për më tepër që

⁴⁷⁰ Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Lisbona* BvE 2/08 [2009], paragrafi 391.

⁴⁷¹ Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Lisbona* BvE 2/08 [2009], shih paragrafin 391, sipas të cilit: *In such a case, the requirement of parliamentary approval under the provisions of the Basic Law could not be bypassed by an ordinary treaty amendment (Article 48.2 to 48.5 Lisbon TEU) which would abolish the principle of unanimity in favour of qualified majority voting.*

⁴⁷² Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Lisbona* BvE 2/08 [2009], shih paragrafin 391, sipas të cilit: *The Federal Republic of Germany would be constitutionally prohibited to take part in such a treaty amendment.*

⁴⁷³ Neni 346/1, TFBE: “Dispozitat e Traktateve nuk e pengojnë zbatimin e rregullave të mëposhtme: (a) asnjë Shtet Anëtar nuk ka detyrimin të japë informacion, dhënia e të cilit konsiderohet prej tij se bie ndesh me interesat thelbësore të sigurisë së tij; (b) çdo Shtet Anëtar mund të marrë ato masa që i konsideron të nevojshme për mbrojtjen e interesave thelbësore të sigurisë së tij të cilat lidhen me prodhimin ose tregtimin e armëve, municioneve dhe materialeve të luftës; masa të tilla nuk duhet t’i prekin negativisht kushtet e konkurrencës në tregun e brendshëm lidhur me produktet përdorimi i të cilave nuk është përqëllime veçanërisht ushtarake”.

neni 348 parashikon që Komisioni ose çdo Shtet Anëtar mund ta ngrej në çështjen drejtpërsëdrejti përpara Gjykatës së Drejtësisë, nëse mendojnë se i janë shkelur kompetencat e parashikuara në nenin 346.⁴⁷⁴

Një qasje tjetër e rëndësishme është juridiksioni i GJED-së për çështjet në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes dhe në raste të tilla GJED-ja nuk pranon pretendimet e Shteteve Anëtare për të mos respektuar të drejtën komunitare me qëllim ruajtjen e sovranitetit.

Në juridiksionin e saj në çështjen *Komisioni kundër Spanjës*⁴⁷⁵ të vitit 1999, në çështjen *Fiocchi*⁴⁷⁶ të vitit 2003, dhe në dy çështjet *Komisioni kundër Italisë*⁴⁷⁷ të vitit 2008, GJED-ja bën të qartë se mbështetja në nocionin e domosdoshmërisë së sigurisë kombëtare nuk mund të justifikojë *ipso facto* shmangien nga rregullat e Bashkimit Evropian. GJED-ja mban një qëndrim të ashpër ndaj argumenteve të paqarta të paraqitur nga qeveritë kombëtare në emër të sovranitetit të tyre, por duke ruajtur pozicionin e saj për mos u përfshirë në çështjet e brendshme politike të lidhura me sovranitetin e tyre kombëtar (Koutrakos, 2011: 251).

Në rastin *Komisioni kundër Spanjës*, legjislacioni Spanjoll përjashton TVSH-në e Komunitetit për importin e armëve, municioneve dhe pajisjeve ushtarake, ndërkohë që një direktivë kishte përjashtuar TVSH-në për aeroplanë dhe anije lufte. Qeveria Spanjolle argumenton se përjashtimi i TVSH-së për armatimet është e nevojshme për të garantuar objektivat strategjike të mbrojtjes dhe për të siguruar efektivitetin e armatimit spanjoll si në

⁴⁷⁴ Sipas nenit 248, TFBE, në këto raste Gjykata e Drejtësisë e merr vendimin në seancë me dyer të mbyllura.

⁴⁷⁵ Vendimi C-414/97 *Komisioni kundër Spanjës* [1999] ECR I-5585.

⁴⁷⁶ Vendimi T-26/01 *Fiocchi* [2003] ECR II-3951.

⁴⁷⁷ Vendimi C-337/05 *Komisioni kundër Italisë* [2008] ECR I-2173; Vendimi C-157/06 *Komisioni kundër Italisë* [2008] ECR I-7313.

mbrojtjen kombëtare ashtu edhe si pjesë e NATO-s.⁴⁷⁸ GJED-ja konkludon se përjashtimi i TVSH-së nuk është i nevojshëm për të mbrojtur interesat thelbësore të sigurisë.⁴⁷⁹ Në rastin e *Komisioni kundër Italisë* GJED-ja ka konkluduar se njohja e ekzistencës së kërkuar për përjashtim dëmton natyrën detyruese të ligjit të Komunitetit dhe zbatimin uniform të saj.⁴⁸⁰

Një element shumë i rëndësishëm për t'u trajtuar në lidhje me PSMP-në është *klauzola e ndihmës së ndërsjellë*.⁴⁸¹ Kjo klauzolë nënkupton gatishmërinë e Shteteve Anëtare në BE për të asistuar, mbështetur dhe ndihmuar me të gjitha mjetet e nevojshme një Shtet tjetër Anëtar i cili ndodhet në një situatë konfliktuale apo problematike. Por shpeshherë karakteri detyrues i kësaj klauzole është vënë në dyshim, kjo edhe nga Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane.⁴⁸² Gjithashtu klauzola e ndihmës së ndërsjellë përcakton detyrimin e shteteve për të ndihmuar shtetin në nevojë në përputhje me organizatat ndërkombëtare si NATO dhe OKB.⁴⁸³

Detyrimi i ndihmës së Shteteve Anëtare nuk shkon përtej detyrimit të asistencës dhe nuk përfshin përdorimin e mjeteve ushtarake, por veprimin në përputhje me NATO-n⁴⁸⁴ (Misioli, 2008: 15), (Dyson dhe Konstadinides, 2013: 67). Një klauzolë tjetër që përfshihet në Traktatin e Lisbonës është "*klauzola e solidaritetit*" të parashikuar në nenin 222/1, TFBE. Duke përcaktuar dipozitën dhe duke marrë parasysh që vendoset në TFBE, kuptohet

⁴⁷⁸ Vendimi C-414/97 *Komisioni kundër Spanjës* [1999] ECR I-5585.

⁴⁷⁹ Vendimi C-414/97 *Komisioni kundër Spanjës* [1999] ECR I-5585 shih paragrafin 22, sipas të cilit: *It follows that the VAT exemptions are not necessary in order to achieve the objective of protecting the essential interests of the security of the Kingdom of Spain.*

⁴⁸⁰ Vendimi C-337/05 *Komisioni kundër Italisë* [2008] ECR I-2173 shih paragrafin 43, sipas të cilit: *The recognition of the existence of such an exception, regardless of the specific requirements laid down by the Treaty, would be liable to impair the binding nature of Community law and its uniform application.*

⁴⁸¹ Neni 42/7, TBE.

⁴⁸² Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Lisbona* BvE 2/08 [2009], shih paragrafin 385, sipas të cilit: *It needs not to be addressed whether legal literature rightly calls into question the legally binding effect of this obligation of mutual assistance.*

⁴⁸³ Konkretisht në përputhje me nenin 51 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

⁴⁸⁴ Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, çështja *Lisbona* BvE 2/08 [2009], paragrafi 386.

që kjo klauzolë nuk i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm PSMP-së që rregullohet në TBE. Kjo klauzolë nuk zbatohet në mënyrë specifike vetëm për Politikën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes së Përbashkët (Kaczorowska, 2011: 118). Sipas Dyson dhe Konstadinides (2013: 68), kjo klauzolë cilësohet si një *klauzolë e butë*, por e rëndësishme në të gjitha rastet kur një Shtet Anëtar është objekt i një sulmi terrorist ose viktimë e shkakuar nga një fatkeqësi natyrore ose e njeriut.

Në këto rrethana Bashkimi Evropian dhe Shtetet Anëtare janë të nevojshme për të ndihmuar shtetin përkatës me të gjitha mjetet relevante, duke përfshirë edhe ato ushtarake (neni 222/1, TFBE). Të dyja klauzolat ajo e ndihmës së ndërsjellë dhe ajo e solidaritetit detyrojnë në mënyrë direkte ose indirekte Shtetet Anëtare që të asistojnë Shtetet e tjera Anëtare në rast nevojë. Krahas dy klauzolave në radhën e risive që sjell Traktati i Lisbonës në kuadër të PSMP-së, rëndësi të veçantë merr miratimi i një dispozitë të re të quajtur *“bashkëpunimi i përhershëm i strukturuar”*.

Një bashkëpunim i tillë rregullohet nga neni 42/ 6, TBE,⁴⁸⁵ nga neni 46,⁴⁸⁶ i këtij Traktati dhe nga Protokolli Nr. 10 “Për bashkëpunimin e përhershëm të strukturuar krijuar me nenin 42 të Traktatit të Bashkimit Evropian”.⁴⁸⁷ Kjo dispozitë bën të mundur institucionalizimin e bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare. Traktati i Lisbonës legjitimon bashkëpunimin, koordinimin dhe angazhimin e Shteteve Anëtare që duan të jenë

⁴⁸⁵ Neni 42/6, TBE: “Shtetet Anëtare, të cilat kanë kapacitete ushtarake të larta dhe të cilat kanë angazhime detyruese lidhur me misionet më të vështira të Bashkimit Evropian, vendosin një bashkëpunim të përhershëm të strukturuar brenda kuadrit të Bashkimit Evropian”.

⁴⁸⁶ Neni 46, TBE: “Ato Shtete Anëtare të cilat dëshirojnë të marrin pjesë në bashkëpunimin e përhershëm të strukturuar ... e njoftojnë Këshillin dhe Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit lidhur me qëllimin e tyre”.

⁴⁸⁷ Neni 1. Protokolli Nr. 10: “ Bashkëpunimi i përhershëm i strukturuar...është i hapur për çdo Shtet Anëtar i cili nga data e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, merr përsipër: (a) të vazhdojë të zhvillojë më intensivisht aftësitë mbrojtëse ... dhe (b) të ketë kapacitetin të sigurojë, ... në nivel kombëtar ose si komponent i forcave shumëkombëshe, njësi speciale të luftimit për misionet e planifikuara...”

pjesë e këtij bashkëpunimi të përhershëm të strukturuar që të bashkojnë kapacitetet e tyre ushtarake dhe investimet për nevojat ushtarake. Shtetet Anëtare nuk detyrohen të bëhen pjesë e këtij bashkëpunimi, duke zgjedhur me vullnetin e tyre të lirë përfshirjen në këtë bashkëpunim. Por në rast se shtetet zgjedhin të jenë pjesë duhet të respektojnë rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Protokollin Nr. 10.⁴⁸⁸

*Krijimi i fondit fillestar nga Shtetet Anëtare,*⁴⁸⁹ është një risi tjetër e Traktatit të Lisbonës për zhvillimin e PSMP-së, ky fond i jep dritën jeshile krijimit të një buxheti për mbrojtjen në Bashkimin Evropian. Fond i cili financohet nga kontributet individuale të Shteteve Anëtare në aspektin e mbrojtjes dhe të sigurisë duke mos patur lidhje me buxhetin e Bashkimit Evropian.

PSMP-ja ushtron veprimtarinë e saj në bazë të dy dimensioneve kryesore: dimensionit të mbrojtjes dhe dimensionit të sigurisë. *Dimensioni i mbrojtjes* në vetvete përbëhet nga dy dimensione të tjera, të parashikuara në të drejtën e BE në kuadër të PSMP. Sipas autorëve, Dyson dhe Konstadinides mbrojtja nuk është përkufizuar në mënyrë konkrete në TBE dhe në kontekstin e PSMP, ajo është subjekt i interpretimit *ad hoc* (2013:

⁴⁸⁸ Neni 2. Protokollin Nr. 10: “Për të arritur objektivat e përcaktuar në nenin 1, Shtetet Anëtare pjesëmarrëse në bashkëpunimin e përhershëm të strukturuar marrin përsipër: (a) të bashkëpunojnë, me synim realizimin e objektivave të miratuara në lidhje me nivelin e shpenzimeve për investime në pajime mbrojtjeje, dhe t’i rishikojnë rregullisht këta objektiva, nisur nga situata e sigurisë dhe përgjegjësitë ndërkombëtare të Bashkimit Evropian; (b) t’i përputhin sa më shumë aparatet e tyre të mbrojtjes me njëri-tjetrin, sidomos duke harmonizuar identifikimin e nevojave të tyre ushtarake, duke i bashkuar, dhe sipas rastit, duke i specializuar mjetet e tyre të mbrojtjes dhe aftësitë, dhe duke inkurajuar bashkëpunimin në fushat e trajnimit dhe logjistikës; (c) të marrin masa konkrete për të rritur disponueshmërinë, ndërshtfrytëzueshmërinë, fleksibilitetin dhe dislokueshmërinë e forcave të tyre sidomos duke identifikuar objektiva konkrete në lidhje me angazhimin e forcave, përfshirë këtu rishikimin e mundshëm të procedurave të tyre të vendimmarrjes; (d) të punojnë së bashku që të marrin masat e nevojshme për të pakësuar, nëpërmjet metodave shumëkombëshe dhe pa cenuar sipërmarrjet në këtë drejtim në kuadër të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, mangësitë e konceptuara në kuadër të Mekanizmit të Zhvillimit të Aftësive”.

⁴⁸⁹ Neni 41/3, TBE: “Këshilli miraton një vendim ku vendosen procedurat e caktuara për të garantuar marrjen e shpejtë të fondeve të buxhetit të Bashkimit Evropian për nismat në kuadër të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët... Veprimtaritë përgatitore për Politikën e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët nuk i ngarkohen buxhetit të Bashkimit Evropian, por financohen nga fondi fillestar i ngritur me kontributet e Shteteve Anëtare”.

60). Ndërkohë, pavarësisht mungesës së një përkufizimi të detajuar në nenin 42/2, TBE-ja përcakton se, PSMP-ja përfshin shprehjen e vazhdueshme të një politike të përbashkët të mbrojtjes.

Traktati i Lisbonës bën dallimin ndërmjet, një politike të mbrojtjes së përbashkët dhe mbrojtjes së përbashkët. Politika e mbrojtjes së përbashkët është brenda kufijve të kompetencave të BE-së ndërsa mbrojtja e përbashkët, i nënshtrohet vullnetit politik të Shteteve Anëtare. Ky dimension i referohet ndërmarrjes së operacione ushtarake në kuadër të detyrave të Petërsburgut dhe të NATO-s.⁴⁹⁰ Dimensioni i mbrojtjes së PSMP-së përfshin tre komponentë *komponenti ushtarak*, i përkufizuar në Këshillin Evropian të Helsinkit në dhjetor të vitit 1999,⁴⁹¹ *komponenti civil* u zhvillua nga Këshilli Evropian Feira i qershorit të vitit 1999⁴⁹² dhe Këshilli Evropian i Gotenburg në qershor të vitit 2001,⁴⁹³ dhe *komponentin e parandalimit të konflikteve*, Këshilli Evropian i Gotenburgut miratoi Programin e BE-së për parandalimin e konflikteve të dhunshme,⁴⁹⁴ (Kaczorowska, 2011: 119-123).

Dimensioni i sigurisë është dimension i dytë i Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët. Ky dimension është bazuar në Strategjinë Evropiane të Sigurisë të krijuar në Këshillin Evropian të Brukselit në dhjetor të vitit 2003.⁴⁹⁵ Strategjia jep, udhëzime në lidhje me strategjitë ndërkombëtare të sigurisë së BE-së, përcakton prioritetet kryesore, dhe përcakton kërcënimet kryesore për sigurinë e BE-së. Këto kërcënime nënkuptojnë

⁴⁹⁰ Për informacion të zgjeruar të historikut dhe komponentëve të dimensionit të mbrojtjes mund të referoheni tek Kaczorowska, 2011.

⁴⁹¹ Presidency Conclusions, Helsinki European Council, 10 and 11 December 1999

⁴⁹² Presidency Conclusions of the European Council of Santa Maria da Feira (19 and 20 June 2000).

⁴⁹³ Gothenburg European Council on 15-16 June 2001. The conclusions of the Presidency and fixtures.

⁴⁹⁴ Po aty.

⁴⁹⁵ A Secure Europe in a Better World: European Security Strategy, Brussels, 12 December 2003.

terrorizmi, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, konfliktet rajonale, krimi i organizuar etj. (Kaczorowska, 2011:123).

b) Organet kryesore politike dhe ushtarake të themeluara në bazë të Politikës së Sigurisë dhe të Mbrojtjes së Përbashkët

Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët disponon organet e veta për implementimin e objektivave të saj dhe për të forcuar rolin e Bashkimit Evropian si një aktor global. Organet më të rëndësishme të PSMP janë: Përfaqësuesi i Lartë, Këshilli i Ministrave dhe Komiteti Politik dhe i Sigurisë.⁴⁹⁶ *Përfaqësuesi i Lartë* së bashku me *Këshillin* janë organet kryesore vendimmarrëse të PSMP-së. Përfaqësuesi i Lartë duke vepruar nën autoritetin e Këshillit dhe në bashkëpunim me Komitetin Politik dhe të Sigurisë, mundëson garantimin e misionëve civile dhe ushtarake.⁴⁹⁷ Vendimet për PSMP-në miratohen unanimisht nga Këshilli,⁴⁹⁸ i cili gjithashtu lejon përdorimin e fondit fillestar të ngritur me kontributin e Shteteve Anëtare nëpërmjet autorizimit të Përfaqësuesit të Lartë.⁴⁹⁹

(i) *Komiteti Politik dhe i Sigurisë (KPS)*⁵⁰⁰ është një organ i përhershëm në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët që vepron edhe në kuadrin e PSMP-së.⁵⁰¹ KPS përbëhet nga drejtuesit politikë të ministrave të jashtëm të Shteteve Anëtare. Komiteti

⁴⁹⁶ Shih: Duquette, (2001); De Baere, (2008); Kaddous, (2008); Freire, (2008); Chalmers, Davies dhe Monti, (2010); Keukeleire, (2010); Eeckhout, (2011); Kaczorowska, (2011); Dyson dhe Konstadinides, (2013); Fischer dhe Thym, (2013); Koutrakos, (2013); Mix, (2013); Rehrl dhe Glume, (2015).

⁴⁹⁷ Neni 43/2, TBE.

⁴⁹⁸ Neni 42/4, TBE.

⁴⁹⁹ Neni 41/3, TBE.

⁵⁰⁰ Vendim i Këshillit 2001/78/PJSP i 22 janar 2001 për ngritjen e Komitetit Politik dhe të Sigurisë (*Council Decision 2001/78/CFSP*).

⁵⁰¹ Komiteti Politik dhe i Sigurisë rregullohet në nenin 38 të Traktatit të Bashkimit Evropian, (funksionet e këtij organi janë shpjeguar në Kreu IV të këtij studimi).

Politik dhe i Sigurisë ushtron kontroll politik dhe drejtim strategjik të operacioneve të menaxhimit të krizave. Në veprimtarinë e tij, ai asistohet nga një grup politiko-ushtarak, që përfshin Komitetin për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave, Komitetin Ushtarak dhe stafin ushtarak (Vooren dhe Wessel, 2014: 372). Organet ushtarake të PSMP-së janë:

(ii) *Komiteti Ushtarak i Bashkimit Evropian*,⁵⁰² i cili përbëhet nga Ministrat e Mbrojtjes së Shteteve Anëtare dhe është organi më i lartë ushtarak brenda Këshillit. Komiteti Ushtarak i Bashkimit Evropian është një strukturë e përhershme ushtarake dhe politike. Ky Komitet jep ekspertizën, këshillon dhe drejton aktivitetet ushtarake të Bashkimit Evropian (Rehrl dhe Glume, 2015: 23).

(iii) *Stafi Ushtarak i Bashkimit Evropian*,⁵⁰³ është i përbërë nga 140 oficerë nga Shtetet Anëtare. Stafi Ushtarak i Bashkimit Evropian është përgjegjës për politikën operationale të mbrojtjes dhe burim i ekspertizës kolektive ushtarake. Ai është i vendosur nën drejtimin e Komitetit Ushtarak të Bashkimit Evropian dhe nën autoritetin e Përfaqësuesit të Lartë.

(iv) *Instituti i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë*,⁵⁰⁴ është një agjenci e Bashkimit Evropian, që merret me analizimin e çështjeve, që lidhen me politikën e jashtme, mbrojtjen dhe sigurinë. Ky është një institut i rëndësishëm i cili shërben për hulumtimet kryesore në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Misioni kryesor i Institutit është të realizojë

⁵⁰² Vendim i Këshillit 2001/79/PJSP i 22 janar 2001 për ngritjen e Komitetit Ushtarak të Bashkimit Evropian (*Council Decision 2001/79/CFSP*).

⁵⁰³ Vendim i Këshillit 2001/80/PJSP i 22 janar 2001 mbi themelimin e Shtabit Ushtarak të Bashkimit Evropian (*Council Decision 2001/80/CFSP*); Vendim i Këshillit 2005/395/PJSP i 10 maj 2005 për ndryshimin e vendimit 2001/80/PJSP për themelimin e Shtabit Ushtarak të Bashkimit Evropian (*Council Decision 2005/395/CFSP*); Vendim i Këshillit 2003/479/KE i 16 qershorit 2003 në lidhje me rregullat e zbatueshme të ekspertëve kombëtarë dhe personelit ushtarak në atashimin në Sekretariatin e Përgjithshëm të Këshillit (*Council Decision 2003/479/EC*).

⁵⁰⁴ Veprim i Përbashkët i Këshillit 2001/554, tani rregullohet me Vendimin e Këshillit 2014/75/PJSP.

analiza dhe diskutime, të cilat mund të jenë të përdorshme dhe të vlefshme për formulimin e politikave të Bashkimit Evropian. Në përmbushje të këtij misioni, ai vepron edhe si ballafaqim ndërmjet ekspertëve dhe vendim-marrësve të të gjitha niveleve.

(v) *Qendra Satelite e Bashkimit Evropian*⁵⁰⁵ ndihmon në vendimmarrjen e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët dhe Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët përmes analizimit të të dhënave që merr nga satelitët që mbikëqyrin Tokën. Qendra satelitore është një agjenci e Këshillit, e cila operon nën drejtimin e Përfaqësuesit të Lartë.

(vi) Një hap i rëndësishëm për të rritur rolin e BE-së në zgjidhjen e konflikteve dhe për të forcuar aspektin e tij mbrojtës është themelimi në vitin 2004 i *Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes* (AEM).⁵⁰⁶ Krijimi i kësaj agjencie, që para miratimit të Traktatit Kushtetues është realizuar nëpërmjet një veprimi të përbashkët të Këshillit.⁵⁰⁷ Kjo agjensi është shumë e rëndësishme për të koordinuar politikën e mbrojtjes së Bashkimit Evropian dhe ka një rol përcaktues për mbarrëvajtjen e kësaj politike.

Agjencia Evropiane e Mbrojtjes synon përmirësimin e aftësive ushtarake të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, koordinimin e politikave të mbrojtjes industriale si dhe politikat e prokurimit në mënyrë që të shtrijë shpenzimet e mbrojtjes evropiane (Mix, 2013: 5). Agjencia Evropiane e Mbrojtjes është subjekt i autoritetit të Këshillit dhe është e hapur

⁵⁰⁵ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2001/555/PJSP i 20 korrik 2001 mbi themelimin e një Qendre Satelitore së Bashkimit Evropian (*Council Joint Action 2001/555/CFSP*); Vendim i Këshillit 2014/401/PJSP i 26 qershor 2014 për Qendrën Satelite të Bashkimit Evropian dhe shfuqizimin e Veprimit të Përbashkët 2001/555/PJSP për themelimin e një Qendre Satelitore të Bashkimit Evropian (*Council Decision 2014/401/CFSP*).

⁵⁰⁶ Neni 42/3, TBE: “Agjencia Evropiane e Mbrojtjes është një agjensi, që shërben në fushën e kërkimit, zhvillimit, marrjes dhe armatimit të kapaciteteve të mbrojtjes duke identifikuar kërkesat operative, si dhe promovon masat për përmbushjen e këtyre kërkesave”.

⁵⁰⁷ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2004/551/PJSP i 12 korrik 2004 mbi themelimin e Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes (*Council Joint Action 2004/551/CFSP*).

për të gjitha Shtetet Anëtare, që dëshirojnë të jenë pjesë e saj.⁵⁰⁸ Agjencia Evropiane e Mbrojtjes ka katër detyra kryesore,⁵⁰⁹ kjo agjensi zhvillon aftësitë mbrojtëse në fushën e menaxhimit të krizave; promovon dhe përmirëson bashkëpunimin në armatimin e BE-së; forcon mbrojtjen e bazës teknologjike dhe industriale të BE-së dhe rrit kërkimet evropiane në mbrojtje dhe në teknologji.⁵¹⁰

Roli i Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes nuk është të kopjojë programet ekzistuese të armatimit në Evropë, por për të mbështetur Këshillin dhe Shtetet Anëtare në drejtim të përmirësimit të aftësive mbrojtëse të Bashkimit Evropian brenda një kuadri vullnetare dhe jo-detyrues ndërqeveritar (Dyson dhe Konstadinides, 2013). Ajo thjesht menaxhon projektet në emër të Shteteve Anëtare, projekte që kontrollohet dhe financohen nga shtetet nën mbikqyrjen e Këshillit (Koutrakos, 2011).

6.2.4. Misionet civile të Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët

Roli i Bashkimit Evropian në skenën ndërkombëtare ka evoluar vazhdimisht duke përfshirë menaxhimin e krizave, masat ndërkombëtare për të frenuar migrimin e paligjshëm, trafikun e drogës, promovimin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, zhvillimin dhe ndihmën humanitare etj., (Freire, 2008: 20-21). Për të përballuar këto kërcënime ndaj

⁵⁰⁸ Neni 42/3, TBE; Neni 45, TBE.

⁵⁰⁹ Neni 45/1, TBE: “Agjencia Evropiane për Mbrojtjen, në varësi të autoritetit të Këshillit ka si detyrë të vetën: (a) të kontribuojë në identifikimin e objektivave të mundshme ushtarake dhe në vlerësimin e respektimit të angazhimeve me kapacitete që kanë dhënë Shtetet Anëtare; (b) të promovojë harmonizimin e nevojave operative dhe përfaqimin e metodave të efektshme dhe të përputhshme të prokurimit; (c) të propozojë projekte shumëpalëshe për përmbushjen e objektivave në lidhje me kapacitetet ushtarake, të sigurojë bashkërendimin e programeve që zbatojnë Shtetet Anëtare dhe administrimin e programeve të veçanta të bashkëpunimit; (d) të mbështesë kërkimin në fushën e teknologjisë së mbrojtjes dhe të bashkërendojë e planifikojë veprimtari të përbashkëta kërkimore dhe të studimeve të zgjidhjeve teknike që përmbushin nevojat operative për të ardhmen; (e) të kontribuojë në identifikimi dhe, nëse është nevoja, në zbatimin e masave të dobishme për fuqizimin e bazës industriale dhe teknologjike të sektorit të mbrojtjes dhe në përmirësimin e efektshmërisë së shpenzimeve ushtarake”.

⁵¹⁰ Protokoll Nr.10, Për bashkëpunimin e përhershëm të strukturuar krijuar me nenin 42 të Traktatit të Bashkimit Evropian.

sigurisë globale, Shtete Anëtare duhet të shprehin vullnetin e tyre dhe t'i japin Bashkimit Evropian të drejtën për të ndërmarrë operacioneve civile dhe ushtarake. Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët nëpërmjet nisjes së misioneve civile dhe ushtarake ka rritur rolin e Bashkimit Evropian si një aktor global në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare.

Bashkimi Evropian ka ndërmarrë një numër të madh të operacioneve civile dhe ushtarake, por që në operacionet e para të ndërmarra prej tij në kuadër të Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët është vënë re natyra civile e këtyre operacioneve (Naert, 2007: 61). Bashkimi Evropian ka përfunduar me sukses 17⁵¹¹ operacione civile dhe ushtarake, ndërsa 18⁵¹² operacione të tjera janë akoma në vazhdim nga Bashkimi Evropian, operacione të shtrira në vende të ndryshme të të gjitha kontinenteve. Natyra e operacioneve që në të shumtën e rasteve është civile përfshin misione për asistencën në polici, për monitorimin, për shtetin e të drejtës etj.

Ndër misionet për asistencën në polici mund të përmendim EUPOL Afganistan,⁵¹³ është një mision civil në vazhdim i themeluar në vitin 2007. Ky mision mbështeti përpjekjet e reformave të qeverisë afgane në ndërtimin e një shërbimi policor civil që operon brenda një rregulli të përmirësuar të kuadrit të ligjit dhe në lidhje me të drejtat e njeriut.⁵¹⁴ Misioni është pjesë e angazhimit afatgjatë të Bashkimit Evropian dhe kontribuon në objektivat e përgjithshme politike dhe strategjike të Bashkimit Evropian në Afganistan.⁵¹⁵ EUPOL

⁵¹¹ Marrë nga [www.http://eeas.europa.eu/csdp/missions-and-operations](http://eeas.europa.eu/csdp/missions-and-operations).

⁵¹² Po aty.

⁵¹³ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2007/369/PJSP i 30 maj 2007 mbi themelimin e Misionit Policor të Bashkimit Evropian në Afganistan, EUPOL Afganistan (*Council Joint Action 2007/369/CFSP*).

⁵¹⁴ Vendim i Këshillit 2010/279/PJSP i 18 maj 2010 për Misionin Policor të Bashkimit Evropian në Afganistan, EUPOL Afganistan (*Council Decision 2010/279/CFSP*).

⁵¹⁵ Vendim i Këshillit 2013/240/PJSP i 27 maj 2013 për ndryshimin e vendimit 2010/279/PJSP për Misionin Policor të Bashkimit Evropian në Afganistan, EUPOL Afganistan (*Council Decision 2013/240/CFSP*).

COPPS në territorin Palestinez,⁵¹⁶ është një tjetër mision civil në vazhdim, për asistencën në polici.

EUPM Bosnjë-Hercegovinë,⁵¹⁷ ishte misioni i parë i Bashkimit Evropian që filloi në vitin 2003 dhe përfundoi në dhjetor të vitit 2011, i ndjekur nga Task Forca Policore Ndërkombëtare të OKB-së.⁵¹⁸ EUPOL DRC Republika Demokratike e Kongos,⁵¹⁹ misioni policor i përfunduar kishte si qëllim ofrimin e ndihmës, këshillime, dhe mbështetje për reformën e sektorit të sigurisë.⁵²⁰ EUPAT Macedonia,⁵²¹ një mision policor i përfunduar në vitin 2005. Misioni ushtarak Konkordia në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, u pasua nga misioni policor EUPOL Proxima nisi në vitin 2003 dhe përfundoi në vitin 2005. Misione civile për asistencën kufitare mund të përmendim EUBAM Rafah,⁵²² misione

⁵¹⁶ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2005/797/PJSP i 14 nëntor 2005 për Misionin Policor të Bashkimit Evropian në Territoret Palestineze (*Council Joint Action 2005/797/CFSP*).; Vendim i Komiteti Politik dhe i Sigurisë 2013/511/PJSP i 8 tetor 2013 për zgjatjen e mandatit të Shefit të Misionit Policor të Bashkimit Evropian, të ndërmarrë në kuadër të reformës së sektorit të sigurisë (RSS) dhe ndërfaqen e tij me sistemin e drejtësisë në Republikën Demokratike të Kongos (EUPOL RD Kongo) (*Political and Security Committee Decision 2013/511/CFSP*).

⁵¹⁷ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2002/210/PJSP i 11 mars 2002 mbi Misionin Policor të Bashkimit Evropian (EUPM) në mënyrë që të sigurojnë që nga 1 janari 2003 vazhdimin e Task Forcës Ndërkombëtare të Policisë të Kombeve të Bashkuara (IETF) në Bosnje dhe Hercegovinë (*Council Joint Action 2002/210/CFSP*).; Vendim i Këshillit 2002/845/PJSP i 30 shtator 2002 në lidhje me përfundimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Bosnje dhe Hercegovinës në aktivitetet e Misionit Policor të Bashkimit Evropian (EUTM) në Bosnjë dhe Hercegovinë (*Council Decision 2002/845/CFSP*).; Vendim i Këshillit 2002/845/PJSP i 30 shtator 2002 në lidhje me përfundimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Bosnje dhe Hercegovinës në aktivitetet e Misionit Policor të Bashkimit Evropian (EUTM) në Bosnjë dhe Hercegovinë (*Council Decision 2002/845/CFSP*).; Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2003/141/PJSP i 27 shkurt 2003 për ndryshimin e Veprimit të Përbashkët 2002/210/PJSP për Misionin Policor të Bashkimit Evropian (*Council Joint Action 2003/141/CFSP*).

⁵¹⁸ Vendim i Këshillit 2010/755/PJSP i datës 6 dhjetor 2010, për ndryshimin e vendimit 2009/906/PJSP për Misionin Policor të Bashkimit Evropian (EUPM) në Bosnjë dhe Hercegovinë (*Council Decision 2010/755/CFSP*).

⁵¹⁹ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2007/405/PJSP i 12 qershor 2007 për Misionin Policor të Bashkimit Evropian të ndërmarrë në kuadër të reformës së sektorit të sigurisë (RSS) dhe ndërfaqen e tij me sistemin e drejtësisë në Republikën Demokratike të Kongos, EUPOL RD Kongo (*Council Joint Action 2007/405/CFSP*).

⁵²⁰ Political and Security Committee Decision 2013/511/CFSP.

⁵²¹ Council Joint Action 2005/826/CFSP.

⁵²² Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2005/889/PJSP të 12 dhjetor 2005 mbi krijimin e Misionit të Asistencës Kufitare të Bashkimit Evropian për vendkalimin Rafah, BE-BAM Rafah (*Council Joint Action 2005/889/CFSP*).; Vendim i Këshillit 2014/430/PJSP i 3 korrik 2014 për ndryshimin e Veprimit të Përbashkët

monitorimi EUMM Georgjia,⁵²³ nisi punën në vitin 2009 dhe u bë i vetmi ndërkombëtar monitorues në Gjeorgji.

Ky mision civil është i ngarkuar me monitorimin e pajtueshmërisë së palëve me marrëveshjen e armëpushimit dhe zbatimin e masave për të kontribuar në stabilitetin, normalizimin, dhe ndërtimin e besimit përmes lehtësimit të komunikimit mes palëve në terren.⁵²⁴ AMM Indonezi⁵²⁵ është misioni monitorues në Aceh, Indonezi, ky mision konsiderohet si një nga sukseset më të mëdha të Bashkimit Evropian në zgjidhjen e konflikteve.⁵²⁶ Reforma në sektorin e sigurisë dhe për shtetin e të drejtës janë marrë një sërë misionesh si ato të EU SSR Guinea Bissau,⁵²⁷ EUJUST Lex Irak,⁵²⁸ EULEX Kosovë⁵²⁹ është një nga misionet civile më të gjata në historinë e Bashkimit Evropian, ka nisur në

2005/889/PJSP për themelimin e një Misioni të Asistencës Kufitare të Bashkimit Evropian për vendkalimin Rafah (BE-BAM Rafah) (*Council Decision 2014/430/CFSP*).

⁵²³ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/736/PJSP i 15 shtatorit 2008 mbi Misionin Monitorues të Bashkimit Evropian në Gjeorgji, EUMM Gjeorgji. (*Council Joint Action 2008/736/CFSP*).

⁵²⁴ Vendim i Këshillit 2015/2008/PJSP i 10 nëntor 2015 për ndryshimin e vendimit 2010/452/PJSP për Misionin Monitorues të Bashkimit Evropian në Gjeorgji, EUMM Gjeorgji. (*Council Decision 2015/2008/CFSP*).

⁵²⁵ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2005/643/PJSP i datës 9 shtator 2005 për Misionin Monitorues të Bashkimit Evropian në Aceh Indonezi, Aceh misionit vëzhgues – AMM. (*Council Joint Action 2005/643/CFSP*).

⁵²⁶ Pieter Feith ishte kreu i misionit në Aceh, në një raport të tij analizon arsyet për përfundim të suksesshëm të procesit të paqes Aceh. Feith, P. (2007). *The Aceh Peace Process: Nothing Less than Success*. United States Institute of Peace.

⁵²⁷ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/112/PJSP i 12 shkurt 2008 për misionin e Bashkimit Evropian në mbështetje të reformës së sektorit të sigurisë në Republikën e Guinea-Bissau (SSR nga BE Guinea-Bissau. (*Council Joint Action 2008/112/CFSP*); Vendim i Këshillit 2010/298/PJSP i 25 maj 2010 për ndryshimin dhe zgjerimin e Veprimit të Përbashkët 2008/112/PJSP për misionin e Bashkimit Evropian në mbështetje të reformës së sektorit të sigurisë në Republikën e Guinea-Bissau, SSR Guinea-Bissau. (*Council Decision 2010/298/CFSP*).

⁵²⁸ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2005/190/PJSP i datës 7 mars 2005 për Misionin e Bashkimit Evropian për Shtetin e të Drejtës në Irak, misioni EUJUST LEX. (*Council Joint Action 2005/190/CFSP*); Vendim i Këshillit 2012/372/PJSP i 10 korrik 2012 për ndryshimin dhe zgjerimin e vendimit 2010/330/PJSP për Misionin e Bashkimit Evropian për shtetin e të drejtës në Irak, misioni EUJUST LEX. (*Council Decision 2010/330/CFSP*).

⁵²⁹ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2006/304/PJSP i 10 prill 2006 mbi themelimin e Ekipit Planifikues të Bashkimit Evropian (EUPHAT Kosovë) në lidhje me një operacion të mundshëm të BE-së për menaxhimin e krizës në fushën e sundimit të ligjit dhe fusha të tjera të mundshme në Kosovë. (*Council Joint Action 2006/304/CFSP*); Vendim i Këshillit 2015/901/PJSP i 11 qershorit 2015 për ndryshimin e Veprimit të Përbashkët 2008/124/PJSP të Bashkimit Evropian për Misionin e Sundimit të Ligjit në Kosovë, EULEX Kosovë. (*Council Decision 2015/901/CFSP*).

vitin 2008 dhe ka për detyrë të ndërtojë, trajnojë, kontrollojë policinë, gjykatësit, zyrtarët e doganave, zyrtarët civilë dhe administratorët në Kosovë.

EUJUST Themis⁵³⁰ është misioni i shtetit ligjor në Gjeorgji, me kërkesën e qeverisë gjeorgjiane, nisi në vitin 2004 dhe përfundoi në vitin 2005. Misioni EUBAM nisi në vitin 2005, ishte mision për asistencë teknike, përmirësimin e sigurisë dhe operacioneve doganore përgjatë kufirit Ukrainë-Moldavi, duke lehtësuar zgjidhjen e konfliktit në Transdnjestri.⁵³¹ Operacioni për stabilizimin post-konfliktual i njohur si EUFOR Althea,⁵³² është operacioni që po vepron aktualisht në Bosnjë dhe Hercegovinë. Misioni ka nisur në dhjetor të vitit 2004 dhe ka përgjegjësinë të stabilizojë gjendjen në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Ka dhe një sërë misionesh të tjera të marra nga Bashkimi Evropian por duhet të përmendim dhe se misioni i fundit i Bashkimit Evropian është EUAM në Ukrainë i nisur në korrik të vitit 2014⁵³³ për të ndihmuar vendin në reformat e sektorit civil të sigurisë, duke përfshirë policinë dhe sundimin e ligjit. Të gjitha këto misione janë dëshmi për rolin e Bashkimit Evropian si një aktor në skenën ndërkombëtare. Bashkimi Evropian nëpërmjet ndërmarrjes së këtyre misionëve tregon që pavarësisht se, është një organizatë rajonale me fokus të veçantë fushën ekonomike, ka arritur të krijojë një rol si aktor i vetëm krahas organizatave të tjera rajonale dhe ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve. Politikat e

⁵³⁰ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2004/523/PJSP i 28 qershor 2004 mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e ligjit në Gjeorgji, misioni EUJUST Themis (*Council Joint Action 2004/523/CFSP*).

⁵³¹ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2005/776/PJSP i 7 nëntor 2005 për ndryshimin e mandatit të Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian për Moldavinë (*Council Joint Action 2005/776/CFSP*).

⁵³² Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2004/569/PJSP i 12 korrik 2004 mbi mandatin e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian në Bosnje-Hercegovinë dhe shfuqizimi i Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2002/211/PJSP (*Council Joint Action 2004/569/CFSP*).

⁵³³ Vendim i Këshillit 2014/486/PJSP i 22 korrik 2014 për Misionin Këshillimor të Bashkimit Evropian për Reformën në Sektorit e Sigurisë Civile në Ukrainë, EUAM Ukrainë (*Council Decision 2014/486/CFSP*).

Bashkimit Evropian në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes kanë adresuar më së miri kapacitetet e Bashkimit Evropian për të konfirmuar këtë rol.

6.3. Politika Evropiane e Fqinjësisë në funksion të zgjidhjes së konflikteve ndërkombëtare

6.3.1. Krijimi i Politikës Evropiane të Fqinjësisë dhe kuptimi i saj

Në vitin 2003, Bashkimi Evropian për të mbrojtur sigurinë dhe për të promovuar vlerat e tij në botë, nëpërmjet Strategjisë së Sigurisë Evropiane vendosi tre objektiva strategjike: së pari, adresimin e kërcënimeve, së dyti, sendërtimin e sigurisë në fqinjët e tij dhe së treti, ndërtimin e një rendi ndërkombëtar të bazuar në multilateralizëm efektiv.⁵³⁴ Objektivi i dytë i Strategjisë së Sigurisë Evropiane përcaktoi dhe bazën kryesore të krijimit dhe zhvillimit të Politikës Evropiane të Fqinjësisë (PEF) në vitin 2004.

Politika Evropiane e Fqinjësisë kishte, si synim vendosjen e marrëdhënieve të veçanta me vendet fqinje në Evropën Lindore, Mesdheun e Jugut dhe Kaukazin e Jugut. Qëllimi kryesor i PEF⁵³⁵ ishte adresimi i sfidave të reja, më të cilat do të përballej BE pas raundeve të fundit të zgjerimit (Emerson, 2004: 7) dhe të kontribuonte në përparimin e mëtejshëm të objektivave të politikës së jashtme të BE⁵³⁶ (Hillion, 2013: 2). Në synimin e Politikës Evropiane të Fqinjësisë ishte forcimi i prosperitetit, sigurisë, stabilitetit dhe vlerave demokratike.⁵³⁷

⁵³⁴ A Secure Europe in a Better World: European Security Strategy, Brussels, 12 December 2003.

⁵³⁵ Council Conclusion, Wider Europe- Council of Ministers of the European Union, 13 October 2003.

⁵³⁶ European Commission, European Neighbourhood Policy Strategy Paper, Communication from the Commission COM (2004) 373 final, 12 May.

⁵³⁷ European Commission, Wider Europe-Neighbourhood: a New Framework for Relations with our Eastern and Southern Neighbours, communication to the Council and the Parliament, 11/03/2003, COM (2003) 104 final.

Në qershor të vitit 2003, Këshilli për Çështjet e Përgjithshme dhe Marrëdhënieve me Jashtë vuri në dukje rëndësinë e përgjegjësisë së përbashkët për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve⁵³⁸ ndërmjet partnerëve të Politikës Evropiane të Fqinjësisë dhe Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër, Komisioni nënvizoi përputhjen e plotë të Politikës Evropiane të Fqinjësisë me qëllimet e Strategjisë së Sigurisë Evropiane të vitit 2003. Sipas Komisionit, detyra e Bashkimit Evropian është të promovojë një rrjet të vendeve të mirëqeverisura në lindjen e Bashkimit Evropian dhe në kufijtë mesdhetare, me të cilët mund të gëzojnë marrëdhënie të ngushta dhe bashkëpunuese⁵³⁹ (Hillion, 2013: 3).

Zgjerimi i Bashkimit Evropian me dhjetë vende ish-komuniste krijoi rrezikun e ndarjes së Evropës në dy kampe, një Evropë shumë të zhvilluar dhe tjetrën jashtë saj të varfër. Siç thekson dhe Bindi, rreziku ishte ai i krijimit të një Evrope me dy shpejtësi, një e integruar në mënyrë të vendosur, të qëndrueshme, të pasur në Perëndim dhe një më pak e qëndrueshme, më e varfër, dhe më pak demokratike në Lindje (2010: 99). Kjo ndarje ishte kundër vlerave, që mbronte Bashkimit Evropian, në perceptimin e tij si një aktor i rëndësishëm global.

Për këtë arsye për të shmangur frikën e një destabiliteti të mundshëm nga kërcënimi i krizave dhe konflikteve në radhët e fqinjëve në rajon dhe më gjerë, Bashkimi Evropian krijoi politika të reja efektive, si ajo e PEF-së. Politika Evropiane e Fqinjësisë zë një vend qendror në marrëdhëniet e Bashkimit Evropian me vendet fqinje të tij, në fusha të ndryshme, por kryesisht edhe në zgjidhjen e konflikteve (Blockmans dhe Lazowski, 2006). Politika Evropiane e Fqinjësisë përveç zgjidhjes së konflikteve, pjesë të objektivave të saj

⁵³⁸ GAERC conclusions of the Council, Press Release no. 10369/03, Press 166, 33, 2003.

⁵³⁹ CFSP High Representative, A Secure Europe in a Better World, European Security Strategy 2003.

ka dhe politikat e energjisë, politikat e mjedisit, bujqësisë, zhvillimin e tregut të brendshëm, kërkimin dhe inovacionin, mbështetjen në shëndetësi, edukimin, kulturën dhe natyrisht procesin e zgjerimit të vendeve fqinjë.

Politika Evropiane e Fqinjësisë është përpjekur të japë një kontribut të sajton i cili konsiston në vendosjen e paqes ndërkombëtare nëpërmjet promovimit të demokracisë lokale, bashkëpunimit rajonal dhe përparimit socio-ekonomik. Këta janë elementë, të cilët kontribuojnë në garantimin e një klime sigurie pozitive për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare (Blockmans dhe Wessel, 2011: 73-103). Në dokumentin strategjik të Politikës Evropiane të Fqinjësisë të vitit 2004,⁵⁴⁰

Komisioni Evropian tregon ambicien e tij dhe angazhimin serioz, nëpërmjet përcaktimit të fushave specifike të aktivitetit të kësaj politike përtej dialogut politik. Këto fusha përfshijnë konsolidimin e marrëdhënieve ndërmjet BE dhe fqinjëve të tij në aspektet e politikës së jashtme dhe të sigurisë në çështje të tilla si: parandalimi i konflikteve; menaxhimi i krizave; shkëmbimi i informacionit; trajnimi i përbashkët; dhe pjesëmarrja në operacionet e menaxhimit të krizave të udhëhequr nga BE.⁵⁴¹

5.2.2. Politika Evropiane e Fqinjësisë, një politikë e qeverisur nëpërmjet instrumenteve ligjore të buta (*soft law*)

Politika Evropiane e Fqinjësisë mbron një sërë objektivash që kontribuojnë në vendosjen e paqes dhe stabilitetit, pjesë e këtyre objektivave është edhe zgjidhja e konflikteve. Megjithatë zgjidhja e konflikteve nuk është qëllimi parësor i kësaj politike e

⁵⁴⁰ European Commission, European Neighbourhood Policy Strategy Paper, Communication from the Commission COM (2004) 373 final, 12 May.

⁵⁴¹ Po aty.

cila varet nga marrëveshjet e nënshkruara me vende specifike, për këtë Politika Evropiane e Fqinjësisë është indentifikuar si *soft law*. Para miratimit të Traktatit të Lisbonës, sipas Comellit PEF-ja perceptohej si një politikë e qeverisur nëpërmjet instrumenteve ligjore të buta, (*soft law*) (2014: 267-289).⁵⁴² Kuadri ligjor i Politikës Evropiane të Fqinjësisë është e përqëndruar në Titullin I, të Dispozitave të Përbashkëta, në nenin 8 të Traktatit të Bashkimit Evropian.⁵⁴³ Traktati i Lisbonës nëpërmjet nenit 8 TBE, i dha një status kushtetues marrëdhënieve të Bashkimit Evropian dhe fqinjëve të tij (Hanf, 2011: 2).

Ky është neni i vetëm, i cili rregullon Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe parashikon rolin e PEF në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Neni 8 TBE e ka origjinën në Traktatin Kushtetues për Evropën përkatësisht në nenin I-57, në pjesën e parë, si një Titull më vete i quajtur Bashkimi Evropian dhe fqinjët e tij. Traktati i Lisbonës sanksionoi ndryshime të rëndësishme legjislative dhe institucionale në aspektin e lidhjes së marrëdhënieve më të forta dhe të sigurta me vendet fqinje. Ky Traktat u përpoq të krijonte kompetenca të reja për Bashkimin Evropian në funksion të Politikës Evropiane të Fqinjësisë.

Neni 8/2, TBE parashikon se, Bashkimi Evropian mund të lidhë marrëveshje të veçanta me vendet përkatëse. Këto marrëveshje mund të përmbajnë të drejta dhe detyrime të ndërsjellta, si dhe mundësinë e ndërmarrjes së aktiviteteve të përbashkëta.⁵⁴⁴ Duke iu referuar përmbajtjes së dispozitës, kuptimi i vendeve fqinje nuk është specifikuar qartë në këtë dispozitë, por me vende fqinje i referohemi një kuptimi të gjerë të fjalës duke mos u

⁵⁴² Ky referim është mbështetur edhe nga studiues të tjerë të së drejtës si Cremona (2008), Koutrakos (2011) etj.

⁵⁴³ Neni 8/1, TBE: “Bashkimi Evropian ndërton marrëdhënie të veçanta me vendet fqinje, me qëllim krijimin e një zone begatie e fqinjësie të mirë, të bazuar në vlerat e Bashkimit Evropian dhe të karakterizuara nga marrëdhënie të ngushta dhe paqësore bashkëpunimi”.

⁵⁴⁴ Neni 8/2, TBE.

kufizuar vetëm në kufijtë e BE-së, por dhe në vende të kontinenteve të tjera. Kjo shprehje konkretizon faktin se synimi i Bashkimit Evropian nuk është vetëm të mbrojë territoret e tij apo të zgjidhë konfliktet në këto territore, por themi që është një aktor global sepse marrëveshjet e tij në kuadër të PEF-së nënshkruhen me vende në nevojë në të gjitha anët e globit.

Termi marrëdhënie të veçanta ka parasysh që kjo politikë vihet në jetë përmes planeve dypalëshe të veprimit, të cilët pasqyrojnë nevojat e fqinjët në fjalë dhe interesat e ndërsjellta të atij vendi me Bashkimin Evropian. Politika Evropiane e Fqinjësisë është kryesisht një politikë bilaterale,⁵⁴⁵ ndërmjet BE-së dhe një vendi tjetër me të cilin BE-ja është partner. Politika Evropiane e Fqinjësisë formulohet, gjithashtu edhe nga iniciativa e bashkëpunimi rajonal dhe marrëveshje multilaterale (Thurer dhe Bretschger, 2013: 378).

Shprehja se, Bashkimi Evropian mund të lidhë marrëveshje të veçanta, sipas Hillion përcakton një formulim të detyrueshëm, i cili përfshin detyrimin e Bashkimit Evropian për të zhvilluar një marrëdhënie të tillë (2013:13). Por, shprehja se Bashkimi Evropian mund të lidhë marrëveshje të veçanta, nënkupton faktin që normalisht një marrëveshje e lidhur nga dy palë, percepton jo vetëm angazhimin e njëres palë, por të të dyjave palëve. Në rastin konkret, Bashkimi Evropian nuk mund të avancojë në parandalimin apo zgjidhjen e një konflikti nëse shteti tjetër palë e marrëveshjes nuk e lejon diçka të tillë.

Në kuadër të Politikës Evropiane të Fqinjësisë, Bashkimi Evropian nuk mund të marrë përsipër angazhime, që shkojnë përtej kompetencave të tij. Kështu Politika Evropiane e Fqinjësisë në asnjë mënyrë nuk paracakton zhvillimin e marrëdhënieve

⁵⁴⁵ European Commission. Joint Communication of the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions. Neighborhood at a crossroads: Implementation of the European Neighbourhood Policy in 2013, fq. 17.

ndërmjet Bashkimit Evropian dhe fqinjëve të saj.⁵⁴⁶ Një marrëdhënie zhvillohet vetëm nëse kontribuojnë të dyja palët. Rritja e rolit të Bashkimit Evropian, si aktor ndërkombëtar në zgjidhjen e konflikteve varet nga qëndrueshmëria e këtyre marrëdhënieve dhe kontributit të tij në rastet, kur këto vende janë në konflikt. Politika Evropiane e Fqinjësisë synon të krijojë një kuadër veprimi koherent dhe efikas të Bashkimit Evropian ndaj fqinjëve të saj në Lindje dhe Jug.

Politika Evropiane e Fqinjësisë në mënyrë eksplicite ka për qëllim të promovojë vlerat e BE-së, si një mjet për të përhapur stabilitetin, sigurinë dhe prosperitetin (Tocci, 2007: 7). Gjithashtu, këto vlera nuk janë kusht i domosdoshëm për pjesëmarrjen në PEF (Thurer dhe Bretschger, 2013: 380). Në mënyrë që Politika Evropiane e Fqinjësisë të mbetet relevante për partnerët e saj, të shmangë krizat politike, ekonomike dhe të sigurisë, Bashkimi Evropian vepron me diplomaci nëpërmjet instrumentit të ndërmjetësimit për parandalimin e konflikteve dhe zgjidhjen e tyre.⁵⁴⁷

Në kuadrin e zgjidhjes së konflikteve dhe mosmarrëveshjeve ndërmjet vendeve fqinje, neni 8 TBE thekson krijimin e një zone begatie dhe marrëdhënie të ngushtë paqësore bashkëpunimi. Mbi bazën e këtyre marrëdhënieve të ngushta të fqinjësisë së mirë, shtetet palë të Bashkimit Evropian do të ndihen më të sigurta dhe larg kërcënimit nga terrorizmi dhe konfliktet e dhunshme. Natyra e konfliktit, që ekziston në një nga vendet fqinje të Bashkimit Evropian përcakton dhe metodën, që Bashkimi Evropian duhet të përdorë për ta zgjidhur atë.

⁵⁴⁶ European Commission, Communication from the Commission to the Council and the European Parliament on Strengthening the European Neighbourhood Policy, COM (2006) 726 final, 4 December 2006.

⁵⁴⁷ European Commission. Joint Communication of the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions. Neighborhood at a crossroads: Implementation of the European Neighbourhood Policy in 2013, fq. 17.

5.3.3. Politika Evropiane e Fqinjësisë dhe zgjidhja e konflikteve: mekanizëm efikas?

Një element i rëndësishëm për interpretimin dhe për përcaktimin e efektshmërinë së një politike të tillë për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian, lidhet me vendndodhjen e kësaj dispozite. Neni 8 në Traktatin e Lisbonës bën pjesë në aktet e përbashkëta të Traktatit të Bashkimit Evropian. Ky nen është jashtë dispozitave të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Një ndarje e tillë përcakton, se politika e fqinjësisë nuk duhet të ndikohet nga PJSP. Vendosja e kësaj politike jashtë dispozitave të Traktateve mbi Veprimin e Jashtëm të BE, përcakton se kompetencat e fqinjësisë janë konceptuar, si një politikë me të dyja dimensionet të brendshme dhe të jashtme (Hillion, 2013: 2).

Në vitin 2011 pas kryengritjeve të Pranverës Arabe u vendos në fokus të kësaj politike, promovimi i parimeve demokratike, me qëllim krijimin e një zonë sigurie për parandalimin e konflikteve. Politika Evropiane e Fqinjësisë rregullon marrëdhëniet e BE-së me 16 fqinjët më të afërt lindor dhe jugor të saj. Në Jug me Algjerinë, Egjiptin, Izraelin, Jordaninë, Libanin, Libinë, Marokun, Palestinën, Sirinë dhe Tunizinë. Në Lindje me Armeninë, Azerbajxhanin, Bjellorusinë, Gjeorgjinë, Moldavinë dhe Ukrainën.

Nga këto vende 12 janë aktualisht pjesë e politikës Evropiane të Fqinjësisë nëpërmjet planeve të veprimit (ENP action plans).⁵⁴⁸ Algjeria është duke negociuar një plan veprimi në PEF-së, ndërsa Bjellorusia, Libia dhe Siria mbeten jashtë shumicës së strukturave të PEF-së. Rusia merr pjesë në aktivitetet e bashkëpunimit ndërkufitar në kuadër të PEF-së, por nuk është zyrtarisht pjesë e PEF-së. Rusia është një rast i veçantë, e cila është një fqinje reale e BE-së, në kufijtë e tij.

⁵⁴⁸ Planet e veprimit ndryshe quhen edhe Association Agendas for Eastern Partner Countries.

Llojet e konflikteve, të cilat janë në fokus të trajtimit dhe zgjidhjes nga Bashkimi Evropian në kuadër të Politikës Evropiane të Fqinjësisë janë të shumta. Aktivitetet e PEF-së përfshijnë dy lloj veprimesh; veprimet afatshkurtër dhe veprimet afatmesme. Këto veprime kanë për qëllim, menaxhimin civil dhe ushtarak të krizës; zgjidhjen e konflikteve dhe rehabilitimin; si dhe përpjekjet afatgjata të përshtatura për shtet-ndërtimin, demokratizimin dhe pajtimin shoqëror (Tocci, 2011:2).

Politika Evropiane e Fqinjësisë përfshihet në zgjidhjen e konflikteve atëherë kur vendet partnere të Bashkimit Evropian janë në konflikt apo në situatë krize. Ndryshe, është rasti i PJSP-së dhe PSMP-së, në këto politika Bashkimi Evropian merr pjesë në zgjidhjen e konflikteve, në të cilat BE-ja nuk ka asnjë detyrim apo marrëveshje. Përfshirja e tij për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve është në mbrojtje të vlerave kryesore të tij të parashikuara në nenin 2 TBE. Nëpërmjet pjesëmarrjes, si ndërmjetës apo formave të tjera Bashkimi Evropian ndihmon në krijimin e një rendi paqësor dhe të sigurtë në arenën ndërkombëtare, duke afirmuar rolin e tij si aktor global në zgjidhjen e konflikteve.

Bashkimi Evropian ka treguar një rol aktiv dhe të rëndësishëm në kontributin e tij për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, pasi shumë nga shtetet fqinje të BE-së, pjesë të PEF-së janë në konflikt. Mjafton të përmendim krizën në Gjeorgji dhe konfliktin në Ukrainë, vendet në fqinjësinë Jugore, si konflikti në Siri, kriza në Egjipt, konflikti i vazhdueshëm në Libi, Gaza etj.⁵⁴⁹ Në këto raste, Bashkimi Evropian nëpërmjet PEF-së ka mbështetur partnerët e tij, që të ndërmarrin reforma në drejtim të demokracisë, shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut, zhvillimit ekonomik etj.

⁵⁴⁹ European Commission. Joint Communication of the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions. Neighborhood at a crossroads: Implementation of the European Neighbourhood Policy in 2013, fq. 3.

Pikërisht, karakteri dy dimensional i brendshëm dhe i jashtëm i kësaj politike redukton kapacitetin e Politikës Evropiane të Fqinjësisë për tu konsideruar si një mekanizëm efikas për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Pasi zgjidhja e konflikteve është vetëm njëra nga fushat e veprimtarisë së kësaj politike. Karakteri i saj gjithëpërfshirës bën që të largohet nga zgjidhja e konflikteve ndërmjet vendeve fqinjë. Por, arsyeja nëse kjo zhvendosje është e rastësishme në hartimin e Traktatit të Lisbonës, apo një zgjedhje e qëllimshme mbetet e diskutueshme (Hillion, 2013:2). Karakteri gjithëpërfshirës i Politikës Evropiane të Fqinjësisë mund të jenë një nga arsyet, që është lënë jashtë PJSP-së dhe është rregulluar në një dispozitë të veçantë në dispozitat e përbashkëta të Traktatit të Bashkimit Evropian.

Benita Ferrero Waldner, ish-Komisionere e marrëdhënieve me jashtë, ka vërejtur se Politika Evropiane e Fqinjësisë është një mekanizëm për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Kjo politikë përqendrohet në një kontribut më të drejtpërdrejtë për stabilitet në fqinjët e Bashkimit Evropian (Waldner, 2006), (Blockmans dhe Wessel, 2011: 73-103). Përqendrimi i stabilitetit është termi, i cili përfshin aspektin e zgjidhjes së konflikteve, gatishmërinë dhe mundësinë e Bashkimit Evropian për të qenë i rëndësishëm dhe për të ofruar zgjidhje efektive.

Politika Evropiane e Fqinjësisë pavarësisht ekzistencës së një sërë problematikash strukturore, procedurale dhe ligjore përpiket të luajë një rol dhe të kontribuojë në stabilitetin e vendeve në nevojë. Politika Evropiane e Fqinjësisë ka shërbyer në një sërë rastesh për zgjidhjen e konflikteve, megjithatë ka dyshime për perceptimin e kësaj politike si një mekanizëm efikas i Bashkimit Evropian për rritjen e rolin të tij si një aktor global në arenën ndërkombëtare.

KREU VI. EFEKTIVITETI I BASHKIMIT EVROPIAN NË ZGJIDHJEN E KONFLIKTEVE NDËRKOMBËTARE

6.1. Bashkëpunimi ndërmjet Bashkimit Evropian dhe NATO-s në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare

Bashkimi Evropian bashkëpunon ngushtë me NATO-n për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Në sajë të këtij bashkëpunimi Bashkimi Evropian ka rritur rolin e tij si një aktor efektiv në arenën ndërkombëtare që ndërmerr misione civile dhe operacione ushtarake të suksesshme. Një bashkëpunim i tillë ekziston, që në kohën e themelimit të Komunitetit Evropian. Fillimisht, bashkëpunimi i tyre realizohej në kuadër të Bashkëpunimit Evropian Perëndimor, më pas nëpërmjet Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët.

Në kohën e krijimit të Politikës Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes ekzistonte frika e një zëvendësimi të mundshëm të fuqisë së sigurisë nga ajo e NATO-s në Politikën Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Kështu, Shtetet Anëtare pranuan PESM-në me kushtin, që Bashkimi Evropian të shmangte tre elementë të quajtura “3 D-të”,⁵⁵⁰ jo shpërbërjes (nga NATO në PESM), jo dyfishimit (të aftësive), jo diskriminimit (kundër Shteteve Anëtare jo anëtare në NATO), (Bindi, 2009: 36).

Tre D-të garantonin përparësinë e NATO-s ndaj Bashkimit Evropian, duke ju dhënë gjithashtu atyre më shumë përgjegjësi në zgjidhjen e konflikteve (Buharalı, 2010). Kuadri i përgjithshëm për marrëdhëniet e përhershme të Bashkimit Evropian dhe NATO-s u

⁵⁵⁰ Sekretarja e shtetit të SHBA-së, Madeleine Albright në 1999 përcaktoi “3D”, ato ishin: *Duplicate, Decouple, Discriminate*.

nënshkruan nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Përfaqësuesi i Lartë në mars të vitit 2003,⁵⁵¹ me nënshkrimin e marrëveshjes të quajtur “Berlin Plus”.⁵⁵²

Marrëveshja Berlin Plus përfshin tre elementë kryesorë për zhvillimin e operacioneve, *së pari*, aksesin e Bashkimit Evropian në planifikimin e NATO-s, *së dyti*, mundësinë për zotërimin e komandës evropiane dhe *së treti* përdorimin e aseteve dhe kapaciteteve të NATO-s.⁵⁵³ Objekti i studimit për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian si aktor i rëndësishëm global përforcohet nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me NATO-n, sepse në këtë marrëveshje Bashkimi Evropian udhëheq operacione ushtarake⁵⁵⁴ dhe misione civile duke përdorur kapacitetet apo burimet e NATO-s.

Në këtë marrëveshje përfshihet detyrimi i konsultimit efektiv,⁵⁵⁵ bashkëpunimi për shkëmbimin e dokumenteve të klasifikuara dhe informacioneve të sigurt.⁵⁵⁶ Marrëveshja Berlin Plus lehtësoi nisjen e operacionit të parë ushtarak të Bashkimit Evropian në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, operacioni *Concordia*, në vitin 2003.⁵⁵⁷ Ndërsa operacioni i dytë që u nis në kuadrin e kësaj marrëveshjeve ishte misioni *Althea* në 2004 në

⁵⁵¹ NATO-EU: Framework for Permanent Relations and ‘Berlin Plus’, 2003, paragrafi 1.

⁵⁵² Berlin Plus Arrangements 2003.

⁵⁵³ NATO-EU: Framework for Permanent Relations and ‘Berlin Plus’, 2003, shih citimin origjinal të paragrafit 5, sipas të cilit: *These arrangements cover three main elements that are directly connected to operations and which can be combined: EU access to NATO planning, NATO European command options and use of NATO assets and capabilities.*

⁵⁵⁴ NATO Parliamentary Assembly's (DSC 166 TC 07 E, 2007), Cooperation Between the EU and NATO.

⁵⁵⁵ NATO-EU: Framework for Permanent Relations and ‘Berlin Plus’, 2003, shih citimin origjinal të paragrafit 3, sipas të cilit: *For this purpose, the EU and NATO agreed on mutual crisis consultation arrangements that are geared towards an efficient and rapid decision-making in each organisation in the presence of a crisis.*

⁵⁵⁶ NATO-EU: Framework for Permanent Relations and ‘Berlin Plus’, 2003, shih citimin origjinal të paragrafit 4, sipas të cilit: *In order to foster these consultations by guaranteeing a secure physical environment and enabling the exchange of classified documents and information, the EU and NATO concluded an agreement on the security of information.*

⁵⁵⁷ Vendim i Këshillit 2003/202/PJSP i 18 mars 2003 në lidhje me nisjen e operacionit ushtarak të BE-së në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (*Council Decision 2003/202/CFSP*).

Bosnjë dhe Hercegovinë, që ende po përdor marrëveshjen Berlin Plus.⁵⁵⁸ Operacioni *Althea* në Bosnje-Hercegovinë është operacioni më i madh i ndërmarrë nga Bashkimi Evropian, që vepron në kuadër të marrëveshjes Berlin Plus.

Qëllimi i këtij misioni ishte zgjidhja e konfliktit, stabilitetit dhe mbështetjes në trajnimin e forcave të armatosura në Bosnje-Hercegovinë. Marrëveshja e Dejtonit dhe Rezoluta 1575 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së përbënte bazën ligjore të këtij operacioni (Naert, 2012: 127), ndërsa baza ligjore e BE-së në përputhje me këto dy dokumente ishte një Veprim i Përbashkët i Këshillit.⁵⁵⁹ Ky kuadër ligjor u shoqërua më pas me vendimin e NATO-s për të përfunduar operacionin e saj *SFOR* dhe Rezolutën 1575 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.⁵⁶⁰

Operacioni *Althea* i BE-së është ende në fuqi pas riorganizimeve të herë pas herëshme⁵⁶¹ dhe aktualisht vazhdon të veprojë nën një mandat të OKB-së në bazë të Rezolutës 2074 të vitit 2012 të Këshillit të Sigurimit nën Kapitullin VII të Kartës së OKB-së. Në këtë rezolutë është trajtuar bashkëpunimi i BE-së me NATO-n dhe specifikohet operacioni *Althea* si një pasardhësi ligjor i *SFOR-it* nën komandën dhe kontrollin e unifikuar të NATO-s.⁵⁶² Shumë zyrtarë evropianë theksojnë, se PSMP-ja nuk ka për qëllim të rivalizojë ose konkurrojë NATO-n, por është menduar të jetë një alternativë plotësuese.

⁵⁵⁸ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2004/569/PJSP i 12 korrik 2004 mbi mandatin e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian në Bosnje-Hercegovinë dhe shfuqizimi i Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2002/211/PJSP (*Council Joint Action 2004/569/CFSP*).

⁵⁵⁹ Veprim i Përbashkët i Këshillit 2004/570/PJSP i 12 korrik 2004 për operacionin ushtarak të Bashkimit Evropian në Bosnje dhe Hercegovinë (*Council Joint Action 2004/570/CFSP*).

⁵⁶⁰ Security Council Resolution 1575 (2004) Bosnia and Herzegovina.

⁵⁶¹ Security Council Resolution 2074 (2012) Bosnia and Herzegovina.; Security Council Resolution 2019 (2011) Bosnia and Herzegovina.; Security Council Resolution 1948 (2010) Bosnia and Herzegovina.; Security Council Resolution 1895 (2009) Bosnia and Herzegovina.

⁵⁶² Security Council Resolution 2074 (2012) Bosnia and Herzegovina, shih citimin origjinal të paragrafit 10, sipas të cilit: *...EUFOR ALTHEA) as a legal successor to SFOR under unified command and control, which will fulfil its missions ... in cooperation with the NATO Headquarters presence in accordance with the arrangements agreed between NATO and the EU...*

Pikërisht për këtë Traktati i Lisbonës konfirmon rolin parësor të NATO-s në mbrojtje të ndërsjelltë të anëtarëve të tij (Vooren dhe Wessel, 2014: 403-404). Ekzistenca e Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët i jep BE-së aftësinë për të vepruar, në raste ku ndërhyrja e Bashkimit Evropian mund të jetë më e përshtatshme apo më e efektshme. Gjithashtu, Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët është menduar të jetë një alternativë, në rastet kur NATO ose Kombet e Bashkuara zgjedhin të mos jenë të përfshira në konflikt (Mix, 2013: 5).

Roli qëndror i NATO-s në aspektin mbrojtës dhe të sigurisë është përcaktuar në nenin 42 të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe në Protokollin Nr. 11, “Për nenin 42 të Traktatit të Bashkimit Evropian të Lisbonës”. Në rendin juridik të BE-së është parashikuar se Bashkimi Evropian ndërmerr misione dhe operacione ushtarake në përputhje me veprimet dhe angazhimet e NATO-s.⁵⁶³ Në dispozitat e TBE-së theksohet se NATO mbetet “themeli” i mbrojtjes kolektive të Shteteve Anëtare.⁵⁶⁴ Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët vepron pa cënuar detyrimet e Shteteve Anëtare të cilat preferojnë që mbrojtjen e tyre kombëtare ta shohin të realizuar në kuadrin e NATO-s.⁵⁶⁵

Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet dy organizatave për përdorimin e kapaciteteve të NATO-s, në rastet e ndihmës reciproke ndërmjet Shteteve Anëtare parashikohet në përputhje me klauzolën e ndihmës së ndërsjelltë. Kjo politikë nuk kuptohet si një shndërrim i Bashkimit Evropian në një aleancë ushtarake, sepse detyrimi është vetëm për të dhënë

⁵⁶³ Neni 42/7, TBE: “angazhimet dhe bashkëpunimi në këtë fushë duhet të pajtohen me angazhimet, që rrjedhin nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, e cila, për ato Shtete që janë Anëtare të saj mbetet baza e mbrojtjes së përbashkët të tyre dhe forumi për zbatimin e saj”.

⁵⁶⁴ Neni 42/7, TBE.

⁵⁶⁵ Neni 42/2, TBE: “Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët të Bashkimit Evropian i respekton detyrimet e Shteteve të caktuara Anëtare, të cilat mbrojtjen e tyre të përbashkët e shohin të realizuar nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut”.

ndihmë dhe asistencë dhe jo për t'u bashkuar në luftë kolektive kundër agresorit (Chalmers, Davies dhe Monti, 2010: 670). Politika e Bashkimit Evropian, nuk e cënon karakterin e veçantë të politikës për sigurimin dhe mbrojtjen, që kanë Shtete të caktuara Anëtare. Kjo do të thotë, se veprimet dhe vendimet, që ata ndërmarrin në kuadër të menaxhimit të krizës ushtarake të BE-së do të respektojnë në çdo kohë të gjitha detyrimet e tyre, si aleatë të NATO-s.⁵⁶⁶ Një qëndrim i tillë është shprehur, që në dispozitat e Traktatit të Maastrichtit, e shpjeguar në kapitullin e dytë të këtij studimi.

Marrëdhënia ndërmjet BE-së dhe NATO-s ka rezultuar e suksesshme dhe bashkëpunuese, p.sh, në rastin e Bosnjës, NATO i ka dhënë Bashkimit Evropian komandën e trupave të saj paqeruajtëse. Megjithatë, organizatat kanë 21 vende anëtare të përbashkëta, por ato vazhdojnë të ketë vështirësi në krijimin e një marrëdhënie më bashkëpunuese dhe të koordinuar të punës (Mix, 2013: 23). Këto përçarje mund të evidentohen lehtësisht në konfliktin e *Darfurit* në Bashkimin Afrikan, ku rivaliteti ndërmjet dy organizatave ka treguar se mund të dëmtojë realisht efektivitetin e të dy institucioneve dhe solidaritetin ndërmjet aleatëve⁵⁶⁷ (Shimkus, 2007).

Rast tjetër përplasjeje ka qënë edhe misioni *Artemis*, në këtë mision BE-ja nuk është konsultuar me NATO-n para nisjes së saj.⁵⁶⁸ Mosmarrëveshjet ndërmjet Turqisë (një anëtar i NATO-s, por jo i BE-së) dhe Qipros (një anëtar i BE-së, por jo i NATO-s), janë

⁵⁶⁶ Protokoli Nr. 11, "Për nenin 42 të Traktatit të Bashkimit Evropian".

⁵⁶⁷ Reporter John Shimkus (SHBA) 2007, 166 DSCTC 07 E BIS - NATO-EU Operational Cooperation, shih citimin origjinal të paragrafit 3, sipas të cilit: *...the turf battle over assisting the African Union in Darfur suggested that rivalry could erode the effectiveness of both institutions, while potentially undermining Allied solidarity.*

⁵⁶⁸ Reporter John Shimkus (SHBA) 2007, 166 DSCTC 07 E BIS - NATO-EU Operational Cooperation, shih citimin origjinal të paragrafit 14, sipas të cilit: *Artemis also highlighted another point of operational friction between the two organizations: while the EU informed NATO of its intentions during Artemis, it apparently did not consult NATO prior to its launching.*

përmendur shpesh si një pengesë kryesore për bashkëpunim dhe shkëmbim i informacionit (Mix, 2013: 24). Gjithsesi pavarësisht mosmarrëveshjeve marrëdhënia ndërmjet organizatave është e qëndrueshme.

Gjithashtu Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë rënë dakord, që të ketë konsultime të përhershme dhe të vazhdueshme me aleatët jo-evropianë të Bashkimit Evropian, që mbulojnë gamën e plotë të çështjeve të sigurisë, mbrojtjes dhe menaxhimit të krizës. Në rastin e një operacioni të udhëhequr nga Bashkimi Evropian, që përdor asetet dhe aftësitë e NATO-s, aleatët jo-evropianë të Bashkimit Evropian, nëse dëshirojnë mund të bëhen pjesë e operacionit.

Aleatët jo-evropianë do të përfshihen në planifikimin dhe përgatitjen e operacionit në përputhje me procedurat e parashikuara në kuadër të NATO-s. Në rast të ndonjë operacioni të udhëhequr nga Bashkimi Evropian, aleatët jo-evropianë të Bashkimit Evropian mund të ftohen të marrin pjesë me një vendim të Këshillit. Në fakt, një marrëveshje kuadër përcakton kushtet e pjesëmarrjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në operacionet e menaxhimit të krizave të Bashkimit Evropian.⁵⁶⁹

6.2. Marrëdhënia e ngushtë ndërmjet BE-së dhe OKB-së për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare në kuadër të sistemit të sigurisë kolektive të OKB-së

Bashkëpunimi i ngushtë i Bashkimit Evropian me organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kolektive është elementi kryesor që konfirmon tezën e këtij studimi. Bashkëpunimi me OKB-në dhe NATO-n vërteton se

⁵⁶⁹ Vendim i Këshillit 2011/318/PJSP i 31 marsit 2011 për nënshkrimin dhe përfundimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në operacionet e menaxhimit të krizave të Bashkimit Evropian (*Council Decision 2011/318/CFSP*).

Bashkimi Evropian është një aktor efektiv i të drejtës ndërkombëtare për zgjidhjen e konflikteve, menaxhimin e krizave dhe garantimin e sigurisë në arenën ndërkombëtare.

Bashkimi Evropian dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara janë partnerë të natyrshëm.⁵⁷⁰ Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, konflikteve, krizave, menaxhimi i krizave dhe parandalimi i konflikteve, janë qëllime të përbashkëta të të dyja organizatave. Ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara ekziston një bashkëpunim i ngushtë sepse ndajnë të njëjtat vlera dhe qëllime për sigurimin e rendit ndërkombëtar. Bashkëpunimi i tyre bazohet në respektimin e vlerave thelbësore të paraqitura në Kartën e vitit 1945 të Kombeve të Bashkuara dhe nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut të vitit 1948. Për këtë arsye, Traktatet e Bashkimit Evropian i referohen zbatimit të parimeve që mbrojnë e drejta ndërkombëtare publike në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare.

Organizata e Kombeve të Bashkuara ka përparësi ndaj çdo organizate tjetër në ruajtjen e paqes, sigurisë ndërkombëtare dhe zgjidhjes së konflikteve ndërkombëtare. Për këtë arsye Bashkimi Evropian njihet përgjegjësinë kryesore të OKB-së dhe përparësinë e saj në një numër shumë të gjerë të dispozitave. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara është organi kryesor për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.⁵⁷¹ Ky rol parashikohet në katër kapituj të Kartës së OKB-së. Përkatësisht në kapitullin për “Zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve”, “Masa në rast kërcënimi apo shkeljeje të paqes si dhe në rast veprimesh agresive”, “Marrëveshjet rajonale” dhe “Sistemi ndërkombëtar i

⁵⁷⁰ United Nation, The partnership between the UN and the EU, The United Nations and the European Commission working together in Development and Humanitarian Cooperation, 2006, paragrafi 6.

⁵⁷¹ Neni 24/1, të Kartës së OKB-së: “Për të garantuar një veprim të shpejtë dhe të efektshëm të Kombeve të Bashkuara anëtarët e tyre ia kalojnë Këshillit të Sigurimit përgjegjësinë kryesore për ruajtjen e paqes botërore dhe të sigurisë ndërkombëtare si dhe njohin faktin, që Këshilli i Sigurimit gjatë realizimit të detyrimeve, që rrjedhin nga kjo përgjegjësi, vepron në emrin e Kombeve të Bashkuara”.

kujdestarisë”.⁵⁷² Në menaxhimin e krizave, legjitimiteti ndërkombëtar është i garantuar në mënyrë të veçantë nga dispozitat e sistemit të sigurisë kolektive të OKB-së, nga shtetet ose nga organizatat ndërkombëtare këtu mund të përfshijmë edhe BE-në (Paladini, 2009: 11).

Bashkimi Evropian vepron si një organizatë rajonale⁵⁷³ në përputhje dhe duke zbatuar objektivat e OKB-së,⁵⁷⁴ si qendra e sistemit ndërkombëtar.⁵⁷⁵ Koncept ky që bazohet në bashkëpunimin shumëpalësh ndërmjet OKB-së dhe organizatave rajonale si pjesë e multilaterizmit efektiv,⁵⁷⁶ që në vetvete është lajmotivi i Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët (Biscop dhe Drieskens, 2006: 278).

7.2.1. Përparësia e Kartës së Kombeve të Bashkuara në rendin juridik të Bashkimit Evropian

Traktati i Lisbonës rriti numrin e referencave në TBE për rolin e Bashkimit Evropian në botë dhe në marrëdhënien e tij me Kombet e Bashkuara (Jorgensen dhe Wessel, 2011: 262). Bashkëpunimi ndërmjet BE-së dhe Kombeve të Bashkuara legjitimohet në Deklaratën Nr. 14, Protokollin Nr. 10 dhe një sërë dispozitash të TBE dhe TFBE. Kjo marrëdhënie e ngushtë ndërmjet BE-së dhe OKB-së është cituar të paktën 19

⁵⁷² Neni 24/2, të Kartës së OKB-së: “Gjatë përmbushjes së këtyre detyrimeve Këshilli i Sigurimit vepron në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara. Kompetencat, që atij i njihen në këtë kontekst, sqarohen në kapitujt VI, VII, VIII dhe XII”.

⁵⁷³ Neni 52/1, Karta e Kombeve të Bashkuara: “Kjo Kartë nuk e përjashton ekzistencën e marrëveshjeve rajonale për trajtimin e atyre çështjeve, që kanë të bëjnë me ruajtjen e paqes botërore dhe të sigurisë ndërkombëtare, në kuadër të të cilave merren masa të natyrës rajonale; kusht paraprak për këtë është, që këto marrëveshje ose institucione dhe efekti i tyre të përputhen me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.”

⁵⁷⁴ Report on the Implementation of the European Security Strategy - Providing Security in a Changing World, Brussels European council, 11-12 December 2008, in particular point C, paragrafi 11, shih citimi original të raportit, sipas të cilit: *everything the EU has done in the field of security has been linked to UN objectives*.

⁵⁷⁵ Summary of remarks to the press by Javier SOLANA, EU High Representative for the CFSP, at a joint press briefing with UN Secretary-General BAN KI-MOON, Brussels, 24 January 2007.

⁵⁷⁶ Communication from the Commission to the Council and the European Parliament, The European Union and the United Nations: The choice of Multilateralism, COM (2003) 526 final.

herë (Blockmans dhe Wessel, 2011: 77), nëpër Traktate, Protokolle dhe Deklarata të Bashkimit Evropian. BE-ja në zgjidhjen e konflikteve i referohet Kartës së OKB-së, parimeve të OKB-së dhe veprimtarisë së Këshillit të Sigurimit.

Sipas nenit 3/5, nenit 42/1, TBE, Bashkimi Evropian mund të përdorë mjetet civile dhe ushtarake për misionet jashtë BE-së, për ruajtjen e paqes, për parandalimin e konflikteve dhe fuqizimin e sigurisë ndërkombëtare, *në përputhje me parimet* e Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Realizimi i këtyre detyrave bëhet duke përdorur kapacitetet e siguruara nga Shtetet Anëtare.⁵⁷⁷ E njëjta frymë bashkëpunimi dhe respektimi ndaj parimeve të Kartës së OKB-së për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve vërehet edhe në nenin 21 TBE. Në këtë mënyrë, Karta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë janë paraqitur, si korniza ligjore udhëzuese për BE-në në marrëdhëniet e saj të jashtme (Blockmans dhe Wessel, 2011: 77).

Fakt është gjithashtu referimi dhe përfshirja e OKB-së në një pjesë të konsiderueshme të veprimit të jashtëm të BE-së dhe në çështjet që lidhen me zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Megjithëse ka patur raste kur GJED-ja ka hedhur poshtë zbatimin e Rezolutave të Këshillit të Sigurimit, në çështjen *Kadi*,⁵⁷⁸ neni 34/2 i TBE-së parashikon mbrojtjen e interesave të Bashkimit Evropian në frymën e parimeve të OKB-së.⁵⁷⁹ Kështu, Shtetet Anëtare, të Bashkimit Evropian njëkohësisht anëtare në OKB, gjatë trajtimit të çështjeve që rrezikojnë sigurinë globale dhe që kanë të bëjnë me zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare, duhet të kenë parasysh: *së pari*, mbrojtjen e interesave të

⁵⁷⁷ Neni 42/10, TBE.

⁵⁷⁸ Shih: Kreun IV, 4.6. “Raporti i të drejtës së Bashkimit Evropian me të drejtën ndërkombëtare publike” të këtij studimi.

⁵⁷⁹ Neni 34/2, TBE: “Shtetet Anëtare, të cilat janë anëtare të Këshillit të Sigurimit gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre mbrojnë qëndrimet dhe interesat e Bashkimit Evropian pa cënuar përgjegjësitë, që u ngarkojnë dispozitat e Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara”.

përgjithshme të BE; *së dyti*, veprimin në përputhje me të drejtën ndërkombëtare publike; dhe *së treti*, respektimin e parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Bashkimi Evropian ka statusin e një vëzhguesi të përhershëm⁵⁸⁰ në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, që prej vitit 1974, dhe pas vitit 2011, Bashkimi Evropian zotëron të drejta të zgjeruara pjesëmarrjeje. Mirëpo, edhe pse Bashkimi Evropian, si organizatë nuk ka të drejtën e votës dhe as të drejtën për t'u ulur në Këshillin e Sigurimit, rëndësia e tij në vendimmarrje është e madhe. Bashkimi Evropian përfaqësohet në Organizatën e Kombeve të Bashkuara nga 28 Shtetet e tij Anëtare (në cilësinë e tyre individuale).

Dy prej Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar, janë anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit, nga pesë anëtarët e përhershëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara së bashku me SHBA-në, Kinën dhe Rusinë. Në bazë të këtij argumenti përforcojmë rolin e Bashkimit Evropian, si aktor global në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Gjithashtu, Bashkimit Evropian i është dhënë një vend i privilegjuar në paraqitjen për shqyrtimin dhe diskutimin e marrëveshjeve ndërmjet vëzhguesve të tjerë (Emerson, Balfour, Corthaut, Wouters, Kaczynski dhe Renard, 2011: 65).

Bashkimi Evropian shihet si një partner i dobishëm nga OKB-ja dhe një organizatë rajonale nëpërmjet kontributit të tij në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare në kuadër të zbatimit të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit⁵⁸¹ (Graham, 2008: 6). Organizata e Kombeve të Bashkuara mund të kërkojë mbështetjen e Bashkimit Evropian për realizimin e

⁵⁸⁰ Sipas nenit 4 të Kartës së KB anëtarësimi i rezervohet vetëm Shteteve.

⁵⁸¹ Neni 53/1, i Kartës së OKB: "Pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit nuk mund të merren masa detyruese parashikuar në marrëveshje rajonale apo nga ana e institucioneve rajonale".

ngutshëm të misioneve të ndërmarra sipas Kartës së OKB-së.⁵⁸² Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, anëtare gjithashtu edhe në Këshillin e Sigurimit, kanë si prioritet kryesor interesat e Bashkimit Evropian.⁵⁸³

Për shkak të zhvillimit të politikës të sigurisë dhe të mbrojtjes, Bashkimi Evropian u bë një partner tërheqës për Organizatën e Kombeve të Bashkuara në fushën e menaxhimit të krizës (Norberto, 2012). OKB-ja e njëj kontributin e konsiderueshëm në burime njerëzore dhe materiale të Bashkimit Evropian, në menaxhimin e krizave, si një ofrues potencial i drejtpërdrejtë, i aftësive civile dhe ushtarake për ndërtimin e paqes.⁵⁸⁴ Në Deklaratën e Përbashkët⁵⁸⁵ ndërmjet OKB-së dhe BE-së për “Bashkëpunimin në Menaxhimin e Krizave” në vitin 2004,⁵⁸⁶ u nënvizua se Strategjia e Sigurisë Evropiane vlerësonte rëndësinë e OKB-së në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe qëllimin primar të Këshillit të Sigurimit për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Mbi bazën e kësaj u citua, se përmbushja e përgjegjësisë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për të vepruar në mënyrë efektive në zgjidhjen e konflikteve, përbën një prej prioriteve kryesore të Bashkimit Evropian.⁵⁸⁷ Këto objektiva u përforcuan përsëri në një Deklaratë të Përbashkët ndërmjet KB-së dhe BE-së për “Bashkëpunimin në

⁵⁸² Protokolli Nr. 10, për Bashkëpunimin e Përhershëm të Strukturuar, krijuar me Nenin 42, të Traktatit të Bashkimit Evropian: “Kreut VI, Zgjidhja Paqësore e Konflikteve dhe Kreut VII, Masat në rast kërcënimi ose thyerje të paqes si dhe në rast sulmesh”.

⁵⁸³ Neni 34, TBE: “Shtetet Anëtare, të cilat janë dhe anëtare të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, bashkëpunojnë dhe i mbajnë Shtetet e tjera Anëtare dhe Përfaqësuesin e Lartë tërësisht të informuar...”.

⁵⁸⁴ Joint Statement on UN-EU Cooperation in Crisis Management. Council of the European Union, 2007, Brussels.

⁵⁸⁵ Deklarata e përbashkët nuk është një marrëveshje ndërkombëtare, ajo paraqet një strukturë informale dhe nuk paraqet një dokument me natyrë juridike, që krijon të drejta dhe detyrime por një instrument “soft law”

⁵⁸⁶ EU-UN co-operation in Military Crisis Management Operations, Elements of Implementation of the EU-UN Joint Declaration adopted by the European Council, 2004.

⁵⁸⁷ Po aty.

Menaxhimin e Krizave” në qershor të 2007.⁵⁸⁸ Këto objektiva janë të njëjtat edhe pas miratimit të Traktatit të Lisbonës.

Deklarata Nr. 13, në lidhje me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, thekson se dispozitat e Kartës së OKB-së dhe veprimtaria e Këshillit të Sigurimit me qëllim garantimin e sigurisë ndërkombëtare, janë të *detyrueshme* për Bashkimin Evropian.⁵⁸⁹ Termi i detyrueshëm, i përdorur në këtë Deklaratë detyron Bashkimin Evropian për respektimin e rezolutave të Këshillit të Sigurimit.⁵⁹⁰ Në kuadër të sigurisë kolektive dhe marrëdhënieve bashkëpunuese me OKB-në, Bashkimi Evropian sanksionon si pjesë të rendit të tij juridik dhënien e ndihmës për zgjidhjen e konflikteve sa herë që kërkohet e nevojshme.

Serioziteti i Bashkimit Evropian në kontributin për përmirësimin e sistemit demokratik dhe përmirësimin e jetesës është përcaktuar në një sërë politikash, aktesh dhe strategjish për veprim të jashtëm. Roli i Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare është rritur nëpërmjet kontributit në aspektin e dhënies së ndihmave humanitare, garantimin e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës, vendosjen e demokracisë dhe zgjidhjen e konflikteve. Përgjegjësia e Bashkimit Evropian e parashikuar në dispozitat e TBE dhe TFBE është zgjidhja e konflikteve dhe përdorimi i mjeteve për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve në kuadër të nenit 33, të Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

⁵⁸⁸ Joint Statement on UN-EU Cooperation in Crisis Management. Council of the European Union, 2007, Brussels.

⁵⁸⁹ Deklarata Nr. 13, në lidhje me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët: “Konferenca thekson se dispozitat e Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe, në veçanti, përgjegjësia parësore e Këshillit të Sigurimit dhe të Anëtarëve të tij për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare vazhdojnë të jenë të detyrueshme për Bashkimin Evropian dhe Shtetet e tij Anëtare”.

⁵⁹⁰ Protokollin Nr. 10, për Bashkëpunimin e Përhershëm të Strukturuar, krijuar me Nenin 42, të Traktatit të Bashkimit Evropian, mban të njëjtin qëndrim, si Deklarata Nr. 13.

Kjo përfshin edhe rastet kur në konflikt janë vende jo anëtare të BE-së, raste që veprojnë në bazë të Politikës Evropiane të Fqinjësisë dhe rastet e konflikteve ndërkombëtare, me të cilat BE-ja nuk ka marrëveshje. Përveç nenit 33 të Kartës së OKB-së, rëndësi merr neni 51 i Kartës së OKB-së në forcimin e sigurisë kolektive, sepse në rastet kur një Shtet Anëtar ose jo është viktimë e një agresioni të armatosur, Shtetet Anëtare kanë *detyrimin*⁵⁹¹ ta ndihmojnë dhe ta mbështesin në përputhje me nenin 51 të Kartës së OKB-së.⁵⁹²

Përsëri bëhet i detyrueshëm angazhimi i Shteteve Anëtare në zgjidhjen e konflikteve, por në përputhje me dispozitat e Kartës së OKB-së, përveç politikave të Bashkimit Evropian në fushën e zgjidhjes së konflikteve. Tradicionalisht, Bashkimi Evropian ka luajtur një rol të rëndësishëm në OKB. Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian janë përpjekur gjithnjë për të koordinuar përpjekjet e tyre me ato të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (Wouters dhe Ruys, 2005: 20).

6.2.2. Misionet civile dhe ushtarake të Bashkimit Evropian në sistemin e sigurisë kolektive të OKB

Bashkimi Evropian ka përfituar përvojën e zgjidhjes së konflikteve dhe menaxhimit të krizave nga sistemi i OKB-së për ruajtjen e paqes.⁵⁹³ Sipas një pakice të doktrinës,

⁵⁹¹ Neni 42/7, TBE.

⁵⁹² Neni 51 Karta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara: “Në rast të një sulmi të armatosur kundër një anëtar të Kombeve të Bashkuara, kjo Kartë nuk bie absolutisht ndesh me të drejtën natyrore të vetëmbrojtjes individuale apo kolektive, deri sa Këshilli i Sigurimit të ketë marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e paqes botërore dhe të sigurisë ndërkombëtare. Masat, që një anëtar merr gjatë ushtrimit të së drejtës së tij për vetëmbrojtje, i duhen bërë menjëherë të ditura Këshillit të Sigurimit; ato nuk prekin asesi plotfuqinë dhe detyrimin e këtij Këshilli, që burojnë nga kjo Kartë, për të marrë në çdo moment masat, që ai i konsideron të domosdoshme për ruajtjen ose rivendosjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare”.

⁵⁹³ Për misionet e përbashkëta në vazhdim ndërmjet BE dhe OKB shih: European Parliament, EU-UN co-operation in maintaining peace and crisis management, November 2015, fq. 9.

përfshirja e Shteteve Anëtare në zgjidhjen e konflikteve është një përgjegjësi kombëtare e këtyre shteteve si personazhe kryesore (Paladini, 2009: 18). Ndërkohë që roli i Bashkimit Evropian kufizohet vetëm në koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet Shteteve Anëtare dhe ndërmjet BE-së dhe OKB-së (Tsagourias, 2007: 115).

Në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet OKB-së dhe BE-së shumica e misionëve civile dhe operacioneve ushtarake të dërguara nga PSMP-ja të Bashkimit Evropian janë zhvilluar në përputhje me kërkesa të dërguara nga OKB-ja. Në këto raste Këshilli i Sigurimit miraton një Rezolutë lidhur me një konflikt apo një krizë duke vendos për këtë çështje dhe njëkohësisht asiston misionin e BE-së nëpërmjet inkurajimit të tij, mbështetjes dhe raportimit të rezultateve të arritura. Në bashkëpunimin ndërmjet BE-KB për menaxhimin e operacioneve ushtarake,⁵⁹⁴ u përcaktuan dy modele kryesore në të cilat BE-ja mund të niste një operacion ushtarak nën mandatin e OKB-së.

Modeli i parë quhet *bridging model*, BE-ja ndërhyr për një periudhë të shkurtër për të arritur një qëllim të caktuar, në mënyrë që t'i jepet kohë OKB-së të fillojë një operacion të ri ose të riorganizojë atë ekzistues (Pirozzi, 2010: 8). Modeli i dytë quhet *stand-by model*, i cili mundëson që BE-ja të ofrojë mbështetje për një operacion të OKB-së (Pirozzi, 2010: 8), (Paladini, 2009: 18). Kështu, dërgimi i një kërkesë nga Këshilli i Sigurimit rregullohet në dy mënyra, në rastin e parë një operacioni ushtarak apo civil i nisur nga BE-së vepron nën mandatin e OKB-së, p.sh, si operacioni ushtarak Althea në Bosnjë.⁵⁹⁵

⁵⁹⁴ EU-UN co-operation in Military Crisis Management Operations, Elements of Implementation of the EU-UN Joint Declaration adopted by the European Council, 2004.

⁵⁹⁵ Security Council Resolution 1551 (2004) Bosnia and Herzegovina.; Security Council Resolution 1574 (2004) Sudan.; Security Council Resolution 1895 (2009) Bosnia and Herzegovina.; Security Council Resolution 1948 (2010) Bosnia and Herzegovina.; Security Council Resolution 2019 (2011) Bosnia and Herzegovina.; Security Council Resolution 2074 (2012) Bosnia and Herzegovina.; Security Council Resolution 2123 (2013) Bosnia and Herzegovina.

Në këtë rezolutë Këshilli i Sigurimit ndër të tjera vlerëson Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit Evropian.⁵⁹⁶ Në misionin e Bosnjes, misioni Policor i BE, i vendosur në vitin 2002, ishte pasardhës i Task Forcës Ndërkombëtare të Policisë të OKB-së.⁵⁹⁷ Ndërkohë Rezolutat e kohëve të fundit e Këshillit të Sigurimit është një rezolutë që rinovon autorizimin e Bashkimit Evropian për të udhëhequr stabilizim e forcës në Bosnje dhe Hercegovinë.⁵⁹⁸ Një operacion i tillë që vepron nën një mandat të OKB-së cilësohet si një komponent specifik i një operacioni paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara p.sh, operacioni i Darfurit.⁵⁹⁹

Ndërsa në rastin e dytë Bashkimi Evropian synon të organizojë një operacion të ri ose të riorganizojë një operacion ekzistues. Këtu mund të përmendim rastet e ndërhyrjeve ushtarake të BE-së në misionin Artemis,⁶⁰⁰ në Republikën Demokratike të Kongo. Operacioni Artemis i BE-së u bë me kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, i miratuar nga Këshilli i Sigurimit, ky operacion i BE-së shërbeu për forcimin e operacionit ekzistent MONUC të OKB-së.⁶⁰¹ Ky ishte një operacion ushtarak i zhvilluar në mënyrë autonome nga BE-ja pa ndihmën e burimeve të NATO-s. Një tjetër operacion ushtarak i

⁵⁹⁶ Rezoluta 1551 (2004); Rezoluta 1575 (2004)..., shih citimi origjinal të rezolutave, sipas të cilave: *Emphasizing its appreciation to the High Representative, ..., the European Union (EU)*,...

⁵⁹⁷ Security Council Resolution 1035 (1995) International Police Task Force (IPTF); Security Council Resolution 1423 (2002) Bosnia and Herzegovina.

⁵⁹⁸ Security Council Resolution 2247 (2015) Bosnia and Herzegovina.

⁵⁹⁹ Security Council Resolution 1547 (2004) Report of the Secretary-General on the Sudan (S/2004/453); Security Council Resolution 1564 (2004) Report of the Secretary-General on the Sudan; Security Council Resolution 1574 (2004) Sudan; Security Council Resolution 1590 (2005) Sudan; Security Council Resolution 1593 (2005) Sudan; Veprim i Përbashkët i Këshillit 2005/556/PJSP i 18 qershor 2005 për emërimin e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian në Sudan (*Council Joint Action 2005/556/CFSP*); Veprim i Përbashkët i Këshillit 2005/557/PJSP i 18 korrik 2005 për veprimin mbështetës civil-ushtarak të Bashkimit Evropian në misionin e Bashkimit Afrikan në rajonin Darfur të Sudanit (*Council Joint Action 2005/557/CFSP*).

⁶⁰⁰ Security Council Resolution 1484 (2003) Democratic Republic of the Congo; Veprim i Përbashkët i Këshillit 2003/423/PJSP i 5 qershor 2003 për operacionin ushtarak të Bashkimit Evropian në Republikën Demokratike të Kongos (*Council Joint Action 2003/423/CFSP*).

⁶⁰¹ Security Council Resolution 1291 (2000) Democratic Republic of the Congo.

nisur nga Bashkimi Evropian⁶⁰² në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit⁶⁰³ është operacioni EUFOR TCHAD në Republikën e Afrikës Qendrore dhe Çad. Gjithashtu mund të përmendim edhe misionin EUROPOL në Afganistan,⁶⁰⁴ Irak,⁶⁰⁵ Kosovë⁶⁰⁶ dhe Guinea-Bissau.⁶⁰⁷

Krahas bashkëpunim të ngushtë është e nevojshme të përmendet se kjo marrëdhënie në raste të veçanta është karakterizuar nga tensionet. Kjo marrëdhënie e tensionuar i referohet ambicieve të BE-së për të luajtur një rol të rëndësishëm si aktor global në zgjidhjen e konflikteve. Marrëdhënia tensionuese vihet re në misionet paralele në Republikën e Afrikës Qendrore dhe Çad që u lançuan njëkohësisht në vitin 2007 nga BE-ja dhe OKB-ja, megjithëse të autorizuar nga Rezoluta 1778 e Këshillit të Sigurimit (Weber, 2011: 227).

Tensionet u vunë re në problemet e koordinimit, konkretisht mosmarrëveshje politike, ndërmjet Shteteve Anëtare të BE-së për të vendosur ndërmjet Këshillit për Çështjet e Përgjithshme dhe Marrëdhëniet e Jashtme dhe Këshillit të Sigurimit (Gowan,

⁶⁰² Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2007/677/PJSP i 15 tetor 2007 mbi operacionin ushtarak të Bashkimit Evropian në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore (*Council Joint Action 2007/677/CFSP*).

⁶⁰³ Security Council Resolution 1778 (2007) Chad, the Central African Republic and the subregion.; Security Council Resolution 1834 (2008) Chad, the Central African Republic and the subregion.; Security Council Resolution 1861 (2009) Chad, the Central African Republic and the subregion.

⁶⁰⁴ Security Council Resolution 1806 (2008) Afghanistan.; Security Council Resolution 1868 (2009) Afghanistan.; Veprim i Përbashkët i Këshillit 2007/369/PJSP i 30 maj 2007 për themelimin e misionit policor të Bashkimit Evropian në Afganistan (*Council Joint Action 2007/369/CFSP*).

⁶⁰⁵ Security Council Resolution 1546 (2004) Situation between Iraq and Kuwait.; Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2005/190/PJSP i datës 7 mars 2005 për Misionin e Bashkimit Evropian për Shtetin e të Drejtës në Irak, misioni EUJUST LEX (*Council Joint Action 2005/190/CFSP*).

⁶⁰⁶ Security Council Resolution 1244 (1999) Kosovo.; Security Council Resolution 1674 (2006) Protection of civilians in armed conflict.; Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/PJSP i 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX Kosovë (*Council Joint Action 2008/124/CFSP*).

⁶⁰⁷ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për zhvillimet në Guinea-Bissau mbi aktivitetet e Zyrës së Ndërtimit të Paqes të Kombeve të Bashkuara në këtë vend, 10 Qershor 2009, S/2009/302; Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/112/PJSP i 12 shkurt 2008 për misionin e Bashkimit Evropian në mbështetje të reformës së sektorit të sigurisë në Republikën e Guinea-Bissau (SSR nga BE Guinea-Bissau (*Council Joint Action 2008/112/CFSP*).

2009: 123). Ka gjithashtu një konkurrencë ndërmjet BE-së dhe OKB-së dhe dëshira për të vepruar si një aktor global ka bërë që një sërë misionesh të Bashkimit Evropian të merren pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit. Kështu misionet EUPM në Bosnje, Operacioneve Concordia dhe Proxima në Maqedoni, misionin EUJUST THEMIS në Irak, EUPOL KINSHASA dhe misionin EUJUST LEX në Gjeorgjia janë të gjitha të filluar pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit (Tardy, 2005: 49).⁶⁰⁸

6.3. Bashkimi Evropian një aktor në ndërmjetësim

Ndërmjetësimi është një nga mjetet paqësore të metodave politiko-diplomatike, i cili ka në thelb të tij ndërhyrjen aktive, për reduktimin dhe zbutjen e tensioneve ndërmjet aktorëve palë në mosmarrëveshje. Bashkimi Evropian ka treguar besueshmëri dhe etikë në trajtimin e situatave konfliktuale, nëpërmjet pozicionimit të tij në rolin e ndërmjetësuesit, lehtësuesit ose dialoguesit.⁶⁰⁹ Dialogu dhe ndërmjetësimi janë aktivitetet kyçe të aplikuara nga BE-ja për ndërtimin e paqes dhe zgjidhjes së konflikteve.⁶¹⁰

Ndërmjetësimi është një instrument për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Ndërmjetësimi në thelb ka referimin si i *tretë*⁶¹¹ (Shaw, 2003: 921), një subjekt asnjës, i paanshëm dhe objektiv. Ndërmjetësi është i *miratuar*⁶¹² (Dixon, 2010: 365), i zgjedhur me vullnetin e lirë të të dyja palëve në mosmarrëveshje. Pra, ndërmjetësimi nuk është një

⁶⁰⁸ Shih gjithashtu: Weber, (2011: 228).

⁶⁰⁹ Council of the European Union, Concept on Strengthening EU Mediation and Dialogue Capacities, 2009, paragrafi 2.

⁶¹⁰ Statement on the European Union's Role in Dialogue and Mediation, 2009.

⁶¹¹ United Nations, Handbook on the Peaceful Settlement of Disputes between States, New York 1992, paragrafi 123: "Ndërmjetësimi është një instrument i mjeteve paqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, ku një palë e tretë ndërhyr të pajtojë pretendimet e ngritura nga palët, si dhe të çojë përpara propozimet e veta, të cilat synojnë një zgjidhje reciprokisht të pranueshme nga të dyja palët".

⁶¹² United Nations, Handbook on the Peaceful Settlement of Disputes between States, New York 1992: "Ndërmjetësi është një person gjithnjë i miratuar nga të dyja palët, i cili merr pjesë në bisedime dhe ka për detyrë të propozojë kushtet e një zgjidhjeje dhe të përpiqet të arrijë mirëkuptimin nëpërmjet pikëpamjeve kundërshtare.

proces i *detyruar*,⁶¹³ (Merrills, 2005: 32) por ka vetëm karakter këshillimor.⁶¹⁴ Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian mund të inkurajojë shtetet në konflikt të rifillojnë negociatat, ose t'u sigurojë atyre një element tjetër shtesë të komunikimit.

Ndërmjetësuesi e vendos theksin në mënjanimin e komunikimit të ashpër dhe presioneve ndërmjet palëve (Merrills, 2005:31), zbutjen e pakënaqësive⁶¹⁵ dhe sqarimin e çështjeve të paqarta, duke bërë sugjerime për zgjidhje alternative.⁶¹⁶ Ndërmjetësimi mund të jetë edhe i “imponuar”, nëpërmjet presioneve të drejtpërdrejta nga Bashkimi Evropian, p.sh, në rastin e konfliktit Kosovë–Serbi me ndërprerjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Serbia, gjithashtu në luftë me Bosnjen ishte nën presion të rëndë ekonomik nga sanksionet ekonomike të vendosura nga OKB-ja dhe BE-ja.

Ndërmjetësimi nuk është një fushë e re për BE-në, por një nga qasjet më të koordinuara dhe të fokusuara, që ka rritur aftësinë e BE-së për të luajtur një rol ndërkombëtar më aktiv në këtë fushë.⁶¹⁷ Ndërmjetësimi është parashikuar në një sërë dokumentash të rëndësishme në: Programin e Gotenbourg për parandalimin e konflikteve të dhunshme në vitin 2001,⁶¹⁸ Strategjinë Evropiane e Sigurisë të vitit 2003, Raporti Implementues i Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian i vitit 2008, Forcimi i

⁶¹³ United Nations, Handbook on the Peaceful Settlement of Disputes between States, New York 1992: “Ndërmjetësimi nuk mund të jetë e detyruar mbi palët në një mosmarrëveshje ndërkombëtare, por ndërmjetësimi mund të ndodhë vetëm, nëse ata japin pëlqimin e tyre. Pra, nëse ata e kanë marrë iniciativën dhe kanë emëruar një ndërmjetës, mosgatishmëria e palëve për të marrë parasysh këtë formë të ndihmës mund të përbëjë një pengesë të madhe. Kjo është për shkak se edhe pse propozimet e ndërmjetësve nuk janë të detyrueshme, vetë akti i ndërmjetësimit ka pasoja, të cilat mund të jenë të papranueshme për një ose të dyja qeveritë e interesuara.”

⁶¹⁴ Konventave për Zgjidhjen Paqësore të Mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare të vitit 1899 dhe 1907, neni 6.

⁶¹⁵ Po aty, neni 4.

⁶¹⁶ Council of the European Union, Concept on Strengthening EU Mediation and Dialogue Capacities, 2009, paragrafi 3.

⁶¹⁷ Po aty, paragrafi 2.

⁶¹⁸ Council of the European Union, Brussels, 7 June 2001, Draft European Union Programme for the Prevention of Violent Conflicts.

kapaciteteve të Ndërmjetësimit dhe Dialogut të Bashkimit Evropian i miratuar nga Këshilli Evropian në nëntor të vitit 2009 dhe Traktatet e Bashkimit Evropian.

Fillimisht roli i ndërmjetësit nuk është përqafuar me entuziazëm nga institucionet apo Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian (Stewart, 2007: 8), më pas ndërmjetësimi u pa si një objektiv i rëndësishëm i Bashkimit Evropian. Organizatat më me përvojë në arenën ndërkombëtare është OKB-ja. Ajo ka parashikuar në nenin 33 të Kartës së OKB-së, mjetet për zgjidhjen e paqësore të mosmarrëveshjeve, ka miratuar në vitin 1992 Manualin për Zgjidhjen Paqësore të Mosmarrëveshjeve ndërmjet shteteve dhe i referohet dy Konventave për Zgjidhjen Paqësore të Mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare të vitit 1899 dhe 1907. Ky kuadër ligjor është pikërisht kuadri i adoptuar nga Bashkimi Evropian për ndërmjetësimin e konflikteve ndërkombëtare.

Në arenën ndërkombëtare, ndërmjetësimi si procedure realizohet nga organizatat, shtetet dhe individët.⁶¹⁹ Në Bashkimin Evropian ndërmjetësimi, përveç Përfaqësuesit të Posaçëm të Bashkimit Evropian mund të realizohet, nga Shtetet Anëtare dhe nga një funksionar i lartë i tij, për shembull, më 8 mars të vitit 2011, në raundin e parë të dialogut Beograd-Prishtinë, që u mbajt në Bruksel, u emëroi Robert Cooper si ndërmjetës kryesor, këshilltar i Catherine Ashton në Ballkan dhe Lindjen e Mesme (Bergmann dhe Niemann, 2015:10).

Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët dhe Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët, para miratimit të Traktatit të Lisbonës nuk përmbanin dispozita të

⁶¹⁹ Neni 11, i Paktit Bogota, SHBA, 1948; Përcaktimi i shteteve dhe individëve, si ndërmjetësues është parashikuar në shumë instrumente ndërkombëtare, më konkretisht tek Pakti Bogota është theksuar, që procedura e ndërmjetësimit: “konsiston në eliminimin e kundërshtimeve nga një ose më shumë qeveri amerikane, jo palë e mosmarrëveshjes dhe nga një ose më shumë qytetarë të shquar të ndonjë shteti amerikan, që nuk është palë në mosmarrëveshje”.

qarta për ndërmjetësimin ose politikat e zgjidhjes së konfliktit (Gentz, 2007: 54). Me miratimin e Traktatit të Lisbonës, themelimi i organeve të reja të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët krijoi kuadrin institucional për ndërmjetësimin (Rehrl dhe Glume, 2015: 27).

a) Aktorët kryesore për ndërmjetësim në Bashkimin Evropian

Aktorë të ndryshëm të Bashkimit Evropian si Përfaqësuesi i Lartë, Presidenca, Komisioni Evropian, Shërbimi i Veprimit të Jashtëm të Bashkimit Evropian, Ekipi Mbështetës i Ndërmjetësimit dhe Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian për një rajon të veçantë të konfliktit kanë qenë të përfshirë në aktivitetet e ndërmjetësimit të BE-së (Bergmann dhe Niemann, 2015: 8). Të tilla kanë qenë Marrëveshja Kornizë e Ohrit të vitit 2001 dhe Marrëveshja e Paqes në Aceh 2005.⁶²⁰

Komisioni është pjesë e qasjes gjithëpërfshirëse ndaj krizave dhe veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian në përgjithësi me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë.⁶²¹ Pas Traktatit të Lisbonës, Komisioni e humbi të drejtën e iniciativës në politikën e jashtme dhe të sigurisë dhe si pasojë zbehet edhe roli i tij në ndërmjetësimin e çështjeve të krizave. Komisioni menaxhon një numër instrumentash, që veprojnë paralelisht me misionet e Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët. Komisionit bën pjesë të shërbimit të tij, Zhvillimin dhe Bashkëpunimin si dhe Shërbimin e Instrumentave për Politikën e Jashtme (Rehrl dhe Glume, 2015: 34).

⁶²⁰ Council of the European Union, Concept on Strengthening EU Mediation and Dialogue Capacities, 2009, shih citimin origjinal të paragrafit 2, sipas të cilit: *...such as those leading to the Ohrid Framework Agreement of 2001 or the Aceh Peace Agreement of 2005.*

⁶²¹ Neni 21/3, TBE: “Këshilli dhe Komisioni, të asistuar nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, garantojnë këtë qëndrueshmëri dhe bashkëpunojnë për këtë qëllim”.

Përfaqësuesi i Lartë pas miratimit të Traktatit të Lisbonës nuk ka marrë një rol të drejtpërdrejtë, si ndërmjetësues, ndryshe nga paraardhësi i tij Javier Solana, i cili është angazhuar në bisedimet e paqes, në Lindjen e Mesme dhe së bashku me Britaninë e Madhe dhe Francën, në bisedimet me Iranin.⁶²² Përfaqësuesi i Lartë, pavarësisht mungesës së ndërmjetësimit të drejtpërdrejtë është në krye të çdo procesi ndërmjetësues. Përfaqësuesi i Lartë përcakton, objektivat, politikat dhe orientimet kryesore për ndërmjetësim.

Shërbimi i Veprimit të Jashtëm të Bashkimit Evropian është organi kryesor, që koordinon veprimtarinë e ndërmjetësimit nga Bashkimi Evropian në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Shërbimi i Veprimit të Jashtëm të Bashkimit Evropian është i organizuar në Drejtori gjeografike dhe në Drejtorinë e çështjeve globale dhe shumëpalëshe. Drejtoria përgjegjëse për ndërmjetësimin është Drejtoria për çështjet globale dhe shumëpalëshe, nën Departamentin për Parandalimin e Konflikteve dhe Politikën e Sigurisë.⁶²³ Ky departament, është përgjegjës për zhvillimin e politikave, në çështjet e monitorimit të mundshme të krizave, ndërmjetësimit, përcaktimin e ndërmjetësuesve dhe vendosjen e vëzhguesve në terren, në zonat e konfliktit potencial.⁶²⁴

Nën kompetencat e Përfaqësuesit të Lartë, instrumenti kryesor i Bashkimit Evropian për punën e ndërmjetësimit është Përfaqësuesi i Posaçëm (ose special) i Bashkimit Evropian. Posti i Përfaqësuesit të Posaçëm të Bashkimit Evropian është vendosur jashtë strukturës formale të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian. Ai raporton drejtpërdrejt përpara Përfaqësuesit të Lartë për procesin e ndërmjetësimit në zonat konkrete të konfliktit.

⁶²² European Parliament. Directorate-General for External Policies of the Union 2011. Implementing the EU Concept on Mediation: Learning from the Cases of Sudan and the Great Lakes, fq.14.

⁶²³ Për më shumë informacion rreth organigramës së SHVJE (EEAS), shih këtë website: http://eeas.europa.eu/background/docs/organisation_en.pdf.

⁶²⁴ European Parliament. Directorate-General for External Policies of the Union 2011. Implementing the EU Concept on Mediation: Learning from the Cases of Sudan and the Great Lakes, fq.16.

Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian siguron komunikimin e menjëhershëm midis Brukselit dhe zonave të konfliktit.

Aktiviteti i tyre në terren shpesh përqendrohet në vëzhgimin, mbledhjen e informacionit dhe ofrimin e ndihmës. Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian për një zonë të veçantë konflikti, nuk është pjesë e strukturës së përhershme dhe ekipet e tyre, duke përfshirë këshilltarët politikë janë mbledhur në baza *ad hoc*.⁶²⁵ Kjo metodë ka shërbyer, si një mekanizëm efikas po të kemi parasysh rolin që ajo ka luajtur në dhënien fund të luftërave civile në Bosnjë-Hercegovinë, Sudan, Burundi, konflikteve të zgjatura dhe të dhunshme si në Irlandën e Veriut, në nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet Indisë dhe Pakistanit, të Haitit, Koresë së Veriut etj.

Bashkimi Evropian, gjithashtu ka ndërmjetësuar dhe luajtur rol të rëndësishëm në një sërë çështjesh, si konflikti i Qipros, Gjeorgjisë, Kosovës, Kurdëve të Turqisë, etj. Për shembull, Martin Ahtisaari ku luajtur një rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin e tërheqjes së trupave serbe nga Kosova.⁶²⁶ Ai ndërmjetësoi, që Kosova të bëhej shtet i pavarur, nga veprimet antikushtetuese të Serbisë (Caspersen dhe Herrberg, 2010: 12). Efektiviteti i BE-së, si një ndërmjetës është i lidhur ngushtë me efektivitetin e tij si një aktor i politikës së jashtme.

Suksesi i Bashkimit Evropian në ndërmjetësim përcakton reputacionin e tij në arenën ndërkombëtare.⁶²⁷ Pavarësisht, efikasitetit që ndërmjetësimi, si procedurë, ka evidentuar sfidat me të cilat ai përballët janë të shumta. Ka raste specifike në të cilat ky mekanizëm

⁶²⁵ European Parliament. Directorate-General for External Policies of the Union 2011. Implementing the EU Concept on Mediation: Learning from the Cases of Sudan and the Great Lakes, fq.15.

⁶²⁶ Declaration by the European Union on Kosovo 31 May 1999. Council Press Release 53/99, 8658/99, Presse 172.

⁶²⁷ European Parliament. Directorate-General for External Policies of the Union 2011. Implementing the EU Concept on Mediation: Learning from the Cases of Sudan and the Great Lakes.

has në vështirësi dhe është i paaplikueshëm. Për shembull, në dy rastet e trajtuara nga Direktorati i Përgjithshëm për politikën e jashtme të Bashkimit Evropian është konkluduar se, ai ka marrë një rol udhëheqës në ndërmjetësim në rastin e Liqenit të Madh, ku Bashkimi Evropian ka një histori angazhimi serioz dhe ndikues.⁶²⁸ Këtu përforcohet, teza e studimit, se Bashkimi Evropian mund të luajë rol kryesor në zgjidhjen e konflikteve. Ndërsa në rastin e Sudanit, ndonëse BE-ja ka luajtur një rol të dobishëm me mbështetjen financiare, nuk është pozicionuar mirë për të qenë një ndërmjetës kryesor.⁶²⁹

Ndërmjetësimi i efektshëm rrit rolin e Bashkimit Evropian në skenën ndërkombëtare. Për këtë ndërmjetësuesit nuk duhet të kufizohen vetëm në dhënien e inkurajimit dhe këshillave për rifillimin e negociatave të drejtpërdrejta, por të avancojnë me propozime konkrete (Alheritiere, 1985:707). Bashkimi Evropian për të rritur aftësinë dhe rolin e tij në skenën ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve në kuadër të ndërmjetësimit përcakton një sërë aspiratash.

Këto synime të Bashkimit Evropian janë: forcimi i kapacitetit për mbështetje të ndërmjetësimit; të sigurojë trajnime, ndër të tjera edhe për ekipin e Përfaqësuesit të Posaçëm të Bashkimit Evropian; të mbështesë mekanizmat vendore të ndërmjetësimit; të sigurojë koherencë me objektivat, që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, shtetin e të drejtës dhe rolin e grave; të bashkëpunojë në mënyrë efektive me aktorët e tjerë të ndërmjetësimit.⁶³⁰ Raporte të veçanta kanë arritur në përfundim se, Bashkimi Evropian mund të luajë një rol të rëndësishëm në përpjekjet e ndërmjetësimit për të parandaluar ose

⁶²⁸ Po aty.

⁶²⁹ Po aty.

⁶³⁰ European Parliament. Directorate-General for External Policies of the Union 2011. Implementing the EU Concept on Mediation: Learning from the Cases of Sudan and the Great Lakes, fq. 10.

përfunduar konflikte. Bashkimi Evropian, si çdo organizatë tjetër ndërkombëtare apo aktor në procesin e ndërmjetësimit ka patur raste, në të cilat ka qënë i suksesshëm ka patur dhe raste, në të cilat roli i tij nuk ka rezultuar i efektshëm. Por, për ta bërë ndërmjetësimin në mënyrë më të efektshëm, ky proces duhet të zhvillohet në mënyrë më koherente dhe fleksibël në qasjen e saj.

Roli i Bashkimi Evropian si ndërmjetës i nivelit të lartë është i dukshëm në rastet e Kosovës, Serbisë, Malit të Zi, Sudanit Jugut dhe Gjeorgjisë etj. (Rehrl dhe Glume, 2015: 95). Në rastin e kurdëve të Turqisë, për shembull, Bashkimi Evropian ka mbështetur dhe ka ushtruar presion për përforcimin e të drejtave individuale të njeriut, pjesëmarrjen efektive politike, zgjerimin e të drejtave kulturore dhe të minoriteteve ndaj shtetasve kurdë.⁶³¹ Bashkimi Evropian është angazhuar në mbështetjen e ndërmjetësimit dhe dialogut në nivele të ndryshme, në shtetet e Filipines, Kolumbisë, Sirisë dhe Libisë etj.

b) Raste praktike të ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve nga Bashkimi Evropian

Bashkimi Evropian është angazhuar dhe ka dhënë kontributin kryesor në një sërë raste të konflikteve ndërkombëtare. Bashkimi Evropian ka treguar të jetë një aktor kryesor dhe i vetëm në arenën ndërkombëtare për zgjidhjen e konflikteve. Më poshtë do të trajtohen disa raste praktike të ndërmjetësimit, menaxhimit të krizave dhe zgjidhjes së konflikteve nga Bashkimi Evropian.

(i) *Konflikti Aceh*: Një nga rastet më të suksesshme të Bashkimit Evropian për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare është konflikti ndërmjet qeverisë së Indonezisë dhe

⁶³¹ European Commission, Communication from the Commission to the Council and the European Parliament on Strengthening the European Neighbourhood Policy, COM (2006) 726 final, 4 December 2006.

Lëvizjes së Lirë Aceh.⁶³² Konflikti në Aceh ka qënë një konflikt i gjatë dhe i vështirë në Azi, ka patur disa përpjekje të mëparshme për zgjidhjen e këtij konflikti por kushtet e duhura për një paqe të qëndrueshme nuk ekzistonin deri në vitin 2005. Bashkimi Evropian mbështeti procesin e paqes që në fillim duke themeluar një Mision Monitorimi në Aceh në 9 shtator të vitit 2005 (AMM).⁶³³

Misioni është themeluar për të monitoruar zbatimin e aspekteve të ndryshme të marrëveshjes së paqes të përcaktuara në Memorandumin e Mirëkuptimit. Ky mision i Bashkimit Evropian kishte si qëllim monitorimin e situatës, ndihmën në qeverisjen lokale, reformën në drejtësi, reformën në siguri, dhe nxitjen e dialogut ndërmjet palëve. Mision Monitorimi në Aceh ishte një sukses i qartë (Schulze, 2007: 13). Ky sukses i dedikohet disa elementëve të përgjithshëm të strukturës së AMM dhe paanshmërisë së kreut të misionit monitorues,⁶³⁴ apo ndryshe përfaqësuesi i Bashkimit Evropian (Schulze, 2007: 14). Një aktor tjetër përveç përfaqësuesit që ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin e konfliktit në Aceh ka qënë Martin Ahtisaari (Feith, 2007).

Ndërmjetësuesi i Bashkimit Evropian negocioi për arritjen e autonomisë, ndërkohë që pavarësia nuk ishte një mundësi për negociim. Megjithatë në negociata u bë e qartë se zgjidhja ishte një status autonomie i veçantë, që mund t'i shërbente interesave të të dyja palëve (Caspersen dhe Herrberg, 2010: 12). Faktorë të tjerë shumë të rëndësishëm që

⁶³² Në vitin 1976 shpërtheu konflikti në provincën indoneziane në Aceh, ndërmjet Lëvizjes së Lirë Aceh dhe ushtrisë indoneziane. Konflikti ishte rezultat i shkeljeve të premtimeve nga ana e qeverisë qendrore në Xhakartë për autonominë rajonale si dhe shfrytëzimin e burimeve të Aceh-së nga qeveria qendrore pas zbulimit të gazit natyror. Konflikti zgjati pothuajse 30 vjet dhe secila nga palët në përpjekje për të ndikuar mbi popullsinë shkelën në mënyrë të vazhdueshme të drejtat e njeriut. Pas Tsunami në vitin 2004, bisedimet sekrete ndërmjet Lëvizjes së Lirë Aceh dhe qeverisë qendrore në Xhakartë u shndërruan në negociata zyrtare për t'i dhënë fund konfliktit. Një Memorandum Mirëkuptimi u nënshkrua më 15 gusht të vitit 2005.

⁶³³ Council Joint Action 2005/643/CFSP .

⁶³⁴ Misioni Monitorues Aceh, u udhëhoq nga Pieter Feith.

kontribuan në zgjidhjen e konfliktit ishin angazhimi i palëve të konfliktit në procesin e paqes, dhe mbështetja e vendeve anëtare të BE-së, veçanërisht Mbretërisë së Bashkuar, Finlandës dhe Suedisë (Schulze, 2007: 14).

(ii) *Konflikti Kosovë-Serbi*: Bashkimi Evropian ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin e konfliktit Kosovë-Serbi.⁶³⁵ Në 22 korrik të vitit 2010, Bashkimi Evropian dha një deklaratë,⁶³⁶ për ndërmjetësim, e cila erdhi rishtaz pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Sipas, Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë shpallja e njëanshme e pavarësisë nga Kosova në shkurt të vitit 2008 “nuk përbën shkelje të asnjë rregulli të aplikueshëm të ligjit ndërkombëtar”.⁶³⁷

Në deklaratë Bashkimi Evropian, shprehej se ishte i gatshëm për të lehtësuar procesin e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Ky dialog do të promovonte bashkëpunimin, përparimin drejt rrugës për në Evropë, një proces i cili në vetvete do të ishte një faktor për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në rajon”,⁶³⁸ (Bergmann dhe Niemann, 2015:10).

Që në hapat e parë të konfliktit, Bashkimi Evropian favorizoi një shkallë të lartë autonomie të Kosovës, po kurrësi pavarësinë. Njohje e cila mund të sillte pasoja edhe për vendet e tjera të Evropës, përfshirë këtu edhe Spanjën (Hill dhe Smith, 2000: 385). Bashkimi Evropian në mënyrë të vazhdueshme ka asistuar situatën në Kosovë dhe pas shpalljes së pavarësisë ka qënë pjesërisht i suksesshëm në aspektin e zgjidhjes së konfliktit

⁶³⁵ Konflikti Kosovë-Serbi është një konflikt territorial, ai shpërtheu në luftë në vitin 1999, dhe në 17 shkurt të vitit 2008, Kosova u shkëput nga Serbia dhe shpalli pavarësinë.

⁶³⁶ The Council of the European Union May 31, 1999. The declaration of the European Union for Kosovo. Press Statement 53/99, 8658/99, Release 172.

⁶³⁷ Advisory Opinion, 2010. On the Accordance with International Law of Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo, 2010 I.C.J. 141.

⁶³⁸ Declaration by High Representative Catherine Ashton on behalf of the European Union on the ICJ advisory opinion. Press Statement 12516/10, Brussels (22 July 2010).

ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Suksesi i tij, si ndërmjetës konsiston në nënshkrimin e një sërë çështjesh të vogla me karakter teknik, ndërmjet dy palëve në konflikt. Çështjet për të cilat u ndërmjetësuan në mënyrë të suksesshme dhe që u arrit një marrëveshje ndërmjet palëve ishin: njohja reciproke e diplomave universitare, vulat doganore, kthimin e librave të regjistrit civil, çështja e qeverisjes së veriut të Kosovës etj.

Si pasojë e ndërmjetësimit nga Bashkimi Evropian të dyja vendet kanë pasur një përmirësim të lehtë të kushteve të jetesës së popullsisë (Bergmann dhe Niemann, 2015:24). Suksesi në ndërmjetësimin e një numri marrëveshjesh, ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mund të shpjegohet me një qëllim të përbashkët të palëve kundrejt Bashkimit Evropian. Në këtë rast qëllimi i përbashkët i të dyja palëve është anëtarësim në BE. Krahas kësaj përdorimi edhe i *strategjisë së manipulimit* që nënkupton përdorimin e stimujve pozitive drejt procesit të anëtarësimit në BE, ndihmon në arritjen e një ndërmjetësimi të suksesshmë. Përveç kësaj, mbështetja e jashtme nga palët e treta, në veçanti SHBA, kanë qenë të favorshme për Bashkimin Evropian në suksesin e ndërmjetësimit (Bergmann dhe Niemann, 2015:24).

Rasti i Kosovës trajton një nga problemet kryesore në lidhje me hipotezën e kërimit nëse, Bashkimi Evropian luan një rol të rëndësishëm, si një aktor i vetëm në arenën ndërkombëtare apo flet në shumë zëra? Kjo është pjesërisht rezultat i rolit të lidërshipt, që kanë marrë Shtetet Anëtare. Pavarësisht, se Shtete Anëtare të Bashkimit Evropian, si Franca dhe Danimarka kanë luajtur një rol domethënës, në kuadrin e angazhimit me misionet ushtarake në periudhën e zhvillimit të luftës, Bashkimi Evropian i ka lënë NATO-s rolin e udhëheqësit ushtarak. Kontributi i Shteteve Anëtare ishte individual, ndërsa kolektivisht Bashkimi Evropian veprroi në çështje relativisht të vogla, siç

ishte emërimi i një Përfaqësuesi të Posaçëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.⁶³⁹ Nga ana tjetër, faktorët që kanë ndikuar në mungesën e efektivitetit të Bashkimit Evropian, si aktor në zgjidhjen e konflikteve lidhen dhe me strategjitë e përdorura nga ai, apo dhe me kushtet e konfliktit.

Së pari, problemet lidhur me situatën e popullatës serbe në veri të Kosovës dhe opozita e brendshme kundër procesit të dialogut në të dyja vendet kanë kufizuar gamën negociuese të qeverive të tyre. *Së dyti*, duke synuar përmirësimin e kushteve të jetesës të popullsisë së prekur dhe për të promovuar normalizimin e marrëdhënieve dypalëshe, Bashkimi Evropian i ka vënë vetes synime mjaft ambicioze dhe afatgjata. *Së treti*, sjellja më tepër manipuluese e ndërmjetësimit të Bashkimit Evropian mund të jetë e përshtatshme për të arritur marrëveshje afat-shkurtër, por kjo nuk është një strategji adekuate për të nxitur besimin reciprok mes palëve në konflikt, i cili është bazë për një bashkëpunim afatgjatë (Bergmann dhe Niemann, 2015:24). Ndërsa, njohja zyrtare e Kosovës nga Serbia nuk ka qenë vendosur, si kusht për anëtarësimin e ardhshëm të Serbisë në BE. Serbia nuk do të “shpërblehet” me anëtarësim deri sa çështja e Kosovës të zgjidhet në mënyrë të qëndrueshme (Koeth 2013: 133).

Në rastin e Kosovës identiteti i Bashkimit Evropian, si aktor ndërkombëtar është i kontestuar për shkak të ndarjes së brendshme të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian në dy pjesë, përse i përket njohjes së pavarësisë së Kosovës (Weller, 2008). Kjo ndarje e brendshme e shteteve, ku 5 nga 28 vendet anëtare si; Spanja, Sllovakia, Rumania, Greqia dhe Qipro nuk e kanë njohur zyrtarisht pavarësinë e Kosovës (Lindsay, 2009), dëmton

⁶³⁹ Declaration by the European Union on Kosovo. Council Press Release 53/99 (8658/99, Presse 172), 31 May 1999.

perceptimin e Bashkimit Evropian, si aktor global. Karakteri i bashkëpunimit ndërqeveritar i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, dhe kërkesa për unanimitet pengojnë marrjen e politikave në favor të Kosovës.

Por, pavarësisht kësaj pikëpamjeje identiteti i BE-së dhe pozicioni i tij, si aktor ndërkombëtar është treguar në seriozitetin dhe angazhimin maksimal për zgjidhjen e konfliktit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ky angazhim është evidentuar në rimëkembjen e Kosovës, si një shtet i porsaformuar, përmes Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët dhe misionit të saj EULEX në Kosovë⁶⁴⁰ (Keukeleire, Kalaja dhe Çollaku, 2011: 202). Elementët që mbështesin hipotezën e studimit, lidhen me themelimin e një trupi Eu-LEX dhe rolin si ndërmjetës në Kosovë. Fakt i rëndësishëm ky, pavarësisht se Kosova nuk është njohur ende nga 5 Shtete Anëtare (që gjithashtu është një e dhënë e rëndësishme për të përcaktuar rolin e Bashkimit Evropian).

(iii) *Konflikti Ukrainë-Rusi*.⁶⁴¹ është një tjetër konflikt që ka tërhequr vëmendjen e Bashkimit Evropian këtë periudhën e fundit dhe ka marrë masa për ndërmjetësim e tij. Bashkimi Evropian ka marrë masa ndaj Rusisë, si pasojë e pushtimit të rajonit Ukrainas të Krimesë. Ndërmjetësimi në këtë konflikt ka qënë i vështirë sepse edhe këtu evidentohet i njëjti problem si në rastin e Kosovës. Shtete Anëtare janë përsëri të ndara sipas interesave të tyre (p.sh. Britania dhe Gjermania janë të varura nga Rusia përsa i përket tregtisë dhe energjisë ruse).

⁶⁴⁰ Vendim i Këshillit 2012/291/PJSP i 5 qershorit 2012 ndryshimin dhe zgjerimin e Veprimit të Përbashkët 2008/124/PJSP për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (*Council Decision 2012/291/CFSP*).

⁶⁴¹ Konflikti i zgjatur në Ukrainë shpërtheu në vitin 2013, si pasojë e pezullimit të përgatitjeve për zbatimin e Marrëveshjes së Asocimit me Bashkimin Evropian. Ky vendim rezultoi në protesta masive, ndërmjet mbështetësve të tij dhe pjesës tjetër të popullsisë. Një krizë politike pasoi në Krime rajonin autonom të Ukrainës, duke çuar në aneksimin e këtij territori nga Rusia.

Megjithatë BE-ja ka themeluar një mekanizëm multilateral për dialog dhe ndërmjetësim, me qëllim gjetjen e një zgjidhje politike për sovranitet të plotë të Ukrainës dhe ruajtjen e integritetit territorial. Gjithashtu BE-ja ka dënuar veprimet e individëve të armatosur në qytetet e Ukrainës Lindore⁶⁴² duke i konsideruar, si “akte destabilizuese”, që duhet të ndalen.⁶⁴³

Këshilli mori masa nëpërmjet zgjerimit të listës së atyre, që u nënshtrohen ngrirjes së pasurisë dhe ndalimit të vizave.⁶⁴⁴ Ukraina që prej vitit 2014 është pjesë e Politikës Evropiane të Fqinjësisë në kuadër të parametrave të BE-së. Në këtë aspekt detyrat e Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian⁶⁴⁵ ishin të vendosnin një mision ekspertësh, për të përpunuar një kuadër politik për qasjen e krizës.

(iv) *Konflikti Moldavi-Transdnjestria*:⁶⁴⁶ përbën një nga rastet e pakta të Politikës Evropiane⁶⁴⁷ të Fqinjësisë i vendosur direkt në kufijtë e Bashkimit Evropian. Që nga viti 2004, Bashkimi Evropian me Planin e Veprimit të Politikës Evropiane të Fqinjësisë (BE-Moldavi), përfshinte një seksion mbi problemin Transdnjestrian (Cristescu dhe Matveev, 2011:11). Bashkimi Evropian është angazhuar progresivisht duke kontribuar në zgjidhjen e konfliktit.⁶⁴⁸ Moldavisë i ishte dhënë nga Bashkimi Evropian asistencë nëpërmjet programeve rajonale të tilla si, Instrumenti i Politikës Evropiane të Fqinjësisë, Instrumenti

⁶⁴² Council of European Union, Statement of Heads of State or Government on Ukraine Brussels, 6 March 2014.

⁶⁴³ Po aty.

⁶⁴⁴ Council of European Union, EU freezes misappropriated Council Ukrainian state funds 7281/14.

⁶⁴⁵ European Union External Action (2014). EU-Ukraine Association Agreement.

⁶⁴⁶ Konflikti Moldavi-Transdnjestri, është një konflikt territorial i dhunshëm, i zhvilluar në vitin 1990-1992, me shpalljen e njëanshme të Transdnjestrisë, si shtet i pavarur. Transdnjestria është e njohur ndërkombëtarisht, si pjesë e Moldavisë, por pretendonte pavarësi dhe me ndihmën e Rusisë fitoi pavarësinë dhe gëzon sovranitet

⁶⁴⁷ European Commission, European Neighbourhood Policy EU/Moldova Action Plan, 9 December 2004.

⁶⁴⁸ Qëndrim i Përbashkët i Këshillit 2003/139/PJSP i 27 shkurt 2003 lidhur me masat restriktive ndaj Kryesisë së Rajonit Transnistrian të Republikës Moldave (*Council Common Position 2003/139/CFSP*).

Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut dhe Instrumenti për Stabilitet. Përfaqësuesit të Posaçëm të Bashkimit Evropian në vitin 2005 iu dha një mandat për Moldavinë për të forcuar kontributin e Bashkimit Evropian në zgjidhjen e konfliktit në përputhje me objektivat dhe politikat e Bashkimit Evropian (Cristescu dhe Matveev, 2011: 11).

Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian do të merrte statusin e vëzhguesit në negociatat 5+2,⁶⁴⁹ duke siguruar, përmes një ekipi të ekspertëve, zhvillimin politik dhe aktivitetet në lidhje me Misionin e Ndihmës Kufitare të Bashkimit Evropian në Moldavi dhe Ukrainë. Nëpërmjet ndërmjetësimit Bashkimi Evropian ka luajtur një rol kyç, kryesisht pas rënies së bisedimeve zyrtare ndërmjet vendeve.

Ai ka marrë rolin udhëheqës në angazhimin e Transdniestrisë duke i hapur rrugën për komunitetin diplomatik evropian, si dhe duke kontribuar në ndërtimin e besimit reciprok dhe marrjen e masave social-ekonomike (Schuneman, 2011).⁶⁵⁰ Kontributi i vitit 2009 në fondet për shoqërinë civile për Transdniestrinë dhe masat e ndërtimit të besimit, kanë qenë hapat kryesorë në thellimin e angazhimit të Bashkimit Evropian (Cristescu dhe Matveev, 2011: 11).

(v) *Konflikti në Mindanao*: Bashkimi Evropian ka treguar, se është një aktor i rëndësishëm global, kur vjen fjala për ndërmjetësim në konfliktin në Mindanao.⁶⁵¹ Bashkimi Evropian ka kontribuar në ndërmjetësimin në procesin e paqes në Mindanao, si një aktor i cili nuk kishte interesa të drejtpërdrejta në rajon. Pas dy dekada të bashkëpunimit

⁶⁴⁹ Veprim i Përbashkët i Këshillit 2007/107/PJSP i 15 shkurt 2007 për emërimin e Përfaqësuesin Special të Bashkimit Evropian për Republikën e Moldavisë (*Council Joint Action 2007/107/CFSP*).

⁶⁵⁰ United Nations Program for Development in Moldova, Project Support to Confidence Building Measures, June 7, 2011.

⁶⁵¹ Konflikti zhvillohej midis popullsisë muslimane në Mindanao dhe autoriteteve në Manila me bazë qendrore në shtetet Filipine.

dhe ndihmës humanitare, Bashkimi Evropian u konsiderua nga palët, si një partner i besueshëm (MacDonald dhe Vinals 2012). Si rezultat, Bashkimi Evropian u ftua zyrtarisht të marrë pjesë në Ekipin Monitorues Ndërkombëtar dhe për të udhëhequr Komponentin e Zhvillimit dhe Rehabilitimit Humanitar.

Bashkimi Evropian ka siguruar fonde përmes Instrumentit për Stabilitet dhe ka vepruar, si pajtues dhe ndërmjetësues. Roli i Bashkimit Evropian në Mindanao ka qenë në sigurimin e ndihmave humanitare, mbështetjen aktive për ndërtimin e besimit, monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve të armëpushimit, nëpërmjet aspekteve civile dhe mbrojtëse të saj dhe në pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në negociatat për paqen.

(vi) *Konflikti në Sudan*: Bashkimi Evropian i ka kushtuar një vëmendje të veçantë konfliktit në Sudan,⁶⁵² nëpërmjet promovimit të paqes, mbështetjes aktive për zgjidhjen e konfliktit. Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian për Sudanin ka ndërmjetësuar dhe kontribuar në promovimin e paqes dhe stabilitetit në Sudan, mbi bazën e prioritetëve kyçe të Bashkimit Evropian për Afrikën.⁶⁵³ Rasti i Sudanit trajton të njëjtin problem të konstatuar në rastin e Kosovës dhe Ukrainës në lidhje me përfaqësimin e Bashkimit Evropian, jo si aktor global i unifikuar, por që flet në shumë zëra.

Rasti i Sudanit në zgjidhjen e konfliktit ka treguar, që Shtetet Anëtare në Bashkimin Evropian shpeshherë kanë demonstruar efektivitetin e tyre në zgjidhjen e konfliktit. Mbretëria e Bashkuar dhe Holanda kanë treguar kontributin e tyre në shumë raste të konfliktit, Italia, për shembull, ka qenë një lojtar i rëndësishëm në bisedimet në Naivasha.

⁶⁵² Konflikti në Sudan është konflikti për pushtet politik, nga grupet rebele kundrejt qeverisë së Sudanit. Ky konflikt merr përmasa të mëdha në vitin 2003 në luftën e Darfur-it. Tensionet ndërmjet Sudanit Jugor dhe Sudanit Verior çuan në një luftë civile brutale për 21 vjet që përfundoi në vitin 2005.

⁶⁵³ European Parliament. Directorate-General for External Policies of the Union 2011. Implementing the EU Concept on Mediation: Learning from the Cases of Sudan and the Great Lakes.

Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian ka formuar një grup pune të posaçëm në Sudan, për të koordinuar aktivitetet e Bashkimit Evropian në drejtim të Sudanit. Bashkimi Evropian ka përvojë në situatat pas konfliktit dhe Sudanit Jugor i nevojitet një mbështetje e tillë për të shmangur paqëndrueshmërinë.

6.4. Bashkimi Evropian si aktor efektiv në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare

Bashkimi Evropian paraqet një nga produktet më të mëdha dhe më të suksesshme në përpjekjet për zgjidhjen e konflikteve në mbarë botën (Tocci, 2011). Bashkimi Evropian ka nisur projekte të suksesshme në zgjidhjen e konflikteve, megjithatë ai ende lufton për të qenë një aktor koherent në politikën e jashtme dhe të sigurisë. Kështu, pavarësisht disfatave dhe dështimeve, me të cilat është përballur Bashkimi Evropian ndër vite, kontributi historik i tij për paqen dhe sigurinë në Evropë është i pamohueshëm. Sipas një studimi të Qendrës së Robert Schuman për studime të avancuara të qeverisjes globale me autor Thomas Renard (2014: 4), trashëgimia e këtij kontributi është mbështetur në disa elementë.

Së pari, në zgjerimin e Bashkimit Evropian ndaj ish republikave sovjetike, kjo politikë është ndoshta kontributi më absolut i BE-së për sigurinë rajonale dhe globale. *Së dyti*, në zgjerimin e BE-së në mënyrë paqësore dhe vullnetare, duke i bërë të vjetëruara konceptet e kolonializmit dhe pushtimit. *Së treti*, vendet që janë bashkuar me BE-në janë zhvilluar pozitivisht, ekonomikisht dhe politikisht. *Së katërti*, në përgjithësi, kontinenti evropian, që pas themelimit të BE është bërë më i begatë dhe i sigurt.

Kontributi i BE për sjelljen e paqes është vlerësuar edhe nga Komiteti norvegjez për çmimin Nobel, duke vendosur që ti jepte BE në vitin 2012 një çmim të tillë, për kontributin e tij për transformimin e suksesshëm të Evropës nga një kontinent i luftës në një kontinent

të paqes,⁶⁵⁴ (Blockman, 2014: 5). Pas themelimit të PSMP-së, roli i Bashkimit Evropian si aktor ndërkombëtar në zgjidhjen e konflikteve është rritur ndjeshëm. Për këtë mund t'i referohemi një krahasimi të Bashkimit Evropian me organizata të tjera rajonale.

Sipas një studimi të zhvilluar nga Kirsten Soder⁶⁵⁵ (2009) Bashkimi Evropian (në terma sasiore) është një nga ofruesit më të rëndësishëm të operacioneve të paqes, në krahasim me organizata të tjera rajonale si: Komonuelthi i Shteteve të Pavarura, Bashkimi Afrikan, OSBE-ja dhe nga Organizata e Shteteve Amerikane.⁶⁵⁶ Suksesi i Bashkimit Evropian i dedikohet bashkëpunimit të ngushtë me OKB-në dhe NATO-n, nëpërmjet përdorimit të kapaciteteve ushtarake (Webber, 2011: 218).

Pavarësisht, mungesës së koherencës Bashkimi Evropian ka bërë përpjekje të vazhdueshme në ndërtimin e një Politike të Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët kompetente (Ginsberg, 1999), (Smith, 2008). Bashkimi Evropian, së bashku me partnerët e tij ndërkombëtarë ka dhënë një kontribut të madh në ndërtimin e paqes dhe rehabilitimin në Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni dhe Kosovë etj. Pas Traktatit të Lisbonës, roli i Bashkimit Evropian është bërë i padiskutueshëm (Cameron, 1998), (Griçevci, 2007).

Rastet, në të cilat Bashkimi Evropian nuk ka rezultuar i suksesshëm nuk nënkuptojnë, që Bashkimi Evropian nuk është aktor i rëndësishëm në arenën ndërkombëtare (Bretherton and Vogler, 2006). Mungesa e efektivitetit në ndërmjetësim, menaxhimin e krizave, misioneve ushtarake, civile dhe zgjidhjen e konflikteve nuk i mbart vetëm Bashkimi Evropian, por dhe organizata të afirmuara ndërkombëtare, apo dhe shtete

⁶⁵⁴ The Nobel Peace Prize for 2012.

⁶⁵⁵ Anëtar i Institutit Kërkimor të Stokholmit për Paqen Ndërkombëtare, studim vjetor.

⁶⁵⁶ Sipas studimit të Soder për operacionet paqësore shumëpalëshe, numri i misioneve për secilën nga organizatat ishte: OKB, 23 misione; OAS, 1 misione; Bashkimi Afrikan, 2 misione; CIS, 3 misione; OSCE, 9 misione; BE, 12 misione; NATO, 3 misione.

të fuqishme. Bashkimi Evropian zotëron kapacitetet e duhura për të qenë një aktor global edhe pse gjatë rrugës mund të përballet me pengesa të ndryshme. Bashkimi Evropian ka kontribuar në një sërë drejtimesh duke qenë i suksesshëm edhe në menaxhimin e krizave.

Cremona (2004: 553) ka identifikuar të paktën pesë role të ndryshme, të luajtura nga Bashkimi Evropian si një aktor global: (i) një laborator dhe model për rajone të tjera, (ii) një lojtar tregu që mbron dhe promovon interesat e tij ekonomike, (iii) një gjenerator rregullues dhe eksportues normash, që vepron nëpërmjet një rrjeti marrëveshjesh me shtete dhe rajone të tjera, (iv) një forcë për stabilizim, brenda BE-së dhe përtej, si dhe (v) një magnet dhe fqinj duke përdorur nxitjen e anëtarësisë.

Profesorët e të drejtës së Bashkimit Evropian, Steven Blockmans dhe Ramses A. Wessel, anëtarë të bordit të Qendrës për të drejtën e BE-së në marrëdhëniet e jashtme (CLEER) në një botim të tyre (2009: 9-10) analizojnë shumëllojshmërinë e niveleve të Bashkimit Evropian, si menaxher i krizës dhe rolin e tij si aktor ndërkombëtar.

Sipas tyre BE-ja vepron: si një ndërmjetës i ndershëm për paqen ndërmjet palëve në konflikt (p.sh. Aceh); si asistent për menaxhimin e kufijve (p.sh. Moldavia/Ukrainë); si një këshilltar në reformën në drejtësi (p.sh. Gjeorgji); si një trajner i policisë dhe stafit të burgut (p.sh. Irak); si një reformator i sektorit të sigurisë (p.sh. Guinea-Bissau); si garantues i sigurisë gjatë zgjedhjeve (p.sh. Republika Demokratike e Kongos); si një paqeruajtës me ftesën e një vendi pritës (p.sh. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë); si një organizatë rajonale, që vepron nën një mandat të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për t'iu kundërvënë kërcënimit për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare (që paraqet, p.sh., piraterinë dhe plaçkitjet e armatosura kundër anijeve të rrezikuara në brigjet e Somalisë-Operacioni Atalanta) dhe për të ndihmuar ruajtjen e paqes, operacionet e kryera nga

organizata të tjera ndërkombëtare (p.sh. Darfurit); dhe si një komponent i një administrate kalimtare ndërkombëtare (p.sh. Shtylla IV e UNMIK-ut në Kosovë).⁶⁵⁷

⁶⁵⁷ Studim i Qendrës për të drejtën e Bashkimit Evropian në marrëdhëniet e jashtme, 2009.

KREU VII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

7.1. Konkluzione

Në përfundim të këtij studimi mund të pohojmë se, Bashkimi Evropian vazhdimisht është përpjekur të luajë një rol aktiv për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare nëpërmjet instrumentit të tij kryesor Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët. Pavarësisht dështimeve, BE-ja ka treguar në shumë raste të jetë një aktor global në çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes. Bashkimi Evropian ka legjitimuar konceptin e *sigurisë kolektive*, trajton dhe përpiket të *zgjidhë konfliktet ndërkombëtare* dhe *krizat ndërkombëtare*, megjithatë BE-ja ndryshe nga OKB-ja nuk përfshin *zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare* që shqyrtohen nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

Bashkimi Evropian si një aktor i të drejtës ndërkombëtare ka përqëndruar vëmendjen në një sërë projektesh në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, por pas dështimesh të vazhdueshme vetëm pas disa dekada, në vitet 90' ka mundur të krijojë një politikë të sigurisë dhe të mbrojtjes. Traktatet njëra pas tjetrës kanë legjitimuar procedurat, objektivat, instrumentet, organet për politikën e jashtme dhe janë përpjekur në mënyrë të vazhdueshme të rrisin koherencën e Bashkimit Evropian.

(i) Politika e Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët është legjitimuar për herë të parë në *Traktatin e Maastrichtit*, sëbashku me karakterin e bashkëpunimit ndërqeveritar. Në këtë kuadër, proces ligjor zhvillohet vetëm nëpërmjet vendimeve të miratuara nga Shtetet Anëtare si subjekte sovranë, mbi bazën e të drejtës ndërkombëtare publike. Traktati i Maastrichtit shfaqti dobësi në formulimin dhe zbatimin e politikës së jashtme dhe të sigurisë.

(ii) *Traktati i Amsterdimit* përcaktoi instrumentat e politikës së sigurisë dhe detyrat e Petersbergut, megjithatë traktati nuk arriti të sillte koordinimin e mjaftueshëm në çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes.

(iii) *Traktati i Nicës*, shtoi sistemin e menaxhimit të krizave dhe bashkëpunimin e intensifikuar, por përsëri u konstatuan nivele të ulëta të angazhimit dhe bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare. Të treja traktatet synonin rritjen e rolit të Bashkimit Evropian si aktor në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes por tensioni ndërmjet shtyllave nuk arriti të konfirmonte këtë rol të Bashkimit Evropian.

(iv) *Traktati i Lisbonës*, traktati i fundit i miratuar në BE, ka sjellë ndryshime të rëndësishme për rritjen e rolit të Bashkimit Evropian si aktor global dhe forcimin e kuadrit ligjor të politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes. Këto risi të rëndësishme i referohen krijimit të strukturave të reja institucionale, forcimit të koherencës në PJSP dhe shtimit të dispozitave që rregullojnë PJSP-në dhe PSMP-në.

Normat dhe natyra ligjore e PJSP-së është e ndryshme nga instrumentet e tjera legislative, të miratuara nga BE-ja. Në rendin juridik të BE-së e drejta e politikës së jashtme dhe e sigurisë është një e drejtë detyruese e cila ndahet në *të drejtën parësore* dhe *të drejtën dytësore*.

(i) E drejta parësore përfshin dy parime kryesore a) *parimin e bashkëpunimit sistematik* (neni 32 TBE) dhe b) *parimin e bashkëpunimit të sinqertë* (neni 24/3 dhe neni 4/3 TBE), (*çështja Pupino*).

(ii) Ndërsa e drejta dytësore i referohet dy instrumentave kryesorë të politikës së jashtme dhe sigurisë, a) *veprimet e përbashkëta* (neni 28 TBE) dhe b) *qëndrimet e përbashkëta* (neni 29 TBE), (*çështja Segi*).

Politika e jashtme dhe e sigurisë rregullohet nga një kuadër ligjor i veçantë nga pjesa tjetër e politikave të BE-së, nga norma të cilat varen nga vullneti politik i Shteteve Anëtare. Normat e PJSP-së kategorizohen si norma *soft law* ose norma të ligjit të butë, pasi ekziston një prezumim në favor të një uniformiteti të ligjshëm, që mbizotëron procedurën e vendimmarrjes dhe ekzistencën e natyrës ndërqeveritare të PJSP-së (neni 24 TBE). Ndryshe nga e drejta komunitare e cila udhëhiqet nga një grup i instrumenteve ligjore që përfshin rregullore dhe direktiva, PJSP-ja vepron nëpërmjet instrumente ligjore që përfshijnë vendimet e Këshillit, veprimet e përbashkëta, strategjitë e përbashkëta dhe qëndrimet e përbashkëta (*çështja Segi*).

Shpeshherë doktrina ka mbajtur një pozicion kritik lidhur me natyrën juridike të PJSP-së, kjo për faktin se PJSP-së i mungojnë dy nocioneve kyçe të së drejtës së Bashkimit Evropian, *doktrina e përparësisë* (*Costa kundër Enel*), (*Simmenthal*) etj., dhe *efekti i drejtpërdrejtë* (*Van Gend en Loos*). Megjithatë dalim në konkluzion se aktet që rregullojnë politikën e jashtme dhe të sigurisë nuk mund të trajtohen të izoluara dhe të shkëputura nga tërësia e normave dhe rendi juridik i Bashkimit Evropian pavarësisht rregullave, procedurave specifike dhe rolit të ndryshëm të Gjykatës së Drejtësisë. *Politika e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët përjashtohet nga miratimi i akteve legislative*, por kjo nuk i heq akteve të PJSP-së natyrën e tyre juridike dhe detyrimin e tyre ligjor.

PJSP-ja konsolidohet nga parimet e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian, dhe udhëhiqet nga një parim kryesor i saj që është *koherenca*. Koherenca parashikohet në një sërë dispozitash të Traktatit të Lisbonës, dhe gjithashtu ka qënë subjekt i jurisprudencës së GJED-së në shumë raste (neni 7, neni 13, neni 21, neni 24 TBE dhe neni 275, TFBE). Koherenca është elementi kryesor përcaktues i unitetit dhe efektivitetit të PJSP-së si dhe

rritjes së rolit të BE-së në arenën ndërkombëtare. Parimi i koherencës identifikohet në tre nivele dhe në tre dimensione kryesore. Në nivelin e parë janë *rregullat e hierarkisë*, në nivelin e dytë *rregullat e delimitimit*, dhe në nivelin e tretë parimet e *bashkëpunimit dhe të komplementaritetit*. Dimensionet e koherencës ndahen në koherencën vertikale, horizontale dhe koherencën multilaterale.

(i) Koherenca *vertikale* trajton koherencën ndërmjet politikave të jashtme të Bashkimit Evropian dhe politikave të jashtme kombëtare të Shteteve Anëtare. Koherenca vertikale si pjesë e *rregullave të hierarkisë* përqendrohet në sundimin e përparësisë së legjislacionit të BE-së mbi legjislacionin e Shteteve Anëtare (*Solange I* dhe *Solange II*). Rasti i politikës së jashtme dhe të sigurisë nuk lejon që doktrina e përparësisë të sundojë mbi legjislacionin kombëtar.

(ii) Koherenca *horizontale* i referohet qëndrueshmërisë ndërmjet PJSP, PSMP dhe politikave të tjera të Bashkimit Evropian, koherenca horizontale konsiderohet si ekuivalent i koherencës ndërmjet shtyllave (*çështja ECOWAS*).

(iii) *Koherenca multilaterale* përcakton qëndrueshmërinë ndërmjet veprimeve të jashtme të Bashkimit Evropian dhe aktorëve të tjerë ndërkombëtarë për zgjidhjen e konflikteve.

Traktati i Lisbonës solli një ndryshim të rëndësishëm në favor të forcimit të rolit të BE-së në arenën ndërkombëtare, dhe kjo ka të bëjë me faktin që BE-ja gëzon personalitet juridik ndërkombëtar (*çështja ERTA*). Në këtë rast BE-ja ka të drejtën e nënshkrimit të të gjitha marrëveshjeve në fushën e politikës së sigurisë dhe të mbrojtjes me konsensusine Shteteve Anëtare. Bashkimi Evropian në çdo rast synon garantimin e sigurisë dhe stabiliteti për këtë BE-ja i referohet të drejtës ndërkombëtare. Në rendin juridik të Bashkimit

Evropian një rol të rëndësishëm luajnë kompetencat e jashtme, por marrëdhënia e këtyre të fundit me PJSP-në është një marrëdhënie e veçantë dhe e dallueshme nga të gjitha politikat e tjera të BE-së. Ndarja e kompetencave ndërmjet Shteteve Anëtare dhe BE-së në fushën e PJSP-së është e paqartë. Dispozitat që rregullojnë tre kompetencat e Bashkimit Evropian, kompetencat ekskluzive, të përbashkëta dhe mbështetëse janë të përcaktuara në TFBE, për rrjedhojë, PJSP-ja duke qenë e rregulluar në TBE nuk ka një kuadër të mirëpërcaktuar të kompetencave në TFBE. Karakteri ndërqeveritar i PJSP-së e nënshtron këtë politike ndaj rregullave dhe procedurave të veçanta.

Bashkimi Evropian përfaqëson një të drejtë shumë të veçantë dhe të avancuar të së drejtës ndërkombëtare. BE-ja respekton dhe zbaton parimet e së drejtës ndërkombëtare publike, parime që janë të detyrueshme për Bashkimin Evropian. Çështja e famshme *Kadi I, II, III* e GJED-së është një rast që ka provokuar reagime të ashpra ndërmjet raportit të së drejtës së Bashkimit Evropian dhe të drejtës ndërkombëtare publike. Gjykata rrëzoi një rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, duke shprehur se detyrimet e imponuara nga një marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të ketë efektin e cënimit të parimeve kushtetuese (të drejtat e njeriut) të Bashkimit Evropian. Vendimi i Gjykatës u kundërshtua me pretendimin se ky vendim injoron përgjegjësinë kryesore të Këshillit të Sigurimit për përcaktimin e masave të nevojshme për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe përparësinë e detyrimeve të Kartës së OKB-së. Megjithatë në çdo rast është bërë e qartë se BE-ja në fushën e sigurisë i konsideron veprimet e saj pjesë të rëndësishme të programit të qeverisjes globale.

Mënyra e organizimit institucional përcakton efektivitetin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, institucionet që veprojnë në politikën e jashtme dhe të sigurisë

kanë një organizim të ndryshëm nga politikat e tjera të BE-së. Nga të gjitha organet e Bashkimit Evropian vetëm dy janë organet që luajnë rol kryesor në formulimin dhe zbatimin e PJSP-së.

(i) *Këshilli Evropian*, i cili është organi qendror, që vendos drejtimin politik, udhëzimet, axhendën për caktimin e qëllimeve, objektivave, kohëzgjatjen dhe mjetet për çdo veprim të jashtëm të BE-së; dhe

(ii) *Këshilli* i cili është organi kryesor në procesin e vendimmarrjes së PJSP-së. Këshilli vepron nëpërmjet një sërë organesh të tjera në fushën e politikës së sigurisë dhe mbrojtjes.

Institucionet komunitare si Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian (*çështja Parlamenti Evropian kundër Këshillit*) luajnë një rol të kufizuar në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët. Ndërsa Gjykata e Drejtësisë nuk ka juridiksion në Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (neni 24/1, TBE), (*Grau Gomis dhe të tjerë*). Megjithatë, GJED-ja ka juridiksion në PJSP të paktën në dy çështje kryesore

(i) GJED-ja ka juridiksion të sigurojë që PJSP-ja nuk shkel mbi politikat apo kompetencat e tjera të Bashkimit Evropian dhe anasjelltas (neni 40, TBE), (*The Queen, ex parte Centro-Com Srl kundër HM Treasury and Bank of England*).

(ii) Të shqyrtojë ligjshmërinë e sanksioneve të vendosura ndaj personave fizikë dhe juridikë në kuadër të PJSP-së (neni 275, TFBE), (*çështja Kadi*).

Fakti që Bashkimi Evropian është një aktor ndërkombëtar në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare konfirmohet edhe nga organet e veçanta të krijuara në Traktatin e Lisbonës për PJSP-në, bëhet fjalë për

(i) Përfaqësuesin e Lartë;

(ii) Presidentin e Këshillit Evropian; dhe

(iii) Shërbimin e Veprimit të Jashtëm Evropian.

Këto organe kanë përgjegjësinë të forcojnë koherencën dhe të sigurojnë hartimin e këtyre politikave dhe zbatimin në kohë të të gjitha vendimeve që merren për zgjidhjen e konflikteve. Vendimet në PJSP dhe në PSMP merren me unanimitet si një rregull i përgjithshëm dhe i pakontestueshëm nga Shtetet Anëtare në kuadër të ruajtjes së sovranitetit të tyre në çështjet e sigurisë. Neni 30 dhe neni 31 TBE përbëjnë dispozitat që formojnë thelbin e procedurës së vendimmarrjes, që përfshin iniciativën ligjvënëse dhe rregullat e votimit.

Bashkimi Evropian zotëron tre politika kryesore për zgjidhjen e konflikteve, PJSP-ja që është politika kryesore e BE-së, PSMP-ja dhe PEF-ja. Politika e Sigurisë dhe e Mbrojtjes së Përbashkët (*çështja Lisbona*) është politika e cila në kuadër të sigurisë kolektive përfaqëson krahun e armatosur të Bashkimit Evropian. Kjo politikë drejton misionet civile dhe operacionet ushtarake të BE-së në përputhje me detyrat e Petërsburgut. PSMP-ja udhëhiqet nga Përfaqësuesi i Lartë dhe është pjesë integrale e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët (neni 42, TBE) dhe trajton 5 lloje misionesh civile, aktivitetet për ruajtjen e paqes, parandalimin e konflikteve, menaxhimin e krizave, stabilitetin postkonflikt dhe misionet humanitare.

Kjo politikë drejtohet nga një sërë strukturash ushtarake dhe në mënyrë të suksesshme ka ndërmarrë një numër misionesh civile dhe operacionesh ushtarake, misioni policor (*EUPM*) në Bosnjë dhe Hercegovinë, operacioni i parë ushtarak Operacionin Konkordia në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe operacioni i menaxhimit të krizave (*Artemis*) në Republikën Demokratike të Kongos, si misioni i parë jashtë Evropës.

Instrumentet ligjore bazë që rregullojnë çdo operacion të Bashkimit Evropian janë vendimet e Këshillit të Ministrave (*council decision*), të miratuara në bazë të nenit 43 TBE.

Në kuadër të procedurave dhe sistemit të menaxhimit të krizës merren 4 lloj vendimesh në politikën e sigurisë dhe mbrojtjes. Në këtë politikë GJED-ja nuk pranon pretendimet e Shteteve Anëtare për të mos respektuar të drejtën komunitare me qëllim ruajtjen e sovranitetit në çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes (*Komisioni kundër Spanjës*). GJED-ja bën të qartë se mbështetja në nocionin e domosdoshmërisë së sigurisë kombëtare nuk mund të justifikojë *ipso facto* shmangien nga rregullat e Bashkimit Evropian. PSMP-ja në kuadër të *klauzolës së ndihmës së ndërsjelltë, të bashkëpunimit të përhershëm të strukturuar* detyron Shtetet Anëtare të bashkëpunojnë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Bashkimi Evropian ka përfunduar me sukses 17 operacione civile dhe ushtarake, të cilat kanë qënë misione për asistencën në polici, për monitorimin, për shtetin e të drejtës etj., dhe 18 operacione janë akoma në vazhdim. Këto misione janë ndërmarrë nga BE-ja si brenda ashtu dhe jashtë Evropës, dhe një e dhënë e tillë konfirmon rolin e Bashkimit Evropian si një aktor i rëndësishëm global për garantimin e sigurisë, paqes dhe stabilitetit. Ndërkohë nuk mund të themi të njëjtën gjë për Politikën Evropiane të Fqinjësisë, e cila perceptohet si një politikë e qeverisur nëpërmjet instrumenteve ligjore të buta (*soft law*).

PEF-ja ka si synim vendosjen e marrëdhënieve të veçanta me vendet fqinje në Evropën Lindore, Mesdheun e Jugut dhe Kaukazin e Jugut, nëpërmjet promovimit të demokracisë lokale, bashkëpunimit rajonal dhe përparimit socio-ekonomik. Politika Evropiane e Fqinjësisë rregullon marrëdhëniet e BE-së me 16 fqinjët më të afërt lindor dhe jugor të saj dhe përfshihet në zgjidhjen e konflikteve vetëm atëherë kur vendet partnere të Bashkimit Evropian janë në konflikt apo në situatë krize. PEF ka një karakter

gjithpërfshirës dhe nuk ka si synim vetëm zgjidhjen e konflikteve ndryshe nga PJSP dhe PSMP që disiplinojnë çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes. PEF rregullohet nga një dispozitë e vetme (neni 8 TBE) e cila bën pjesë në dispozitat e përbashkëta të TBE.

Bashkimi Evropian ka mundur të jetë një aktor i suksesshëm në zgjidhjen e konflikteve sepse misionet e tij civile dhe operacionet ushtarake janë ndërmarrë në bashkëpunim me dy organizatat më të rëndësishme në arenën ndërkombëtare, me NATO-n dhe OKB-në. BE-ja ka një marrëdhënie të ngushtë me NATO-n, ajo në asnjë rast nuk kërkon të jetë një konkurrente e NATO-s, por një alternative në çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes. Ndërmjet BE-së dhe NATO-s është nënshkruar marrëveshja “Berlin Plus” një marrëveshje që i lejon Bashkimit Evropian të udhëheqë operacione ushtarake dhe misione civile duke përdorur kapacitetet apo burimet e NATO-s (*operacioni Concordia, operacioni Althea etj.*).

Gjithashtu ndërmjet BE-së dhe OKB-së ekziston një bashkëpunim i ngushtë sepse ndajnë të njëjtat vlera dhe qëllime për sigurimin e rendit ndërkombëtar. Bashkimi Evropian njihë përparësinë e OKB-së në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare dhe vepron në përputhje me parimet e Kartës së OKB-së Statutin e GJND-së dhe Rezolutat e Këshillit të Sigurimit, të cilat paraqiten si korniza ligjore udhëzuese për BE-në në marrëdhëniet e saj të jashtme. OKB-ja njihë Bashkimin Evropian si një partner i dobishëm dhe një organizatë rajonale nëpërmjet kontributit të tij në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare në kuadër të zbatimit të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit. Nisja e një operacion ushtarak të BE-së nën mandatin e OKB-së bëhet në bazë të dy modeleve kryesore *bridging model* dhe *stand-by model* (*operacioni ushtarak Althea, operacioni i Darfurit, misioni Artemis*).

Një sërë operacionesh janë ndërmarrë nga BE-ja në përputhje me Rezolutat e Këshillit të Sigurimit si, operacioni EUFOR TCHAD, misioni EUROPOL në Afganistan, Irak, Kosovë dhe Guinea-Bissau. Ka gjithashtu një konkurrencë ndërmjet BE-së dhe OKB-së dhe dëshira për të vepruar si një aktor global ka bërë që një sërë misionesh të Bashkimit Evropian të merren pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit. Kështu misionet EUPM në Bosnje, Operacioneve Concordia dhe Proxima në Maqedoni, misionin EUJUST THEMIS në Irak, EUPOL KINSHASA dhe misionin EUJUST LEX në Gjeorgjia janë të gjitha misione të filluar pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit. Raste përplasjeje ka patur edhe ndërmjet NATO-s dhe BE-së p.sh, në konfliktin e *Darfurit*, në Qipro, në misionin *Artemis*, në këtë mision BE-ja nuk është konsultuar me NATO-n para nisjes së saj.

Bashkimi Evropian është aktor në ndërmjetësimin e konflikteve ndërkombëtare, ai ka arritur të ndërmjetësojë në mënyrë të suksesshme në një sërë konfliktesh. Ka një sërë aktorësh që ndërmjetësojnë në emër të bashkimit Evropian ndër të gjithë mund të evidentojmë Përfaqësuesin e Posaçëm për një zonë konflikti. Bashkimi Evropian ka rezultuar i suksesshmën në ndërmjetësimin e konfliktit të Kosovë dhe Serbi (dialogu i nivelit të lartë), në Bosnjë-Hercegovinë, Qipro, Gjeorgji, Sudan, Burundi, Kurdëve të Turqisë, konflikteve të zgjatura dhe të dhunshme si në Irlandën e Veriut, në nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet Indisë dhe Pakistanit, të Haitit, Koresë së Veriut etj.

Bashkimi Evropian është një aktor ndërkombëtar sepse pavarësisht disfatave dhe dështimeve, kontributi historik për paqen dhe sigurinë në Evropë është i pamohueshëm. Në bazë të studimeve të ndryshme Bashkimi Evropian (në terma sasiorë) është një nga ofruesit më të rëndësishëm të operacioneve të paqes, në krahasim me organizata të tjera rajonale. Rasti më i suksesshëm i BE-së në zgjidhjen e konflikteve ka qënë në konfliktin Aceh.

Bashkimi Evropian është një aktor për zgjidhjen e konflikteve sepse ai ka vepruar si asistent për menaxhimin e kufijve, si këshilltar në reformën në drejtësi, si një trajner i policisë dhe stafit të burgut, si një reformator i sektorit të sigurisë, si një paqeruajtës me ftesën e një vendi pritës, si një organizatë rajonale, nën mandatin e Këshillit të Sigurimit etj.

7.2. Rekomandime

Referuar konkluzioneve të mësipërme, rritja e rolit të Bashkimit Evropian në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare kërkon marrjen e reformave të thella institucionale dhe ligjore. Roli i Bashkimit Evropian mund të rritet vetëm nëpërmjet përfshirjes së PJSP-së dhe PSMP-së në traktatet e ardhshme reformuese në metodën komunitare, në këtë kuadër rekomandohet marrja e masave të mëposhtme:

Rekomandimi 1. Kalimi i PJSP-së dhe PSMP-së në të drejtën komunitare. Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët është pjesë e bashkëpunimit ndërqeveritar e rregulluar në Traktatin mbi Bashkimin Evropian. Rekomandohet marrja e masave që personifikojnë kalimin e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët nga metoda ndërqeveritare në metodën komunitare të vendimmarrjes dhe kapërcimi i pengesave për bashkëpunim ndërmjet Shteteve Anëtare. Roli i Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare do të përforcohet vetëm nëse PJSP-ja nuk do të varet më nga vullneti politik i Shteteve Anëtare por të vendoset me konsensus nga institucionet e Bashkimit Evropian.

Propozimi: Përfshirja e *TITULLI-it V. “Dispozita të Përgjithshme për Veprimin e Jashtëm të Bashkimit dhe Dispozita të Veçanta për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurimit”* në Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian.

Rekomandimi 2. Parashikimi i zgjidhjes së konflikteve si një paragraf më vete në objektivat e veprimit të jashtëm të BE-së. Zgjidhja e konflikteve është përmendur shkurtimisht vetëm në një dispozitë të TBE-së në nenin 21/2, paragrafi c, me qëllim rritjen e rolit të Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare propozohet shtimi i një paragrafi tjetër, pas paragrafit c, referuar në mënyrë të veçantë zgjidhjes së konflikteve ndërkombëtare nga Bashkimi Evropian. Në këtë mënyrë zgjidhja e konflikteve ndërkombëtare kthehet një objektiv i detyrueshëm për Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian.

Propozimi: Neni 21/2,⁶⁵⁸: Bashkimi Evropian përcakton dhe ndjek politika dhe veprime të përbashkëta dhe punon për një shkallë të lartë bashkëpunimi në të gjitha fushat e marrëdhënieve ndërkombëtare, në mënyrë që:

... c) të ruajë paqen, ~~të parandalojë konfliktet~~ dhe të fuqizojë sigurinë ndërkombëtare, në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, me parimet e Aktit Përfundimtar të Helsinkit dhe me qëllimet e Kartës

⁶⁵⁸ Neni 21/2, TBE: Bashkimi Evropian përcakton dhe ndjek politika dhe veprime të përbashkëta dhe punon për një shkallë të lartë bashkëpunimi në të gjitha fushat e marrëdhënieve ndërkombëtare, në mënyrë që:

(a) të mbrojë vlerat, interesat themelore, sigurinë, pavarësinë dhe integritetin e tij;

(b) të konsolidojë dhe mbështesë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare;

(c) të ruajë paqen, të parandalojë konfliktet dhe të fuqizojë sigurinë ndërkombëtare, në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, me parimet e Aktit Përfundimtar të Helsinkit dhe me qëllimet e Kartës së Parisit, duke përfshirë edhe ato që lidhen me kufijtë e jashtëm; traktati i bashkimit evropian

(d) të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor të vendeve në zhvillim, me qëllim kryesor zhdukjen e varfërisë;

(e) të nxisë integrimin e të gjitha vendeve në ekonominë botërore, duke përfshirë edhe përmes heqjes progresive të kufizimeve mbi tregtinë ndërkombëtare;

(f) të ndihmojë përgatitjen e masave ndërkombëtare për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe administrimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore botërore, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm;

(g) të mbështetë popujt, vendet dhe rajonet të cilat përballen me fatkeqësi të shkaktuara nga natyra ose njeriu; dhe

(h) të promovojë një sistem ndërkombëtar të mbështetur mbi një bashkëpunim shumëpalësh më të fuqishëm dhe qeverisje globale të mirë.

së Parisit, duke përfshirë edhe ato që lidhen me kufijtë e jashtëm. *(Të shtohet si paragraf më vete), ndryshohet në:*

ç) të parandalojë konfliktet ndërkombëtare, të menaxhojë konfliktet ndërkombëtare dhe të zgjidhë konfliktet ndërkombëtare në përputhje me parimet e të drejtës ndërkombëtare publike dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Rekomandimi 3. Aktet legislative dhe juridiksioni i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë mbi Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët: E drejta detyruese e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët, kryesisht në të drejtën dytësore të saj që përfshin 2 instrumentet e PJSP-së, *veprimet e përbashkëta dhe qëndrimet e përbashkëta*, të përfshijë katër instrumente të përcaktuara në Traktatin e Lisbonës. Instrumentet ligjore si: vendimet e Këshillit, veprimet e përbashkëta, strategjitë e përbashkëta dhe qëndrimet e përbashkëta propozohen të përafrohen me natyrën juridike që parashikon e drejta komunitare e ngjashme me rregulloret dhe direktivat.

